RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
(Auditim përputhshmërie)

në
KOMISIONERIN PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Tetor 2021

Nr Përmbajtja **Faqe**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE
1. Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit 3
2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve 3
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit 14

II. HYRJA 18
a) Objektivat dhe qëllimi
b) Identifikimi i çështjes
c) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese
d) Përgjegjësitë e audituesve
e) Kriteret e vlerësimit
f) Standardet e auditimit
g) Metodat e auditimit
h) Dokumentimi i auditimit

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT 18
Drejtimi 1: Zbatimi i detyrimeve ligjore nga ana e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përputhje me përcaktimet e nenit 11 e në vijim, të ligjit nr. 152/2013 ñpër nëpunësit civilëò, i ndryshuar. 19
Drejtimi 2: Organizimi dhe funksionimi i Sekretariatit të KMSHC. Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm 58
Drejtimi 3: Çështje të auditimit financiar 69
a. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit 69
b. Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe dispozitave ligjore për pagat e punonjësve. 75
c. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare; 80
d. Prokurimet e fondeve publike: 86
e. Auditimi i llogarive vjetore të institucionit, etj. 102
Drejtimi 4: Të tjera nga auditimi 108
IV. GJETJE DHE REKOMANDIME 114
VI. ANEKSE 127

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Mbështetur në ligjin 154/2014 datë 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe funksionimin e KLSHò, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 157/1, datë 26.01.2021, i ndryshuar, në Komisionierin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, gjatë periudhës 02.02.2021-03.05.2021, për periudhën e auditimit 01.01.2017 deri në 28.02.2021, u krye auditim Përputhshmërie. Grupi i auditimit, për të realizuar objektin e auditimit, për dhënien e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së KMSHC-së, auditoi drejtimet kryesore, nëse janë paraqitur saktë, në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.

Misioni i KMSHC-së është që në mbështetje të Kushtetutës, Ligjit Nr. 152/2013, ñPër nëpunësin civilò, i ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë në bazë e për zbatim të tij, të garantojë mbizotërimin e ligjit (zbatimin e ligjshmërisë) në administrimin e shërbimit civil (përgjatë procedurës së pranimit, emërimit, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, transferimit, pezullimit, vlerësimit, procedurës disiplinore, formimit profesional të thelluar dhe formimit profesional të vazhdueshëm, të drejtat dhe detyrimet e nëpunësit civil, përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil), në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë (institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore), me qëllim që ky proces të jetë i ndershëm, objektiv, i paanshëm dhe transparent.

Ky auditimi i përputhshmërisë ka për qëllim që në kuptimin që i njeh ligji nr. 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, të kryejë një vlerësim objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e vlerësimit).

Me shkresen nr. 157, date 14.09.2021, KLSH ka derguar në subjekt projekt raportin, mbi auditimin e përputhshmërisë në KMSHC.

2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr	Përmbledhje e Gjetjes	Referenca me Raportin Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
1	Problematika lidhur me planifikimin e mbikqyrjeve/inspektimeve të kryera nga KMSHC që kanë konsistuar në: përzgjedhjen e institucioneve e cila bazohet në indikatorë të tillë si regjistri i ankesave/informacioneve të qytetarëve, dhe raporteve të mbikëqyrjeve orientuese, por pa dokumentuar një metodologji të caktuar në bazë risku shoqëruar; në planin e vitit **2019** dhe **2020**, tek monitorimet/inspektimet e përgjithshme, nuk rezultojnë të jenë përcaktuar qartësisht subjektet e përfshira në monitorim, pasi në plan është përcaktuar se mbikëqyrja do të realizohet për institucionet në varësinë e disa ministrive, por jo saktësisht se kush do jenë këto institucione; nuk janë hartuar	20-90	E mesme	KMSHC të hartojë dhe dokumentojë procedurat e ndjekura/metodologjinë për përzgjedhjen e institucioneve objekt inspektimi/mbikëqyrjeje, në mënyrë që të evidentohet qartë ky proces, duke përfshire në të analiza të kryera mbi bazë risku për institucionet e përzgjedhura, mbështetur në kritere/indikatorë të tjerë si: numri i pozicioneve të punës në shërbimin civil që ka çdo institucion i mbikëqyrur, apo të dhëna të tjera, në mënyrë që të garantohet gjithë përfshirja dhe

	plane periodike 3 mujore për monitorimet/inspektimet, sikundër përcakton, neni 12 pika 2 e rregullores; në planet e hartuara dhe të rishikuara të KMSHC nuk është marë parasysh neni 1, pika 10 e rregullores, pasi në planet e vitit korrent nuk janë përfshirë mbikëqyrjet e pa realizuara në vitin paraardhës dhe janë konstatuar një sërë mbikëqyrjesh të planifikuara fillimisht, duke mos u mbartur në planet e viteve pasardhës, kanë mbetur pa realizuar.			monitorimi sa më i plotë i institucioneve publike. -KMSHC, në planin vjetor të mbikëqyrjeve/inspektimeve të reflektojë qartë dhe individualisht të gjitha subjektet e përfshira në plan (të ndara këto sipas mbikëqyrjeve të mbartura nga vitit paraardhës dhe ato të planifikuara rishtaz për vitin korrent), si dhe të reflektojë në këtë dokument ndryshime sa herë të diktohen nga nevoja e institucionit. -Komisioneri të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me qëllim analizën dhe verifikimin e zbatueshmërisë së çështjeve që lidhen me planet periodike (3 mujore) apo të tjera lidhur me planifikimin, duke identifikuar nivelin e zbatueshmërisë së tyre dhe shkaqet që kanë çuar në mos aplikimin e disa prej kërkesave të rregullores, në lidhje me këtë proces.
2	Në rregulloren "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr.17, datë 11.03.2015 të Komisionerit të KMSHC, janë përshkruar hollësisht procedurat dhe dokumentacionet që do të hartohen për mbikqyrjet/inspektimet "e përgjithshmeë, ndërsa për mbikqyrjet/inspektimet "orientueseë, dhe ato "tematikeë, numri i të cilave është rritur ndjeshëm vitet e fundit, ka munguar rrjedha e dokumentuar e proceseve nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to, përfshirë këtu dokumentacionin, raportimin dhe sistemimin e mbajtjes së dosjeve; struktura në fuqi është miratuar me Vendimin nr. 18, datë 11.03.2015. Edhe pse referuar rregullores dhe strukturës organizative të KMSHC, ekziston një ndarje për kryerjen e "inspektimeveë nga Drejtoria e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ dhe "mbikëqyrjeveë nga Drejtoria e Mbikëqyrjes, në praktikë rezultoi se këto drejtori kanë funksionuar si një e vetme duke mbivendosur detyrat e njëra tjetrës; Mungesa e gjurmëve të auditimit për këto procese të rëndësishme të KMSHC-së, nuk ka siguruar dokumentimin e operacioneve në formë të tillë që tëu mundësojë audituesve të brendshëm, të	20-90	E mesme	-KMSHC të marrë masa për të miratuar gjurmët e auditimit, të detajuara për aktivitetet kryesore të institucionit duke siguruar që të gjitha operacionet e njësisë publike të dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm si dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit të KMSHC. Veçanërisht të merren masat për të reflektuar sa më sipër në rregullore, duke parashikuar proceset e punës që do të ndiqen për kategoritë e tjera të mbikqyrjes/inspektimeve që institucioni kryhen, të ndryshme nga ato të përgjithshme, me qëllim përgatitjen e hartës së proceseve të punës duke i unifikuar këto procedurave sipas dokumenteve standarde, të zbatueshëm nga inspektorët si gjurmë të punës së kryer. - Në kushtet kur aktiviteti i KMSHC-së ka pësuar ndryshime nga viti në vit, diktuar këto edhe nga nevojat e institucioneve subjekt

	jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit, në kundërshtim kjo me nenin 16, të ligjit nr, 10296, datë 8.7.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar.			mbikëqyrjeje apo rekomandimet e lëna nga rezoluta e Kuvendit, dhe KMSHCS-së i është dashur që, me të njëjtin staf inspektorësh, të mbulojë një gamë më të gjerë aktivitetesh, **rekomandojmë** rishikimin e strukturës në drejtim të shtimit të stafit ï inspektorë, dhe ri-organizimin e punës brenda secilës drejtori të mbikëqyrjes dhe inspektimit, me qëllim ndarjen dhe realizimin e detyrave sikundër parashikohen ne rregullore.
3	Numri i mbikëqyrjeve ñtë përgjithshmeò, ka patur një rënie nga viti 2017 në 2020 si në planifikim dhe në realizim, krahasuar me vitet e mëparshme dhe ndërsa numri i mbikëqyrjeve të përgjithshme është ulur, numri i mbikëqyrjeve dhe inspektimeve ñtematikeò dhe ñtë orientuaraò ka ardhur në rritje dhe ka përfshirë jo vetëm çështje të iniciuara nga denoncime por edhe të tjera shtesë . KMSHC ka operuar në mungesë të një sistemi informacioni (qoftë edhe në formën e një regjistri/databaze të kategorizuar sipas llojit të inspektimeve/mbikëqyrjeve të kryera për çdo vit), në mënyrë që të ndiqet realizimi i tyre në kohë, dhe që tô sigurojë drejtuesve informacion rregullisht mbi arritjen e objektivave të njësisë dhe progresi drejt arritjes së objektivave është i vështirë për tô monitoruar rregullisht si dhe për tô analizuar shkaqet që mund të çojnë në mosrealizimin e tyre.	20-90	E mesme	-KMSHC, të marë masat për hartimin e një regjistri ku të evidentohen të gjitha inspektimet dhe mbikëqyrjet e kryera të ndara sipas kategorive dhe sipas planit të çdo viti, në mënyrë që të bëhet e mundur ndjekja e vijueshmërisë së vendimeve të lëna nga Komisoneri për mbikqyrjet dhe inspektimet respektive. -Në rregulloren e brendshme të KMSHC, në lidhje me këtë proces, të parashikohen procedurat që do të ndiqen dhe personat përgjegjës për ruajtjen dhe administrimin e të dhënave zyrtare të aktivitetit të institucionit.
4	Mangësi në drejtim të dokumentimit të punës së bërë nga KMSHC në vijim të zbatimit të **rekomandimit të lënë në rezolutat e Kuvendit**[1] për përmbylljen e veprimeve për administrimin e të dhënave që kanë të bëjnë me rikthimin e nëpunësve civilë gjyqfitues në detyrë, në të gjithë sistemin e shërbimit civil, me qëllim evidentimin e arsyeve që pengojnë ecurinë e këtij procesi dhe vijimit të procesit të hetimit administrativ në lidhje me rastet individuale, të konstatuara në shkelje të ligjit. Ky proces ka nisur në vitin 2018 me urdhrin nr. 589, datë 01.08.2018, të Komisionerit dhe në vijim, me urdhrin nr. 10, datë 21.01.2019, të Komisionerit parashikohet të fillojë **hetimi administrativ** për çdo rast të konstatuar	20-90	E mesme	KMSHC, në vijim edhe të detyrave të lënë nga Rezoluta e Kuvendit të marrë masat për intensifikimin e punës nëpërmjet një roli më aktiv në drejtim të problematikës lidhur me nëpunësit gjyqfitues civil në listë pritjeje në të gjithë sistemin e shërbimit civil, nëpërmjet hartimit dhe miratimit të rrjedhës së dokumentuar të aktiviteteve që lidhen me mbikëqyrjet orientuese dhe hetimit administrativ (ne veçanti në lidhje me proceset gjyqësore), nga fillimi deri në përfundim të tyre, i cili duhet të synojë të përshkojë të gjitha veprimtaritë

[1] Publikuar gjithashtu ne faqe zyrtare të KMSHC: http://www.kmshc.al/raportimi-vjetor-per-kuvendin/ (fq 12, 126, 158 e Raportit te vitit 2019; 101, 128 e Raportit te vitit 2020)

	në shkelje të ligjit, akt i cili i ka shtrirë efektet e tij edhe gjatë vitit 2020. Për këtë proces të rëndësishëm por edhe sensitiv, në KMSHC nuk është hartuar dhe miratuar rrjedha e dokumentuar e aktiviteteve nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to (gjurma e auditimit). Në lidhje me procesin e monitorimit dhe hetimit administrativ për çështjet e mësipërme që lidhen me vendimet gjyqësore: Ka munguar gjurma e auditimit, dhe Ka munguar evidenca e mjaftueshme dhe përkatëse dhe **grupi i auditimit nuk jep siguri të arsyeshme mbi efektivitetin e këtij procesi dhe impaktin e tij në përmirësimin e situatës.** Pavarësisht se kjo detyrë e lënë nga rezoluta e Kuvendit, në raportet vjetore të KMSHC është raportuar si ñe realizuar plotësishtò, numri i vendimeve të pa ekzekutuara dhe i gjyqfituesve në listën e pritjes për sistemim në pozicionet e punës, vijon të mbetet i lartë dhe një dosje e vetme e vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, mbi realizimin e kësaj detyre, nuk është përfaqësuese për procesin në tërësi. Ndërsa rezultoi se, databaza e përgjithshme e rekordeve historike që përfshin aktet e largimit nga shërbimi civil të gjyqfituese, e rekomanduar për tô zbatuar nga Kuvendi, është ende në proces plotësimi të dhënash, dhe si rezultat platforma administrata.al vijon të mos jetë funksionale.			individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Pas miratimit të gjurmës së auditimit, KMSHC, të marrë masa për kryerjen dhe dokumentimin sa i takon punës mbikëqyrëse *për rastet individuale të konstatuara në shkelje të ligjit për proceset e rikthimit të nëpunësve civilë gjyqfitues në detyrë, si dhe finalizimin me sukses të databazës së përgjithshme të rekordeve historike, ku të përfshihen aktet e largimit nga shërbimi civil të gjyqfituesve, sikundër kërkuar në Rezolutën e Kuvendit.* Sa më sipër me kontribut në minimizimin e efekteve negative në buxhet si pasojë e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për largimet e padrejta të punonjësve nga puna.
5	Procedurat e rekrutimit dhe largimit nga puna në shërbimin civil janë pjesë e përhershme e çdo plani vjetor/periodik të mbikëqyrjes/inspektimit, nëpërmjet kryerjes së mbikëqyrjes së orientuar konceptuar nga Komisioneri për tô kryer online nëpërmjet mbledhjes së informacionit në drejtim të funksionimit të procedurave të konkurrimit planifikuar nga Departamenti i Administratës Publike, duke përfshirë pranimin në nivelin ekzekutiv në shërbimin civilë, lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në trupën e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues (TND). Në një vit të caktuar ka patur një tentativë për pjesëmarrjen e grupeve nga ana e KMSHC në këto procedura, për të cilin ka munguar gjurma e auditimit, në vijim (për vitet 2019,2020) nuk është proceduar më në këtë formë. Plotësimi i vendeve të punës në mënyra	20-90	E mesme	KMSHC të shqyrtojë mundësinë për të zgjeruar fushën e veprimit të saj në kuadër të mbikqyrjes së procesit të rekrutimit dhe largimit nga puna pranë DAP, duke mos u bazuar vetëm në verifikimet online të procedurave, por duke përfshirë edhe monitorimin e plotësimit të vakancave në mënyra alternative; pjesëmarrjen e grupeve të punës nga KMSHC në disa procedura të përzgjedhura me bazë risku; përfshirjen në raportin vjetor të kësaj mbikqyrjeje të problematikave kryesore të konstatuara në vijim të ankesave të përcjella nga pjesëmarrësit gjatë procesit

	alternative nga ana e DAP (i cili përfshin edhe sistemimin e gjyqfituesve në pozicione vakante), nuk është objekt mbikëqyrjeje nga ana e KMSHC, dhe këto evidenca raportohen vetëm statistikisht sipas të dhënave të DAP. Edhe pse pjesë e veprimtarisë institucionale është verifikimi i një numri të konsiderueshëm të ankesave/informacioneve të përcjella lidhur me procedurat e konkurrimit kryer pranë DAP, ky proces rezulton të kryhet në mënyrë të pavarur nga KMSHC si inspektime tematike. Si rezultat në raportin vjetor të përcjellë pranë DAP nuk përfshihen konstatimet që kanë rezultuar nga verifikimi i inspektimeve tematike mbi procedurat e konkurrimit, për tâu bërë pjesë e konkluzionit përfundimtar dhe rekomandimeve të lëna për mbikëqyrjen e procedurave të rekrutimit dhe largimit nga puna të punonjësve në shërbimin civil.			dhe rekomandimeve të lëna për rastet respektive; për garantimin e një roli sa më aktiv të mbiqkyrjes së institucionit në procedurat e rekrutimit dhe largimit nga puna në shërbimin civil.
6	Sipas nenit 2, pika 2.j e Rregullores së Procedurave të Mbikëqyrjes/Inspektimit, pjesë e fushës së veprimit të KMSHC është mbikëqyrja e zbatimit të detyrave të lëna nga mbikëqyrjet e mëparshme, duke kryer **mbikëqyrje/inspektim në vazhdim**. Në vijim, në nenin 35, të kësaj rregulloreje përcaktohen më hollësisht procedurat që ndiqen nga institucioni për zbatimin e vendimeve dhe afatet përkatëse, konkretisht: Megjithatë, mbetet e paqartë se si KMSHC ndjek procesin e verifikimit të vendimeve, në kushtet kur nuk ka iniciuar kryerjen e ndonjë mbikëqyrjeje/inspektimi për të kontrolluar zbatimin e vendimit nga subjekti i mbikëqyrur/inspektuar, por thjesht duke mbetur në pritje të njoftimit nga ana e s*ubjektit të mbikëqyrjes/inspektimit/verifikimit apo hetimit* administrativ për korrigjimin e shkeljeve brenda afatit të përcaktuar dhe, paraqitjes së provave që vërtetojnë këtë fakt. Gjithashtu rezultoi se, KMSHC ka dalë me vendime përmbyllëse, vetëm kur për të gjithë rastet individuale të përmendura në vendim, situata është përmirësuar. Për ato raste kur brenda të njëjtit vendim disa raste individuale janë zbatuar, dhe të tjerat jo, në përfundim të afateve, KMSHC **nuk ka** dal me vendim përmbyllës, ku të cilësojë sa prej tyre janë zbatuar, sa nuk janë zbatuar dhe sa janë në proces; si dhe **nuk** ka ngritur mekanzima për të ndjekur ecurinë më tej të zbatueshmërisë së tyre të plotë. Në gjykimin e pavarur të audituesit, monitorimi në këtë formë (pra duke	20-90	E mesme	KMSHC, të marë masa për hartimin dhe miratimin e procedurave të detajuara që do të duhet të ndiqen për verifikimin e zbatimit të vendimeve të KMSHC edhe në nivel rastesh individuale, për të garantuar përmirësimin e situatës brenda afateve të parashikuara; rikërkimin e zbatimit të tyre dhe analizën e shkaqeve në rastet e moszbatimit, kjo në funksion të misionit të institucionit në zbatim të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil.

	raportuar në nivel vendimi vetëm) nuk mundëson identifikimin e rasteve individuale të pazbatuara me qëllim ndjekjen deri në zbatimin e plotë të tyre, nëpërmjet aplikimit të gjobave respektive në rast të moszbatimit të masave, në përputhje me nenin 15, të ligjit nr. 152/2013 ñPër nëpunësin civilò, i ndryshuar.			
7	Nga auditimi mbi vlerësimin e funksionimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm rezultoi se: - në KMSHC nuk është hartuar plani i trajnimeve për periudhën objekt auditimi. Gjithashtu nuk janë kryer trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik në fushën e Menaxhimit të Riskut dhe atë të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, në kundërshtim ke kërkesat që burojnë nga Ligji Nr. 10296, datë 8.7.2010, ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar. - Regjistri i Riskut është kryer çdo 2 vite, konkretisht në 2016 me nr. prot. 869/1, datë 30.12.2016; në vitin 2018 me nr. prot. 358/6, datë 12.10.2018; dhe në vitin 2020 me nr. prot. 652/1, datë 01.09.2020. Rezultoi se risqet e parashtruara në këto dokumente kanë të njëjtin koeficient vlerësimi (i njëjtë për të tre vitet), konfirmuar si procedohet si dhe cilët janë zotëruesit e risqeve por vihet re se, nuk janë parashikuar masa konkrete për tû ndërmarrë nga personat përgjegjës sipas drejtorive, në mënyrë që të bëhet adresimi i risqeve dhe ndjekja e tyre (gjurmimi). - në KMSHC nuk është kryer asnjë shërbim i auditit të brendshëm, i cili ka për qëllim të ofrojë siguri objektive dhe këshillim për drejtimin e institucionit, si dhe të ndihmojë njësinë publike për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike. Kjo pasi KMSHC nuk ka në strukturën organizative, një strukturë të dedikuar për kryerjen e këtij shërbimi.	94-103	E mesme	-Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil të marrë masa që për periudhën në vijim, të kryhet hartimit dhe zbatimi i planit të trajnimeve për stafin si dhe të kryhen trajnime veçanërisht për GMS-në në fushën e Menaxhimit financiar dhe Kontrollit si dhe Menaxhimit të Riskut. -Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil të marrë masa për ngritjen e grupit të punës me qëllim identifikimin dhe vlerësimin e risqeve me qëllim marrjen e masave për ndjekjen dhe adresimin e tyre, në funksion të realizmit të objektivave të njësisë. - Si institucion që kryen funksione publike, KMSHC duhet të marrë masa të sigurojë kryerjen e shërbimit të auditimit të brendshëm, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. Nr. 114/2015 ñPër Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publikò, ose nëpërmjet krijimit të një njësie të dedikuar brenda strukturës organizative të institucionit, ose nga njësia e auditimit të brendshëm e një njësie tjetër publike, në bazë të një marrëveshjeje ndërmjet titullarëve të njësive publike përkatëse, e cila duhet të miratohet paraprakisht nga Ministri i Financave, sa më sipër me qëllim dhënien e sigurisë së arsyeshme për titullarin e njësisë së sektorit publik, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshillimit për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë e sektorit publik.

8	Nga auditimi rezultoi se, për periudhën objekt auditimi, nga buxheti i KMSHC janë likuiduar fonde për shpenzime përmbarimore, për ekzekutimin e 4 vendimeve gjyqësore në shumën 1,311,349 lekë. Prej vitit 2017 e në vijim KMSHC ka likuiduar në total 19,038,985, fonde të cilat lidhen më 5 vendime gjyqësore (prej vitit 2015 e në vijim). Pagesat e kryera për likuidim të vendimeve gjyqësore dhe ato përmbarimore, përbëjnë menaxhim jo efektiv të fondeve buxhetore. Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mbylljes së institucionit Komisionit të Shërbimit Civil, në nëntor të vitit 2014, të krijuar sipas ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, ñStatusi i nëpunësit civilò.	110-116	E mesme	Drejtoria Juridike, në vijim të marrë masa të monitorojë me përgjegjësi ecurinë e vendimeve gjyqësore me qëllim shmangien e kostove shtesë me impakt në buxhet. Për raste të vendimeve të formës së prerë, të merren masa që të njoftohet në kohë sektori i financës me qëllim planifikimin e fondeve dhe shmangien e kostove të mëtejshme si pasojë e vonesave.
9	Nga auditimi rezultoi se, procesi i inventarizimit për vitin 2020 nuk është realizuar nga KMSHC. Në kushtet kur ky proces synon ndër të tjera, të evidentojë gjendjen fizike të aktiveve dhe krahasimin e tyre me gjendjen kontabël, moskryerja e tij cënon dhënien e sigurisë së arsyeshme mbi plotësinë dhe saktësinë e vlerës së zërave të aktiveve të pasqyruar në kontabilitet si dhe mbi ekzistencën e tyre.	118-121	E mesme	Në kushtet kur moskryerja e inventarizimit ka pasur si shkak kryesor situatën e krijuar prej Covid 19, rekomandojmë që nga ana e Komisionerit të merren masa që ky proces të kryhet menjëherë në funksion të ruajtjes dhe mbrojtjes së aktiveve në pronësi të KMSHC.
10	-Referuar autorizimit Nr. 1460/5, datë 20.09.2019, të KMSHC, rezultoi se punonjësi A.Sh. ka përfituar dieta për udhëtime nga Tirana për në Has, Kukës, Dibër, Bulqizë, Mat dhe Klos në datat 23.09.2019 ï 27.09.2019, ku ndërkohë për të njëjtën periudhë, sipas autorizimit Nr.1460/1, datë 20.09.2019, i njëjti punonjës rezulton të ketë qenë pjesë edhe e grupit të punës të autorizuar për të shkuar me shërbim nga Tirana në Vorë, Shijak, Divjakë, Lushnjë, praktikë për të cilën edhe është paguar. Në vijim, referuar edhe observacioneve të vetë subjektit konstatojmë se, Drejtori i *Mbikëqyrjes gjendet në disa Autorizime të nxjerra nga Komisioneri njëkohësisht dhe se prioriteti se në cilin destinacion do shkojë Drejtori në këto raste, vendoset sipas orientimeve të dhëna nga Komisioneri, si dhe problematikave të ndryshme që mund të hasen nga grupet e punës në subjektet përkatëse. Vendosja e drejtorit të mbikëqyrjes në disa autorizime njëkohësisht, për të njëjtat periudha kohore, jo vetëm nuk gjen mbështetje ligjore, po gjithashtu krijon konfuzion dhe hapësira për abuzime. Për më tepër që vetë drejtori firmos listëprezencën për punonjësit në shërbim.* *Në këto kushte, grupi i auditimit me qëllim marrjen e evidencës së besueshme dhe*	122-124	E mesme	

	relevante për këtë çështje kërkon vënien në dispozicion nga ana e KMSHC, të urdhër-shërbimeve për rastet e konstatuara për grupin e inspektimit përfshirë edhe Drejtorin e Drejtorisë së Mbikëqyrjes, me qëllim mbërritjen në një konkluzion të mbështetur.			
11	Për procedurën e prokurimit ñkërkesë për propozimò me REF-08452-04-24-2017, me objekt ñ**Blerje mobiljesh dhe orendi zyre"**, dhe fond limit prej **2,322,222** leke, nuk është kryer studim tregu. Për këtë procedurë, rezultoi se, pas hapjes së ofertave, kanë marrë pjesë 3 OE, nga të cilat ofertat e paraqitura nga 2 operatorët ekonomik kanë qenë në vlerën 1,254,000 lekë dhe 1,203,000 lekë pa TVSh dhe oferta fituese ka qenë në vlerën 2,224,000 lekë pa TVSh, çka tregon se nuk është kryer studimi i duhur i tregut, duke shkaktuar efekte negative financiare si pasojë e menaxhimit pa efektivitet, efiçencë dhe ekonomicitet të fondeve publike. Këta operatorë nuk janë sô kualifikuar si oferta anomalisht të ulëta, por si OE që nuk kanë përmbushur kriteret e veçanta. Në vendosjen e kritereve të veçanta të kualifikimit, pika **3.3** kapaciteti teknik dhe profesional: është kërkuar një punonjës arkitekt dhe licenca profesionale e ushtrimit të aktivitetit. Vendosja e një kriteri të tillë, siç është licenca e ushtrimit të aktivitetit të arkitektit, është një kriter i diskriminues dhe jo i barabartë sepse objektet e kërkuara për prodhim nga AK, janë të dizenjuara e të specifikuara nga një arkitekt i jashtëm i AK dhe kriteri i lejes së ushtrimit të profesionit në këtë pikë vlerësohet se është i panevojshëm, duke e konsideruar si një nga kriteret diskriminues të operatorëve ekonomik. *Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*	125-145	E lartë	-Titullari i institucionit të marrë masa që me grupe të veçanta të analizojë situatën, shkaqet të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa e nevojshme, për sa konstatuar më sipër. -Në çdo rast, grupet e përllogaritjes së specifikimeve teknike në KMSHC, të respektojnë rregullat e hartimit të DST të tenderit, me qëllim që këto të fundit të mundësojnë një trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit.
12	Nga auditimi i procedurës së prokurimit ñkërkesë për propozimò, me objekt "Blerje pajisje elektronike", dhe fond limit 931.667 lekë, konstatuam mungesë në studimit të tregut, për nevoja të përllogaritjes së fondit limit. Rezulton se fondi limit nuk është përllogaritur duke studiuar tregun apo mbi burime të dhënash të cilat do të ndihmonin në përllogaritjen më të saktë të fondeve, por është bërë duke u bazuar vetëm në përvojën e mëparshme dhe duke marre oferta nga 3 OE, për më tepër kur këto 3 OE rezultojnë	125-145	E lartë	-Titullari i institucionit të marrë masa që me grupe të veçanta të analizojë situatën, shkaqet të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa e nevojshme, për sa konstatuar më sipër. -Në të gjitha rastet në vijim, grupet respektive në KMSHC, përgjatë përllogaritjes së fondit limit të vlerësojnë dhe argumentojnë me kujdes përzgjedhjen e alternativave që

	të kenë marrë pjesë në këtë tender, duke mbartur risqe që k*ëta operatorë të kenë një informacion paraprak mbi çmimin që do tenderohet*. Gjithashtu rezultoi se, në kriteret e vendosura nga AK, pika **2.3** Kapaciteti teknik kërkon që *OE:* - *duhet të paraqesë çertifikatën ISO 9001:2008 për sistemet e menaxhimit të cilësisë.* - *të kenë minimumi **3** punonjës të punësuar, nga të cilët **2** punonjës, me profesion inxhinier elektronik ose informatik ose telekomunikacioni* sipas DST (fq.80-82), Sa më sipër, të pa shoqëruar me fjalët ñ***ose ekuivalent i tij/saj'', duke mos stimuluar pjesëmarrjen në kundërshtim me*** **nenin 46**, pika 3 të LPP. Këto çertifikata janë gjithmonë subjekt i përmirësimeve në bazë të direktivave të reja që dalin për përmirësimin e cilësisë dhe shërbimeve, por gjithmonë pa ndryshuar objektin e tyre. Në këto kushte nuk argumentohet se pse për procedurën e kryer në vitin 2017, është kërkuar certifikata e EN ISO e vitit 2008 për menaxhimin e cilësisë. Sa më sipër, këto të dhëna janë të paargumentuar nga AK, janë kërkesa diskriminuese duke kufizuar konkurrencën dhe janë jashtë natyrës dhe llojit të kontratës. Gjithashtu kriteri i lejes së ushtrimit të profesionit, vlerësohet se është i panevojshëm, dhe diskriminues pasi në gjykimin e pavarur të audituesit, montimi i pajisjeve dhe vendosja sipas një konfigurimi të përshtatshëm për nevojat e KMSHC, për zbatimin e kontratës nga OE, mund të kryhen edhe nga punonjës që kanë njohuri dhe janë të pajisur me licencat profesionale apo dëshmi përkatëse, sipas përcaktimeve të *nenit 28, pika 5, të vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, ''për miratimin e rregullave të prokurimit publik'', i ndryshuar.*			do tôu referohen, me qëllim rritjen e transparencës në procedurat e prokurimit. Anëtarët e njësive të prokurimit, në vendosjen e kritereve specifike për kualifikim të zbatojnë parimet që mundësojnë trajtim të njëjtë dhe jo diskriminues për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit, me qëllim rritjen e konkurrencës, ndër të tjera duke shoqëruar kriteret edhe me fjalët ñose ekuivalent i tij/e sajò.
13	Për vitin 2018, nga auditimi i procedurës së prokurimit ñkërkesë për propozimò, me objekt "Blerje pajisje elektronike", dhe fond limit 1,246,663 lekë, konstatuam se n*ë këtë praktikë nuk është bërë argumentimi mbi vendosjen e kritereve të veçanta të kualifikimit mbi certifikatat ISO, sipas shtojcave 6,7,8,9 të DST[2], si dhe nuk është argumentuar nevoja për këto kërkesa, në kundërshtim me* nenin 23,	125-145	E lartë	-Titullari i institucionit të marrë masa që me grupe të veçanta të analizojë situatën, shkaqet të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa e nevojshme, për sa konstatuar më sipër. -Në të gjitha rastet në vijim, grupet respektive në KMSHC, në <u>vendosjen e kritereve</u>

[2] *Sipas Dokumentave Standartë të Tenderit (DST), neni 10, VKM 614, datë 29.12.2004 dhe pikës 1,2,3,4, të nenit 23 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 për PP, i ndryshuar.*

	ku në përshkrimin e mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Konstatuam se, Autoriteti Kontraktor ka vendosur specifikime teknike pa përdorur fjalët ñose ekuivalent i tij/e sajò, në kundërshtim me shkronjën óôcôô, pika 3, të nenit 23, të ligjit 9643, datë 20.11.2006, duke kërkuar që operatorët ekonomik të provojnë se zotërojnë edhe certifikatat ISO 20000-1:2011, mbi óôMenaxhimin e shërbimitôô, ISO 22301:2012, mbi óôsistemet e menaxhimit të vazhdimësisë së biznesitôô, ISO 9001:2008, mbi óôSistemet e menaxhimit të cilësisë, ISO 27001:2013, óômbi sistemet e menaxhimit të sigurisë informatikeôô. Sipas AK, certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga RSH. Grupi i auditimit vëren se, këto certifikata janë gjithmonë subjekt i përmirësimeve në bazë të direktivave të reja që dalin për përmirësimin e cilësisë dhe shërbimeve, por gjithmonë pa ndryshuar objektin e tyre.			specifike për kualifikim të marr masa të zbatohen parimet që mundësojnë trajtim të njëjtë dhe jo diskriminues për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit, me qëllim rritjen e konkurrencës, ndër të tjera duke shoqëruar në çdo rast kriteret edhe me fjalët ñose ekuivalent i tij/e sajò.
14	Nga auditimi rezultoi se, për vitin 2018, nga auditimi i procedurës së prokurimit ñkërkesë për propozimò, me objekt "Blerje pajisje elektronike", dhe fond limit 1,246,663 lekë, për pajisjen kompjuter Desktop, tek modeli DELL Optiplex 3050 MT në katalog nuk ishin markuar specifikimet për *"sound and speaker"*, por ky model, i verifikuar nga anëtari i Komisionit me cilësinë e ekspertit të fushës në faqen zyrtare të DELL, i përfshin të gjitha specifikimet e kërkuara. Nga ana tjetër, Operatori Ekonomik, përmes deklaratës së përmbushjes së specifikimeve teknike ka marrë përsipër përmbushjen e të gjitha specifikimeve të kërkuara në DST, si dhe pas verifikimit në SPE rezultoi se këto specifikime nga Operatori Ekonomik fitues nuk janë ngarkuar (nëse përfshihen ose jo), por ndërkohë, KVO-ja ka vlerësuar këtë operator ekonomik, edhe pse nuk i përmbushte këto specifikime, gjë e cila më pas, është sqaruar se këto specifikime do të përshkruheshin me procesverbal me lidhjen e kontratës nga Komisioni, me marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve. -Me shkresën Nr. 332/15, datë 19.06.2018, të Urdhrit Nr. 56, datë 19.06.2018 është	125-145	E lartë	-Titullari i institucionit të marrë masa që me grupe të veçanta të analizojë situatën, shkaqet të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa e nevojshme, për sa konstatuar më sipër. -Në të gjitha rastet në vijim, grupet respektive në KMSHC, në vendosjen e kritereve specifike për kualifikim të marrin masa që të zbatojnë parimet që mundësojnë trajtim të njëjtë dhe jo diskriminues për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit, me qëllim rritjen e konkurrencës, ndër të tjera duke shoqëruar kriteret edhe me fjalët ñose ekuivalent i tij/e saj). Çdo etapë e procesit të prokurimit të dokumentohet në përputhje me rregullat e parashikuara sipas kuadrit ligjor dhe rregullator në fushën e legjislacionit, në përputhje me kriterin e prokurimit publik.

	ngritur Komisioni për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara nëpërmjet procedurës së prokurimit ôKërkesë për propozimõ, me objekt ôBlerje pajisje elektronikeõ, me përbërje si më poshtë: B. H. ï Kryetar, M. I., A. R., i cili më datë 25.06.2018 ka mbajtur proçesverbalin për marrjen në dorëzim të pajisjeve elektronike, bashkëlidhur të cilit gjendet fatura tatimore e shitjes, datë 25.06.2018, ku cilësohen emërtimet e pajisjeve, por vijojnë të **mos** përmendet nëse specifikimet për ñ***sound and speakers"*** janë të përfshira ose jo. - Nga auditimi rezultoi se, AK ka kërkuar që OE të ketë një inxhinier të certifikuar për serinë e serverit DELL Power Edge R710, kriter i vendosur, jo në përputhje me kërkesat e nenit 23, pika 5, të ligjit 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, ku përcakton se specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë **apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë […].** **Vendosja e një kriteri të tillë, jo ligjor mbart riskun e një procedure të paracaktuar**, ku cënohen parimet e trajtimit të barabartë, si dhe të mosdiskriminim të operatorëve ekonomik. Në përfundim të procedurës së tenderimit rezulton të jetë shpallur fituesi ôS.õ sh.p.k, njëkohësisht promovuesi i markës **Dell** në Shqipëri që prej vitit 1998[3].			
15	Për vitin 2018, nga auditimi i procedurës së prokurimit ñBlerje mobilje zyre", me fond limit **2,073,267** lekë, rezultoi se me qëllim përllogaritjen e fondit limit, AK i është drejtuar 3 OE-ve, pa marrë në konsideratë alternativave të tjera si: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj). Për më tepër kur, bazuar në ekstraktin historik në QKB, një nga 3 subjektet në fjalë , **C. shpk** me NUIS **J.....I**, në fakt **nuk** ka objekt veprimtarie tregtimin e mobilieve, pajisjeve dhe orendive për zyra, por veprimtaria e tij është: *Import eksport të lëndëve të para dhe ndihmëse për industrinë, pajisje elektromekanike, elektronike, goma të gjitha llojeve etj. Projektim dhe instalimi i pajisjeve të transmetimit (figurë dhe zë) si dhe të pajisjeve të vëzhgimit (kamera). Importimi, tregtimi, riparimi i të gjitha*	125-145	E lartë	Titullari i institucionit të marrë masa që me grupe të veçanta të analizojë situatën, shkaqet të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa e nevojshme, për sa konstatuar më sipër. Në të gjitha rastet në vijim, grupet respektive në KMSHC, duhet të respektojnë procedurën e saktë në përllogaritjen e vlerës së fondit limit, duke ju referuar alternativave të tjera si: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj), dhe jo të mjaftohet me përzgjedhjen e disa ofertave për më tepër nga OE, të cilët nuk kanë për objekt ushtrimin e aktivitetit - objekt prokurimi.

[3] sinteza-al.com

	llojeve e pajisjeve të telekomunikacionit si qendrore dhe fundore. Të projektojë e zbatoj të gjitha llojet e rrjetat lokale dhe kombëtare me pajisje telekomunikacioni si qëndrore ashtu dhe fundore etj. Në këto kushte vlera e fondit limit e përllogaritur mbi një bazë të tillë është e pasaktë dhe e pambështetur, duke rrezikuar të ketë pasoja negative në buxhetin e institucionit, për arsye të përllogaritjes së vlerës së fondit më të lartë nga vlera e tregut.			
16	Nga auditimi rezultoi se, referuar treguesve të realizimit të buxhetit për vitin 2017 vlera e llogarisë 60274 ñShpenzime për ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësoreò, rezultoi të jetë 3,094,000 lekë; Ndërkohë në Pasqyrën Financiare të Ardhura-Shpenzime kjo llogari është paraqitet në vlerën 1,441,638 lekë (ose rreth 1,652 mijë lekë më pak nga sa deklaruar në buxhet). Gjithashtu referuar treguesve të realizimit të buxhetit për vitin 2018 vlera e llogarisë 60274 shpenzime për ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësore, është 2,264,050 lekë; Ndërkohë në Pasqyrën Financiare të Ardhura-Shpenzime kjo llogari paraqitet në vlerën 567,451 lekë (ose 1,697 mijë lekë më pak nga sa deklaruar në buxhet).	145-152	E lartë	Titullari i KMSHC të marr masa për ngritjen e një grupi pune me qëllim analizimin e shkaqeve të mosrakordimit të këtyre shifrave dhe vlerësimin e impaktit që ka sjellë kjo mospërputhje në zërat kontabël të mbartur në pasqyrat financiare (më konkretisht në çeljet e viteve pasardhës). Sektori i Financës të marr masa të bëjë sistemimet e nevojshme ne kontabilitet në lidhje me reflektimin e kësaj vlerë.

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit

OPINIONI I AUDITIMIT

I. <u>Opinion i kualifikuar</u>[4] <u>për auditimin e përputhshmërisë</u>.

Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 400, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, nën gjykimin tonë, aktiviteti i MB, me përjashtim të çështjeve të trajtuara në <u>bazën për kualifikimin e opinionit,</u> ku u konstatuan shmangie nga kuadri ligjor dhe rregullator, është në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e vlerësimit, si dhe me parimet dhe rregullat e aplikueshme.

<u>Baza për kualifikimin e opinionit mbi përputhshmërinë.</u>

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin *"Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së"*, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI P 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe INTOSAI P 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare, të cilat përmenden në ISSAI-n 4000 òStandardi i Auditimit të Përputhshmërisëò. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona

[4]*-Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së", dhe MAP të KLSH-së kapitulli VII, pika 7.3.3: Opinion i kualifikuar/i cilësuar,jepet në ato raste kur është marrë siguri e arsyeshme, është siguruar një evidencë e majftueshme dhe e plotë, por janë evidentuar raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara, të cilat janë materiale, por jo të përhapura, ose kur audituesi nuk është në gjendje të mbledhë prova të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, dhe efektet e mundshme janë materiale, por jo të përhapura*

etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, përfshirë marrjen në konsideratë të risqeve të mospërputhshmërisë materiale të transaksioneve me kriteret e parashikuara.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen **e opinionit të kualifikuar të auditimit**[5] **.**

Raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara janë si më poshtë:

-Mangësi të identifikuara në përcaktimet e Rregullores ñMbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimitò, e cila është miratuar me vendim nr.17, datë 11.03.2015 të Komisionerit, pra mbi 6 vite më parë, një periudhë kjo përgjatë së cilës jo vetëm institucioni ka pësuar ndryshime në aktivitetin e tij, por edhe nevojat në institucionet e mbikqyrura për zbatimin e ligjit të shërbimit civil, kanë pësuar transformime. Si rezultat, KMSHC i është dashur të kryejë inspektime, mbikqyrje apo monitorime për çështje të veçanta, procedurat dhe dokumentacionet e të cilave nuk kanë qenë të parashikuara hollësisht në këtë akt rregullativ. Në këtë situatë, vendimmarrja e institucionit dhe procesi i punës ka vijuar rast pas rasti pa miratimin e gjurmëve të auditimit për aktivitetet respektive.

- Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes me një personel prej rreth 15 punonjësish, janë përgjegjës për të mbuluar një fushë tepër të gjerë veprimi për garantimin e mbikëqyrjes së zbatimit të përcaktimeve të ligjit për nëpunësit civil në institucionet shtetërore.

- Regjistri sipas së cilit pasqyrohen vendimet e KMSHC, nuk mundëson njohjen dhe vijueshmërinë e inspektimeve dhe vendimeve për zbatimin e vendimeve të lëna për këto inspektime, apo kategorizimin e tyre sipas llojit për të mundësuar më pas përpunuar këtë informacion për qëllime të punës institucionale, apo edhe auditimit të tyre.

-Metodologjia e përdorur për menaxhimin e këtyre të dhënave nuk dokumenton qartë procesin e përzgjedhjes së institucioneve, apo edhe monitorimin e realizimit të planit të mbikëqyrjeve apo inspektimeve sipas afateve respektive.

-Për procesin e monitorimit dhe hetimit administrativ në vijim të detyrës së lënë nga Rezoluta e Kuvendit për vendimet gjyqësore me objekt kthim në punë të ish nëpunësve civil ka munguar gjurma e auditimit, dhe ka munguar evidenca e mjaftueshme dhe përkatëse.

-Problematika të konstatuara gjatë auditimit të procedurave të prokurimit të zhvilluara nga KMSHC, në drejtim të hartimit të specifikimeve teknike, përllogaritjes së fondit limit apo vendosjen e kritereve specifike për kualifikim duke zbatuar parimet që mundësojnë trajtim të njëjtë dhe jo diskriminues.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Menaxhimi i KMSHC është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatorë në fuqi.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:

[5] *ISSAI 4000- Audituesit e sektorit publik mund të modifikojnë opinionin e tyre kur konstatohen raste të mos përputhshmërisë, të cilat nëse janë materiale po jo të përhapura rezultojnë në një opinion të kualifikuar.*

Përgjegjësia e auditimit është të shprehë një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar në rezultatet e auditimit të kryer, për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.
Audituesit e KLSH-së nëpërmjet auditimit të realizuar në këtë institucion krijuan bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare, raportimit financiar (*kriteret e auditimit financiar*) dhe shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), ku veprimet janë kryer në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi (*kriteret*), dhe që gabimet apo parregullsitë e vërejtura, nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë jo materiale dhe jo të përhapura.
Objektivi ynë lidhet me dhënien e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të MB, me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara, administrative si dhe mbi përdorimin e duhur dhe efecient të burimeve administrative të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH, kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

II. Hyrja

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñ*Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH*ò, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 157/1, datë 26.01.2021, i ndryshuar, në Komisionierin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, gjatë periudhës 02.02.2021-03.05.2021, për periudhën e auditimit 01.01.2017 deri në 28.02.2021, u krye auditim Përputhshmërie, nga grupi i auditimit me përbërje:
1- Znj. A. J. (*përgjegjës grupi*),
2- Znj. J. T., anëtar
3- Z. E. G., anëtar
4- Znj. E. M., anëtar
5- Znj. K. Sh., anëtar

a. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Auditimi i përputhshmërisë, në kuptimin që i njeh ligji nr. 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, ka për qëllim dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e vlerësimit).
Ky auditim gjithashtu, mbështetur në standardet ISSAI, ka për qëllim përcaktimin nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si p.sh. me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin; si dhe nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik, në funksion të realizimit të misionit dhe objektivave të vetë institucionit.

b. Identifikimi i çështjes

Për ushtrimin e aktivitetit, KMSHC mbështetet në Ligjin Nr.152/2013, ñPër nëpunësin civilò, dhe të gjitha aktet ligjore e nënligjore të dala në funksion të tij si dhe rregullore e udhëzime përkatëse.

Përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare në KMSHC, është realizuar në mbështetje të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 ñ*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"* i ndryshuar, dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi, në funksion të këtij ligji. Pasqyrat financiare janë dorëzuar brenda afateve të parashikuara në ligjet dhe aktet nënligjore të sipërcituara si edhe shoqërohen me relacion shpjegues (si lista e kreditorëve, e debitorëve, akt-rakordimet me sistemin e Thesarit, si edhe shpjegime të tjera sa i takon evidentimit të transaksioneve në llogaritë respektive).

c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Drejtimi i KMSHC-së është përgjegjës për përputhshmërinë e përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

d. Përgjegjësia e audituesve të KLSH:

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali material, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu dhënia e një opinioni mbi përputhshmërinë e aktivitetit të institucionit, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

e Kriteret e vlerësimit:

1) Ligji nr. 9936, datë 26,06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHò, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016
2) Ligji nr. 109/2017 ñPër buxhetin e vitit 2018ò
3) Ligji nr. 99/2018 ñPër buxhetin e vitit 2019ò
4) Ligji nr. 88/2019 ñPër buxhetin e vitit 2020ò
5) Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"*
6) UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñMbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò i ndryshuar
7) Ligji 10296, datë 08.07.2010 ñMbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, i ndryshuar;
8) Ligji Nr.152/2013, ñPër nëpunësin civilò,
9) Rregullorja e Brendshme ñPër organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civilò,
10) Ligji Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar ñPër Prokurimin Publik

11) Rregullore ôMbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimitö, miratuar me vendimin nr.17, datë 11.03.2015 të Komisionerit.
12) Ligji Nr. 114/2015 ñPër Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publikò, VKM nr. 83, datë 03.02.2016
13) Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò
14) VKM Nr.997, datë 10.12.2010 Kreut V, pika 2, ñPër trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda venditò, i ndryshuar,
15) VKM 914, datë 29.12.2014 ôöPër miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikô

f. Standardet e auditimit.

Auditimi u bazua në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñ*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*ò, Manualin e Auditimit Financiar të KLSH, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit Publik (ISSAI).

g) Metodat e auditimit.

Për arritjen e objektivave, metoda e auditimit u bazua tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në kryerjen e auditimit janë përdorur metoda e bazuar në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, metoda e bazuar në procedurat bazë dhe në procedurat analitike. Pas testimit të kryer, për të kuptuar se si funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm dhe pas marrjes së informacionit në mënyre të përgjithshme, në ushtrimin e auditimit për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar u bënë teste lidhur me zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

Puna e auditit të brendshëm u bë pjesë efektive e mjedisit të kontrollit, duke dhënë ndihmesë në drejtim të risqeve të punës në mënyrë të strukturuar dhe dha siguri për operacionet dhe procedurat e kontrollit.

Po kështu nga ana jonë u përshkrua legjislacioni autorizues, rregullat e vendosura sipas legjislacionit autorizues, shumat e autorizuara për vitet 2017 dhe 2018, caktimi i përgjegjësisë dhe autoritetit, etj.

h) Dokumentimi i rezultateve të auditimit.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 ñ*Dokumentimi i Auditimit*ò.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, rezultateve të akt konstatimeve dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar u përgatit Raporti i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. **Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka për mision që, në mbështetje të Kushtetutës, Ligjit Nr. 152/2013, ñPër nëpunësin civilò, i ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë në bazë e për zbatim të tij, të garantojë mbizotërimin e ligjit (zbatimin e ligjshmërisë) në administrimin e shërbimit civil (përgjatë procedurës së pranimit, emërimit, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, transferimit, pezullimit, vlerësimit, procedurës disiplinore, formimit profesional të thelluar dhe formimit profesional të vazhdueshëm, të drejtat dhe detyrimet e nëpunësit civil, përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil), në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë (institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore), me qëllim që ky proces të jetë i ndershëm, objektiv, i paanshëm dhe transparent.
Vizioni i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është krijimi i një administrate publike (shërbimi civil) sa më të qëndrueshme, profesionale, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit:

DREJTIMI 1: Zbatimi i detyrimeve ligjore nga ana e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përputhje me përcaktimet e nenit 11 e në vijim, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësit civilë", i ndryshuar.

1.1 Hartimi dhe zbatimi i Planit Vjetor të Inspektimeve për periudhën objekt auditimi

Në zbatim të pikës 1/a, të programit të auditimit nr. 157/1, datë 26.01.2021, i ndryshuar u shqyrtua dokumentacioni dhe baza ligjore si më poshtë:

16) Ligji nr. 9936, datë 26,06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHò, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016
17) Ligji nr. 109/2017 ñPër buxhetin e vitit 2018ò
18) Ligji nr. 99/2018 ñPër buxhetin e vitit 2019ò
19) Ligji nr. 88/2019 ñPër buxhetin e vitit 2020ò

Në Ligjin për Nëpunësin Civil dhe në Rregulloren e Brendshme të KMSHC përcaktohet se Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbikëqyr kryesisht dhe për aq sa është e mundur, edhe në bazë të kërkesës së institucioneve, zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, bazuar në planin vjetor dhe planet periodike, duke siguruar një mbulim sa më të plotë të zbatimit të ligjit në lidhje me administrimin e shërbimit civil nga institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore. Neni 14, i Rregullores së Procedurave të Punës përcakton llojet e mbikëqyrjes/inspektimit që KMSHC kryen, më hollësisht:
1. Mbikëqyrja/inspektimi i iniciuar kryesisht nga Komisioneri apo në bazë të kërkesës së institucioneve mund të jetë:
a. **Mbikëqyrje/inspektim tematik**, i cili zhvillohet për një çështje të caktuar, në bazë të informacioneve të nëpunësve civilë, qytetarëve, medias apo kërkesave të institucioneve.
b. **Mbikëqyrje/inspektim i përgjithshëm**, i cili zhvillohet për një procedurë të ligjit, tek të gjitha apo tek një numër përfaqësues i institucioneve të administratës shtetërore, institucioneve të pavarura dhe njësive të qeverisjes vendore.

c. **Mbikëqyrje/inspektim i orientuar/përgatitor**, i cili synon mbledhjen e informacionit për fusha të panjohura tërësisht ose pjesërisht nga mbikëqyrjet/inspektimet e mëparshme.
d. **Mbikëqyrje/inspektim në vazhdim**, i cili shërben për të kontrolluar zbatimin e vendimit apo rekomandimeve të Komisionerit.ò

Plani i inspektimeve dhe monitorimeve

Grupi i auditimit shqyrtoi të dhënat lidhur me planin e monitorimeve dhe inspektimeve për periudhën nën auditim, sipas planifikimit të KMSHC në fillim të vitit dhe ndryshimeve përkatëse, sipas rastit. Në tabelën e mëposhtme paraqitet ecuria në vite e planit të mbikëqyrjes së përgjithshme për periudhën 2017-2020, sipas kategorizimit të institucioneve të përfshira në këtë proces.



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH sipas të dhënave të KMSHC

Sikundër paraqitet nga tabela e mësipërme, kemi të bëjmë me një ulje të numrit të mbikëqyrjeve të përgjithshme të kryera, ku viti 2020 paraqitet me numrin më të vogël, krahasuar me vitin 2017. Për sa i përket mbikëqyrjeve/inspektimeve tematike apo orientuese, grupi i auditimit nuk mund të kryejë një analizë të ngjashme, për shkak se në vitet 2019 dhe 2020 nuk janë përcaktuar saktësisht institucionet e përfshira në monitorim, por edhe pasi në disa raste ky proces është kryer në rang sistemi, për një çështje të veçantë, apo sipas ankesave/informacioneve të përcjella nga qytetarët apo institucionet pranë KMSHC, numri i të cilave nuk mund të përcaktohet paraprakisht nga institucioni. Këtu mund të përmendim përfshirjen në mbikëqyrje të procesit të zgjedhjeve dhe sjelljes së nëpunësve në vitin 2017 dhe 2019; apo në vitin 2020, vendimet gjyqësore për largimin e padrejtë të nëpunësve.

- Nga auditimi konstatohet se planet vjetore janë miratuar nga Komisioneri **në fillim të vitit pasardhës**, në kundërshtim me pikën 8 të nenit 11 ñPlani vjetor dhe planet periodike të mbikëqyrjes/inspektimitò, të Rregullores së Brendshme të KMSHC ñPër organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civilò, ku përcaktohet se*: "Plani vjetor i mbikëqyrjes/inspektimit miratohet nga Komisioneri jo më vonë se fundi i viti paraardhës",* më hollësisht:

-Për vitin 2017, plani vjetor i punës në të cilin janë përfshirë procedurat e mbikëqyrjes dhe inspektimit është miratuar nga Komisioneri i KMSHC, sipas shkresës nr.22, prot datë 13.01.2017.
-Për vitin 2018, plani vjetor i punës në të cilin janë përfshirë procedurat e mbikëqyrjes dhe inspektimit është miratuar nga Komisioneri i KMSHC, sipas shkresës nr.1, prot datë 3.01.2018.

-Për vitin 2019, plani vjetor i punës në të cilin janë përfshirë procedurat e mbikëqyrjes dhe inspektimit është miratuar nga Komisioneri i KMSHC, sipas shkresës nr.1, prot datë 3.01.2019.
-Për vitin 2020, plani vjetor i punës në të cilin janë përfshirë procedurat e mbikëqyrjes dhe inspektimit është miratuar nga Komisioneri i KMSHC, sipas shkresës nr.1, prot datë 6.01.2020.

- Për vitin 2017 dhe 2018 në planin e monitorimeve dhe inspektimeve, për inspektimet tematike dhe ato të përgjithshme janë përcaktuar paraprakisht lista e plotë e subjekteve të përzgjedhura që do të nënshtrohen mbikëqyrjes/inspektimit sipas kategorive përkatëse në të cilat ato bëjnë pjesë.
- Nga auditimi konstatohet se në planin e vitit **2019** dhe **2020**, tek monitorimet/inspektimet e përgjithshme, nuk rezultojnë të jenë përcaktuar qartësisht subjektet e përfshira në monitorim, pasi në plan është përcaktuar se mbikëqyrja do të realizohet për institucionet në varësinë e disa ministrive, por jo saktësisht se cilat janë konkretisht institucionet e përzgjedhura nga KMSHC. Në planin e inspektimeve tematike për vitin 2019, është përcaktuar mbikëqyrja e të gjithë institucioneve që disponojnë statusin e nëpunësit civil. Në inspektimet tematike për vitin 2020 është përcaktuar mbikëqyrja e të gjithë institucioneve të administratës shtetërore, të pavarura, vendore për vendimet gjyqësore/ dhe bashkia Tropojë për shkak të ankesave të mëdha.
- Nga auditimi konstatohet se në kundërshtim me nenin 11, pika 10 e rregullores, e cila përcakton se: ñ*Mbikëqyrjet/inspektimet e papërfunduara, të planifikuara në planin paraardhës vjetor apo periodik, bëhen automatikisht pjesë e planit të ri vjetor apo periodik të mbikëqyrjes/inspektimit"*, konstatohet se në planet e hartuara dhe të rishikuara të KMSHC nuk është marë parasysh kjo pikë e rregullores, kjo edhe pasi regjistri sipas së cilit administrohet lista e planit nuk paraqet informacion mbi planifikimin dhe realizimin sipas vitit, në mënyrë që të identifikohen institucionet e përfshira në vitin pasardhës në kushtet e mos realizimit të tyre një vit më parë. Si rezultat, në planin e hartuar çdo fillim viti, nuk rezultojnë të jenë pasqyruar edhe lista e institucioneve të mbartura nga viti më parë, kjo sipas observacionit të paraqitur nga subjekti i audituar, për faktin se këto institucione janë automatikisht pjesë e planit dhe nuk është nevoja të përsëriten në planin e periudhës pasardhëse.
- Nga auditimi konstatohet se KMSHC për periudhën objekt auditimi nuk ka hartuar plane periodike 3 mujore për monitorimet/inspektimet, në kundërshtim me rregulloren e brendshme të KMSHC, neni 12 pika 2 ku përcaktohet ñ*Planet periodike (3-mujore) të mbikëqyrjes/inspektimit duhet të përmbajnë një pasqyrë të detajuar të mbikëqyrjeve/inspektimeve që synohen të kryhen gjatë asaj periudhe, ku nuk duhet të mungojnë elementët e mëposhtëm: a. Objekti i mbikëqyrjes/inspektimit. b. Subjektet që do t'i nënshtrohen mbikëqyrjes/inspektimit. c. Grupi i inspektorëve që do të kryejë mbikëqyrjen/inspektimin. d. Kohëzgjatjen e planifikuar për kryerjen e mbikëqyrjes/inspektimit. e. Veprimet që do të kryhen nga inspektorët. f. Burimet financiare dhe burime të tjera të nevojshme për kryerjen e mbikëqyrjes/inspektimit."*
- KMSHC përgjatë vitit i është dashur të kryejë ndryshime në planin e monitorimeve dhe inspektimeve për subjektet e përzgjedhura. Nga auditimi konstatohet se këto ndryshime nuk rezultojnë të jenë shoqëruar me rishikim të planit vjetor të monitorimeve, duke vepruar kështu në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme, Neni 11, pika 6 e cila përcakton si më poshtë*:* ñ*Në rast se është e nevojshme, Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në bashkëpunim me Drejtorinë e Mbikëqyrjes dhe Drejtorinë e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, harton dhe i paraqet Komisionerit për miratim ndryshimet dhe përshtatjet e planit vjetor dhe planeve periodike (3-mujore) të mbikëqyrjes/inspektimit*ò / pika 7 ñ*Planet e hartuara sipas*

pikës 2 më sipër mund të ndryshojnë në varësi të problematikës së konstatuar përgjatë vitit në lidhje me mbikëqyrjen e procedurave që janë në vazhdim apo të iniciuara në bazë të kërkesës së institucioneve, në përputhje me Ligjin Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar./ Pika 9 *"Planet periodike (tremujore) të mbikëqyrjes/inspektimit miratohen nga Komisioneri jo më vonë se 15 ditë përpara hyrjes në fuqi të tyre."* Për inspektimin/mbikëqyrjen e institucioneve të pa përfshira në plane, njoftimi kryhet direkt për institucionin, pa u përfshirë në një plan të rishikuar sikundër përcakton rregullorja më sipër, pasi sipas KMSHC ndryshimet e planit kanë qenë të nevojave imediate, duke mos mundësuar kohën e nevojshme për rishikim e tij, si përpara faktit ashtu edhe pasi është bërë njoftimi për institucionin.

- Nga auditimi konstatohet se në kundërshtim me nenin 12 të rregullores, ñPërmbajtja e planit vjetor dhe planeve periodikeò ku përcaktohet se*: ñPlani vjetor i mbikëqyrjes/inspektimit duhet të përmbajë një pasqyrë të përgjithshme të mbikëqyrjeve/inspektimeve që synohen të kryhen gjatë vitit pasardhës, ku nuk duhet të mungojnë elementët e mëposhtëm: 1. Objekti i mbikëqyrjes/inspektimit. 2. Subjektet që do t'i nënshtrohen mbikëqyrjes/inspektimit.3. Veprimet që do të kryhen nga inspektorët. 4. Burimet financiare dhe burime të tjera të nevojshme për kryerjen e mbikëqyrjes/inspektimit.",* në planet vjetore të punës paraqiten vetëm motivet që kanë çuar për përfshirjen e subjekteve në planin e mbikëqyrjes, ku mungojnë përcaktimet për veprimet që do të kryhen nga inspektorët, dhe burimet financiare apo burime të tjera të nevojshme për kryerjen e mbikëqyrjes/inspektimit, informacione këto që nga KMSHC bëhen pjesë e programeve të inspektimeve/mbikëqyrjeve respektive në institucionet e përzgjedhura.

Realizimi i planit të inspektimeve dhe monitorimeve

Në tabelën e mëposhtme paraqitet niveli i realizimit të planit të mbikëqyrjes së përgjithshme të kryer nga KMSHC për periudhën 2017-2020 sipas kategorive të institucioneve, bazuar në realizimin e planit të periudhës respektive, pra pa përfshirë në plan, atë të mbartur, duke qenë se në tabelat e planit të institucionit nuk përfshiheshin të gjitha institucionet e mbartura nga plani paraardhës.

Realizimi i planit te mbikëqyrjeve të përgjithshme sipas planit të vitit respektiv

Viti	Institucione të Administratës Shtetërore		Njësitë e Qeverisjes Vendore		Institucione të Pavarura	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
2017	13	10	37	27	0	0
2018	8	10	10	10	3	3
2019	3	2	4	0	0	0
2020	3	2	2	0	1	0

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH sipas të dhënave të KMSHC



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH sipas të dhënave të KMSHC

KMSHC nuk rezulton të disponojë një regjistër për llojet e inspektimeve/mbikëqyrjeve të kryera për çdo vit, në mënyrë që të ndiqet realizimi i tyre me qëllim monitorimin sa më të plotë të punës së institucionit. Nga viti 2020, në faqen zyrtare të KMSHC publikohet një regjistër mbi të dhënat e ankesave apo informacioneve të qytetarëve/subjekteve , i cili përdoret nga KMSHC për statistika dhe për të ndjekur ecurinë e çështjeve. Gjithashtu, institucioni disponon një regjistër me vendimet e Komisionerit sipas numrit rendor (pra një informacion tepër voluminoz), një paraqitje kjo që e vështirëson përpunimin dhe analizimin e informacionit, dhe për këtë arsye u kërkua një kategorizim i informacionit mbi planifikimin-realizimin e mbikëqyrjeve/inspektimeve të ndara në vite, dhe sipas llojit të tyre, në qëllim të auditimit. Megjithatë, për shkak të volumit të madh të informacionit, pati një sërë komunikimesh të vazhdueshme me subjektin për reflektimin e plotë dhe të saktë të dhënave, por materiali final nuk arriti të përgatitej deri në përfundim të auditimit në terren. Grupi i auditimit konstaton se mangësitë e identifikuara në administrimin e të dhënave mbi vendimet e Komisionerit dhe ndjekjen e zbatimit të tyre, mund të cënojë kryerjen e një planifikimi efektiv dhe gjithëpërfshirës të mbikqyrjeve/inspektimeve që institucioni do të kryejë në periudhat e ardhshme. Të dhënat e përpunuara nga grupi i auditimit sipas informacionit të KMSHC, dhe verifikimeve ne web-in e vendimeve të publikuara paraqiten në aneksin nr.1.

Nga auditimi konstatohet se edhe pse në rregulloren e brendshme, si dhe në strukturën organizative të KMSHC është kryer një ndarje për kryerjen e inspektimeve dhe mbikëqyrjeve, në praktikë rezulton se këto drejtori (pra Drejtoria e Mbikëqyrjes, dhe Drejtoria e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ.) funksionojnë si një e vetme, kjo edhe për shkak të stafit të reduktuar që duhet të kryejë një mbulim relativisht të gjerë (Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes ka në total një staf prej 15 punonjësish, nga të cilët 12 inspektorë, 2 drejtorë drejtorie, dhe 1 drejtor i përgjithshëm). Përgjatë vitit institucionit i duhet të kryejë inspektime, mbikëqyrje dhe monitorime për çështje të ndryshme (pra përveç atyre të përgjithshme), ku evidentohet se në aktet rregullative të KMSHC, nuk janë parashikuar saktësisht dhe hollësisht procedurat dhe dokumentacionet që do të hartohen rast pas rasti. Mbikëqyrjet e përgjithshme rezultojnë të kryera sipas përcaktimeve në rregullore, duke hartuar akt konstatimet, pritjen e observacionit, hartimin e projektraportit, raportit përfundimtar dhe vendimit final të Komisionerit, pasi akti rregullativ i miratuar e trajton gjerësisht hap pas hapi këtë proces dhe dokumentacionet respektive që duhet të shoqërojnë vendimmarrjen në çdo hallkë. Në rastin e inspektimeve tematike, apo mbikëqyrjeve të rastit për një çështje të caktuar, në rregullore nuk ka një përcaktim për dokumentacionet standard që do të jenë pjesë e proceseve, pasi kë. Si rezultat, mbetet nën vendimmarrjen e vetë institucionit që në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe për sa mund të jetë e përcaktuar, të përcaktojë rast pas rasti, aktet që do të hartohen gjatë secilit proces, qoftë inspektim tematik, mbiqkyrje tematike apo monitorim i një çështjeje të veçante. Grupi i auditimit kërkoi një informacion lidhur me realizimin e inspektimeve dhe monitorimeve sipas kategorive respektive, ku situata rezulton si më poshtë:

Verifikimi i realizimit të disa prej inspektimeve dhe monitorimeve të kryera nga KMSHC sipas llojit të tyre

a. 1. Mbikëqyrje/inspektim i përgjithshëm

Procesi i mbikëqyrjes së përgjithshme, ka patur një rënie graduale nga viti 2017 në 2020 si në planifikim dhe në realizim, krahasuar me vitet e mëparshme, kjo për shkak edhe të shtimit të mbikëqyrjeve tematike në vitet e fundit, nevojat për të cilat sipas KMSHC kanë qenë më të

mëdha. Edhe pse grupi i auditimit kërkoi një regjistër risku (nëse disponohej) ose informacion, në bazë të të cilit të kryhet edhe përzgjedhja e institucioneve që do të jenë objekt i kësaj mbikëqyrjeje, ky regjistër/informacion nuk na u vu në dispozicion. Në këto kushte, mbështetur mbi evidencat e vendosura në dispozicion, grupi i auditimit gjykon se planifikimi nuk është mbështetur mbi një metodologji të qartë ose është kryer në mungesën e plotë të kësaj metodologjie. Në observacionin e subjektit të audituar është përcjellë informacioni se regjistri i brendshëm i institucionit që administron të dhëna lidhur me ankesa të ndryshme apo informacione të përcjellë nga qytetarë apo subjekte i cili është edhe i publikuar në faqen zyrtare të KMSHC, është një nga indikatorët që shërben për të orientuar veprimtarinë e Komisionerit në të ardhmen, për të përzgjedhur çështjen që do të trajtohet në mbikëqyrjet e përgjithshme dhe tipologjinë e subjekteve që do të planifikohen për tâu kontrolluar për vitin në vijim. Një tjetër indikator sipas KMSHC është edhe relacioni i hartuar në përfundim të mbikqyrjeve/inspektimeve orientuese, konkluzionet e të cilave i shërbejnë institucionit për kryerjen e planit të punës.

Sikundër u trajtua edhe më lart, u konstatua se fillimisht në planet vjetore të KMSHC në vitin 2017, është kryer një planifikim i qartë për listën e institucioneve që do të mbikëqyren, ndërsa në vitet e fundit (2019-2020), në planifikim është përcaktuar se do të mbikëqyren në mënyrë të përgjithshme òInstitucionet nën varësinë e ministrisëé ò, pra pa përcaktuar në mënyrë nominative se cilat do të jenë këto institucione dhe si janë përzgjedhur në planin e punës. Sipas KMSHC në planifikim përfshihen të gjitha institucionet e varësisë së ministrisë respektive, dhe përgjatë vitit nga kjo listë, sipas mundësisë së institucionit përzgjidhen disa prej tyre për të qenë objekt mbikëqyrjeje, megjithatë konstatohet se ky proces, pra përzgjedhja e institucionit të varësisë, rezulton gjithashtu një proces i pa dokumentuar me një analizë/metodologji konkrete nga ana e institucionit.

- ✓ Nga auditimi u konstatua se në rregulloren e KMSHC, nuk rezultojnë të jenë përcaktuar afate të paracaktuara, për dërgimin e observacioneve, dhe si rezultat ky afat rezulton të jetë lënë rast pas rasti, ku varion në 5 apo 20 ditë, brenda një afati të arsyeshëm, në kompetencë të Komisionerit, duke vlerësuar problematikën e trajtuar dhe kohën që i nevojitet institucionit për të përgatitur përgjigjen.
- ✓ Në njoftime dhe në programe, nuk parashikohet afati apo një periudhë që do tâi duhet punonjësve për të kryer këto mbikqyrje (faza e terrenit). Si rezultat, për disa mbikëqyrje procesi ka përfunduar për një periudhë relativisht të shkurtër, dhe në disa raste të tjera ka zgjatur për muaj me rradhë.
- ✓ Në rregullore nuk ka përcaktime mbi afatet që do i duhen KMSHC për hartimin e raportit përfundimtar pas dorëzimit të projektraportit.

Nga përpunimi i të dhënave nga ana e grupit të auditimit, bazuar në informacionin e KMSHC dhe atë të publikuar në web, për sa i përket nivelit të realizimit, situata paraqitet si më poshtë[6].

Vendime në vijim të monitorimit të përgjithshëm

Grupi i auditimit përpunoi realizimin e planit të ndarë sipas periudhave në vite, dhe duke analizuar edhe nivelin e realizimit të tij nga institucionet e pa realizuara në vitet kur janë planifikuara, por të mbartura nga vitet paraardhëse, situata rezulton si më poshtë:

Plani dhe realizimi i mbikqyrjeve të përgjithshme për periudhën 2017-2020

Viti	Institucionet e mbartura nga plani i vitit paraardhës	Numri i institucioneve në planin vjetor	Realizuar me vendim deri në fund të vitit	Realizimi i planit të vitit%
2017		50	7	17%

[6] Konfirmimi i këtyre të dhënave nga ana e KMSHC është kërkuar nga grupi i auditimit, në mënyrë verbale dhe zyrtare, por nuk kemi marrë asnjë përgjigje.

2018	43	30	42[7]	57%
2019	17[8]	19[9]	21[10]	58%
2020	11 [11]	15	7[12]	27%

-Në planin e vitit **2017,** nuk janë realizuar **mbikqyrjet e përgjithshme** ne disa Drejtori Arsimore, për shkak të ristrukturimit të tyre, më hollësisht Drejtoria Arsimore Rajonale Dibër dhe Zyrat Arsimore: Bulqizë, Mat, Drejtoria Arsimore Rajonale Fier dhe Zyrat Arsimore: Lushnje, Mallakastër, Drejtoria Arsimore Rajonale Gjirokastër dhe Zyrat Arsimore: Përmet, Tepelenë, Drejtoria Arsimore Rajonale Vlorë dhe Zyrat Arsimore: Delvinë, Sarandë.
-Referuar planit të vitit **2018**, rezultojnë të mos jenë realizuar **mbikëqyrjet e përgjithshme** sipas planit vjetor apo planeve të mëtejshme në vitet pasardhëse deri në përfundim të periudhës së auditimit në 7 institucione, nga të cilat **3 ministri:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit; dhe 4 Drejtori të Ujitjes së Kullimit të cilat pas ndryshimeve të ligjit nuk janë më objekt mbikëqyrjeje nga KMSHC: Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë, Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Durrës, Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier, Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Korçë.
-Referuar planit të vitit **2019**, rezultojnë të mos jenë realizuar **mbikëqyrjet e përgjithshme** sipas planit vjetor apo planeve të mëtejshme në vitet pasardhëse deri në përfundim të periudhës së auditimit në 4 Bashki: Bashkia Elbasan dhe Njësitë Administrative përbërëse të saj, Bashkia Shkodër dhe Njësitë Administrative përbërëse të saj, Bashkia Kavajë dhe Njësitë Administrative përbërëse të saj, Bashkia Berat dhe Njësitë Administrative përbërëse të saj; dhe planifikimi për kryerjen e mbikëqyrjeve në Institucionet e varësisë së Ministrisë së Turizmit.
-Referuar planit të vitit **2020**, rezultojnë të mos jenë realizuar **mbikëqyrjet e përgjithshme** sipas planit vjetor apo planeve të mëtejshme në vitet pasardhëse deri në përfundim të periudhës së auditimit në 2 bashki: Bashkia Kavajë dhe Njësitë Administrative përbërëse të saj, Bashkia Pogradec dhe Njësitë Administrative përbërëse të saj; dhe në INSTAT.

Grupi i auditimit shqyrtoi vendimet dhe raportet e publikuara në web-in e KMSHC për mbikëqyrjet e përgjithshme të kryera në vitin 2020, si më poshtë:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

Procesi i mbikëqyrjes kryesisht në këtë institucion filloi në datën 23.04.2019. Programi i Mbikëqyrjes me nr. 437/1 prot., datë 19.04.2019, është miratuar nga Komisioneri dhe me shkresën nr. 437/2 prot., datë 19.04.2019, ñ*Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit*ò. Me shkresën nr. 437/7 prot., datë 18.12.2019, të Komisionerit, ñ*Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në lidhje me administrimin e shërbimit civil"* projektraporti i hartuar nga grupi i punës, i është dërguar për njohje institucionit të mbikëqyrur, duke i lënë 20 ditë kohë për të paraqitur observacionet. Me Shkresën nr. 23402/1 prot., datë 10.01.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit, ñDërgohet observacionò (protokolluar në KMSHC me nr. 63 prot., datë 16.01.2020). Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, pasi është njohur më

[7] 24 institucione kane qene pjese e planit paraardhës dhe 18 janë realizuar sipas planit të vitit 2018
[8] 5 institucione jane mbartur nga viti 2017 dhe 12 nga viti 2018
[9] Në këtë vit, në planin vjetor nuk jane listuar institucionet e varesise qe do te perfshihen, dhe si rezultat nje ministri paraqitet në numër si 1 (një) institucion, në një kohë ku sipas planit duhet te jene te gjitha varesite e saj ne zbatim te ligjit respektiv.
[10] Lidhur me realizimin, 5 institucione jan realizuar si të mbartur nga vitit 2017, 5 nga viti 2018 dhe 11 nga 2019.
[11] Nga plani paraardhës janë mbartur 3 institucione nga viti 2018 dhe 8 nga viti 2019
[12] Lidhur me realizimin, 2 institucione janë realizuar si të mbartur nga 2019 dhe 5 nga plani i vitit 2020

përmbajtjen e projektraportit, me shkresën nr. 7594/1 prot., datë 24.01.2020 (protokolluar në KMSHC me nr. 138 prot., datë 28.01.2020), ka dërguar observacionet në lidhje me konstatimet e grupit të punës, të cilat janë analizuar në vijim të raportit përfundimtar, duke konkluduar me Vendimin nr. 8, datë 05.02.2020 ñ*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë".*

2. Instituti i Integrimit të të Përndjekurve Politikë

Programi i Mbikëqyrjes me nr. 193/1, datë 13.02.2020, miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr.193/2, datë 13.02.2020 ñ*Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në Institutin e Integrimit të të Përndjekurve Politikë*ò ka filluar në datën 17.02.2020. Me shkresën nr. 193/5 prot., datë 06.05.2020 të Komisionerit, projektraporti i hartuar nga grupi i punës, i është dërguar për njohje institucionit të mbikëqyrur, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur observacionet. Me shkresën nr. 198 prot., datë 13.05.2020 ñ*Projektraporti i mbikëqyrjes në Institutin e Integrimit të të Përndjekurve Politikë në lidhje me administrimin e shërbimit civil"* (protokolluar në KMSHC me nr. 193/8 prot., datë 15.05.2020), ka dërguar të nënshkruar projektraportin, pa vërejtje, i cili është administruar në dosjen e mbikëqyrjes. Procesi ka konkluduar me Vendimin nr.33, datë 22.05.2020 ñ*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Institutin e Integrimit të të Përndjekurve Politikë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë.*ò

3. **Qendra Kombëtare e Edukimit**

KMSHC ka filluar mbikëqyrjen e përgjithshme sipas vendimit nr. 19, datë 13.2.2020 ñ*Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*ò. Me shkresën nr. 192/5 prot., datë 6.5.2020 të Komisionerit, projektraporti i hartuar nga grupi i punës, i është dërguar për njohje Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur observacionet. Pas kësaj, me shkresën nr. 85/3 prot., datë 11.5.2020, ñKthim përgjigjeò, institucioni i mbikëqyrur ka dërguar pranë Komisionerit, projektraportin e nënshkruar nga titullari i institucionit dhe nëpunësi përgjegjës për administrimin e burimeve njerëzore, pa bërë vërejtje, i cili është administruar në dosjen e mbikëqyrjes. Procesi është konkluduar sipas vendimit nr.36, datë 02.06.2020 ñ*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin qendra kombëtare e edukimit në vazhdim dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë".*

4. **Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës**

Procesi i mbikëqyrjes kryesisht në këtë institucion filloi në datën 17.02.2020. Programi i Mbikëqyrjes me nr. 191/1 prot., datë 13.02.2020, miratuar nga Komisioneri dhe me shkresën nr. 191/2 prot., datë 13.02.2020, ñ*Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës*ò, i është njoftuar subjektit fillimi i procesit. Me shkresën nr. 191/5, prot. datë 06.05.2020, të Komisionerit, ñ*Dërgohet projekt raporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, në lidhje me administrimin e shërbimit civil*ò projekt raporti i hartuar nga grupi i punës, i është dërguar për njohje institucionit të mbikëqyrur, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur observacionet. Subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me përmbajtjen e materialit, nëpërmjet shkresës nr. 191/8 prot., datë 21.05.2020, të Kryetarit të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ñKonfirmim i Projekt raportitò, ka dërguar projekt raportin e nënshkruar pa paraqitur observacione, duke u shprehur dakord në lidhje me gjetjet e grupit të mbikëqyrjes, të pasqyruara në të. Procesi është konkluduar me vendimin nr. 40, datë

12.06.2020 ñ*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionet në varësi të ministrisë së shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, agjencia shtetërore për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë*ò.

5. Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore

Procesi i mbikëqyrjes kryesisht në këtë institucion filloi me vendimin nr. 30, datë 5.3.2020, ñ*Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore".* Procesi i mbikëqyrjes në këtë institucion, filloi në datën 9.3.2020, në zbatim të Programit të Mbikëqyrjes nr. 248/1 prot., datë 6.3.2020, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar institucionit me shkresën nr. 248/2 prot., datë 6.3.2020, ñ*Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore".* Projektraporti është përcjellë sipas shkresës nr. 248/5 prot., datë 28.5.2020 pranë institucionit, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur observacionet e tyre në lidhje me gjetjet e grupit të punës. Pas kësaj, me shkresën nr.46/3 prot., datë 1.6.2020, institucioni ka dërguar të nënshkruar projektraportin pa vërejtje, i cili është administruar në dosjen e mbikëqyrjes. Procesi është konkluduar me vendimin nr. 41, datë 12.06.2020 për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë.

6. Drejtoria e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror

Procesi i mbikëqyrjes kryesisht në këtë institucion filloi me vendimin nr. 17, datë 13.02.2020, ñ*Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimi e shërbimit civil, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror*ò. Programi i Mbikëqyrjes me nr. 190/1 prot., datë 13.02.2020, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili i është njoftuar subjektit me shkresën nr. 190/2 prot., datë 13.02.2020, ñ*Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror"*. Projektraporti për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 190/6 prot., datë 09.06.2020, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ñ*Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin Drejtoria e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, në lidhje me administrimin e shërbimit civil*ò, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes. Subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të punës, me shkresën nr. 332/2 prot., datë 15.06.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Social Shtetëror, ñKthim përgjigjeò (protokolluar në KMSHC me nr. 190/8 prot., datë 17.06.2020), ka dërguar projekt raportin e nënshkruar nga personat përgjegjës, bashkëlidhur edhe observacionin, duke u shprehur dakord në lidhje me gjetjet e grupit të mbikëqyrjes, të pasqyruara në të. Procesi është konkluduar me vendimin nr.42, datë 19.06.2020 ñ*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmëris*ëò.

7. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera

Procesi i mbikëqyrjes kryesisht në këtë institucion filloi me vendimin nr. 130, datë 22.10.2020, ñ*Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Minier*aò, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme, në zbatim të Programit të Mbikëqyrjes me nr. 797/1 prot., datë 22.10.2020, të miratuar nga Komisioneri dhe me

shkresën nr. 797/2 prot., datë 22.10.2020, ñ*Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Minieraò*, i është njoftuar subjektit fillimi i procesit. Me shkresën nr. 797/5 prot. datë 07.12.2020, të Komisionerit, ñ*Dërgohet projekt raporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, në lidhje me administrimin e shërbimit civil"*, projekt raporti i hartuar nga grupi i punës, i është dërguar për njohje institucionit të mbikëqyrur, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur observacionet. Subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me përmbajtjen e materialit, nëpërmjet shkresës nr.1239/2 prot., datë 11.12.2020, të Kryetarit të Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera ñKthim Përgjigje e shkresës nr. 797/5 datë 07.12.2020ò, ka dërguar projekt raportin e nënshkruar pa paraqitur observacione, duke u shprehur dakord në lidhje me gjetjet e grupit të mbikëqyrjes, të pasqyruara në të. Procesi është konkluduar me vendimin Nr.222, datë 30.12.2020 ñ*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë".*

8. Arkivi Qendror Teknik të Ndërtimit (AQTN)

Procesi i mbikëqyrjes kryesisht në këtë institucion filloi me vendimin nr. 129, datë 22.10.2020 ñ*Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit*ò, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme. Programi i Mbikëqyrjes me nr. 796/1, datë 22.10.2020, miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Me shkresën nr. 796/5 prot., datë 03.12.2020 të Komisionerit, projektraporti i hartuar nga grupi i punës, i është dërguar për njohje institucionit të mbikëqyrur, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur observacionet. Institucioni i mbikëqyrur pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të mbikëqyrjes me shkresën nr. 1057/2 prot., datë 07.12.2020 ñDërgohet projektraportiò (protokolluar në KMSHC me nr. 796/8 prot., datë 14.12.2020), ka dërguar të nënshkruar projektraportin, pa vërejtje, i cili është administruar në dosjen e mbikëqyrjes. Procesi është konkluduar me vendimin nr.223, datë 30.12.2020 ñ*Për miratimin e raportit përfundimtar dhe përfundimin e procesit të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit".*

a.2 Mbikëqyrje/inspektim i orientuar/përgatitor

a. 2.1Monitorimi i zbatimit të vendimeve gjyqësore

Sipas dokumentacioneve të vendosura në dispozicion nga KMSHC, si dhe raportet vjetore te dorëzuara ne Kuvend, puna e institucionit për sa i përket ekzekutimit të vendimeve gjyqësore nga institucionet shtetërore, ka nisur në vitin 2018 me urdhrin nr. 589, datë 01.08.2018, të Komisionerit ò*Për fillimin e procesit të monitorimit të zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë*ò. Në vijim, me urdhrin nr. 10, datë 21.01.2019, të Komisionerit "*Mbi fillimin e inspektimit për rastet e mos zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë, në institucionet që janë subjekt i ligjit për nëpunësin civil*", parashikohet të fillojë **hetimi administrativ** për çdo rast të konstatuar në shkelje të ligjit, akt i cili i ka shtrirë efektet e tij edhe gjatë vitit 2020, sikundër është trajtuar në Raportin Vjetor të KMSHC për Kuvendin për vitin 2019 dhe 2020[13]. Grupi i auditimit kërkoi informacion mbi listën e hetimeve administrative të kryera gjatë periudhës 2017-2021, informacion që nuk u vendos në dispozicion. Lidhur me rekomandimin e rezolutës së Kuvendit *"Të përmbyllen veprimet*

[13] Publikuar gjithashtu ne faqe zyrtare të KMSHC: http://www.kmshc.al/raportimi-vjetor-per-kuvendin/ (fq 12, 126, 158 e Raportit te vitit 2019; 101, 128 e Raportit te vitit 2020)

për administrimin e të dhënave që kanë të bëjnë me rikthimin e nëpunësve civilë gjyqfitues në detyrë, në të gjithë sistemin e shërbimit civil, me qëllim që të evidentohen arsyet që pengojnë ecurinë e këtij procesi dhe të vijojë procesi i hetimit administrativ në lidhje me rastet individuale, të konstatuara në shkelje të ligjit, në fazën e parë të procesi.", sipas Raportit të vitit **2019** të KMSHC, është raportuar se kjo pikë e rezolutës është **realizuar plotësisht**: ñ*Komisioneri ka finalizuar procesin e administrimit të të dhënave dhe aktualisht ka kaluar në procesin e hetimit administrativ në lidhje me rastet individuale, kur nëpunësit gjyqfitues ende nuk janë rikthyer në shërbimin civil."*. Ndër të tjera është raportuar se procesi i hetimit administrativ për çdo rast të vendimeve gjyqësore të pa ekzekutuara ka nisur dhe po realizohet nëpërmjet seancave dëgjimore me pjesëmarrjen e institucioneve të administratës shtetërore, në kushtet kur kjo tipologji institucionesh e ka më të theksuar këtë problem. Në raport përcaktohet se: "*Kanë përfunduar seancat dëgjimore për 11 Ministritë e linjës. Në këto takime janë rakorduar të dhënat e administruara deri në këtë fazë të procesit dhe janë diskutuar në mënyrë nominale të gjitha rastet e vendimeve të pa zbatuara, duke lënë edhe detyra konkrete për Komisionet e Posaçme të ngritura në institucion, si edhe për Departamentin e Administratës Publike. Seancat dëgjimore janë realizuar në selinë e Komisionerit dhe në to kanë marrë pjesë me përfaqësues të autorizuar, Departamenti i Administratës Publike dhe institucioni i thirrur nga Komisioneri. Procesi do të vijojë gjatë vitit 2020 me ndjekjen e zbatimit të vendimeve nga ministritë e linjës dhe do të vijojnë seancat dëgjimore me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, e cila ka rreth 143 vendime të pa ekzekutuara dhe me institucionet e administratës vendore dhe ato të pavarur"*.

Në raportin e vitit **2020** është përmendur edhe shkalla e zbatimit nga ana e Komisionerit të rezolutës së Kuvendit i cili ka rekomanduar: ñ*Të vijojë procesin e hetimit administrativ për rastet individuale të konstatuara në shkelje të ligjit për proceset e rikthimit të nëpunësve civilë gjyqfitues në detyrë, si dhe të vlerësohet mundësia e ndërtimit të një databaze të përgjithshme të rekordeve historike, që të përfshijë aktet e largimit nga shërbimi civil të gjyqfituesve"*.

-Për sa më sipër grupi i auditimit ka kërkuar informacion lidhur me proceset e realizuara gjatë vitit 2019 dhe 2020 sikundër është trajtuar në raportet respektive të këtyre periudhave, nga KMSHC janë zhvilluar seanca dëgjimore si dhe janë lënë detyra konkrete për 11 ministritë e linjës, dhe DAP; dhe në vitin 2020 është shtrirë procesi në varësitë e ministrive. Nisur nga ky informacion, grupi i auditimit ka kërkuar minutat e këtyre seancave si dhe detyrat konkrete të lëna nga Komisioneri. Në bazë të rregullores ôMbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimitö, miratuar me vendimin nr.17, datë 11.03.2015 të Komisionerit, ndër të tjera trajtohen edhe procedurat që duhet të ndiqen nga institucioni për kryerjen e hetimeve administrative, apo edhe inspektimeve sikundër ka përmendur KMSHC në raportin vjetor. Në këtë rregullore parashikohet detyrimi i KMSHC për njoftimin e institucionit që do të jetë objekt inspektimi apo hetimi administrativ, mbajtja e akteve për vendosjen në dispozicion të dokumentacioneve, hartimin e akt konstatimeve për parregullsitë e konstatuara, projektraportit, raportit e më pas të vendimit të KMSHC për rezultatet *e inspektimit* apo *hetimit*. Nisur nga sa më sipër, grupi i auditimit kërkoi **gjurmët e këtij procesi**, parashikuar në nenin 10 të rregullores së procedurave: ñ*Vendimmarrja e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe të gjitha veprimet procedurale të kryera nga Sekretariati, përfshi procesverbalet administrative të mbajtura gjatë procesit të mbikëqyrjes/inspektimit duhet të jenë të dokumentuara në formë të shkruar dhe të ruhen sipas legjislacionit në fuqi për arkivat*ö, por edhe në Ligjin nr. 111/2015 ò*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* ku në pikën 5, të nenit 23 të tij përcaktohet se:ò*Titullarët e njësive publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi, që sigurojnë: Dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.*ò. Gjatë auditimit në terren, këto

dokumentacione janë vendosur në dispozicion vetëm për një ministri (Ministria e Arsimit), dhe në mënyrë të përmbledhur analizat statistikore në rang ministrie për listën në total, të detyrimeve si rezultat i vendimeve gjyqësore. Procesi në Ministrinë e Arsimit, sipas dokumentacioneve daton deri në Shkurt 2020, ku kanë mbetur ende gjyqfitues të pa sistemuar për shkak se MASR ka shprehur pamundësinë, duke kërkuar ndërhyrjen e DAP. Për këtë, grupi i auditimit ka kërkuar informacion lidhur me vijueshmërinë e procesit (nëse ka pasur) deri në përfundim të periudhës objekt auditimi, por ende nuk kemi një informacion për sa më sipër.

Auditimi i këtyre dokumentacioneve, ka për qëllim evidentimin e problematikave në këtë proces i cili realizohet për herë të parë, në vijim të rekomandimit të Kuvendit, për të ndërmarrë në kohë masat e nevojshme për përmirësim, nëse do të jetë e nevojshme, për vetë rëndësinë që ka kjo çështje e ngritur për disa vite radhazi nga KLSH, duke konsideruar gjithashtu edhe kufizimet në personel të KMSHC.

Në zbatim të urdhrit të brendshëm nr.589, prot datë 01.08.2018 **"***Për fillimin e procesit të monitorimit të zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civil në detyrë",* është hartuar relacioni për ecurinë e monitorimit të vendimeve gjyqësore në datë 22.01.2019.Në këtë relacion është përcaktuar se kryerja e mbikëqyrjes së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore është një detyrë e lënë nga rezoluta e kuvendit ñPër vlerësimin e veprimtarisë së KMSHC për vitin 2017ò, pika 3 ku shprehimisht është përcaktuar si më poshtë: ñ*Me qëllim që të sigurohet zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve në detyrë, KMSHC të koordinojë veprimtarinë mes DAP, i njësia përgjegjëse për administratën shtetërore dhe njësive të menaxhimit të burimeve njerëzore në administratën vendore dhe në institucionet e pavarura, për të vlerësuar situatën në lidhje me nivelin e zbatimit të ligjit në këtë institut të tij. Nëse për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, pozicioni i mëparshëm nuk ekziston më, apo është plotësuar në përputhje me ligjin, si dhe në rastet e tjera të pamundësive objektive për të zbatuar vendimin gjyqësor, Komisioneri në bashkëpunim me DAP-in dhe njësitë përgjegjëse në institucionet që evidentohen raste të tilla, të shqyrtojnë mundësinë për sistemimin e tyre në një nga pozicionet e punës të të njëjtës kategori, të cilat rezultojnë të lira, në një institucion të shërbimit civil dhe ku i plotësojnë kriteret.".* Nëse i referohemi relacionit të hartuar nga KMSHC, është kryer një analizë e hollësishme statistikore lidhur me institucionet që disponojnë vendime gjyqësore pas vitit 2014, nivelin e ekzekutimit të tyre dhe numrin e çështjeve që ende janë në pritje.

Deri në datën 31.12.2018, sipas raportimit në relacion:

Institucioni	Vendime gjyqësore të formës së prerë	Nëpunës të sistemuar	Nëpunës në pritje
Administrata Shtetërore	309	100	209
Administrata vendore	152	62	90
Institucione te pavarura	16	4	12
Total	**477**	**166**	**311**

Deri në 31.12.2019,sipas raportimit në relacion:

Institucioni	Vendime gjyqësore të formës së prerë	Nëpunës të sistemuar	Nëpunës në pritje
Ministritë	165	58	107
DPD	30	30	0
DPT	187	44	143
Total	**382**	**132**	**250**

Nëse i referohemi vlerave monetare, rezulton se deri ne fund të 2019, vetëm nga ministritë (në total 11) janë paguar **540,515 mijë** lekë për nëpunësit gjyqfitues. Për sa i përket relacionit të vitit 2021, i cili paraqet situatën deri ne fund të vitit 2020, fokusi është vendosur në të dhënat e raportuara nga njësitë vendore, pasi në këtë raport nuk janë reflektuar të dhëna

lidhur me nëpunësit civil në procese gjyqësore për institucionet e administratës qendrore, të varësisë apo të pavarura, por vetëm ato të vendorit. Të dhënat për ekzekutimin e vendimeve për periudhën 26.02.2020-31.12.2020 për njësitë vendore paraqiten:

Institucioni	Vendime gjyqësore të formës së prerë	Ekzekutuar	Në listë pritje
Bashkitë	143	57	86
Këshilla qarku	79	56	23

Për institucionet qendrore në raport përcaktohet se komisioneri ka zhvilluar në selinë e tij seanca dëgjimore me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga DAP dhe institucionet përkatëse, për punonjësit e listuar në listë pritje që ende nuk janë sistemuar, ku kanë përfunduar për ministritë e linjës dhe varësitë e tyre, ku në përfundim nga ana e Komisionerit janë lënë detyra konkrete për institucionin dhe DAP, për tâu realizuar brenda një afati kohor. Këto detyra duhet të lihen tek Komisionet e Posaçme, të ngritura për ekzekutimin e vendimeve dhe rast pas rasti tek nëpunësit e ngarkuar në këtë proces. Grupi i auditimit kërkoi nga KMSHC gjurmët e auditimit për këto procese, për të shqyrtuar detyrat e lëna lidhur me sistemimin e punonjësve gjyqfitues dhe realizimin e tyre nga institucionet respektive. Seancat dëgjimore janë realizuar në të gjitha ministritë, por grupit të auditimit i është vendosur në dispozicion dosja vetëm për MASR, situata në të cilën rezulton si më poshtë:

1. Ministria e Arsimit

Në dosjen e vendosur në dispozicion, disponohen dokumentacionet e mëposhtme:

- Dosjet e punonjësve
- Formularë e përshkrimit të pozicioneve të punës;
- Struktura organizative e institucionit, dhe ndryshimet e kryera ;
- Struktura emërore ku janë identifikuar vakancat;

-Në dosje disponohet procesverbali me nr.3603/1, prot në datë 29.03.2019, ku kanë qenë të pranishëm anëtarët e komisionit të posaçëm për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë pranë MASR. Në vijim të tij është marë vendimi nr.1, datë 29.03.2019. Në këtë procesverbal është përcaktuar se komisioni ka shqyrtuar vendimet e nëpunësve gjyqfitues si më poshtë:

1-A. K., ish specialiste e Sektorit të Planifikimit dhe Monitorimit të Investimeve, sipas vendimit nr.440, datë **05.03.2015** të Gjykatës së Apelit, por ky pozicion nuk është më vakant dhe është sygjeruar sistemimi i saj në një institucion të varësisë, përkatësisht përgjegjëse sektori në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse në Inspektoriatin Shtetëror të Arsimit.

2-E. K., ish specialiste në Sektorin e Shërbimeve Juridike, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, sipas vendimit nr.1712, datë **07.07.2015** të Gjykatës së Apelit, por ky pozicion nuk është më vakant dhe është sygjeruar sistemimi i saj në një institucion të varësisë, përkatësisht specialist në Sektorin e Shërbimeve të Përgjithshme në DAR Tiranë.

3-E. K. ish Përgjegjëse Sektori në Sektorin e Analizës së Politikave dhe Strategjive në Drejtorinë e Politikave dhe Programeve Ndërkombëtare, sipas vendimit nr.2482, datë **19.11.2015** të Gjykatës së Apelit, por ky pozicion nuk është më vakant dhe është sygjeruar sistemimi i saj në një institucion të varësisë, përkatësisht Përgjegjës Sektori në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse në ZA Kamëz.

4- A. A. ish përgjegjës sektori në Sektorin e Publikimeve dhe Marketingut, Drejtoria e Publikimit dhe Komunikimit, sipas vendimit nr.1974, datë **11.05.2017** të Gjykatës së Apelit, por ky pozicion nuk është më vakant dhe është sygjeruar sistemimi i saj në një institucion të varësisë, përkatësisht specialist në Sektorin e Kualifikimit dhe Cilësisë dhe ZA Kamëz.

5-N. M. ish përgjegjës sektori në Sektorin e Vlerësimit dhe Monitorimit të Cilësisë, Drejtoria e Edukimit Parauniversitar, sipas vendimit nr.3982, datë **10.07.2014** të Gjykatës së Apelit, por ky pozicion nuk është më vakant dhe është sygjeruar sistemimi i saj si Përgjegjës sektori

në Sektorin e Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve për Arsimin Parauniversitar në Drejtorinë e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

6. Z. D. S., ish specialist në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm, sipas vendimit nr.602, datë **11.03.2014** të Gjykatës së Apelit, dhe ky pozicion rezulton vakant dhe është propozuar sistemimi i tij në të.

Për punonjësit e mëposhtëm, Komisioni nuk ka mundur të identifikojë pozicione që i përputhen formimit të tyre, dhe në kushtet kur pozicionet që kanë mbajtur më parë nuk janë më vakante, i është propozuar DAP të shqyrtojë sistemimin e tyre.

7. Z. A. Zh., ish specialist /sekretar i Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akadamike, sipas vendimit nr.1861, datë **09.04.2015** të Gjykatës së Apelit.

8. Z. S. M., ish specialist në Sektorin e Planifikimit dhe Monitorimit të Investimeve, sipas vendimit nr.2751, datë **17.12.2015** të Gjykatës së Apelit.

9. Z. Z. E., ish specialist në Sektorin e Komunikimit, Drejtoria e Publikimit dhe Komunikimit, sipas vendimit nr.2751, datë **17.12.2015** të Gjykatës së Apelit.

10. Znj. Sh. N., ish përgjegjëse sektori në Sektorin e Planifikimit dhe Monitorimit të Investimeve, sipas vendimit nr.3048, datë **15.07.2015** të Gjykatës së Apelit.

11. Znj. M. P., ish Drejtor në Drejtorinë e Komunikimit dhe Publikimeve, sipas vendimit nr.230, datë **11.02.2015** të Gjykatës së Apelit.

Në dosje, dokumentacion i parë i kërkuar nga Komisioneri paraqitet sipas shkresës nr.572, prot datë 26.04.2019, ku kërkohen të dhëna të detajuara për ekzekutimin e vendimeve.

-Në shkresën nr.4737/1, prot datë 28.05.2019 e MASR ku është përcjellë vetëm një pjesë e informacioneve të kërkuara.

-Me shkresën nr.572/2, prot datë 19.09.2019 drejtuar MASR , KMSHC ka kërkuar informacion në lidhje me vijueshmërinë e procesit të mbikëqyrjes së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për kthimin në detyrë të nëpunësve gjyqfitues. Në këtë shkresë është konstatuar se ka përfunduar faza e dytë e këtij procesi që kanë konsistuar në administrimin e të dhënave të përgjithshme, dhe deri në këto momente MASR nuk ka mundur të sistemojë 11 vendime të formës së prerë, për të cilat është urdhëruar sistemim. Seanca dëgjimore është parashikuar të kryhet në 10.10.2019.

-Në memon e datës 26.09.2019 të sektorit të financës në MASR, është informuar Sekretari i Përgjithshëm i MASR se deri në datën 31.08.2019, nga buxheti i aparatit të MASR janë likuiduar 46 milion lekë për 11 punonjësit më sipër, ndërkohë që për punonjësit e pa sistemuar (6 prej tyre) detyrimi vazhdon.

-Në vijim të kësaj shkrese, MASR me shkresën nr. 8662/1, prot datë 01.10.2019 ka përcjellë informacion, dhe bashkëlidhur rezultojnë vërtetimet e dërguar nga ISSH për pagesat e kontributeve shoqërore të këtyre punonjësve, i cili më parë është dërguar nga ISSH me shkresën nr. 1781/1, prot datë 04.03.2019 informacion lidhur me pagesat e kontributeve shoqërore për punonjësit gjyqfitues (11 punonjës).

-Seanca dëgjimore është zhvilluar në 10.10.2019, sipas procesverbalit të mbajtur në këtë date i cili nuk është i protokolluar dhe firmosur vetëm nga D. G., operator (pra mbajtës i protokollit), dhe jo të pranishmit e tjerë. Në këtë seancë është trajtuar problematika për sistemimin e 6 punonjësve gjyqfitues të mbetur, pasi 5 prej totalit në fillim janë sistemuar. Përfaqësuesit e MASR kanë konstatuar se për këta punonjës të pa sistemuar po shqyrtohet mundësia për tëju drejtuar DAP.

Mbledhja e ardhshme për diskutimin edhe të legjislacionit është parashikuar në 28.10.2019.

-Në dosje disponohet shkresa e përcjellë nga MASR për DAP, nr.10018/1 prot datë 19.11.2019 në të cilin përcaktohet se në mbledhjen e datës 07.11.2019, komisioni ka shqyrtuar mundësinë e sistemimit të 6 punonjësve, po për 3 prej tyre ka qenë e pamundur të sistemohen për shkak të profilit të tyre, dhe i është kërkuar DAP sistemimi i tyre.

Bashkëlidhur edhe 3 shkresat për propozimet e punonjësve për sistemimin e tyre në MASR ose institucione nën varësinë e saj.
Janë sistemuar punonjësit si më poshtë gjatë vitit 2019:

1. A. A., vendimi i gjykatës së apelit në vitin 2017, me akt emërimi datë 25.04.2019.
2. D. S., vendimi i gjykatës së apelit në vitin 2014, me akt emërimi datë 30.04.2019.
3. A. K., vendimi i gjykatës së apelit në vitin 2015, me akt emërimi datë 16.05.2019.
4. N. M., me akt emërimi datë 17.05.2019.
5. E. K., me akt emërimi datë 07.06.2019.

-Me shkresën nr.158, prot datë 04.02.2020 të KMSHC është përcjellë për MASR, DAP informacioni se sikundër është rënë dakord në seancën dëgjimore, nga institucionet do të përcillet informacion mbi ecurinë e ekzekutimit të detyrave të lëna nga Komisioneri lidhur me vendimet gjyqësore, dhe është konstatuar se për 6 rastet e pa sistemuara, të përcillen propozime konkrete brenda datës 11 Mars për sistemimin e tyre. I njëjti informacion është përcjellë edhe pranë DAP ku është kërkuar ecuria lidhur me këtë proces dhe informimi i Komisionerit brenda datës 13 Mars. Në këtë shkresë të Komisionerit është përcaktuar se në rast se nuk do të zbatohen afatet, nga ana e KMSHC do të ndërmerren masa ndëshkuese për personat përgjegjës.
-Me shkresën nr. 999/2, prot datë 21.02.2020 të MASR është përcjellë për Komisionerin informacioni se Komisioni i Posaçëm në MASR do të mblidhet në 03.03.2020.
-Në procesverbalin e datës 24.02.2020, prot nr.1539, mes Inspektorit të KMSHC dhe Drejtorit të Përgjithshëm në MASR, është deklaruar se nga DAP ende nuk është bërë i mundur sistemimi i 6 punonjësve. Për 5 punonjësit e sistemuar është kryer likuidimi i tyre i plotë deri në fund të 2019 në vlerën 20,408 mijë lekë, dhe për 6 të tjerët është likuiduar vlera prej 26,284 mijë lekë dhe mbetet ende një pjesë e pa likuiduar, e cila deri në fund të vitit 2019 është 3,725 mijë lekë por referuar faktit se këta janë të pa sistemuar, detyrimi vazhdon.
Në dosje nuk ka asnjë informacion të mëtejshëm për ecurinë e këtij procesi deri në përfundim të periudhës së auditimit, i kërkuar nga grupi verbalisht dhe zyrtarisht.

a.2.2 Inspektime në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin

Viti 2019

Për sa i përket procesit të **inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore**, si dhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, të kryera përgjatë vitit 2018 nga KMSHC, grupi i auditimit shqyrtoi konstatoi se:
-Në programet e inspektimeve, nuk evidentohet data në të cilën inspektorët do të paraqiten në institucion për të kryer verifikimet e nevojshme.
-Akti i inspektimit nuk paracaktohet se sa kohë pas programit do të mbahet.
-Gjithashtu, për këto lloj inspektimesh, procesi ka konkluduar me relacione përfundimtare (pra jo raporte përfundimtare, projektraporte sikundër veprohet në rastin e mbikëqyrjeve të përgjithshme).
-Vendimet përfundimtare datojnë 2 muaj pas mbajtës së akt konstatimeve, në mungesë të afateve konkrete të përcaktuara në rregullore.
-Nuk rezulton e dokumentuar puna e kryer përgjatë kësaj kohe 2 mujore. Nga komunikimet verbale me subjektin e audituar, u bëmë me dije se kjo periudhë pritjeje, shërben për institucionin objekt inspektimi tematik, për dërgimin e informacioneve të cilat janë identifikuar si parregullsi nga KMSHC në momentin e mbajtjes së akteve, megjithatë në rregullore nuk ka përcaktime për këtë proces të ndjekur.

a. 2.3 Inspektimet për punonjësit që kanë mbushur moshën e pensionit

Për sa i përket inspektimeve për **punonjësit që kanë mbushur moshën e pensionit** të shtrirë në Ministri, Institucione të pavarura dhe Njësitë vendore, KMSHC për periudhën 2019-2020 ka përcjellë në mënyrë të vazhdueshme listën e institucioneve që disponojnë punonjës, për të cilët duhet të ndërmerren masat në përputhje me ligjin; duke bërë dhe ndjekjen e këtij procesi për institucionet respektive.

a. 2.4 Për sa i përket ristrukturimit të institucioneve

Në zbatim të përcaktimeve të nenit 11 e në vazhdim të ligjit nr. 152/2013 Për nëpunësit Civil, i ndryshuar, ku renditen përgjegjësitë e Komisionerit për garantimin e mbikëqyrjes së ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, si dhe duke u nisur ristrukturimet e kryera në disa institucione (që kanë përfshirë aspekte që lidhen me ndryshimin e strukturës pasuar me apo pa ndryshime të statusit nga ñnëpunës civilò në ñkodin e punësò), grupi i auditimit kërkoi informacion mbi rolin e KMSHC gjatë këtij procesi, si dhe nëse është kërkuar një informacion paraprak nga autoritetet vendimmarrëse të ristrukturimit, për vlerësimin e efekteve të pritshme nga ky proces (ku përmendim edhe Drejtoritë Arsimore, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, etj).

Në mënyrë verbale nga ana e institucionit u bëmë me dije se KMSHC ka mbikëqyrur procesin në rastin e **bashkive**, dhe **ministrive** gjatë periudhës 2017-2018. Në rastin e reformës territoriale, KMSHC ka përcjellë në vitin 2018 një shkresë informuese drejtuar njësive të vetëqeverisjes vendore, Këshillave Bashkiake, Prefekturave, Ministrisë së Brendshme, dhe Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes vendore, me lëndë: ñ*Në vëmendjen tuaj në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil, në zbatim të ligjit nr.152/2013 Për nëpunësin civil, i ndryshuar, gjatë procesit të miratimit të strukturës së institucionit për vitin 2018*ò. Gjithashtu, institucioni ka asistuar në mënyrë të vazhdueshme me këto njësi gjatë këtij procesi.

Në rastin e ristrukturimit të ministrive, është filluar monitorimi në zbatim të ligjit nr.152/2013 *"Për nëpunësin civil i ndryshuar dhe të akteve nënligjore, gjatë aplikimit të procedurave në lidhje me procesin e riorganizimit të institucioneve të administratës shtetërore (mbylljes dhe ristrukturimit), pas miratimit të përbërjes së Këshillit të Ministrave*ò. Për këtë, grupi i auditimit ka kërkuar dosjet/evidencat sipas së cilave është kryer monitorimi i procesit të ristrukturimit në ministritë respektive. Nga auditimi konstatohet se, në rastin e këtyre monitorimeve procesi është iniciuar në vitin 2017 (me fillimin e ristrukturimit) dhe ka konkluduar në vitin 2018. Procesi i ndjekur në këtë rast rezulton gjithashtu i pa paracaktuar në rregullore, se si do të konkludojë si dhe dokumentacionet e nevojshme qe do të shërbejnë si gjurmë për këtë proces. Puna në terren e punonjësve është dokumentuar me një akt konstatim, gjithashtu pjesë e dosjes janë dokumentacione të ministrive si struktura organizative, rregulloret, etj. Konkretisht, këto monitorime kanë konkluduar me hartimin e një relacioni nga grupi i punës, i cili është vijuar me raportin e miratuar nga Komisioneri me rekomandimet përkatëse. Pra, në këtë rast procesi i mbikëqyrjes ka përfunduar me hartimin e raportit nga KMSHC, pa një vendim final sikundër ishte procedura e ndjekur në mbikëqyrjen e përgjithshme. Këtu evidentojmë sërisht mos përcaktimet eksplicite në rregullore për procesin dhe dokumentacionet që duhet të hartohen .

Më hollësisht:

Ministria e Kulturës

Në zbatim të urdhrit nr.85, prot datë 09.10.2017 ñ*Për fillimin e monitorimit në zbatim të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil i ndryshuar dhe të akteve nënligjore, gjatë aplikimit të procedurave në lidhje me procesin e riorganizimit të institucioneve të administratës shtetërore (mbylljes dhe ristrukturimit), pas miratimit të përbërjes së Këshillit të Ministrave"* është mbajtur nga grupi i punës procesverbali në Ministrinë e Kulturës datë 09.02.2018 (i pa protokolluar). Relacioni mbi zbatimin e urdhrit në monitorimin e kryer në Ministrinë e

Kulturës., nr.516, është mbajtur në datë 11.06.2018. Raporti i monitorimit i përcjellë për Ministrinë e Kulturës është përcjellë sipas shkresës nr.516/1, prot datë 25.09.2018. Në relacionin e përgatitur nga inspektorët janë evidentuar edhe rekomandimet që duhet të lihen për çështjen, një nga të cilat lidhet me ndjekjen e një procedure ankimuese të një punonjëseje që është larguar si pasojë e ristrukturimit.

Ministria e Brendshme

Në dosjen e vendosur në dispozicion evidentohet mungesa e procesverbalit me subjektin për të dokumentuar takimin apo punën e KMSHC në këtë institucion, por në relacion përcaktohet se është kryer një takim në subjekt në 05.02.2018. Relacioni është përcjellë me shkresën nr. 525, prot datë 14.06.2018, i firmosur vetëm nga njëri prej inspektorëve të përfshirë në këtë proces. Raporti i monitorimit është përcjellë me shkresën nr.525/1, prot datë 13.09.2018, ku është konkluduar se të gjithë procedurat kanë qenë të rregullta dhe nuk janë lënë rekomandime.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Procesverbali me subjektin mbajtur në 06.02.2018, dhe rezulton i pa protokolluar**.** Relacioni për konkluzionet është hartuar nga grupi i punës sipas shkresës nr.496, prot datë 04.06.2018. Raporti për monitorimin i miratuar nga Komisioneri është përcjellë sipas shkresës nr. 496/1, prot datë 24.09.2018. Konstatohet se në këtë rast problematikat e largimit të disa punonjësve, të cilat janë në procese gjyqësore me Ministrinë janë evidentuar nga KMSHC në raport, por nuk janë bërë pjesë e rekomandimeve për subjektin, kjo duke cituar se këto procese janë nën shqyrtim nga një organ tjetër dhe nuk mund të lihen rekomandime nga KMSHC.

a.2. 5 Lidhur me mbikëqyrjen e sjelljes së nëpunësve gjatë fushatave elektorale

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të kompetencës ligjore për të mbikëqyrur administrimin e shërbimit civil, bazuar në nenin 14 dhe 15 të ligjit nr.152/2013, òPër nëpunësin civilò, i ndryshuar, në kushtet e zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë, si dhe duke vlerësuar faktin se, institute të ndryshme të ligjit për nëpunësin civil do të bëheshin efektiv gjatë fushatës zgjedhore, të tilla si pezullimi, masat disiplinore, si dhe realizimi i veprimtarive të jashtme të nëpunësve civilë, (në kuadrin e pjesëmarrjes së tyre në administratën zgjedhore), ka kryer mbikëqyrjet respektive në institucione. Nga verifikimi i dokumentacioneve të vendosura në dispozicion të këtij procesi gjatë vitit 2019 dhe 2017, një ndër çështjet e evidentuara nga grupi i auditimit është shtrirja e gjerë e kësaj mbikqyrjeje, dhe mbulimi realisht i mundshëm i KMSHC, duke marë në konsideratë numrin e njësive të përfshira dhe stafit të KMSHC. Procesi, si në zgjedhjet e vitit 2017 dhe 2019 ka konkluduar pa evidentuar parregullsi esenciale, por duke sjellë në vëmendje nevojën për kryerjen e ndryshimeve të nevojshme në ligj për këtë proces për harmonizimin e dispozitave që rregullojnë subjektet zgjedhore, në Kodin Zgjedhor, në mënyrë që ato të vendosen në koherencë me ligjin për nëpunësin civil, i cili i njeh nëpunësit civil që kandidon, pavarësisht nivelit të tij në hierarkinë e shërbimit civil, të drejtën e pezullimit nga shërbimi civil dhe nuk e detyron për tâu dorëhequr.

Grupi i auditimit kërkoi informacion mbi rekomandimet konkrete për përmirësimet ligjore të lëna nga KMSHC, si për këtë rast dhe në çështje të tjera (nëse ka patur) por ky informacion nuk u vendos në dispozicion. Për problematikat e evidentuara gjatë procesit, në raportet respektive është bërë me dije se ky proces do të ndiqet në vijim, dhe grupi kërkoi informacion për këto monitorime(nëse janë kryer), informacion që nuk u vendos në dispozicion. Referuar mbikëqyrjeve të kryera nga KMSHC për administrimin e shërbimit civil dhe monitorimin e sjelljes së nëpunësit civil në kushtet e zgjedhjeve politike, nën gjykimin e grupit të auditimit fizikisht është e vështirë për një institucion me **12 inspektorë** të përfshirë në këtë proces në vitin 2017, dhe **10 inspektorë** në vitin 2019, në kushtet kur njëkohësisht duhet të kryejnë

edhe detyra të tjera funksionale qe lidhen me objektin e veprimtarisë se KMSHC, të mundin të mbikëqyrin **285 institucione** me 12302 nëpunës civil për një periudhë 1 mujore (25.05.2017- 23.06.2017) për zgjedhjet e vitit 2017; dhe **208 institucione** që kanë të punësuar 12758 nëpunës civil për periudhën l9.04.2019 ï 30.06.2019. Sipas raporteve respektive, stafi i KMSHC i përfshirë në këtë proces për vitin 2017 në një periudhë 1 mujore para zgjedhore, ka kryer sondazhe në 77 subjekte, me një numër prej 4217 nëpunësish civilë, dhe në vitin 2019 sondazhet janë kryer në 89 subjekte, me një numër prej 3563 nëpunës.

Më hollësisht:

Viti 2017

Në përfundim të mbikëqyrjes është hartuar raporti ñPër *mbikëqyrjen e administrimit të shërbimit civil dhe monitorimin e sjelljes së nëpunësit civil në kushtet e zgjedhjeve politike për Kuvendin e Shqipërisë 5 Maj - 30 Qershor 2017 Tiranë*ò, Qershor 2017 për periudhën 25.05.2017- 23.06.2017;

Në mbikëqyrje, janë përfshirë 285 institucione me 12302 nëpunës civilë, sipas kësaj tipologjie:

➢ 212 Institucione të Administratës Shtetërore:

a. Kryeministria
b. 16 Ministri
c. 183 Institucione varësie
d. 12 Prefektura

➢ 73 Njësi të Qeverisjes Vendore (NJQV):

a. 61 Bashki
b. 12 Këshilla Qarku

Janë ngritur nga institucionet 166 Grupe Monitorimi, të cilët në mënyrë korrekte, kanë komunikuar në vijimësi, gjatë gjithë periudhës zgjedhore me Komisionerin, nëpërmjet koordinatorit të emëruar nga titullari i institucionit dhe në përbërjen e tyre kanë vepruar 584 nëpunës civilë. Komisioneri ka kaluar në fazën e tjetër të procesit të monitorimit, duke komunikuar në mënyrë periodike me grupet e monitorimit dhe duke i mbikëqyrur çdo ditë institucionet, nga inspektorët e grupit të gatshëm. Nga ana tjetër, në lidhje me mungesat pa arsye, rezulton se nga grupet e monitorimit janë **raportuar 270 raste të tilla.** Ky përfundim mbështetet në të dhënat e administruara gjatë sondazheve që janë kryer në **77 subjekte**, me një numër prej **4217 nëpunësish civilë**, ku së bashku me grupin e monitorimit, kanë qenë prezent edhe inspektorët e Komisionerit, dhe në përfundim, janë konstatuar **vetëm 6 raste të** mungesave të pa justifikuara dhe **728 raste** të mungesave të justifikuara, në 1 ditë pune. Për mungesat pa arsye në raport thuhet se, aktualisht janë duke u verifikuar edhe nga ana e Komisionerit dhe në përfundim të hetimit administrativ, nëse konstaton parregullsi, do t'i drejtohet në mënyrë institucionale, organeve të disiplinës, nëse konstaton se nuk është vepruar nga grupet e monitorimit. Në raport është analizuar një rast në të cilin është kërkuar interpretim nga DPD për kryerjen e procedurave për 3 punonjës për të cilët ka ardhur nga MFE kërkesa për pezullim pasi kanë marë pjesë në fushatë zgjedhore dokumentuar me foto, dhe janë në procedim penal në Prokurori, por Komisioneri ka konkluduar se veprimtaria ka qenë në ditë pushimi, dhe faktin se ndalimet që kanë të bëjnë me sjelljen e nëpunësit civil gjatë procesit zgjedhor, për shkak të kufizimeve të vendosura në nenin 37 të ligjit për nëpunësin civil, nuk duhet të çojnë në një interpretim të zgjeruar të kësaj dispozite, duke i ndaluar kategorikisht nëpunësit civilë të marrin pjesë në veprimtari politike, apo në organizime zgjedhore të subjekteve politike edhe jashtë orarit zyrtar, pasi kjo e drejtë e tyre, buron nga e drejta që ata kanë për të zgjedhur alternativën qeverisëse, çfka arrihet duke dëgjuar subjektet zgjedhore dhe programet që ata paraqesin. Në interpretim të dispozitës ligjore që rregullon të drejtat politike të nëpunësve civilë, Komisioneri vlerëson se, nëpunësit

civil, nuk kanë asnjë pengesë ligjore, që të marrin pjesë në organizime elektorale të subjekteve të ndryshme zgjedhore, por gjithmonë jashtë orarit zyrtar dhe duke u kujdesur që të ushtrojnë vetëkontroll për sa i përket manifestimit në publik të pikëpamjeve politike dhe besnikërisë në një forcë politike në jetën private. Komisioneri i ka kushtuar edhe verifikimit të informacioneve lidhur me pretendime për parregullsi në sjelljen e nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhor. Burimet e informacionit kanë qenë të ndryshme, ndër të cilat mediat, qytetarët dhe nëpunësit civilë. Në këtë rast u përfundua hetimi administrativ me vendim të Komisionerit, pasi nuk u gjendën rrethana që të vërtetonin shkelje disiplinore në ngarkim të punonjësit në fjalë:

1. Drejtoria Rajonale te Tatimeve, Kukës (denoncim nga qytetari)
2. Bashkia Berat.

Në raport janë trajtuar 7 raste të pezullimit të punonjësve, për disa nëpunës, ku është urdhëruar nga titullari i institucionit, në tejkalim të hapur të kompetencave ligjore, për të cilat konkluzioni i KMSHC ka qenë se aktet administrative që kanë dalë për pezullimin e tyre, janë akte absolutisht të pavlefshme të dala në kundërshtim flagrant me ligjin nr. 152/2013 ñPër nëpunësin civilò, i ndryshuar, i cili në nenet 53 deri 56, E njëjta gjë është konstatuar edhe për 2 raste të masave disiplinore. Lidhur me kallëzimet penale është thënë se ky proces i nisur, do të ndiqet me një vëmendje të veçantë nga Komisioneri dhe në përfundim të çështjes nga ana e Prokurorisë, apo Gjykatës, do të verifikojë rastet e përfunduara me mos fillim të çështjes penale, për mungese të elementeve të veprës penale. Kjo analizë do të bëhet në funksion të transparencës dhe të mbrojtjes së interesave të nëpunësve civile, të cilët duhet të ushtrojnë në kushte normale pune detyrën e tyre, të pa ndikuar nga presione të çdo lloj natyre. Aktualisht Komisioneri ka marrë informacion nga 69 institucione, ndërkohë që vijojnë të vijnë informacione të tjera dhe ka rezultuar se në 3 raste është regjistruar kallëzim penal me subjekt nëpunës civilë, nga të cilët në 1 rast, punonjësi është pjesë e administratës doganore, në 1 rast, punonjës i Drejtorisë Rajonale të Arsimit dhe 1 rast punonjës i Zyrës Arsimore.

Viti 2019

Raporti ñ*Për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për nëpunësin civil në periudhën elektorale të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë, 9 Prill - 30 Qershor 2019*ò, miratuar në korrik 2019. Në mbikëqyrje janë përfshinë të gjitha institucionet, të cilat punësojnë nëpunës civilë:

208 institucione që kanë të punësuar **12758** nëpunës civilë:

- Kryeministria,
- 11 Ministritë e Linjës,
- 93 institucionet në varësi të Kryeministrisë dhe Ministrive të Linjës (*administrata shtetërore*), 18 Institucionet e Pavarura,
- Njësitë e Qeverisjes Vendore, ku përfshihen 61 Bashkitë dhe 12 Këshillat e Qarkut, 12 Prefektura.

Nga ana tjetër, në lidhje me mungesat pa arsye, rezulton se nga grupet e monitorimit janë raportuar **138** raste të tilla dhe mesatarja ditore e të cilave është **7** mungesa për **12758** nëpunës civilë, ose 0.001 raste në ditë për 1 punonjës, ku kjo shifër paraqitet e papërfillshme dhe vlerësohet si e arsyeshme në normalitetin e punës së përditshme të administratës. Nga verifikimet e kryera për këto raste nuk rezultoi ndonjë e dhënë që këto mungesa të kenë lidhje me tubime të paligjshme apo pjesëmarrje në veprimtari politike në mbështetje të një partie politike apo kandidati në zgjedhje. Këto raste janë në ndjekje nga Komisioneri dhe në përputhje me rrethanat do të mbahet qëndrim sipas ligjit. Në zbatim të urdhrit nr. 53, datë 07.06.2019, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ñ*Për fillimin e procesit të monitorimit në subjekt të emërimeve të reja, largimeve nga puna dhe sjelljes së nëpunësve civilë, gjatë fushatës zgjedhore për njësitë e qeverisjes vendore*ò, u realizua kontroll i

prezencës në punë, nëpërmjet sondazheve të kryera në subjekt në datat 10.06.2019 - 14.06.2019 dhe 25.06.2019 - 27.06.2019. Gjatë këtij procesi, grupet e inspektimit të Komisionerit, në bashkëpunim me grupet e monitorimit të institucioneve përkatëse, verifikuan zbatimin e ligjit në institucionet e shërbimit civil, në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale, duke monitoruar sjelljen e nëpunësve civilë gjatë orarit zyrtar të punës. Në sondazhin e kryer gjatë kësaj periudhe, u monitoruan **89** subjekte, me një numër prej **3563** nëpunës civilë, nga të cilët **42** janë institucione të njësisë së qeverisjes vendore dhe **47** janë institucione varësie të administratës shtetërore. Monitorimi është fokusuar në verifikimin e mënyrës së plotësimit të ñAkt-konstatimitò prej grupit të monitorimit, duke administruar gjithë dokumentacionin provues në lidhje me mungesat dhe lëvizjet e justifikuara të nëpunësve gjatë orarit të punës. Njëkohësisht, gjatë sondazhit të realizuar në institucionet e mësipërme, u verifikuan rastet e emërimeve dhe largimeve të nëpunësve nga shërbimi civil, si dhe rastet e dhënies së masave disiplinore apo fillimit të ecurisë disiplinore, të dhëna të cilat janë materializuar në procesverbalet e nënshkruara nga grupi i monitorimit dhe nga inspektorët e KMSHC-së. gjatë sondazhit të kryer në **89 subjekte**, janë konstatuar vetëm **3 raste të mungesave të pajustifikuara** dhe 533 raste të mungesave të justifikuara, për 3563 nëpunës civilë të monitoruar në 1 (një) ditë pune. Në raportin vjetor të KMSHC lidhur me këtë çështje, problematikat e konstatuara në mënyrë të përmbledhur paraqiten si më poshtë:

- Në vijim të procesit, nga ana e disa institucioneve u ndërpre komunikimi, duke e justifikuar këtë qëndrim me anulimin e datës së zgjedhjeve nga Presidenti, ç`ka u shoqërua me ndërprerjen e dërgimit të informacioneve ditore si dhe të dhënat e kërkuara nga Komisioneri për **1** institucion i pavarur dhe **9** njësi të qeverisjes vendore: Presidenti i Republikës, Bashkia Shkodër, Bashkia Tropojë, Bashkia Kukës, Bashkia Mallakastër, Bashkia Berat, Bashkia Lezhë, Bashkia Përrenjas, Bashkia Mat, Bashkia Kavajë**.** Ky është një veprim që vjen në kundërshtim me ligjin për nëpunësin civil, e për këtë arsye do të analizohet rast pas rasti dhe do të mbahet qëndrim ndaj personave përgjegjës. Grupi kërkoi informacion për vijueshmërinë e këtij procesi, por nuk u disponua informacion.
- Gjatë procesit të mbikëqyrjes, Komisioneri mori denoncime për përfshirjen e nëpunësve civilë në tubime të paligjshme; veprime të dhunshme para KZAZ-ve, si dhe shprehje të preferencave politike në mbështetje të një force të caktuar politike, ose kandidati në zgjedhje, të cilat u adresuan menjëherë për verifikim pranë organeve të disiplinës në institucionet përkatëse. Ky proces është në ndjekje të vazhdueshme nga Komisioneri. Megjithatë, këto mbetën raste të kufizuara, të nxitura nga rrethana specifike që shoqëruan këtë fushatë zgjedhore dhe nuk ndikojnë në vlerësimin pozitiv të veprimtarisë dhe sjelljes së përgjithshme të nëpunësve civilë.

Komisioneri ka marrë informacion se në njësitë e qeverisjes vendore: *Mat, Klos, Berat, Skrapar* dhe *Delvinë,* kishin ndodhur veprime të dhunshme para KZAZ-ve, si dhe janë shprehur hapur preferenca politike në mbështetje të një partie politike ose kandidati në zgjedhje. Menjëherë, Komisioneri i është drejtuar institucioneve përkatëse për të verifikuar informacionin dhe për të vënë përpara përgjegjësisë personat që kanë kryer veprime në kundërshtim me ligjin. Komisioneri i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me shkresën nr. 111, datë 20.6.2019. Në përgjigje të kërkesës së Komisionerit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me shkresën nr. 5120/1, datë 28.6.2019, ñDërgojmë informacion për nëpunësit të cilët kanë marrë pjesë në veprime të dhunshme apo tubime të paligjshme në KZAZ-të e ndryshme të venditò, ka dërguar informacion se raste të tilla janë vërejtur në 13 njësi të qeverisjes vendore: Kamëz, Selenicë, Delvinë, Përrenjas, Shkodër, Tropojë, Pogradec, Devoll, Berat, Skrapar, Burrel, Klos dhe Mat.

33 raste, ku punonjësit e denoncuar ishin të punësuar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të identifikuar si më poshtë:

Bashkia Mat: Punonjës të kësaj bashkie, kanë shprehur publikisht preferencat e tyre politike, duke marrë pjesë në protestat e dhunshme të organizuara pranë KZAZ-së, nr. 16, në qytetin e Burrelit.
Bashkia Berat: Punonjës të kësaj bashkie kanë shprehur publikisht preferencat e tyre politike, duke marrë pjesë në protestat e dhunshme të organizuara pranë KZAZ-së, nr. 64, në qytetin e Beratit.
Bashkia Skrapar: Punonjës të kësaj bashkie kanë shprehur publikisht preferencat e tyre politike, duke marrë pjesë në protestat e dhunshme të organizuara pranë KZAZ-së, nr. 66, në qytetin e Çorovodës.
Bashkia Delvinë: Punonjës të kësaj bashkie kanë shprehur publikisht preferencat e tyre politike, duke marrë pjesë në një tubim përpara KZAZ-së, nr. 87, në qytetin e Delvinës.
Bashkia Shkodër: Punonjës të kësaj bashkie kanë shprehur publikisht preferencat e tyre politike, duke marrë pjesë në protestat e dhunshme të organizuara pranë KZAZ-së, në qytetin e Shkodrës.
Bashkia Pogradec: në Bashkinë Pogradec, ka shprehur publikisht preferencat e tij politike, duke marrë pjesë në protestat e dhunshme ku ishin depozituar materialet zgjedhore, në qytetin e Pogradecit.
Bashkia Cërrik: ka shprehur publikisht preferencat e tij politike, duke marrë pjesë në protestat e dhunshme ku ishin depozituar materialet zgjedhore, në qytetin e Cërrikut.
Bashkia Selenicë
Bashkia Finiq: Nëpërmjet shprehur publikisht preferencat e tij politike, duke marrë pjesë në protestat e dhunshme pranë KZAZ-së, në qytetin e Selenicës e-mailit të datës 20.6.2019, ka informuar Komisionerin në lidhje me një situatë të dhunshme, të ushtruar ndaj anëtarëve të KZAZ-së nr. 89 - Livadhja, në Njësinë Administrative Livadhja, Bashkia Finiq.
Në këto kushte, për të gjitha institucionet e përmendura më sipër është kërkuar menjëherë nga Njësia e Burimeve Njerëzore, që ndaj nëpunësve të mësipërm të fillojë menjëherë ecuria disiplinore dhe të kërkohet nga Komisioni i Disiplinës, shqyrtimi me përparësi i rastit dhe vënia e tyre para përgjegjësisë disiplinore. Ndërkohë, Komisioneri ka vijuar punën për ndjekjen e zbatimit të detyrave të lëna në lidhje me fillimin e procedurave disiplinore dhe ecurinë e tyre me të gjitha institucionet që kanë pasur raste të tilla.

- Nisur nga analiza e dispozitave që rregullojnë subjektet zgjedhore, në Kodin zgjedhor, i cili ende nuk ka ndryshuar, që kanë të bëjnë kryesisht me përcaktimin e funksioneve të larta në administratë, Komisioneri ashtu si e ka shprehur edhe më parë, mbetet përsëri në qëndrimin se ato duhet të rishikohen, dhe duhet të vendosen në koherencë me ligjin për nëpunësin civil, i cili i njeh nëpunësit civil që kandidon, pavarësisht nivelit të tij në hierarkinë e shërbimit civil, të drejtën e pezullimit nga shërbimi civil dhe nuk e detyron për tâu dorëhequr.

Nëpërmjet raportimeve të ardhura nga koordinatorët e grupeve të monitorimit, të ngritur pranë institucioneve pjesë e shërbimit civil, si dhe nga njësitë përgjegjëse Komisioneri është informuar se, janë shënuar vetëm **16** raste të emërimeve të reja ose transferime, si dhe lirime nga detyra në ***32 raste*** *(dorëheqje/pension pleqërie),* të cilat janë kryer sipas procedurave të ligjit.
Në raport është evidentuar dhe ndjekur 1 rast i largimit te nëpunësit civil padrejtësisht në periudhën e zgjedhjeve, dhe kjo çështje është ndjekur nga Komisioneri.
Konkluzioni final:

- Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nisur nga analiza e të dhënave ditore të dërguara nga Grupet e Monitorimit, të ngritura në 208 institucione që punësojnë nëpunës civilë, si dhe duke pasur parasysh situatën e konstatuar gjatë monitorimit nëpërmjet vizitave në subjekt të veprimtarisë dhe sjelljes së nëpunësit civil gjatë kësaj fushate elektorale për zgjedhjen e organeve vendore, vlerëson në përgjithësi një sjellje korrekte të

nëpunësve civilë, të cilët kanë respektuar parimet, kërkesat dhe procedurat e kërkuara nga ligji për nëpunësin civil.

a.3 Lidhur me inspektimet tematike

Nga auditimi konstatohet se KMSHC ka kryer një numër të konsiderueshëm inspektimesh tematike në institucione, për të cilat në rregullore nuk ka një përcaktim të qartë, si për dokumentimin e përzgjedhjes së institucioneve objekt i këtij procesi, ashtu edhe për kryerjen e tyre (pra, dokumentacionet e nevojshme, afatet, etj). Konkretisht, mbetet e pa përcaktuar, nëse konkluzionet që kanë rezultuar nga inspektimi duhet të formalizohen vetëm me një vendim, apo dhe me raport. Ky konkluzion i grupit mbështetet edhe në faktin se në disa raste të këtyre inspektimeve/mbikëqyrjeve tematike është konkluduar me hartimin e një vendimi nga KMSHC; në disa raste me raport apo relacion të grupit, sikundër do të trajtohen më poshtë disa prej praktikave të ndjekura. Gjithashtu, në rregulloren e procedurave nuk rezulton të përcaktohen afatet për hartimin e raporteve, apo periudha që do të zgjasë inspektimi në terren i inspektorëve, sikundër u trajtua edhe më sipër në rastin e mbikëqyrjeve të përgjithshme.

Më hollësisht, nga përpunimi i të dhënave nga ana e grupit të auditimit, bazuar në informacionin e KMSHC dhe atë të publikuar në web, për sa i përket nivelit të realizimit të inspektimeve/monitorimeve tematike situata rezulton si më poshtë.

Viti 2017

- 33 vendime në vijim të kërkesave/ankesave të punonjësve.
-108 vendime për verifikimin e zbatimit të vendimeve dhe përfundimin e inspektimeve. Në këtë vit, zbatimi i vendimeve është kryer bashke me mbikëqyrjet/inspektimet tematike të radhës.
- Gjatë vitit 2017 nga KMSHC ka dalë 1 vendim për miratim raporti tematik të iniciuar në 2015 dhe përfunduar në 2017 në Bashkinë Tiranë. Bashkia Klos ka nisur në 2017, por nuk disponohet informacion kur ka përfunduar.
- Inspektime tematike të planifikuara por të pa realizuara:

1. Drejtoria e Bujqësisë Vlorë
2. Drejtoria e Bujqësisë Gjirokastër
3. Autoriteti i Aviacionit Civil

Viti 2018

- 16 vendime në vijim të kërkesave/ankesave të punonjësve.
- 23 vendime për përfundimin e inspektimit të verifikimit të zbatimit të vendimeve të Komisionerit.
- 2 mbikëqyrje tematike në Autoritetin e Aviacionit Civil, dhe Bashkia Tiranë.

Viti 2019

- 15 vendime të Komisionarit në vijim të kërkesave të punonjësve;
- 32 vendime të Komisionerit në vijim të verifikimeve të kryera për zbatimin e vendimeve të KMSHC;
- 65 vendime për marrjen e masave për punonjësit që kanë mbushur moshën për pensionin e pleqërisë;
- 59 vendime lidhur me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në bashki.

Viti 2020

- 73 vendime në përfundim të trajtimit të kërkesave të punonjësve.

- 64 vendime në vijim të inspektimeve për zbatimin e rekomandimeve.
- 65 vendime për institucionet në të cilat janë identifikuar parregullsi për punonjësit që kanë mbushur moshën për pensionin e pleqërisë.
- Ka përfunduar inspektim tematik i iniciuar në 2019 në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit.
- Janë përfunduar 2 inspektimet tematike për evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil në vazhdim nga viti 2019.
-1 mbikëqyrje tematike për vendosjen e mesatares ne DAP.
- Mbikëqyrje tematike për zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, ende në proces, i papërfunduar.
- Mbikëqyrje tematike në Departamentin e Administratës Publike, ende në proces, i papërfunduar.
- Bashkia Tropojë- e planifikuar në vitin 2020 po e pa realizuar.

Sipas observacioneve të vendosura në dispozicion nga KMSHC pas dorëzimit të Akt Konstatimit, është raportuar situata e inspektimeve tematike si më poshtë:

Tipologjia e institucioneve të inspektuara për vitin 2020

	Tipologjia e institucioneve të inspektuara me çështje të përfunduara	*Inspektime të filluara kryesisht me kërkesë të nëpunësve*	*Inspektime të filluara me kërkesë të institucioneve*	*TOTALI*
A.	**Institucione të Administratës Qendrore**	***82***	***2***	***84***
	Institucione varësie	73	2	75
	Ministri	9	0	9
B.	**Institucione të Administratës Vendore**	***49***	***1***	***50***
	Këshill Qarku	4	0	4
	Bashki	45	1	46
C.	**Institucione të Pavarura**	***2***	***14***	***16***
	TOTALI (*A + B + C*)	**133**	**17**	**150**

Ndërkohë, që për periudhën objekt auditimi, për vitet *2017, 2018, 2019 dhe 2020*, janë raportuara të inspektuara me këtë lloj mbikëqyrjeje, institucionet sipas kësaj tipologjie:

NIVELI I ADMINISTRATËS			
Kërkesa/ankesa/informacione të regjistruara Gjithsej	**Administrata Shtetërore**	**Administrata vendore**	**Institucione të pavarura**
Në vitin 2020 - *150* raste	84	50	**16**
Në vitin 2019 - *142* raste	104	35	**3**
Në vitin 2018 - *105* raste	71	26	**8**
Në vitin 2017 - *91* raste	**71**	**17**	**3**

Nga ana tjetër lidhur me **mbikqyrje/inspektime orientuese** përfshihen monitorimi *"on line"* i procesit të rekrutimit nga ana e Departamentit të Administratës Publike; monitorimi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë për rikthimin në detyrë të nëpunësve civilë gjyqfitues, monitorimi i sjelljes së nëpunësve civilë gjatë proceseve zgjedhore, monitorimi i zbatimit të ligjit në administratën vendore, etj. Çështjet e ndryshme të trajtuara rast pas rasti, rezultojnë si më poshtë:

1.2 Mbikëqyrjet e orientuara nga plotësimi i pozicioneve të punës nga DAP në institucionet e administratës shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore

Neni 11**:** Plani vjetor dhe planet periodike të mbikëqyrjes/inspektimit Rregullores së Brendshme të KMSHC, në pikën 5 të tij përcakton se: *Procedurat e rekrutimit dhe largimit nga puna në shërbimin civil janë pjesë e përhershme e çdo plani vjetor/periodik të mbikëqyrjes/inspektimit.* Në planin vjetor të KMSHC parashikohet për çdo vit kryerja e **mbikëqyrjes së orientuar** me objekt mbledhjen e informacionit në drejtim të funksionimit të procedurave të konkurrimit planifikuar nga Departamenti i Administratës Publike, në lidhje me a)pranimin në nivelin ekzekutiv në shërbimin civilë b) lëvizjen paralele c) ngritjen në detyrë ç)pranimi në trupën e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues (TND).

Grupi i auditimit shqyrtoi të dhënat e raportuara në relacionet e KMSHC për mbikëqyrjen pranë DAP për periudhën 2017-2020, ku situata paraqitet si më poshtë:

Viti	*Numri i procedurave të rekrutimit (shpalljet)*[14]	*Plani vjetor i numrit të rekrutimeve sipas institucioneve*	*Numri i pozicioneve te plotësuara nga konkurrimet DAP*	*Numri i pozicioneve te plotësuara metoda alternative*	*Total numri i vendeve te plotësuara*
2017	198	1082	351	152	**503**
2018	540	1073	834	92	**926**
2019	422	650	457	106	**563**
2020	804	880	985	121	**1106**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH sipas të dhënave të KMSHC

Nga tabela e mësipërme vihet re se nuk ka një ecuri të qëndrueshme rritjeje të numrit të vendeve të plotësuara nga viti në vit, ku konstatohet se vitet 2018 dhe 2020 kanë patur pothuajse të njëjtin numër vendesh të plotësuara, dhe vitet 2017 dhe 2019, gjysmën e këtyre shifrave. Gjithashtu, edhe për numrin e procedurave të kryera të **rekrutimit**, **për vitin 2020 vihet re një numër tepër i lartë (985 pozicioneve pune të rekrutuara) krahasuar me shpalljet e realizuara në periudhat e mëparshme (804 shpallje të kryera në vitin 2020, dhe 422 shpallje një vit më parë).** Nga KMSHC u bëmë me dije se nuk ka një arsye konkrete që lidhet me këtë situatë, pasi kjo mbetet në autoritetin e DAP, i cili për një arsye ose më tepër mund të shpallë një procedurë disa herë për një pozicion, apo mund të dështojnë procedurat e hapura për shkak të mungesës së aplikantëve që plotësojnë kriteret. Por ajo që vëmë re nga tabela është që nr. i shpalljeve vjen ne rritje në vitin 2020, njëlloj si numri i vendeve te plotësuara, fenomen ky që na bën të kuptojmë se ka pasur realisht rritje në numrin e rekrutimeve, dhe se nuk bëhet thjesht fjalë për rishpallje procedurash rekrutimi.

Nga auditimi konstatohet se monitorimi i kryer nga KMSHC për plotësimin e vendeve të punës nga DAP konsiston në verifikimet online të kryera në faqen e internetit sipas publikimeve respektive. Referuar relacionit të grupit të punës për mbikëqyrjen e orientuar, sipas shkresës nr. 394, prot datë 04.04.2019 (ku është raportuar se ky grup qenë prezent në 30 raste procedurash rekrutimi të përzgjedhura për rekrutimet në nivelin ekzekutiv, me numrin më të lartë të pozicioneve të punës, të shpallura për tâu plotësuar), konstatuam se edhe pse në këtë vit të caktuar ka patur një tentativë për pjesëmarrjen e grupeve nga ana e KMSHC në këto procedura, për këtë proces ka munguar gjurma e auditimit, dhe në vijim (për vitet 2019,2020) nuk është proceduar më në këtë formë.

Kryesisht KMSHC në raportin vjetor, bën një raportim statistikor mbi të dhënat e numrit të shpalljeve, realizimit të tyre, duke mos trajtuar raste konkrete apo procedura të caktuara rekrutimi.

Sipas detajimit të përcjellë nga subjekti i audituar në observacione, verifikimi ñ*online"* i procedurave të konkurrimit, mundëson verifikimin jo vetëm të zbatimit të planit vjetor të rekrutimit, por njëkohësisht gjatë këtij monitorimi verifikohen aspekte të veçanta të zbatimit të ligjit, të tilla si:

- Respektimi i procedurës së publikimit të akteve që materializojnë procedurën e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit në shërbimin civil;
- Kriteret e përgjithshme dhe të posaçme të pozicioneve të punës, të publikuara në aktin e shpalljes, me qëllim evidentimin e rasteve të cilat diskriminojnë konkurrencën e hapur midis kandidatëve apo cenojnë respektimin e parimeve të shërbimit civil të përcaktuara në ligj.
- Zhvillimin e procedurave të konkurrimit për pozicionet e nivelit ekzekutiv, sipas grupimit të tyre në pozicione të administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm;

[14] Numri I shpalljeve jo domosdoshëmrisht përkon me nr e planit te rekrutimeve, pasi nje shpallje mund te perfshije disa procedura brenda

- Mënyrën e klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil, në raport më procedurën e konkurrimit të përdorur për plotësimin e tyre.

Lidhur me verifikimet e kryera nga KMSHC duke analizuar dhe shqyrtuar pretendimet për paligjshmëri të ngritur nga personat pjesëmarrës në këto procedura konkurrimi, për të gjitha vitet objekt auditimi, 2017 ï 2020 për të garantuar ligjshmërinë e procedurave të konkurrimit, në raportin e përcjellë nga Komisioneri për mbikëqyrjen e zhvilluar pranë DAP nuk pasqyrohen rezultatet duke i kryer këto dy procese në mënyrë të pavarur nga njëra tjetra, edhe pse faktikisht ato lidhen me të njëjtën procedurë për institucionin e DAP.

Për sa i përket plotësimit të vendeve të punës në mënyra alternative nga ana e DAP (ekzekutimi i vendimeve gjyqësore), këto procese nuk janë objekt mbikëqyrjeje nga ana e KMSHC, referuar raporteve të hartuara nga institucioni për këtë mbikëqyrje (ku këto evidenca raportohen vetëm statistikisht), por edhe sipas komunikimit verbal nga institucioni u vëmë me dije se numri i vakancave të plotësuara nga këto metoda alternative merret si e dhënë statistikore e gatshme nga DAP.

Më hollësisht, janë shqyrtuar relacionet përkatëse të DAP, si më poshtë:

❖ Për vitin **2017,** fillimi i mbikëqyrjes së orientuar në DAP, është përcaktuar ne vendimin nr.70, datë 04.04.2017, prot nr.254, datë 04.04.2017 të Komisionerit të KMSHC. Dy ditë më vonë me autorizimin nr.254/2, prot datë 06.04.2017 janë autorizuar punonjësit që do të mbikëqyrin këtë proces, si dhe është përcjellë njoftimi për znj. A. K. në Departamentin e Administratës Publike për kryerjen e kësaj mbikëqyrjeje, sipas shkresës nr.254/1, prot datë 06.04.2017. Në përfundim të këtij procesi, me shkresën nr.384, prot datë 03.04.208 është përcjellë informacion nga grupi i punës lidhur me monitorimet e konkurrimeve të kryera përgjatë vitit 2017 në formën e një relacioni. Në këtë material, trajtohen të dhëna statistikore lidhur me numrin e procedurave të konkurrimit të planifikuar dhe realizimi i tyre nga DAP, ku fillimisht janë planifikuar të kryhen rekrutime për **1072** vende vakante, por për shkak të ristrukturimit të ministrive pas zgjedhjeve të vitit 2017, ku nga 19 ministri në 13 ministri, u pasua me shkurtim të përgjithshëm të numrit të pozicioneve të punës, dhe në përfundim mundën të konkludohen vetëm **481** pozicione pune, pra më shumë se gjysma (591 pozicione), mbetën të pa hapura procedurat e konkurrimit sipas planit. Për këto pozicione, KMSHC është shkrehur se një pjesë e tyre është plotësuar sipas procedurave alternative, pra emërime nga lista e fituesve nga konkurrime të mëparshme po që nuk u bë i mundur emërimi si kandidat fitues, emërime nga transferimet e përhershme, dhe emërime në zbatim të vendimeve gjyqësore. Këto procedura nuk rezultojnë të kenë qenë objekt i mbikëqyrjes së KMSHC. Në përfundim, në total nga 1072 pozicione janë plotësuar 503 pozicione. Në vijim grupi i punës ka analizuar ecurinë e pranimit në këto procedura, sipas të dhënave statistikore, ku një ndër problematikat e evidentuara lidhet me mospërcaktim të drejtë të kategorisë së pozicionit nga ajo e ulët drejtuese në e lartë drejtuese, po për shkak se nuk kanë përfunduar procedurat nuk ka patur efekte. Gjithashtu, në këtë raport trajtohet mungesa e aplikimeve në procedura e kandidatëve që gëzojnë statusin e nëpunësit, dhe është përcaktuar se duhet të vlerësohet rekomandimi i DAP për plotësimin e këtyre pozicioneve me procedurë të hapur, pra për persona jashtë shërbimit civil, mirëpo ky rekomandim nuk trajtohet në vendimin final, si dhe përse nuk është bërë gjatë procesit të rekrutimit, por pas përfundimit të tij. KMSHC përcakton se ka monitoruar 481 konkurrime, ku është verifikuar publikimi dhe transparenca e treguar në faqen zyrtare për këto procedura, dhe nuk janë evidentuar probleme, dhe janë respektuar të gjitha kërkesat e ligjit. Lidhur me ankesat e përcjella për DAP gjatë procesit të verifikimit paraprak, grupi i punës ka vlerësuar se të gjitha ankesat janë shqyrtuar, dhe kandidatët që kanë paraqitur ankesa janë përfshirë të gjithë në listat përfundimtare, me të drejtë për të kandiduar. KMSHC e vlerëson kryerjen e shqyrtimit të ankesave në përputhje me ligjin, për sa kohë rritet numri i konkurrentëve pas fazës

respektive, indikator ky që ankesat janë marë parasysh. Në përfundim është vlerësuar se parregullsitë kanë qenë të një karakteri formal dhe nuk prekin thelbin e përmbajtës së rekrutimeve dhe është propozuar përfundimi i mbikqyrjes, miratuar më pas me vendim nr.17, datë 03.04.2018 të Komisionerit, nr.384/1, prot datë 03.04.2018.

- Për vitin **2018**, fillimi i mbikëqyrjes së orientuar në DAP, është përcaktuar ne vendimin nr.7, datë 23.02.2018, prot nr.278, datë 23.02.2018 të Komisionerit të KMSHC. Me autorizimin nr.278/2, prot datë 23.02.2018 janë autorizuar punonjësit që do të mbikëqyrin këtë proces, si dhe më pas është përcjellë njoftimi për znj. A. K. në Departamentin e Administratës Publike për kryerjen e kësaj mbikëqyrjeje, sipas shkresës nr.278/1, prot datë 23.02.2018. Përgjatë vitit janë kryer ndryshime në përbërjen e grupit të punës për mbikëqyrjen e procesit, sipas shkresave nr. 714, prot datë 01.10.2018, si dhe nr. 879, prot datë 03.12.2018.Me shkresën nr. 394, prot datë 04,04,2019 është përcjellë informacioni nga grupi i punës lidhur me mbikëqyrjen e orientuar të kryer pranë DAP. Ky relacion paraqet të dhënat statistikore mbi procedurën e rekrutimit të zhvilluar, të ngjashëm me atë të një viti paraardhës. Risia e trajtuar në këtë raport lidhet me procedurat e rekrutimit të nivelit të lartë drejtues TND, të cilat për herë të parë janë zhvilluar me konkurrim të hapur, konkurs kombëtar për kandidatë edhe jashtë shërbimit civil miratuar me VKM nr.79, datë 29.12.2017, për shkak të mos daljes së grupit të parë të anëtareve të TND nga ASPA. Gjithashtu, në këtë relacion është evidentuar fakti se grupi i punës ka kryer mbikëqyrje duke qenë prezent në 30 raste, të përzgjedhura për rekrutimet në nivelin ekzekutiv, me numrin më të lartë të pozicioneve të punës, të shpallura për tâu plotësuar. Për këtë mbikëqyrje nuk disponohet asnjë gjurmë auditimi për procesin e ndjekur nga përfaqësuesit e KMSHC. Për vitin 2018, për plotësimin e 1072 pozicioneve të punës, janë zhvilluar 540 procedura konkurrimi, nga të cilat janë plotësuar 834 pozicione pune. Gjithashtu, 92 pozicione të tjera pune janë plotësuar duke ndjekur metoda alternative, të cilat sikundër trajtohet më lart nuk kanë qenë objekt i mbikyrjes nga KMSHC. Konkluzionet e mbikëqyrjes kanë qenë të njëjta me një vit paraardhës, ku nuk janë evidentuar parregullsi në publikimin e vendeve, apo trajtimin e ankesave të kandidatëve pranë DAP.
- Për vitin **2019**, fillimi i mbikëqyrjes së orientuar në DAP, është përcaktuar ne vendimin nr.18, datë 25.02.2019, prot nr.325, datë 25.02.2019 të Komisionerit të KMSHC. Me shkresën nr. 222, prot datë 21,02,2020, është hartuar nga grupi i punës një relacion lidhur me ecurinë e mbikëqyrjes. Ky relacion paraqet të dhënat statistikore mbi procedurën e rekrutimit të zhvilluar, të ngjashëm me atë të viteve paraardhëse në evidentimin e problematikave. Risia në raportin e këtij viti ka qenë parregullsia e evidentuar në disa pozicione të nivelit ekzekutiv, ku janë kryer konkurrime individuale, dhe jo sipas ndarjes ligjore të grupimit të pozicioneve të nivelit ekzekutiv në grupime të administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm. Për vitin 2019, për plotësimin e 650 pozicioneve të punës, janë zhvilluar 422 procedura konkurrimi, nga të cilat janë plotësuar 457 pozicione pune. Gjithashtu, 106 pozicione të tjera pune janë plotësuar duke ndjekur metoda alternative, të cilat sikundër trajtohet më lart nuk kanë qenë objekt i mbikëqyrjes nga KMSHC. Konkluzionet e mbikëqyrjes kanë qenë të njëjta me një vit paraardhës, ku nuk janë evidentuar parregullsi në publikimin e vendeve, apo trajtimin e ankesave të kandidatëve pranë DAP.
- Për vitin **2020**, fillimi i mbikëqyrjes së orientuar në DAP, është përcaktuar ne vendimin nr.35, datë 28,05,2020, prot nr.448, datë 28,05,2020 të Komisionerit të KMSHC. Me vendimin nr.22, datë 11,03,2021 pror nr. 400/1, datë 11,03,2021, përcjellë vendimi i Komisionerit, në të cilin paraqiten të dhënat statistikore mbi procedurën e rekrutimit të zhvilluar, të ngjashëm me atë të viteve paraardhëse në evidentimin e problematikave. Risia në raportin e këtij viti ka qenë parregullsia e evidentuar në disa pozicione të nivelit

ekzekutiv, ku janë kryer konkurrime individuale, dhe jo sipas ndarjes ligjore të grupimit të pozicioneve të nivelit ekzekutiv në grupime të administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm. Për vitin 2020, për plotësimin e 877 pozicioneve të punës, janë zhvilluar 804 procedura konkurrimi, nga të cilat janë plotësuar 985 pozicione pune. Gjithashtu, 121 pozicione të tjera pune janë plotësuar duke ndjekur metoda alternative, të cilat sikundër trajtohet më lart nuk kanë qenë objekt i mbikëqyrjes nga KMSHC. Konkluzionet e mbikëqyrjes kanë qenë të njëjta me një vit paraardhës, ku nuk janë evidentuar parregullsi në publikimin e vendeve, apo trajtimin e ankesave të kandidatëve pranë DAP. Për këtë vit, për herë të parë KMSHC ka përcaktuar edhe disa rekomandime në përfundim të mbikëqyrjes për DAP, lidhur me kryerjen e procedurave të konkurrimit për nivelin ekzekutiv, si dhe planifikimin e numrit të pozicioneve të punës, pasi nuk është bërë rishikimi i planit, duke rezultuar kështu në një realizim më të lartë se plani fillestar i vakancave përcaktuar në VKM.

1.3 Monitorimi dhe ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të lëna dhe efektiviteti i tyre

Sipas nenit 2, pika 2.j e Rregullores së Procedurave të Mbikëqyrjes/Inspektimit, pjesë e fushës së veprimit të KMSHC është mbikëqyrja e zbatimit të detyrave të lëna nga mbikëqyrjet e mëparshme, duke kryer **mbikëqyrje/inspektim në vazhdim**. Në nenin 35, të kësaj rregulloreje përcaktohen më hollësisht procedurat që ndiqen nga institucioni për zbatimin e vendimeve dhe afatet përkatëse, konkretisht ñ...*2. Subjekti i mbikëqyrjes/inspektimit/verifikimit apo hetimit administrativ është i detyruar të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për korrigjimin e shkeljeve brenda afatit të përcaktuar dhe, nëse është e nevojshme, të paraqesë edhe provat që vërtetojnë këtë fakt. 3. Nëse Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil e konsideron të arsyeshme, urdhëron kryerjen e një mbikëqyrjeje/inspektimi për të kontrolluar zbatimin e vendimit nga subjekti i mbikëqyrur/inspektuar*.ò. Megjithatë, në rregullore nuk ka një përcaktim për procedurat që do të ndiqen për kryerjen e ndjekjes së zbatimit, dhe si do të raportohet situata. Grupi i auditimit kërkoi informacion mbi metodologjinë e ndjekjes së zbatimit të vendimeve të Komisionerit, pra nëse ka patur ndonjë përcaktim për mënyrën se si duhet të kryhet (në terren apo në bazë të dokumentacioneve të institucioneve), afati kohor i parashikuar, mbulimin e institucioneve për të cilat është verifikuar zbatimi, informacion që nuk u vendos në dispozicion. Grupi i auditimit kërkoi informacion nga KMSHC lidhur me të dhënat statistikore të mbikëqyrjeve/inspektimeve të kryera me objekt verifikimin e zbatimeve të Komisionerit për periudhën objekt auditimi. Nga ana e institucionit nuk disponohej një bazë të dhënash, e ndarë sipas llojeve të mbikëqyrjeve apo inspektimeve të kryera, pasi vendimet e Komisionerit administroheshin së bashku në rend kronologjik, dhe grupi i auditimit së bashku me përfaqësuesit e institucionit u përpoqën të përpunonin këto të dhëna, për të verifikuar nëse janë kryer inspektime për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve apo jo, nga ku rezultoi se:

-Për vitin 2017, nuk ishte e mundur ndarja e mbikëqyrjeve/inspektimeve të kryera për zbatimin e vendimeve, pasi në shumë raste ishte përfshirë në një mbikëqyrje të rradhës edhe verifikimi i zbatimit. Grupi i auditimit nga të dhënat e publikuar në web të vendimeve të Komisionerit, i shqyrtoi këto të dhëna dhe i analizoi për të bërë një ndarje të ecurisë së zbatimit të vendimeve.

Neni 15, pika 1 dhe 2 e Ligjit nr. 152/2013 Për nëpunësin civil (ndryshuar me ligjin nr.178/2014), dhe neni 26 i Rregullores ôMbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit ó përcaktojnë se ô1. *Nëse gjatë mbikëqyrjes, Komisioneri çmon se ka shkelje të ligjit në administrimin e shërbimit civil, me vendim me shkrim, paralajmëron institucionin përkatës, duke i lënë detyrat për përmirësimin e situatës dhe duke përcaktuar një afat të arsyeshëm për zbatimin e tyre. 2. Në rast të moszbatimit të vendimit të dhënë, sipas pikës 1 të këtij neni,*

*Komisioneri mund të gjobisë nëpunësin përgjegjës për moszbatimin e masave. Masa e gjobës është nga 20 për qind deri në 30 për qind të pagës mujore të nëpunësit përgjegjës. Në rast të moszbatimit të mëtejshëm të vendimit, Komisioneri mund të vendosë një gjobë tjetër deri në 50 për qind të pagës mujore të personit përgjegjës.*ó Grupi i auditimit kërkoi informacion nëse nga ana e Komisionerit është konkluduar për dhënien e masës së gjobës në rastet e mos zbatimit të vendimit për periudhën objekt auditimi, ku u informuam se nuk ka patur asnjë rast të tillë.

-Për vitin 2018,2019,2020 rezultojnë të jenë kryer verifikime të zbatimit të vendimeve të Komisionerit sipas tabelës në aneksin nr.2.

Për vitin 2020, sa i përket ecurisë së batimit të vendimeve të Komisionerit, konstatohet se nga mbikëqyrjet në 61 Bashkitë e vendit:

-në **15**[15] **raste janë zbatuar vendimet e** Komisionerit

-Në **12**[16] **raste**, Komisioneri ka dalë me vendim përfundimtar se nuk janë konstatuar parregullsi.

- Për **34 bashkitë e mbetura**, ku KMSHC ka dalë me vendim për problematika të ndryshme në kushte të paligjshmërisë së punonjësve në strukturat respektive, nuk na u vu në dispozicion asnjë informacion/evidencë për statusin e tyre, veçanërisht kur për këto nuk është kryer një verifikim nga institucioni për ecurinë e zbatimit të vendimit të Komisionerit për parregullsitë e konstatuara.

Në observacionin e vendosur në dispozicion nga Komisioneri është përcjellë informacioni se në kushtet e pandemisë, me shkresën Nr. 820 Prot., datë 0311.2020, Komisioneri, për shkak të pamundësisë së realizimit të mbikëqyrjes fizike në institucion, ka kërkuar informacion nga njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore (njësitë përgjegjëse në kuptim të ligjit për nëpunësin civil) të njësive të qeverisjes vendore, me qëllim njohjen e situatës. Pas grumbullimit dhe analizimit të informacionit të dërguar, situata e administrimit të shërbimit civil në këto 34 njësi të qeverisjes vendore rezulton si vijon: nga 961 raste në total për të cilat Komisioneri ka kërkuar anulimin e aktit të emërimit në kundërshtim me ligjin dhe plotësimin

[15] 1. Bashkia Pustec
2.Bashkia Shijak
3.Bashkia Dropull
4.Bashkia Konispol
5.Bashkia Himarë
6.Bashkia Vlorë
7.Bashkia Devoll
8.Bashkia Cërrik
9.Bashkia Mirditë
10.Bashkia Bulqizë
11.Bashkia Dibër
12.Bashkia Klos
13.Bashkia Tepelenë
14.Bashkia Libohovë
15.Bashkia Roskovec

[16] 1. Bashkia Durres
2. Bashkia Vorë
3. Bashkia Shkodër
4. Bashkia Kurbin
5. Bashkia Maliq
6. Bashkia Kamëz
7. Bashkia Polican
8. Bashkia Berat
9. Bashkia Pogradec
10. Bashkia Korcë
11. Bashkia Ura Vajgurore
12. Bashkia Tirane

e pozicioneve të punës me anë të procedurave të konkurrimit sipas parashikimeve ligjore e nënligjore në fuqi për shërbimin civil, referuar të dhënave të raportuara rezulton se situata është rregulluar në 667 raste ose 70% të tyre dhe për 294 raste ose 30% të tyre është duke vijuar procesi i verifikimit nga ana e Komisionerit.

Lidhur me numrin e konsiderueshëm të pozicioneve të punës të shërbimit civil të plotësuara në kundërshtim me ligjin në këto 34 bashkitë ku problematika vijon dhe që kërkojnë një kohë të caktuar për të rikthyer ligjshmërinë, duke u kujdesur që të mos pengohet mbarëvajtja e veprimtarisë institucionale si dhe duke pasur parasysh një sërë rrethanash objektive dhe subjektive, të evidentuara nga Komisioneri në vijim:

- kompleksiteti i procedurave të rekrutimit;
- koha që nevojitet për realizimin e të gjitha fazave të këtij procesi të parashikuara nga ligji dhe aktet nënligjore me afate të mirëpërcaktuara, të cilat llogaritet të shkojnë, në kushte ideale, nga rreth 45 ï 60 ditë kalendarike;
- mospasja e një platforme elektronike në dispozicion të administratës vendore për kryerjen e rekrutimeve në mënyrë të përqendruar;
- numri i ulët i pozicioneve të shërbimit civil në këto institucione e bën të vështirë e madje të pamundur realizimin e rekrutimit në grup;
- mungesa e aplikantëve të interesuar për të konkurruar për pozicionin e punës, problematikë e cila haset më së shumti në bashkitë e nivelit të dytë edhe të tretë, ku edhe paga e pozicionit të punës është më pak motivuese;
- burimet që menaxhojnë shërbimin civil në këto institucione, të cilat janë njësitë përgjegjëse në kuptim të ligjit, janë shumë të kufizuara, të pa trajnuara dhe me njohuri në nivele të ulëta në drejtim të zhvillimit të procesit të rekrutimit;
- shpeshherë konstatohen probleme edhe në mundësinë e ngritjes së organizmave që realizojnë procesin e konkurrimit, të tilla si Komisioni i Përhershëm i Pranimit, për shkak të numrit të kufizuar të burimeve njerëzore apo për shkak të pamundësisë financiare për të realizuar pagesat në këtë rast.

Komisioneri ka gjykuar se në kushtet kur në asnjë rast nuk ka konstatuar mosveprim të natyrës subjektive (me dashje) nga ana e subjekteve që janë të ngarkuar me detyra ligjore për administrimin e shërbimit civil, Komisioneri ka vijuar me ekzekutimin e vendimit në disa faza, të diktuara nga rrethanat konkrete të secilit subjekt, e njëkohësisht ka vijuar të ndihmojë me asistencë teknike në të gjitha drejtimet e kërkuara prej tyre, për të zbatuar drejt ligjin.

Pavarësisht sa deklaruar nga subjekti në observacionet e paraqitura, përsëri grupit të punës nuk ju vu në dispozicion asnjë evidencë bashkëlidhur shkresës në mënyrë që të mbështeten rezultat e përmendura.

1.4 Raportimi vjetor para Kuvendit të Shqipërisë

Në zbatim të ligjit nr. 152/2013, òPër nëpunësin civilò, i ndryshuar, neni 11, pika 5, e cila përcakton se ò*Komisioneri raporton para Kuvendit <u>në fund të çdo viti dhe sa herë që i kërkohet rreth veprimtarisë së tij</u>*.ò, konstatohet se për periudhën objekt auditimi, KMSHC në kundërshtim me përcaktimet ligjore ka përcjellë për Kuvendin <u>raportet vjetore brenda muajit Mars të vitit pasardhës</u>. Për këtë çështje nga ana e institucionit u vendos në dispozicion shkresa e Kuvendit për raportin e vitit 2020, përcjellë me nr. 276, prot datë 22.01.2021 me lëndë "Mbi depozitimin në Kuvend të raporteve vjetore të organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, për veprimtarinë e tyre për vitin 2020", në të cilin për KMSHC është përcaktuar se *"s'ka afat të përcaktuar, si rregull brenda 3 mujorit të parë të vitit 2021 "*, <u>duke mos cituar këtu përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, neni 11, pika 5, si më sipër.</u>

Në raportin vjetor për Kuvendin për vitin 2019, lidhur me rekrutimet në kundërshtim me ligjin, KMSHC është shprehur se duke konstatuar se nga ana e subjekteve të zbatimit të ligjit, janë raportuar vështirësi gjatë aplikimit të institutit të rekrutimit dhe në shumë raste është

kërkuar asistencë teknike, për të cilat Komisioneri ka dërguar grupe të inspektorëve në subjekt dhe sidomos në bashkitë që kanë një numër të kufizuar të kapaciteteve, duke arritur që të realizohen të gjitha shpalljet e pozicioneve të lira për tâu plotësuar nëpërmjet konkurrimit. Grupi i auditimit kërkoi gjurmën dhe evidencat lidhura me këtë proces, ku nga ana e institucionit u vendosën në dispozicion vetëm email-et drejtuar njësive vendore ku janë përcjellë procedurat e konkurrimit të materializuara me aktet përkatëse për të lehtësuar punën e njësive të burimeve njerëzore pranë këtyre institucioneve. Ndër të tjera, KMSHC është shprehur se ka asistuar në mënyrë të vazhdueshme institucionet në mënyrë verbale dhe me telefon, por këto procese rezultojnë të pa dokumentuara, si në rastet ku institucioni është shprehur se ka dërguar fizikisht inspektorët për asistim, ashtu edhe në forma të tjera për të cilat është dhënë ndihmesa e raportuar.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është përcjellë pranë KLSH Akt konstatimi i firmosur nga përfaqësuesit e KMSHC, sipas shkresës nr. 157/11, prot në KLSH datë 30.04.2021, ku janë shprehur objeksionet të cilat janë reflektuar në projekt raportin e auditimit që është dërguar në subjekt me shkresën nr. 157/19, datë 14.09.2021.

1.Titulli i Gjetjes:	**Problematika të konstatuara në planifikimin e kryer nga KMSHC për inspektimet/mbikëqyrjet/ në institucionet publike**
Situata	Nga auditimi u konstatuan disa problematika lidhur me e planifikimin e mbikqyrjeve/inspektimeve të kryera nga KMSHC për periudhën objekt auditimi. -Më hollësisht, përzgjedhja e institucioneve, bazohet në indikatorë të tillë si regjistri i ankesave/informacioneve të qytetarëve, dhe raporteve të mbikëqyrjeve orientuese, por pa dokumentuar një metodologji të caktuar në bazë risku shoqëruar me informacione të tjera si numri i pozicioneve të punës në shërbimin civil që ka çdo institucion i mbikëqyrur. -Nga auditimi konstatohet se në planin e vitin **2019** dhe **2020**, tek monitorimet/inspektimet e përgjithshme, nuk rezultojnë të jenë përcaktuar qartësisht subjektet e përfshira në monitorim, pasi në plan është përcaktuar se mbikëqyrja do të realizohet për institucionet në varësinë e disa ministrive, por jo saktësisht se kush do jenë këto institucione. Në inspektimet tematike për vitin 2019 është përcaktuar mbikëqyrja e të gjithë institucioneve që disponojnë statusin e nëpunësit civil. Në inspektimet tematike për vitin 2020 është përcaktuar mbikëqyrja e të gjithë institucioneve të administratës shtetërore, të pavarura, vendore për vendimet gjyqësore/ dhe bashkia Tropojë për shkak të ankesave të mëdha. - KMSHC për periudhën objekt auditimi nuk ka hartuar plane periodike 3 mujore për monitorimet/inspektimet, sikundër përcakton, neni 12 pika 2 e rregullores. -Nga auditimi konstatohet se në planet e hartuara dhe të rishikuara të KMSHC nuk është marë parasysh neni 1, pika 10 e rregullores, pasi në planet e vitit korrent nuk janë përfshirë mbikëqyrjet e pa realizuara në vitin paraardhës. Si rezultat konstatojmë se një sërë mbikëqyrjesh të planifikuara fillimisht, duke mos u mbartur në planet e viteve pasaardhës, kanë mbetur pa realizuar, si vijon: **a.** në planin e vitit **2017,** nuk janë realizuar **mbikëqyrjet e**

	përgjithshme ne disa Drejtori Arsimore, për shkak të ristrukturimit të tyre, më hollësisht Drejtoria Arsimore Rajonale Dibër dhe Zyrat Arsimore: Bulqizë, Mat, Drejtoria Arsimore Rajonale Fier dhe Zyrat Arsimore: Lushnje, Mallakastër, Drejtoria Arsimore Rajonale Gjirokastër dhe Zyrat Arsimore: Përmet, Tepelenë, Drejtoria Arsimore Rajonale Vlorë dhe Zyrat Arsimore: Delvinë, Sarandë **b.** Referuar planit të vitit **2018**, rezultojnë të mos jenë realizuar **mbikëqyrjet e përgjithshme** sipas planit vjetor apo planeve të mëtejshme në vitet pasardhëse deri në përfundim të periudhës së auditimit në **3 ministri:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit **c.** Referuar planit të vitit **2019**, rezultojnë të mos jenë realizuar **mbikëqyrjet e përgjithshme** sipas planit vjetor apo planeve të mëtejshme në vitet pasardhëse deri në përfundim të periudhës së auditimit në 4 Bashki: Bashkia Elbasan dhe Njësitë Administrative përbërëse të saj, Bashkia Shkodër dhe Njësitë Administrative përbërëse të saj, Bashkia Kavajë dhe Njësitë Administrative përbërëse të saj, Bashkia Berat dhe Njësitë Administrative përbërëse të saj; dhe planifikimi për kryerjen e mbikqyrjeve në Institucionet e varësisë së Ministrisë së Turizmit. **d.** Referuar planit të vitit **2020**, rezultojnë të mos jenë realizuar **mbikëqyrjet e përgjithshme** sipas planit vjetor apo planeve të mëtejshme në vitet pasardhëse deri në përfundim të periudhës së auditimit në 2 bashki: Bashkia Kavajë dhe Njësitë Administrative përbërëse të saj, Bashkia Pogradec dhe Njësitë Administrative përbërëse të saj; dhe në INSTAT. - KMSHC-së përgjatë vitit i është dashur të iniciojë mbikëqyrje/inspektime, të cilat nuk rezultojnë të jenë reflektuar më pas në planin vjetor, pasi ky plan nuk është rishikuar asnjëherë, në kundërshtim me Nenin 11, pika 6 e rregullores.
Kriteri:	Rregullore e Brendshme të KMSHC ñPër organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civilò Rregullore óMbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimitô, miratuar me vendimin nr.17, datë 11.03.2015 të Komisionerit. Ligji nr. Nr.10296, datë 8.7.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, I ndryshuar
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e metodologjisë se planifikimit, nuk jep siguri të arsyeshme mbi objektivitetin e përzgjedhjes së subjekteve për tu mbikëqyrur; Mos përfshirja në të gjitha rastet e mbikëqyrjve të parealizuara, në planet vjetore nuk garanton kryerjen e tyre në vitet pasardhës; mos rishikime te planit vjetor edhe pas ndryshimit të disa subjekteve objekt mbikëqyrjeje, jo vetëm flet për planifikime të pambështetura por gjithashtu vështirëson ndjekjen dhe monitorimin e realizimit të këtij plani.
Shkaku:	Mungesa e metodologjisë se planifikimit; Mos përfshirja në të gjitha rastet e mbikëqyrjeve të parealizuara, në planet vjetore; mos reflektimi I ndryshimeve në planin vjetor.

Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	-KMSHC të hartojë dhe dokumentojë procedurat e ndjekura/metodologjinë për përzgjedhjen e institucioneve objekt inspektimi/mbikëqyrjeje, në mënyrë që të evidentohet qartë ky proces, duke përfshire në të analiza të kryera mbi bazë risku për institucionet e përzgjedhura, mbështetur në kritere/indikatorë të tjerë si: numri i pozicioneve të punës në shërbimin civil që ka çdo institucion i mbikëqyrur, apo të dhëna të tjera, në mënyrë që të garantohet gjithëpërfshirja dhe monitorimi sa më i plotë i institucioneve publike. -KMSHC, në planin vjetor të mbikëqyrjeve/inspektimeve të reflektojë qartë dhe individualisht të gjitha subjektet e përfshira në plan (të ndara këto sipas mbikëqyrjeve të mbartura nga vitit paraardhës dhe ato të planifikuara rishtaz për vitin korrent), si dhe të reflektojë në këtë dokument ndryshime sa herë të diktohen nga nevoja e institucionet. -Komisioneri të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me qëllim analizën dhe verifikimin e zbatueshmërisë së çështjeve që lidhen me planet periodike (3 mujore) apo të tjera lidhur me planifikimin, duke identifikuar nivelin e zbatueshmërisë së tyre dhe shkaqet që kanë çuar në mos aplikimin e disa prej kërkesave të rregullores, në lidhje me këtë proces.

2.Titulli i Gjetjes:	**Mungesa e gjurmëve të auditimit për aktivitetet të rëndësishme të KMSHC-së**
Situata	- Nga auditimi rezultoi se, në rregulloren "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr.17, datë 11.03.2015 të Komisionerit të KMSHC, janë përshkruar hollësisht procedurat dhe dokumentacionet që do të hartohen për mbikqyrjet/inspektimet "e përgjithshmeë, ndërsa për mbikqyrjet/inspektimet "orientueseë, dhe ato "tematikeë, numri i të cilave është rritur ndjeshëm vitet e fundit, ka munguar rrjedha e dokumentuar e proceseve nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to, përfshirë këtu dokumentacionin, raportimin dhe sistemimin e mbajtjes së dosjeve. Konkretisht në vitin 2017 ishin planifikuar 50 mbikëqyrje të përgjithshme; në vitin 2018 u planifikuan 30 të tilla (ose 40% më pak se një vit më parë); në vitin 2019 u planifikuan 19 (ose 60% më pak se në vitin 2017); në vitin 2020 u planifikuan të kryhen 15 mbikëqyrje të përgjithshme (ose 70% më pak krahasuar me vitin 2017). - Nga auditimi rezultoi se struktura në fuqi është miratuar me Vendimin nr. 18, datë 11.03.2015. Edhe pse referuar rregullores dhe strukturës organizative të KMSHC, ekziston një ndarje për kryerjen e "inspektimeveë nga Drejtoria e Inspektimit dhe Hetimit Adminstrativ dhe "mbikëqyrjeveë nga Drejtoria e Mbikëqyrjes, në praktikë rezultoi se këto drejtori kanë funksionuar si një e vetme duke mbivendosur detyrat e njëra tjetrës.; Kjo edhe për shkak të stafit të reduktuar që institucioni disponon (ku Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe

	Mbikëqyrjes ka në total një staf prej 15 punonjësish, nga të cilët 1 drejtor i përgjithshëm, 2 drejtorë drejtorie dhe 12 inspektorë), i cili duhet të kryejë një mbulim relativisht të gjerë për garantimin e mbikëqyrjes të zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë; shtuar këtu edhe sa diktuar nga rekomandimet e lëna nga rezoluta e Kuvendit. - Për pasojë afatet e ndjekura, dhe aktet e hartuara gjatë secilës hallkë të procesit, etj; dokumente dakordësohen vazhdimisht rast pas rasti, Mungesa e gjurmëve të auditimit për këto procese të rëndësishme të KMSHC-së, nuk ka siguruar dokumentimin e operacioneve në formë të tillë që tâu mundësojë audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit, në kundërshtim kjo me nenin 16, të ligjit nr, 10296, datë 8.7.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, I ndryshuar
Kriteri:	Ligji nr. Nr.10296, datë 8.7.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, I ndryshuar Rregullore e Brendshme të KMSHC ñPër organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civilò, Rregullore óMbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimitô, miratuar me vendimin nr.17, datë 11.03.2015 të Komisionerit.
Ndikimi/Efekti:	Mungesë unifikimi i procedurave të ndjekura për inspektimet/mbiqkyrjet tematike dhe i proceseve të punës në drejtim të dokumentacioneve që do të hartohen dhe mos përcaktimi i afateve respektiv. Mungesa e gjurmëve të auditimit për këto procese të rëndësishme të KMSHC-së, nuk ka siguruar dokumentimin e operacioneve në formë të tillë që tâu mundësojë audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit, në kundërshtim kjo me nenin 16, të ligjit nr., 10296, datë 8.7.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, I ndryshuar
Shkaku:	Mos reflektimi ne rregullore i kërkesave te ligjit te MFK-së, sa i takon mungesës së gjurmës së auditimit për operacionet që lidhen me aktivitetet e ñmbikëqyrjeveò dhe ñinspektimeveò, të ndryshme nga ato ñtë përgjithshmetò.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	- KMSHC të marr masa për të miratuar gjurmët e auditimit, të detajuara për aktivitetet kryesore të institucionit duke siguruar që të gjitha operacionet e njësisë publike të dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm si dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit të KMSHC. Veçanërisht të merren masat për të reflektuar sa më sipër në rregullore, duke parashikuar proceset e punës që do të ndiqen për kategoritë e tjera të mbikqyrjes/inspektimeve që institucioni kryhen, të ndryshme nga ato të përgjithshme, me qëllim përgatitjen e hartës së proceseve të punës duke i unifikuar këto procedurave sipas dokumenteve standarde, të zbatueshëm nga inspektorët si gjurmë të punës së kryer. -Në kushtet kur aktiviteti i KMSHC-së ka pësuar ndryshime nga viti në vit, diktuar këto edhe nga nevojat e institucioneve subjekt mbikëqyrjeje apo rekomandimet e lëna nga rezoluta e Kuvendit, dhe

	KMSHCS-së i është dashur që, me të njëjtin staf inspektorësh, të mbulojë një gamë më të gjerë aktivitetesh, rekomandojmë rishikimin e strukturës në drejtim të shtimit të stafit ï inspektorë dhe ri-organizimin e punës brenda secilës drejtori me qëllim ndarjen dhe realizimin e detyrave sikundër parashikohen ne rregullore.

3.Titulli i Gjetjes:	**Mbi realizimin plan fakt të mbikëqyrjeve**
Situata	Nga auditimi rezultoi se, numri i mbikëqyrjeve ñtë përgjithshmeò, ka patur një rënie nga viti 2017 në 2020 si në planifikim dhe në realizim, krahasuar me vitet e mëparshme, si vijon: -për vitin 2017 janë realizuar 7 nga 50 të planifikuara në total (ose 14% e planit), - për vitin 2018 janë realizuar 42 nga 73 të planifikuara[17] në total përfshirë dhe 43 mbikëqyrjet e mbartura nga viti 2017 (ose 50% e planit), - për vitin 2019 janë realizuar 21 nga 36 të planifikuara në total përfshirë 17 mbikëqyrjet e mbartura nga vitet e mëparshme (ose 58% e planit), - për vitin 2020 janë realizuar 7 nga 26 të planifikuara në total përfshirë 11 mbikëqyrjet e mbartura nga vitet e mëparshme (ose 27% e planit), Gjithashtu vihet re se, ndërsa numri i mbikëqyrjeve të përgjithshme është ulur, numri i mbikëqyrjeve dhe inspektimeve ñtematikeò dhe ñtë orientuaraò ka ardhur në rritje dhe ka përfshirë jo vetëm çështje të iniciuara nga denoncime por edhe të tjera shtesë si: (i) *Monitorime lidhur me procesin e ristrukturimit të institucioneve të administratës shtetërore; (ii) Monitorime të administrimit të shërbimit civil gjatë zgjedhjeve; (iii) Administrimi dhe analiza e të dhënave për të evidentuar situatën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë; (iv) Respektimi i institutit të lirimit nga shërbimi civil në rastin e plotësimit të moshës për pension të plotë pleqërie.* Nga auditimi konstatohet se për periudhën objekt auditimi KMSHC ka operuar në mungesë të një sistem informacioni (qoftë edhe në formën e një regjistri/databaze të kategorizuar sipas llojit të inspektimeve/mbikëqyrjeve të kryera për çdo vit), në mënyrë që të ndiqet realizimi i tyre në kohë, dhe që tô sigurojë drejtuesve informacion rregullisht mbi arritjen e objektivave të njësisë[18]. Si pasojë progresi drejt arritjes së objektivave është i vështirë për tu monitoruar rregullisht si dhe për tu analizuar shkaqet që mund të çojnë në mosrealizimin e tyre[19]. Gjithashtu një regjistër i tillë do tô shërbente përpunimit dhe analizimit të dhënave për tu lejuar audituesve të jashtëm si dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit të KMSHC.
Kriteri:	Rregullore e Brendshme të KMSHC ñPër organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e

[17] Në këtë zë, grupi I audtimit ka përfshirë edhe auditimet e planifikuara dhe të parealizuara në vitet e mëparshme
[18] Komponenti I "Informimit dhe komunikimit" te MFK-së
[19] Komponenti "Monitorimi" / pyetesori I MFK-se

	Shërbimit Civilò, Rregullore ôMbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimitö, miratuar me vendimin nr.17, datë 11.03.2015 të Komisionerit. Ligji nr. Nr.10296, datë 8.7.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, I ndryshuar Manualin ñPër menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e një sistemi informacioni rrezikon të mos u sigurojë drejtuesve informacion rregullisht mbi arritjen e objektivave të njësisë. Mos disponimi i të dhënave zyrtare për vendimet dhe mos ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KMSHC, cënon kryerjen e një planifikimi efektiv të mbikqyrjeve/inspektimeve që institucioni do të kryejë në periudhat e ardhshme.
Shkaku:	mungesë të një sistem informacioni (qoftë edhe në formën e një regjistri/databaze të kategorizuar sipas llojit të inspektimeve/mbikëqyrjeve të kryera për çdo vit); mos përcaktimi në rregulloren e brendshme të procedurave për administrimin dhe ruajtjen e të dhënave që lidhen me aktivitetin kryesor të institucionit
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	-KMSHC, të marë masat për hartimin e një regjistri ku të evidentohen të gjitha inspektimet dhe mbikëqyrjet e kryera të ndara sipas kategorive dhe sipas planit të çdo viti, në mënyrë që të bëhet e mundur ndjekja e vijueshmërisë së vendimeve të lëna nga Komisoneri për mbikqyrjet dhe inspektimet respektive. -Në rregulloren e brendshme të KMSHC, në lidhje me këtë proces, të parashikohen procedurat që do të ndiqen dhe personat përgjegjës për ruajtjen dhe administrimin e të dhënave zyrtare të aktivitetit të institucionit.

4.Titulli i Gjetjes:	**Mangësi në hartimin dhe miratimin e procedurave të ndjekura nga KMSHC në zbatimin e vendimeve gjyqësore, në vijim të detyrës së lënë nga rezoluta e Kuvendit**
Situata	Nga auditimi u konstatuan mangësi në drejtim të dokumentimit të punës së bërë nga KMSHC në vijim të zbatimit të **rekomandimit të lënë në rezolutat [20]e Kuvendit** për përmbylljen e veprimeve për administrimin e të dhënave që kanë të bëjnë me rikthimin e nëpunësve civilë gjyqfitues në detyrë, në të gjithë sistemin e shërbimit civil, me qëllim evidentimin e arsyeve që pengojnë ecurinë e këtij procesi dhe vijimit të procesit të hetimit administrativ në lidhje me rastet individuale, të konstatuara në shkelje të ligjit[21]. Nga auditimi rezultoi se, puna e institucionit për sa i përket këtij procesi ka nisur në vitin 2018 me urdhrin nr. 589, datë 01.08.2018, të Komisionerit ò*Për fillimin e procesit të monitorimit të zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë*ö. Në vijim, me urdhrin nr. 10, datë 21.01.2019, të Komisionerit "*Mbi fillimin e inspektimit për rastet e mos zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për rikthimin e nëpunësve*

[20]

[21] Publikuar gjithashtu ne faqe zyrtare të KMSHC: http://www.kmshc.al/raportimi-vjetor-per-kuvendin/ (fq 12, 126, 158 e Raportit te vitit 2019; 101, 128 e Raportit te vitit 2020)

	civilë në detyrë, në institucionet që janë subjekt i ligjit për nëpunësin civil", parashikohet të fillojë **hetimi administrativ** për çdo rast të konstatuar në shkelje të ligjit, akt i cili i ka shtrirë efektet e tij edhe gjatë vitit 2020. Nga auditimi rezultoi se, për këtë proces të rëndësishëm por edhe sensitiv, në KMSHC nuk është hartuar dhe miratuar rrjedha e dokumentuar e aktiviteteve nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to (gjurma e auditimit). Grupit të auditimit, iu vu në dispozicion vetëm një dosje (MASR) mbi punën e kryer nga KMSHC në zbatim të këtij procesi, me pretendimin se po njëlloj është monitoruar ky aktivitet në të gjitha ministritë; ndërsa sa I takon hetimeve administrative për rastet individuale të konstatuar në shkelje të ligjit, nuk iu vendosën në dispozicion ,grupit të auditimit. Në kushtet kur, në lidhje me procesin e monitorimit dhe hetimit administrativ për çështjet e mësipërme që lidhen me vendimet gjyqësore: - Ka munguar gjurma e auditimit, dhe - Ka munguar evidenca e mjaftueshme dhe përkatëse **grupi i auditimit nuk jep siguri të arsyeshme mbi efektivitetin e këtij procesi dhe impaktin e tij në përmirësimin e situatës.** Pavarësisht se kjo detyrë e lënë nga rezoluta e Kuvendit, në raportet vjetore të KMSHC është raportuar si ñe realizuar plotësishtò, numri i vendimeve të pa ekzekutuara dhe i gjyqfituesve në listën e pritjes për sistemim në pozicionet e punës, vijon të mbetet i lartë dhe një dosje e vetme e vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, mbi realizimin e kësaj detyre, nuk është përfaqësuese për procesin në tërësi. Ndërsa rezultoi se, databaza e përgjithshme e rekordeve historike që përfshin aktet e largimit nga shërbimi civil të gjyqfituese, e rekomanduar për tu zbatuar nga Kuvendi, është ende në proces plotësimi të dhënash, dhe si rezultat platforma administrata.al vijon të mos jetë funksionale.
Kriteri:	Rregullore óMbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimitô, miratuar me vendimin nr.17, datë 11.03.2015 të Komisionerit, Ligji për Nëpunësin Civil, Rezolutat e Kuvendit për KMSHC
Ndikimi/Efekti:	Numri i lartë i gjyqfituesve në listë pritje, me efekte financiare për buxhetin e shtetit.
Shkaku:	Mangësi në koordinimin ndër institucional mes institucioneve me gjyqfitues në pritje dhe DAP për sistemimin e gjyqfituesve.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	KMSHC, në vijim edhe të detyrave të lënë nga Rezoluta e Kuvendit të marrë masat për intensifikimin e punës nëpërmjet një roli më aktiv në drejtim të problematikës lidhur me nëpunësit gjyqfitues civil në listë pritjeje në të gjithë sistemin e shërbimit civil, nëpërmjet hartimit dhe miratimit të rrjedhës së dokumentuar të aktiviteteve që lidhen me mbikëqyrjet orientuese dhe hetimit administrativ (ne veçanti në lidhje me proceset gjyqësore), nga fillimi deri në përfundim të tyre, i cili duhet të synojë të përshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Pas miratimit të gjurmës së auditimit, KMSHC, të marrë masa për

	kryerjen dhe dokumentimin sa I takon punës mbikëqyrëse *për rastet individuale të konstatuara në shkelje të ligjit për proceset e rikthimit të nëpunësve civilë gjyqfitues në detyrë, si dhe finalizimin me sukses të databazës së përgjithshme të rekordeve historike, ku të përfshihen aktet e largimit nga shërbimi civil të gjyqfituesve, sikundër kërkuar në Rezolutën e Kuvendit.* Sa më sipër me kontribut në minimizimin e efekteve negative në buxhet si pasojë e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për largimet e padrejta të punonjësve nga puna.

5.Titulli i Gjetjes:	**Mangësi në konceptimin e rolit të KMSHC për mbikëqyrjen e procedurave të rekrutimit kryer nga DAP**
Situata	Në zbatim të nenit 11, pika 5 e Rregullores së Brendshme të KMSHC, *Procedurat e rekrutimit dhe largimit nga puna në shërbimin civil janë pjesë e përhershme e çdo plani vjetor/periodik të mbikëqyrjes/inspektimit, nëpërmjet* kryerjes së mbikëqyrjes së orientuar. Ky proces është konceptuar nga Komisioneri për tëu kryer online nëpërmjet mbledhjes së informacionit në drejtim të funksionimit të procedurave të konkurrimit planifikuar nga Departamenti i Administratës Publike, duke përfshirë pranimin në nivelin ekzekutiv në shërbimin civilë, lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në trupën e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues (TND). Në një vit të caktuar ka patur një tentativë për pjesëmarrjen e grupeve nga ana e KMSHC në këto procedura, për të cilin ka munguar gjurma e auditimit, në vijim (për vitet 2019,2020) nuk është proceduar më në këtë formë. Plotësimi i vendeve të punës në mënyra alternative nga ana e DAP (i cili përfshin edhe sistemimin e gjyqfituesve në pozicione vakante), nuk është objekt mbikëqyrjeje nga ana e KMSHC, dhe këto evidenca raportohen vetëm statistikisht sipas të dhënave të DAP. Edhe pse pjesë e veprimtarisë institucionale është verifikimi i një numri të konsiderueshëm të ankesave/informacioneve të përcjella lidhur me procedurat e konkurrimit kryer pranë DAP, ky proces rezulton të kryhet në mënyrë të pavarur nga KMSHC si inspektime tematike. Si rezultat në raportin vjetor të përcjellë pranë DAP në përfundim të mbikqyrjes së orientuar të kryer për afro një vit, nuk përfshihen konstatimet që kanë rezultuar nga verifikimi i inspektimeve tematike mbi procedurat e konkurrimit, për tëu bërë pjesë e konkluzionit përfundimtar dhe rekomandimeve të lëna për mbikëqyrjen e procedurave të rekrutimit dhe largimit nga puna të punonjësve në shërbimin civil.
Kriteri:	Rregullore "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr.17, datë 11.03.2015 të Komisionerit, Rregullore e Brendshme të KMSHC "Për organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil".
Ndikimi/Efekti:	Mos përfshirja në mbikëqyrje/inspektim nga KMSHC të metodave alternative për plotësimin e vendeve vakante, si dhe mos paraqitja në raportin vjetor pranë DAP të problematikave të konstatuara nëpërmjet ankesave të pjesëmarrësve.
Shkaku:	Dizenjimi i rolit mbikqyrës nga KMSHC së procesit të rekrutimit dhe

	largimit nga puna pranë DAP, nëpërmjet mbikqyjes së orientuar online.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	-KMSHC të shqyrtojë mundësinë për të zgjeruar fushën e veprimit të saj në kuadër të mbikqyrjes së procesit të rekrutimit dhe largimit nga puna pranë DAP, duke mos u bazuar vetëm në verifikimet online të procedurave, por duke përfshirë edhe monitorimin e plotësimit të vakancave në mënyra alternative; pjesëmarrjen e grupeve të punës nga KMSHC në disa procedura të përzgjedhura me bazë risku; përfshirjen në raportin vjetor të kësaj mbikqyrjeje të problematikave kryesore të konstatuara në vijim të ankesave të përcjella nga pjesëmarrësit gjatë procesit dhe rekomandimeve të lëna për rastet respektive; për garantimin e një roli sa më aktiv të mbiqkyrjes së institucionit në procedurat e rekrutimit dhe largimit nga puna në shërbimin civil.

6.Titulli i Gjetjes:	**Mangësi të konstatuara në drejtim të monitorimit të zbatimit të vendimeve të Komisionerit nga institucionet publike**
Situata	Nga auditimi rezultoi se, sipas nenit 2, pika 2.j e Rregullores së Procedurave të Mbikëqyrjes/Inspektimit, pjesë e fushës së veprimit të KMSHC është mbikëqyrja e zbatimit të detyrave të lëna nga mbikëqyrjet e mëparshme, duke kryer **mbikëqyrje/inspektim në vazhdim**. Në vijim, në nenin 35, të kësaj rregulloreje përcaktohen më hollësisht procedurat që ndiqen nga institucioni për zbatimin e vendimeve dhe afatet përkatëse, konkretisht: Pika *2: Subjekti i mbikëqyrjes/inspektimit/verifikimit apo hetimit administrativ është i detyruar të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për korrigjimin e shkeljeve brenda afatit të përcaktuar dhe, nëse është e nevojshme, të paraqesë edhe provat që vërtetojnë këtë fakt.* *Pika 3. Nëse Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil e konsideron të arsyeshme, urdhëron kryerjen e një mbikëqyrjeje/inspektimi për të kontrolluar zbatimin e vendimit nga subjekti i mbikëqyrur/inspektuar*.ò. Për vitin 2020, sa i përket ecurisë së zbatimit të vendimeve të Komisionerit, konstatohet se nga mbikëqyrjet në 61 Bashkitë e vendit: -në **15[22] raste janë zbatuar vendimet e** Komisionerit

[22] 1. Bashkia Pustec
2.Bashkia Shijak
3.Bashkia Dropull
4.Bashkia Konispol
5.Bashkia Himarë
6.Bashkia Vlorë
7.Bashkia Devoll
8.Bashkia Cërrik
9.Bashkia Mirditë
10.Bashkia Bulqizë
11.Bashkia Dibër
12.Bashkia Klos
13.Bashkia Tepelenë
14.Bashkia Libohovë
15.Bashkia Roskovec

	-Në **12**[23] **raste**, Komisioneri ka dalë me vendim përfundimtar se nuk janë konstatuar parregullsi. - Për **34 bashkitë e mbetura**, vendimet e Komisionerit nuk janë zbatuar dhe për këto rastet të konstatuara, pas kërkesës së KLSH-së pas mbajtjes së aktit të konstatimit, KMSHC përpunoi të dhënat, dhe me observacione raporton se janë 961 individë në total për të cilat Komisioneri ka kërkuar anulimin e aktit të emërimit dhe plotësimin e pozicioneve të punës me anë të procedurave të konkurrimit; nga të cilët: - në 667 raste ose 70% e totalit raportohet se situata është rregulluar; dhe - në 294 raste ose 30% ndaj totalit, KMSHC është duke vijuar procesin e verifikimit Mbetet e paqartë se si KMSHC ndjek procesin e verifikimit të vendimeve, në kushtet kur nuk ka iniciuar kryerjen e ndonjë mbikëqyrjeje/inspektimi për të kontrolluar zbatimin e vendimit nga subjekti i mbikëqyrur/inspektuar, por thjesht duke mbetur në pritje të njoftimit nga ana e s*ubjektit të mbikëqyrjes/inspektimit/verifikimit apo hetimit* administrativ për korrigjimin e shkeljeve brenda afatit të përcaktuar dhe, paraqitjes së provave që vërtetojnë këtë fakt. Gjithashtu rezultoi se, KMSHC ka dalë me vendime përmbyllëse, vetëm kur për të gjithë rastet individuale të përmendura në vendim, situata është përmirësuar. Për ato raste kur brenda të njëjtit vendim disa raste individuale janë zbatuar, dhe të tjerat jo, në përfundim të afateve, KMSHC **nuk ka** dal me vendim përmbyllës, ku të cilësojë sa prej tyre janë zbatuar, sa nuk janë zbatuar dhe sa janë në proces; si dhe **nuk** ka ngritur mekanizima për të ndjekur ecurinë më tej të zbatueshmërisë së tyre të plotë. Në gjykimin e pavarur të audituesit, monitorimi në këtë formë (pra duke raportuar në nivel vendimi vetëm) nuk mundëson identifikimin e rasteve individuale të pazbatuara me qëllim ndjekjen deri në zbatimin e plotë të tyre, nëpërmjet aplikimit të gjobave respektive në rast të moszbatimit të masave, në përputhje me nenin 15, të ligjit nr. 152/2013 ñPër nëpunësin civilò, i ndryshuar.
Kriteri:	Rregullore e Brendshme të KMSHC ñPër organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civilò, Rregullore óMbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimitô, miratuar me vendimin nr.17, datë 11.03.2015 të Komisionerit. Ligji nr. 152/2013 ñPër nëpunësin civilò, i ndryshuar

1. [23] Bashkia Durres
2. Bashkia Vorë
3. Bashkia Shkodër
4. Bashkia Kurbin
5. Bashkia Maliq
6. Bashkia Kamëz
7. Bashkia Polican
8. Bashkia Berat
9. Bashkia Pogradec
10. Bashkia Korcë
11. Bashkia Ura Vajgurore
12. Bashkia Tirane

Ndikimi/Efekti:	Monitorimi në këtë formë (pra duke raportuar në nivel vendimi vetëm) nuk mundëson identifikimin e rasteve individuale të pazbatuara me qëllim ndjekjen deri në zbatimin e plotë të tyre, nëpërmjet aplikimit të gjobave respektive në rast të moszbatimit të masave
Shkaku:	Mungesa e një regjistri për inspektimet/mbikëqyrjet e kryera çdo vit sipas llojit të tyre; mos përcaktimi në rregulloren e brendshme të procedurave për administrimin dhe ruajtjen e të dhënave që lidhen me aktivitetin kryesor të institucionit në mënyrë që të monitorohet edhe zbatimi i vendimeve të lëna
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	KMSHC, të marë masa për hartimin dhe miratimin e procedurave të detajuara që do të duhet të ndiqen për verifikimin e zbatimit të vendimeve të KMSHC edhe në nivel rastesh individuale, për të garantuar përmirësimin e situatës brenda afateve të parashikuara; ri kërkimin e zbatimit të tyre dhe analizën e shkaqeve në rastet e moszbatimit, kjo në funksion të misionit të institucionit në zbatim të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil.

DREJTIMI 2: Organizimi dhe funksionimi i Sekretariatit të KMSHC. Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm

Në zbatim të pikës 2 të programit të auditimit: mbi ñOrganizimin dhe funksionimin e Sekretariatit të KMSHC, vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëmò, nga auditimi rezultoi se:

Institucioni i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil organizohet dhe funksionon në përputhje me Ligjin Nr.152/2013, ñPër nëpunësin civilò, Rregulloren e Brendshme ñPër organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civilò, si dhe urdhrat, udhëzimet dhe aktet e tjera nënligjore të miratuara nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
Rregullorja e Brendshme ñPër organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civilò, është miratuar me Vendimin nr. 18, datë 11.03.2015. Në këtë rregullore është përcaktuar misioni, vizioni, struktura organizative, organizimi i brendshëm dhe përshkrimi i detyrave për pozicionet e punës si edhe disiplina dhe etika në punë. Kjo rregullore ka për objekt përcaktimin e rregullave të hollësishme lidhur me organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, detyrat funksionale të çdo hallke të strukturës së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, marrëdhëniet ndërmjet këtyre hallkave të strukturës me njëra-tjetrën, si dhe marrëdhëniet e tyre me publikun, subjektet objekt i Ligjit Nr.152/2013, ñPër nëpunësin civilò apo edhe institucionet, subjektet apo organizmat e tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë.
Nga auditimi rezultoi se struktura e miratuar është në përputhje me sa parashikuar në rregullore, mbi mënyrën e organizimit të subjektit sipas drejtorive respektive. Në Kreun 2 të kësaj rregulloreje parashikohet gjithashtu përshkrimi i detyrave

Observacione:
Në lidhje sa më sipër në shkresën e datës 17.05.2021, nr. 602/11 Prot., protokolluar në KLSH, me nr. 157/18 në datën 19.05.2021, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka nisur observacionet mbi akt- konstatimet e mbajtura ku thuhet se: *Në këtë akt-konstatimi bëhet fjalë për rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit të KMSHC, duke mos specifikuar se ku qëndron problemi dhe cilat nga kërkesat e ligjit nuk janë*

reflektuar. Komisioneri vlerëson se grupi i auditimit ka arritur në këtë konkluzion të pasaktë, në kushtet kur nuk ka marrë parasysh faktin se Komisioneri, bazuar në kërkesat e Ligjit Nr. 10296, datë 8.7.2010, ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, dt. 27.12.2011, ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë publikeò; ka nxjerrë edhe akte të tjera rregullatore, të cilat i janë vënë në dispozicion grupit gjatë auditimit, të tilla si: Rregulloren e brendshme ñPër miratimin e rregullores së brendshme për përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimitò, miratuar me Vendimin nr. 103, dt. 28,12,2018, të Komisionerit, si dhe Rregulloren e brendshme ñPër miratimin e rregullores së brendshme për Rregullat e inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes nga përdorimi të aktiveve në zotërim të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civilò, miratuar me Vendimin nr. 104, dt. 28.12.2018, të Komisionerit. Në rregulloren e brendshme të funksionimit, si dhe në këto akte janë materializuar kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar. Ndërkohë, sqarojmë grupin e auditimit se, duke marrë parasysh faktin se ka nevojë për një rishikim të rregullores së funksionimit të institucionit, në aspekte të veçanta të zbatimit të ligjit, Komisioneri ka nxjerrë Urdhrin nr. 22, dt. 02.04.2021 ñPër ngritjen e grupit të punës për ndryshimin e rregullores së procedurave të mbikëqyrjes/inspektimit dhe rregullores për organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civilò, ku do të vlerësohet nevoja për të ndërhyrë me ndryshimet përkatëse.

Përgjigje e grupit të auditimit:

Grupi i auditimit pasi shqyrtoi me kujdes observacionet, i mori në konsideratë

Struktura e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka 31 punonjës dhe 4 punonjës me kontratë.

STRUKTURA E KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL



Burimi: faqja web e KMSHC

Në Rregulloren e Brendshme ñPër organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civilò, të miratuar me Vendim nr. 18, datë 11.03.2015, në Nenin 4 janë përcaktuar rregullat e përgjithshme që drejtojnë veprimtarinë e Sekretariatit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, konkretisht:

1. Sekretariati i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil e kryen veprimtarinë e tij duke respektuar me rigorozitet Kushtetutën, kuadrin ligjor në fuqi dhe të gjitha aktet

nënligjore apo ato me karakter administrativ të nxjerra nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
2. Sekretariati i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka për detyrë të krijojë kushtet optimale për mbarëvajtjen e punës së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe përmbushjen e të gjitha detyrave që burojnë nga ligji.
3. Në veprimtarinë e përditshme, Sekretariati drejtohet dhe përgjigjet për përmbushjen e detyrave përpara Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Për këtë qëllim, Sekretariati harton dhe paraqet përpara eprorit direkt dhe ky i fundit përpara Komisionerit raporte periodike, si dhe raporte të veçanta sa herë çmohet e nevojshme respektivisht nga eprori direkt apo Komisioneri.
4. Drejtimi dhe organizimi i veprimtarisë së Sekretariatit bëhet nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil nëpërmjet urdhërave dhe udhëzimeve me karakter administrativ, si dhe porosive të lëshuara prej tij, qofshin ato me shkrim apo me gojë.
5. Në veprimtarinë e përditshme Sekretariati mban parasysh parimin e unitetit, hierarkisë, paanësisë, pavarësisë politike, përgjegjshmërisë, profesionalizmit, qartësisë në caktimin e detyrave, bashkëpunimit, konfidencialitetit, si dhe rregullat e etikës.
6. Sekretariati i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësive publike shmang kurdoherë rastet që, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndikojnë, mund të ndikojnë apo duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të tyre, duke përbërë në këtë mënyrë konflikt interesi, sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, ñPër parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publikeò, i ndryshuar.
7. Pranimi, transferimi, dhënia e masave disiplinore apo largimi nga detyra i punonjësve të Sekretariatit bëhet nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, sipas procedurave të përcaktuara në Ligjin Nr. 152/2013, ñPër nëpunësin civilò dhe Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë.

Mbi vlerësimin dhe funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm

Nga auditimi rezultoi se, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka përgatitur pyetësorin e vetëvlerësimit për të katërta vitet 2017, 2018, 2019 dhe 2020, ku sipas vetë-vlerësimit, KMSHC nuk paraqet asnjë problematikë. Në vijim kemi bërë analizën për të mbi kërkesat që kërkojnë komponentët e kontrollit të brendshëm, në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.
Sa i takon Pyetësorit të vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Deklarata dhe Raporti për cilësinë e Sistemit të Kontrollit për vitin 2019, janë përcjellë me shkresën Nr. 236, datë 28.02.2020, brenda afatit të parashikuar në ligjin nr.10 296, datë 8.7.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, Neni 18, pika 2, Nëpunësi i parë autorizues përgatit dhe depoziton te Ministri i Financave raportin vjetor dhe deklaratën të konsoliduar jo më vonë se fundi i muajit prill
Sa i takon Pyetësorit të vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Deklarata dhe Raporti për cilësinë e Sistemit të Kontrollit për vitin 2020, janë përcjellë me shkresën Nr. 361, datë 26.02.2021, brenda afatit të parashikuar në ligjin nr.10 296, datë 8.7.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, Neni 18, pika 2.

Grupi i auditimit, në zbatim të Ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, kreu III, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 ñPër disa shtesa dhe ndryshimeò, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së, ka verifikuar

nëse është zbatuar menaxhimi financiar dhe kontrollit nëpërmjet pesë komponentëve të ndërlidhur me njëri- tjetrin:

- ✓ Mjedisi i kontrollit
- ✓ Menaxhimi i riskut
- ✓ Aktivitetet e kontrollit
- ✓ Informimi dhe komunikimi
- ✓ Monitorimi

1. Mjedisi i kontrollit

Mjedisi i Kontrollit ngre strukturën dhe vendos disiplinën. Faktorët që kontribuojnë në gjendjen e një njësie janë: filozofia dhe stili i punës së titullarit, punonjësve, profesionalizmi dhe integriteti i drejtueseve dhe punonjësve, përgjegjshmërinë dhe përkushtimin që i jep çdo punonjës i njësisë përfshirë këtu drejtuesit dhe titullarin. Titullarët e njësive publike janë persona përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit referuar Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, në nenin 20.

1.1 Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil funksionon në përputhje me Ligjin Nr. 152/ 2013, ñPër nëpunësin civilò i ndryshuar, Rregulloren e Brendshme ñPër organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civilò, Rregulloren ñMbi procedurat e mbikëqyrjes/ inspektimitò, si dhe urdhrat dhe aktet nënligjore të miratuara nga KMSHC.

- Rregulloren e Brendshme ñPër organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civilò, miratuar me Vendimin Nr.18, datë 11.03.2015
- Rregullorja ñPër parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Institucionin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civilò, miratuar me Vendimin nr. 11, datë 29.01.2016
- Rregullorja ñMbi procedurat e mbikëqyrjes/ inspektiminò, miratuar me Vendim nr. 17, datë 11.03.2015

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nuk ka funksionuar me Kod Etike të veçantë, por bazuar në Ligjin nr.9131 dt.08.09.2003 ñPër Rregullat e Etikës në Administratën Publikeò, Ligjin nr.10296, Kreu III, neni 20 ñMjedisi i kontrollitò, pika 2/a dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës, Kap II, pika 2.5.1 ñMjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)ò, paragrafi ñKodi i Etikësò, gjendet e formuluar tek Rregullorja e Brendshme ñPër organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civilò, në kreun III ñDisiplina dhe etika në punëò.

1.2 Politika menaxheriale dhe stili i punës

Emërimet janë kryer në zbatim të Ligjit 152/2013 ñPër nëpunësin civilò, i ndryshuar, nenet 22 dhe 25, si dhe Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, ñPër pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutiveò , kreu II, III dhe VII.

1.3 Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, hierarkia, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit

Sekretariati i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është struktura mbështetëse e Komisionerit në përmbushjen e detyrave të ngarkuara nga ligji dhe kjo strukturë funksionon me të gjithë kapacitetin e burimeve njerëzore të miratuara me Vendimin e Kuvendit Nr. 98, datë 4.12.2014, ñPër miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të vendeve të punës së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civilò. Organika e këtij Institucioni parashikon 31 pozicione pune. Në auditimin e kryer u vu re se ka vështirësi në realizimin e mbikëqyrjes

dhe inspektimit në subjekte për arsye të kapacitetit të ulët të burimeve njerëzore, konstatim ky edhe nga ana e institucionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Nga analiza që i bëmë strukturës, vërehet një shpërndarje thuajse e njëtrajtshme e burimeve njerëzore nëpër drejtori, sipas organigramës më poshtë:

Organika e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil		**Vitet**				
Funksioni	**Numri i punonjësve**	**2017**	**2018**	**2019**	**2020**	**2021**
Komisioneri	**1**	1	1	1	1	1
Kabineti	**2**	2	2	2	2	2
Këshilltar	1	1	1	1	1	1
Sekretar	1	1	1	1	1	1
Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes	**15**	15	14	13	15	15
Drejtor i Përgjithshëm	1	1	1	1	1	1
Drejtoria e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ	**7**	7	7	5	7	7
Drejtor	1	1	1	1	1	1
Inspektor	6	6	6	4	6	6
Drejtoria e Mbikëqyrjes	**7**	7	6	7	7	7
Drejtor	1	1	1	1	1	1
Inspektor	6	6	5	6	6	6
Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë	**5**	5	5	5	5	5
Drejtor	1	1	1	1	1	1
Specialist	4	4	4	4	4	4
Drejtoria e Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse	**8**	8	8	8	8	8
Drejtor	1	1	1	1	1	1
Specialist (IT)	1	1	1	1	1	1
Specialist (Marrëdhëniet me Publikun dhe Burimet Njerëzore)	1	1	1	1	1	1
Specialist (Financë/ Buxhet)	1	1	1	1	1	1
Specialist Arkivë/ Protokoll	1	1	1	1	1	1
Punonjës Mirëmbajtjeje	1	1	1	1	1	1
Shofer	1	1	1	1	1	1
Pastrues	1	1	1	1	1	1
Punonjës gjithsej	**31**	**31**	**30**	**29**	**31**	**31**

Nga grupi i auditimit u analizua nëse në strukturën e këtij institucioni ka patur vende vakante dhe koha që këto pozicione kanë qenë vakante. Nga verifikimet konstatojmë se në total për periudhën e auditimit ka patur 8 vendet vakante. Këto vende vakante kanë ardhur si pasojë e pezullimit, dorëheqjes, ngritjes në detyrë, largimi nga jeta e një punonjësi të KMSHC- s. Konstatojmë se për këto vende vakante, KMSHC ka reaguar në kohë për të zëvendësuar. Në vitin 2018, Drejtoria e Mbikëqyrjes ka patur një vend vakant në pozicionin inspektor në qershor të vitit 2018 e cila është plotësuar në vitin 2019. Drejtoria e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ në vitin 2019, për dy vende vakante në pozicionin inspektor: një në tetor të vitit 2019 dhe një nëntor të vitit 2019, të cilat janë plotësuar në vitin 2020.

Duke qenë se kjo drejtori është krijuar dhe mbulon në strukturë misionin e këtij institucioni, vendet vakante në Drejtorinë e Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, mbartin risqe të cënimit të performancës së aktivitetit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Në strukturën e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil deri në prill 2021 nuk ka vende vakante.

Në lidhje sa më sipër në shkresën e datës 17.05.2021, nr. 602/11 Prot., protokolluar në KLSH, me nr. 157/18 në datën 19.05.2021, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka nisur observacionet mbi akt- konstatimet e mbajtura ku thuhet se: Në lidhje me këtë konstatim, sqarojmë se struktura aktuale e Komisionerit është e plotësuar me të gjithë kapacitetin e saj dhe vendet vakante në këtë drejtori, të krijuara për arsye të ligjshme, janë plotësuar rast pas rasti. Vakancat e përkohshme nuk e kanë cenuar veprimtarinë e institucionit, i cili e ka realizuar planin e punës dhe të buxhetit, si dhe të gjitha objektivat e tij.

Përgjigje-

Grupi i auditimit shqyrtoi observacionin duke ritheksuar se më sipër është përshkruar situata për periudhën e auditimit ku thuhet se pozicionet kanë qenë të lira në qershor të vitit 2018, e plotësuar në vitin 2019 dhe dy pozicione nga të cilat një në tetor dhe një në nëntor të vitit

2019, të cilat janë plotësuar në vitin 2020. Gjithashtu sjellim ne vëmendjen tuaj se i referohemi ñrisqeve për tu cënuar veprimtariaò që mbartin vakancat në këto pozicione dhe jo ñcenimit të veprimtarisëò që i referohet KMSHC në observime. Për sa më sipër obseravcioni nuk merret parasysh.

1.4 Aftësitë profesionale të punonjësve

Grupi i auditimit verifikoi dosjet e punonjësve të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil bazuar në Vendimin Nr. 833, datë 28.10.2020, Lidhja I, Lidhja II, **ku dokumentacioni i kërkuar me të dhënat e personelit ishte i plotë.**

Emërimet janë kryer në zbatim të Ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, nenet 22 dhe 25, si dhe Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, ñPër pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutiveò, kreu II, III dhe VII.

- ✓ Në shkresën ñHarta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, të Korrik 2015, të hartuar nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pikën e trajnimit të punonjësve është specifikuar hartimi i planit të trajnimeve, **por këto plane për vitet në auditim nuk janë vënë në dispozicion për grupin e auditimit.**
- ✓ Stafi ka kryer trajnime sipas programeve nga ASPA, për njohuritë e tyre në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, për Procedurat e Prokurimit Publik, etj, ky konstatim vjen edhe nga prezenca e dokumentave të marra nga ASPA pas përfundimeve të trajnimeve në dosjet e audituara të personelit të KMSHC. Nuk janë kryer trajnime për anëtarët e GMS-s në fushën e Menaxhimit të Riskut.
- ✓ Në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit nuk janë kryer trajnime për të gjithë Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS- n).
- ✓ Vlerësimi i performancës së punonjësve organizohet në vlerësim çdo gjashtë mujor, pra 2 herë në vit, në konstatimin nga grupi i auditimit këto vlerësime janë kryer dhe ishin pjesë e dosjeve të personelit.

7. Titulli i Gjetjes	**Mungesë e planit të trajnimit**
Situata:	Nga auditimi rezultoi se, në KMSHC nuk është hartuar plani i trajnimeve për periudhën objekt auditimi. Gjithashtu nuk janë kryer trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik në fushën e Menaxhimit të Riskut dhe atë të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
Kriteri:	Ligji Nr. 10296, datë 8.7.2010, ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar Urdhër Nr. 108, datë 17.11.2016 Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit
Ndikimi/Efekti:	Mos ndjekja e trajnimeve cënon cilësinë e zhvillimit profesional të punonjësve.
Shkaku:	Mungesa e hartimit të planit të trajnimeve dhe ndjekja e tyre.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil të marrë masa që për periudhën në vijim, të kryhet hartimit dhe zbatimi i planit të trajnimeve për stafin si dhe të kryhen trajnime veçanërisht për GMS-në në fushën e Menaxhimit financiar dhe Kontrollit si dhe Menaxhimit të Riskut.

2. Menaxhimi i riskut

Në këtë proces identifikohen situatat e mundshme që mund të kenë efekt të dëmshëm në veprimtarinë e institucionin, të cilat mund të jenë risqe të brendshme apo të jashtme. Komisioneri ka miratuar ñStrategjinë e Menaxhimit të Riskut 2017- 2019, nr. 869 prot. , datë 30.12.2016. Strategjia duhet të përditësohet rregullisht (çdo 3 vite), në zbatim të Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 ñPër përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK- së dhe koordinatorit të riskut në njësitë publikeò, pikën 5.3 Strategjia e Riskut është miratuar ñStrategjia e Menaxhimit të Riskut 2021- 2024 me nr. 34 prot, datë 11.01.2021. Koordinatori i riskut, duhet të jetë Nëpunësi Autorizues (ose kjo detyrë të delegohet), në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, nenit 11, ñPërgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisëò, pika 2, në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kapitulli III, pika 2.5.2 ñMenaxhimi i Riskutò, si dhe nenit 10 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010.

Grupit të auditimit ju paraqitën shkresat e nisura nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për caktimin e **Nëpunësit të Autorizuar të përkohshëm** sipas periudhave të paraqitura.

Në shkresën e datës 24.03.2020, nr. 121/1 prot., drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Njësisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit është kërkuar të delegohet Nëpunës Autorizues (NA), për periudhën 01.04.2020- 01.06.2020 Arbana Basha për kryerjen e pagesave për shpenz. në artikujt 600/601, 602, 605, 606 dhe çdo veprim tjetër të kërkuar në lidhje me Drejtorinë e Thesarit, Tiranë. Në shkresën e kthimit të përgjigjes 5873/1, datë 24.04.2020 ñMbi caktimin e Nënpunësit Autorizues të përkohshëm për Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civilò, KMSHC- ja ka nisur më datë 29.04.2020, nr. 289/1 prot. Urdhërin e Emërimit të znj. B. (Urdhër i Brendshëm Nr. 71 prot., dt. 29.07.2015). Konfirmimi nga Dega e Thesarit, ñMbi caktimin e Nënpunësit Autorizues të përkohshëm për KMSHC- në është kryer në shkresën e nisur në datën 11.05.2020 me nr. prot. 5873/3.

Nga verifikimet e kryera, edhe pse konfirmimi nga Dega e Thesarit ka ardhur një muaj pas periudhës së kërkuar në kryerjen e detyrave si Nënpunës i Autorizuar, caktimin e tij si NA, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka kryer veprime në Degën e Thesarit për të gjithë periudhën e kërkuar 01.04.2020- 01.06.2020.

Në lidhje sa më sipër në shkresën e datës 17.05.2021, nr. 602/11 Prot., protokolluar në KLSH, me nr. 157/18 në datën 19.05.2021, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka nisur observacionet mbi akt- konstatimet e mbajtura ku thuhet se: Lidhur me këtë rast, Komisioneri ka kërkuar informacion nga të dy institucionet *(MF&E dhe Dega e Thesarit Tiranë)* të cilat konfirmuan se për shkak të periudhës tejet të rënduar nga pandemia Covid-19, ku vendi ju nënshtrua një mbyllje (lockdown) totale për rreth tre muaj, institucionet e ngarkuara me pranimin e delegimit në fjalë kanë komunikuar në rrugë elektronike apo telefonike, në pamundësi të prezencës së stafeve në punë. Këtë fakt e konfirmon edhe shkresa e vonuar, por e dërguar në degën e Thesarit Tiranë, me nr. 8573/3, prot, dt 11.05.2020, nga Ministria e Financave, ku KMSHC është vetëm në rolin e institucionit që vihet në dijeni. Bashkëlidhur shkresa në fjalë.

*Përgjigje- Grupi i auditimit shqyrtoi observacionin dhe mori parasysh situat*ën e rënduar nga pandemia Covid- 19.

Dega e Thesarit nuk i është përgjigjur shkresës së datës 10.07.2019, nr. 1208 prot., për caktimin e Nënpunësit Autorizues (NA). Pavarësisht kësaj Komisioneri për Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil ka kryer veprimet nëpërmjet znj. B. për periudhën 01.08.2019- 03.09.2019.

Në lidhje sa më sipër në shkresën e datës 17.05.2021, nr. 602/11 Prot., protokolluar në KLSH, me nr. 157/18 në datën 19.05.2021, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka nisur observacionet mbi akt- konstatimet e mbajtura ku thuhet se: Lidhur me komentin tuaj

në akt konstatimi, kërkuam sqarim nga Dega e Thesarit Tiranë dhe nga ana e këtij institucioni na u vu në dispozicion një kopje e shkresës/aktit me të cilin ata kanë vepruar dhe kanë pranuar transaksione për llogari të KMSHC-së, për periudhën e kërkuar të delegimit (*bashkëlidhur shkresa me nr. 4670, dt. 18.07.2019*).

Përgjigje- Grupi i auditimit shqyrtoi observacionin dhe e mori në konsideratë.

2.1. Procesi i Menaxhimit të Riskut për periudhën e auditimit rezulton të jetë dokumentuar me urdhërat përkatës të jetë realizuar çdo dy vite: Regjistri i Riskut në vitin 2016 me nr.869/1 prot. datë 30.12.2016 ,Regjistri i Riskut në 2018 me nr. 358/6 prot. datë 12.10.2018 dhe Regjistri i Riskut në 2019 me nr. 652/1 prot. datë 01.09.2020 konform Ligjit 10296 dt.08.07.2010, Kreu III dhe nenit 10, Kreu II, ndryshuar me Ligjin nr.110/2015 si dhe Udhëzimit nr.16 dt.20.07.2016 ñPër përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut njësitë publikeò.

Në këtë Regjistër është paraqitur përshkrimi i risqeve, niveli i riskut para kontrollit, kontrollet ekzistuese, risqet pas kontrolleve ekzistuese, nevoja për kontrolle të mëtejshme, veprime për të adresuar boshllëqet, zotëruesit e riskut,ndryshime në risk që nga vlerësimet e fundit, por nuk është pasqyruar mënyra apo rrugëzgjidhja e situatës në rastin e ndodhjes apo konstatimit të dukurisë. Në mbështetje të Ligjit nr. 10296 dt 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò neni 27, në zbatim të Udhëzimit nr.16 dt.20.07.2016 ñPër përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK në Njësitë Publikeò pika 2/2,4, është ngritur Grupi i punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) me shkresën nr. prot. 5 datë 25.01.2016, me 8 anëtarë dhe përbërja e tyre është si vijon më poshtë:

Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS)		
P. S.	Komisioneri	Titullari & NA
A. B.	Drejtor i Përgj. i Drejtorisë së Përgjth. të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes	Anëtar
I. K.	Drejtor i Drejtorisë së Përgjth. të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes	Anëtar
E. H.	Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ	Anëtar
A. Sh.	Drejtor i Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë	Anëtar
O. H.	Drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse	Anëtar

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil nuk ka miratuar Plan Pune Vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjikò - GMS; aktivitetet dhe çështjet që do të analizohen dhe diskutohen, si dhe grafiku i mbledhjeve që do të zhvillohen nga ana e këtij grupi. ñLista e Proçeseve të Punës për përgatitjen e kërkesave buxhetore afatmesme në institucionò dhe ñLista e Proçeseve të Punës për Menaxhimin e Aktiveveò janë hartuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Në auditimin e kryer në analizimin e regjistrat e riskut nga grupi i auditimit u konstatua se Regjistri i Riskut është kryer çdo 2 vite, në 2016 me nr. prot. 869/1, datë 30.12.2016, në vitin 2018 me nr. prot. 358/6, datë 12.10.2018 dhe në vitin 2020 me nr. prot. 652/1, datë 01.09.2020. Rezultoi se risqet e parashtruara në këto dokumente janë kryesisht të përgjithshëm, kanë të njëjtin koeficent vlerësimi (i njëjtë për të tre vitet), konfirmuar si procedohet , cilët janë zotëruesit e risqeve por nuk janë parashikuar masa konkrete për tû ndërmarrë nga personat përgjegjës sipas drejtorive, në mënyrë që të bëhet dhe ndjekja e tyre (gjurmimi).

Në lidhje sa më sipër në shkresën e datës 17.05.2021, nr. 602/11 Prot., protokolluar në KLSH, me nr. 157/18 në datën 19.05.2021, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka nisur observacionet mbi akt- konstatimet e mbajtura ku thuhet se: Në këtë këndvështrim, sipas fushës së veprimtarisë së institucionit, janë vlerësuar dhe janë evidentuar edhe risqet sipas koeficienteve përkatës. Për këtë arsye, Komisioneri nuk është dakord me konstatimin

"risqet...janë kryesisht të përgjithshëm, ...", pasi nuk është i bazuar me argumente konkrete. Nëpërmjet strukturës përkatëse të GMS-së, do të planifikohet që në mbledhjen e radhës të diskutohet edhe rishikimi i regjistri ku do të diskutohen këto probleme për të përfshirë në proces kërkesat sa më lart cituar në lidhje me përmirësime në regjistrin e riskut.
*Përgjigje- Grupi i auditimit shqyrtoi observacionin dhe vler*ëson që në mbledhjen e rradhës do diskutohet edhe rishikimi i regjistrit.

8. Titulli i Gjetjes	**Mbi analizën e riskut të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil**
Situata:	Regjistri i Riskut është kryer çdo 2 vite, konkretisht në 2016 me nr. prot. 869/1, datë 30.12.2016; në vitin 2018 me nr. prot. 358/6, datë 12.10.2018; dhe në vitin 2020 me nr. prot. 652/1, datë 01.09.2020. Rezultoi se risqet e parashtruara në këto dokumente kanë të njëjtin koeficient vlerësimi (i njëjtë për të tre vitet), konfirmuar si procedohet si dhe cilët janë zotëruesit e risqeve por vihet re se, nuk janë parashikuar masa konkrete për tû ndërmarrë nga personat përgjegjës sipas drejtorive, në mënyrë që të bëhet adresimi i risqeve dhe ndjekja e tyre (gjurmimi).
Kriteri:	Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, të Manualit të Auditit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave ñPër miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publikò Udhëzimin Nr. 16, datë 20.07.2016 ñPër përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike.ò
Ndikimi/Efekti:	Mangësi për të identifikuar, analizuar, vlerësuar, trajtuar, monitoruar dhe komunikuar risqet kryesore që shoqërojnë përgjegjësitë e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil
Shkaku:	Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mbylljes së institucionit Komisionit të Shërbimit Civil, në nëntor të vitit 2014, të krijuar sipas ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, ñStatusi i nënpunësit civilò.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil të marrë masa për ngritjen e grupit të punës me qëllim identifikimin dhe vlerësimin e risqeve me qëllim marrjen e masave për ndjekjen dhe adresimin e tyre, në funksion të realizmit të objektivave të njësisë

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka miratuar me Vendimin nr. 103, datë 28.12.2018, miratimin e rregullores së brendshme ñPër përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimitñ. Referuar rregullores së miratuar nga Këshilli i Ministrave/ AKSHI, në 02.12.2008 ñPër ndërtimin e dhomës së serverave, Komisioneri i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil ka një dhomë serveri në të cilën janë të vendosura serverat nga ku njëri shërben për ruajtjen e të dhënave të sistemit statistikor dhe në tjetrin gjenden kopjet e disa prej të dhënave të institucionit si dhe programi financiar Alpha web. Po ashtu në godinën e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është vendosur sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit.
Sistemi i aksesit, i cili menaxhon nëpërmjet aksesimit me karta për menaxhimin e hyrje daljeve të personelit në institucion. Menaxhimi i së cilit bëhet nga specialisti i IT-së dhe është në Shërbim të Drejtorisë së Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Sistemi i monitorimit, i cili monitoron ambientin e brendshëm nëpërmjet kamerave të vendosur. Menaxhimi i këtij sistemi kryhet nga specialisti i IT- së.
Siguria e sistemit menaxhohet nga specialisti i IT në bashkëpunim me AKSHI-n të cilët kanë siguruar internet dhe antivirus për të gjithë përdoruesit.
Sistemi i përpunimit dhe gjenerimit të statistikave, sistem ky i krijuar në shërbim të funksionit të institucionit në të cilën regjistrohen të dhënat e të gjitha mbikëqyrjeve dhe inspektimeve të kryera, këto të dhëna përpunohen dhe bëhen pjesë e raportit përfundimtar çdo vit.
HRMIS- *Human Resources Management Information System*, sistemi për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është një nga institucionet që përdor këtë sistem. Menaxhimi i këtij sistemi kryhet nga specialisti i Burimeve Njerëzore dhe specialisti i Financës dhe Buxhetit. Akses në regjistrimin e punonjësve ka specialisti i Burimeve Njerëzore i cili është i autorizuar nga AKSHI nëpërmjet DAP-it dhe ka kredincialet e tij për akses. Në këtë sistem pasqyrohen të dhënat personale dhe profesionale të çdo punonjësi te punësuar. 1- Të dhënat personale bazë të punonjësit, emër mbiemër, mosha, etj. gjenerohen në mënyrë automatike nga regjistri elektronik i gjendjes civile dhe nuk mund të modifikohen nga përdoruesi. 2- Të dhënat profesionale që kanë të bëjnë me arsimin, përvojën e punës, certifikime të ndryshme profesionale etj. plotësohen manualisht nga specialisti i Burimeve Njerëzore, në bazë të dokumenteve që janë pjesë e dosjes personale të punonjësit. Modifikimi i këtyre të dhënave mund të kryhet në sistem vetëm nga personi i autorizuar duke e shoqëruar këtë ndryshim me ngarkimin e dokumentit të ri që korrigjon dokumentin e parë. Çdo korrigjim i të dhënave që ka të bëj me përvojën e punës, duhet të kenë arsyen përkatëse të ndryshimit si dhe të reflektohen ne historikun e ndryshimeve që kanë pësuar këto të dhëna në sistem. Akses po ashtu ka specialisti i Financës dhe Buxhetit, i cili ka po ashtu kredencialet e tij dhe në bazë të dhënave, kryen rakordimin me listëprezencën dhe miraton ato.

3. Aktivitetet e kontrollit

Referuar Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, politikat dhe proçedurat që vendosen, si parandaluese apo zbuluese në adresimin e risqeve sjellin arritjen e objektivave të institucionit. Titullarët e njësive të sektorit publik miratojnë veprimtaritë e kontrollit, përfshirë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil nuk ka në strukturën e saj Auditin e Brendshëm, mungesë e cila sjell mungesën e vlerësimeve specifike për sistemet e kontrollit të brendshëm.
Ky institucion nuk ka qenë pjesë e programit të auditit të jashtëm, si pasojë e saj nuk ka patur mbikëqyrje nga ana e titullarit për zbatime të rekomandimeve mbi fushën e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Titulli i Gjetjes nr. 9:	**KMSHC nuk i është nënshtruar asnjë shërbimi të shërbimit të auditit të brendshëm**
Situata:	Nga auditimi rezultoi se në KMSHC nuk është kryer asnjë shërbim i auditit të brendshëm, i cili ka për qëllim të ofrojë siguri objektive dhe këshillim për drejtimin e institucionit, si dhe të ndihmojë njësinë publike për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike. Kjo pasi KMSHC nuk ka në strukturën organizative, një strukturë të dedikuar për kryerjen e këtij shërbimi.
Kriteri:	Ligji Nr. 114/2015 ñPër Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publikò, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 Ligji Nr. 10296, datë 8.7.2010, ñPër Menaxhimin Financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar

Ndikimi/Efekti:	Dhënien e sigurisë objektive dhe këshillimin për menaxhimin për të shtuar vlerën e për të përmirësuar veprimtarinë e njësisë publike, gjithashtu për të ndihmuar njësinë publike për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, dhe për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit e të qeverisjes.
Shkaku:	Mungesa e Auditit të Brendshëm në strukturën e KMSHC- së
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Si institucion që kryen funksione publike, KMSHC duhet të marrë masa të sigurojë kryerjen e shërbimit të auditimit të brendshëm, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. Nr. 114/2015 ñPër Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publikò, ose nëpërmjet krijimit të një njësie të dedikuar brenda strukturës organizative të institucionit, ose nga njësia e auditimit të brendshëm e një njësie tjetër publike, në bazë të një marrëveshjeje ndërmjet titullarëve të njësive publike përkatëse, e cila duhet të miratohet paraprakisht nga Ministri i Financave, sa më sipër me qëllim dhënien e sigurisë së arsyeshme për titullarin e njësisë së sektorit publik, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshillimit për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë e sektorit publik
Afati për zbatim:	Brenda vitit 2021

4. Informimi dhe komunikimi

Komisioneri i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil disponon faqen e saj zyrtare në web, ku pasqyrohet aktiviteti i saj. Komunikimi realizohet elektronikisht, verbalisht dhe në formë shkresore. Me subjektet komunikimi kryhet nëpërmjet telefonit, postës zyrtare apo elektronike.

Në Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil funksionojnë këto sisteme informatike: HRMIS, Alpha web, Sistemi i përpunimit dhe gjenerimit të statistikave, Word & Excel. Ky institucion nuk ka akses në sistemin e kontabilitetit SIFQ- Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, ai punon me sistemin Alpha Buxhetor. Alpha Web, përdoret nga specialisti i Financës dhe Buxhetit. HRMIS- *Human Resources Management Information System*, sistemi për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit. Menaxhimi i këtij sistemi kryhet nga specialisti i Burimeve Njerëzore dhe specialisti i Financës dhe Buxhetit. Sistemi i përpunimit dhe gjenerimit të statistikave, sistem ky i krijuar në shërbim të funksionit të institucionit në të cilën regjistrohen të dhënat e të gjitha mbikëqyerjeve dhe inspektimeve të kryera, këto të dhëna përpunohen dhe bëhen pjesë e raportit përfundimtar çdo vit. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për çdo problem apo parregullsi, në rrugë elektronike.

5. Monitorimi

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dërgon Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, si dhe Drejtorisë së Përgjithshme për periudhat Janar- Prill, Janar- Gusht dhe Janar- Dhjetor, në total tre raporte vjetore për ecurinë dhe realizimin e produkteve, masën e realizimit të shpenzimeve, si dhe identifikimin e fushave të cilat nuk janë realizuar në masën e pritshme, duke analizuar dhe shkaqet përkatëse. Ky Raportim monitorimi për periudhën Janar- Dhjetor është dërguar në MFE: për vitin 2017 me shkresën përcjellëse nr. 297 datë 28.02.2018; për vitin 2018 me shkresën përcjellëse nr. 335 datë 28.02.2019; për vitin 2019

me shkresën përcjellëse nr. 235 datë 28.02.2020; për vitin 2020 me shkresën përcjellëse nr. 360 datë 26.02.2021. Pyetësori i Vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Deklarata për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Raporti për Funksionimin e Cilësisë së Kontrollit të Brendshëm dhe Planin e Veprimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si dhe në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për vitin 2017: nr. 302 prot., datë 01.03.2018, për vitin 2018: nr. 72/4 prot., datë 28.02.2019, për vitin 2019: nr. 236 prot., datë 28.02.2020 dhe për vitin 2020: nr. 361 prot., datë 26.02.2021, (nisja e tyre është kryer brenda afatit të përcaktuar në Manualin e MFK, pika 2.2.3, përjashtuar viti 2017 i cili është nisur jashtë afatit të përcaktuar)

Raportimi mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë, përmban informacione dhe evidenca të ndryshme, ku bazohet dhe Raporti vjetor i monitorimit i cili i dërgohet Ministrisë së Financave. Monitorimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e kryen bazuar në Rregulloren e Brendshme, Planin e Punës, dokumentin e PBA- ve si dhe raporteve të monitorimit.

(Gjerësisht problemet mbi "Organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit të KMSHC, vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm" janë trajtuar në akt-konstatimi nr. 2, datë 30.04.2021, dorëzuar me protokoll në Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil)

DREJTIMI 3: ÇËSHTJE TË AUDITIMIT FINANCIAR

a. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit

Në zbatim të pikës 3a të programit të auditimit: mbi ñHartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetitò u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

a. Zbatimi i kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit

b. Zbatimi i kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar

c. Realizimi i planit të buxhetit

Baza ligjore për auditimin e programimit dhe realizimit të treguesve buxhetorë: për vitet 2017, 2018, 2019, 2020.

- Ligji nr. 9936, datë 26,06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHò, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016
- Udhëzimi nr. 2, datë 06.02.2012 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò
- Udhëzimi nr. 22, datë 17.11.2016 ñPër procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit për njësitë e Qeverisjes Qendroreò
- Ligji nr. 109, datë 30.11.2017 ñPër buxhetin e vitit 2018ò
- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2018 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, të ndryshuar
- Udhëzimi plotësues i Ministrit të Financave nr.2, datë 19.02.2018 ñPër zbatimin e buxhetit të vitit 2018ò, i ndryshuar
- Ligji nr. 99/2018 ñPër buxhetin e vitit 2019ò
- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, të ndryshuar
- Udhëzimi plotësues i Ministrit të Financave nr.1, datë 17.01.2019 ñPër zbatimin e buxhetit të vitit 2019ò, i ndryshuar
- Akti Normativ nr. 2, datë 02.10.2019 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin 99/ 2018 ñPër buxhetin e vitit 2019ò

- Vendimi i Këshillit të Ministrisë nr. 750, datë 27.11.2019 ñPër shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranëò
- Shkresa nr. 21920, datë 02.12.2019 të Ministrit të Financave ñMbi prioritetin e pagesave në kushtet e gjendjes së shpallur të fatkeqësive natyroreò, e ndryshuar
- Ligji nr. 88/2019 ñPër buxhetin e vitit 2020ò
- Udhëzimi plotësues i Ministrit të Financave nr.2, datë 20.01.2020 ñPër zbatimin e buxhetit të vitit 2020ò, i ndryshuar
- Akti Normativ nr. 15, datë 15.04.2020 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin 88/ 2019 ñPër buxhetin e vitit 2020ò
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 4, datë 29.02.2016 ñPër përgatitjen e PBA 2017-2019ò
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 10, datë 28.02.2017 ñPër përgatitjen e PBA-së 2018-2020"
- Udhëzim nr. 8, datë 29.03.2012 ñPër Procedurat Standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëmò
- Vendim nr. 515, datë 13.07.2016 ñPër miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të -Programit Buxhetor Afatmesëm 2017- 2019ò

Zbatimi i kritereve në planifikimin e buxhetit për periudhën e audituar është mbështetur në udhëzimet respektive vjetore të Ministrisë së Financave referuar Udhëzimeve të Ministrisë së Financave ñPër përgatitjen e buxhetitò hartimin dhe detajimin e planit të shpenzimeve në zbatimin e buxhetit të shtetitò

Me qëllim që të sigurohet realizimi i kompetencave ligjore të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili si institucion ka mision mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 152, datë 30.05.2013 ñPër nënpunësin civilò, i ndryshuar, është hartuar Programi Buxhetor Afatmesëm 2017- 2019, Programi Buxhetor Afatmesëm 2018- 2020, Programi Buxhetor Afatmesëm 2019- 2022.

Programi për të cilën ky institucion ka administruar fondet vitin 2017 është:

1. Planifikim- menaxhim- administrim

Hartimi i projektbuxhetit për periudhën afatmesme **2017-2019**, mbështetje në fondet buxhetore, sipas tavaneve buxhetore të miratuara me Vendimin nr.230, datë 30.3.2016 të Këshillit të Ministrave ñPër miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2019-2021ò, në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 4, datë 29.02.2016 ñPër përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017- 2019ò.

- Faza e Parë, shkresa nr.363, date 03.05.2016 dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, Vendimin nr.230, datë 30.03.2016 të Këshillit të Ministrave ñPër miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019ò.

Konstatim: Bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 4, datë 29.02.2016 ñPër përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017- 2019ò, afati i dorëzimit për kërkesat e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019 është 2 maj 2016, shkresa e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është dërguar 1 ditë me vonesë.

- Faza e Dytë, shkresa nr.536 , date 01.09.2016 dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, sipas tavaneve buxhetore të rishikuara me vendimin nr.515, datë 13.7.2016 të Këshillit të Ministrave ñPër miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019ò.

Hartimi i projektbuxhetit për periudhën afatmesme **2018-2020**, mbështetje në fondet buxhetore, sipas tavaneve buxhetore të miratuara me vendimin nr.197, datë 15.3.2017 të Këshillit të Ministrave ñPër miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2018-2020ò, në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 10, datë 28.02.2017 ñPër përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2018- 2020ò.

- Faza e Parë: shkresa nr.323, date 02.05.2017 dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, Vendimin nr.197, datë 15.03.2017 të Këshillit të Ministrave ñPër miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020ò.
- Faza e Dytë: shkresa nr.1570 , date 31.08.2017 dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, sipas tavaneve buxhetore të miratuara në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 10, datë 28.02.2017 ñPër përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2018- 2020ò.

Hartimi i projektbuxhetit për periudhën afatmesme **2019-2021**, mbështetje në fondet buxhetore, sipas tavaneve buxhetore të miratuara me vendimin nr. 128, datë 07.03.2018 të Këshillit të Ministrave ñPër miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2018-2020ò.

- Faza e Parë, shkresa nr.358/3, date 02.05.2018 dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, dhe Drejtorinë e Analizave dhe Programit Buxhetor, Vendimin nr.128, datë 07.03.2018 të Këshillit të Ministrave ñPër miratimin e tavaneve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021ò, në zbatim të Udhëzimit nr. 7/1, datë 28.02.2018 ñPër përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2019- 2021ò.
- Faza e Dytë, shkresa nr.673/4, date 31.08.2018 dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, dhe Drejtorinë e Analizave dhe Programit Buxhetor, sipas tavaneve buxhetore përfundimtare të miratuara me VKM nr.476/ 2018 ñPër miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm për 2019- 2021ò, në zbatim të Udhëzimit nr. 7/1, datë 28.02.2018 ñPër përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2019- 2021.

Hartimi i projektbuxhetit për periudhën afatmesme **2020-2022**, mbështetje në fondet buxhetore, sipas tavaneve buxhetore të miratuara me vendimin nr. 117, datë 13.03.2019 të Këshillit të Ministrave ñPër miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2020-2022ò, në zbatim të Udhëzimit nr. 8, datë 28.02.2019 ñPër përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020- 2022ò.

- Faza e Parë, shkresa nr.574, date 26.04.2019 dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Drejtorinë e Përgjithshme dhe, Drejtorinë e Analizave dhe Programit Buxhetor, Vendimin nr.117, datë 13.03.2019 të Këshillit të Ministrave ñPër miratimin e tavaneve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022ò.
- Faza e Dytë: shkresa nr.1103/2, date 02.09.2019 dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, dhe Drejtorisë së Analizave dhe Programit Buxhetor, sipas tavaneve buxhetore përfundimtare të miratuara me VKM nr.523, datë 25.07.2019 ñPër miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm për 2020- 2022ò.

Hartimi i projektbuxhetit për periudhën afatmesme **2021-2023**, mbështetje në fondet buxhetore, sipas tavaneve buxhetore të miratuara me vendimin nr. 577, datë 22.07.2020 të Këshillit të Ministrave ñPër miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2021-2023ò.

- Faza e Parë: shkresa nuk është kryer dhe dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, dhe Drejtorisë së Analizave dhe Programit Buxhetor për arsye të mbylljes nga Covid- 19.
- Faza e Dytë: shkresa nr. 652/1, date 01.09.2020 dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, dhe Drejtorisë së Analizave dhe Programit Buxhetor, sipas tavaneve buxhetore përfundimtare të miratuara me VKM nr.577, datë 22.07.2020 ñPër miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021- 2023ò, në zbatim të Udhëzimit plotësues nr. 28, datë 10.07.2020 ñPër përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021- 2023ò.

Plani dhe Realizimi i buxhetit për vitin 2017

Në zbatim të Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 ñPër procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit për njësitë e Qeverisjes Qendroreò, si dhe Udhëzimit Plotësues nr. 8, datë 13.01.2017 ñPër zbatimin e Buxhetit për vitin 2017ò, të Ministrit të Financave në tabelën e mëposhtme janë paraqitur fondet buxhetore të akorduara dhe të realizuara për Komisionerin e Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, për vitin 2017.

Art.	Emërtimi	Buxheti fillestar 2017	Ndryshimet në buxhet	Buxheti 2017 (i ndryshuar)	Realizimi FAKT	Realizimi ne (%) ndaj Planit përfundimtar te vitit 2017	Struktura ne %
Shpenzime Korrente							
600	Paga	31.700.000	1.120.000	32.820.000	32.754.000	100%	61%
601	Sigurime Shoqërore	5.300.000	-90.000	5.210.000	5.183.000	99%	10%
602	460	12.200.000	1.547.000	13.747.000	11.019.000	80%	21%
605	240	460.000	-347.000	113.000	113.000	100%	0%
606	Trans. për Buxh. Fam. dhe Ind.	240.000	61.000	301.000	301.000	100%	1%
Shpenzime Kapitale							
231	Kapitale të Trupëzuara	4.000.000	0	4.000.000	3.956.000	99%	7%
Totali (Korrente+ Kapitale)	53.900.000	2.291.000	56.191.000	53.326.000	96%	100%	

Fondet buxhetore të miratuara në fillim të vitit 2017 për Komisionerin e Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, në vlerën 53,900,000 lekë. Buxheti i ndryshuar shkoi në vlerën 56,191,000 lekë. Realizimi në vlerën 53,326,000 lekë. Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 96 % ndaj planit për 12-mujorin e 2017. Shpenzimet për paga zënë rreth 61 % dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 10 % të totalit dhe janë realizuar në masën 100 % pagat dhe 99 % sigurimet shoqërore ndaj planit vjetor 2017. Shpenzimet korrente zënë rreth 73 % të totalit dhe janë realizuar në masën 95.8 % ndaj planit vjetor. Ndërsa shpenzimet kapitale zënë rreth 7 % të totalit dhe janë realizuar në masën 99 % ndaj planit vjetor.

Plani dhe Realizimi i buxhetit për vitin 2018

Në zbatim të ligjit nr. 109, datë 30.11.2017 ñPër buxhetin e vitit 2018ò, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2018 ñ Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, të ndryshuar, si dhe Udhëzimit plotësues nr. 2, datë 19.02.2018 ñPër zbatimin e buxhetit të vitit 2018ò, të Ministrit të Financave, fondet buxhetore të miratuara, të alokuara dhe të realizuara për Komisionerin për Mbikëqyrjes e Shërbimit Civil, për vitin 2018 paraqitet si më poshtë:

Art.	Emërtimi	Buxheti fillestar 2018	Ndryshimet në buxhet	Buxheti 2018 (i ndryshuar)	Realizimi FAKT	Realizimi ne (%) ndaj Planit përfundimtar te vitit 2018	Struktura ne %
Shpenzime Korrente							
600	Paga	34.500.000	0	34.500.000	34.129.100	99%	61%

601	Sigurime Shoqërore	5.850.000	0	5.850.000	5.426.200	93%	10%
602	Mallra dhe Shërbime të tjera	12.830.000	0	12.830.000	11.778.300	92%	21%
605	Transferta Korrente të Huaja	200.000	0	200.000	107.100	54%	0%
606	Trans. për Buxh. Fam. dhe Ind.	240.000	100.000	340.000	340.000	100%	1%
Shpenzime Kapitale							
231	Kapitale të Trupëzuara	4.000.000	0	4.000.000	3.852.200	96%	7%
Totali (Korrente+ Kapitale)	57.620.000	100.000	57.720.000	55.632.900	96%	100%	

Fondet buxhetore të miratuara në fillim të vitit 2018 për Komisionerin e Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, në vlerën 57,620,000 lekë. Buxheti i ndryshuar shkoi në vlerën 57,720,000 lekë. Realizimi në vlerën 55,632,900 lekë. Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 96 % ndaj planit për 12-mujorin e 2018. Shpenzimet për paga zënë rreth 61 % dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 10 % të totalit dhe janë realizuar në masën 99 % pagat dhe 93 % sigurimet shoqërore ndaj planit vjetor 2018. Shpenzimet korrente zënë rreth 73 % të totalit dhe janë realizuar në masën 87.6 % ndaj planit vjetor. Ndërsa shpenzimet kapitale zënë rreth 7 % të totalit dhe janë realizuar në masën 96 % ndaj planit vjetor.

Plani dhe Realizimi i buxhetit për vitin 2019

Në zbatim të ligjit nr. 99/2018 ñPër buxhetin e vitit 2020ò, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, të ndryshuar, Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave nr. 1, datë 17.01.2019 ñPër zbatimin e Buxhetit për vitin 2019ò, i ndryshuar, Aktit Normativ nr. 2, datë 02.10.2019 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin 99/2018 ñPër buxhetin e vitit 2019ò fondet buxhetore të miratuara, të alokuara dhe të realizuara për Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2020 paraqiten si më poshtë:

Art.	Emërtimi	Buxheti fillestar 2019	Ndryshimet në buxhet	Buxheti 2019 (i ndryshuar)	Realizimi FAKT	Realizimi ne (%) ndaj Planit përfundimtar te vitit 2019	Struktura ne %
Shpenzime Korrente							
600	Paga	34.500.000	1.093.600	35.593.600	35.312.500	99%	62%
601	Sigurime Shoqërore	5.850.000	0	5.850.000	5.714.000	98%	10%
602	Mallra dhe Shërbime të tjera	13.476.000	0	13.476.000	13.475.800	100%	24%
605	Transferta Korrente të Huaja	200.000	-93.600	106.400	106.400	100%	0%
606	Trans. për Buxh. Fam. dhe Ind.	240.000	120.000	360.000	340.000	94%	1%
Shpenzime Kapitale							

231	Kapitale të Trupëzuara	2.000.000	0	2.000.000	1.656.000	83%	3%
Totali (Korrente+ Kapitale)	56.266.000	1.120.000	57.386.000	56.604.700	98.6%	100%	

Fondet buxhetore të miratuara në fillim të vitit 2019 për Komisionerin e Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, në vlerën 56,266,000 lekë. Buxheti i ndryshuar shkoi në vlerën 56,604,700 lekë. Realizimi në vlerën 56,604,700 lekë. Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 98.6 % ndaj planit për 12-mujorin e 2019. Shpenzimet për paga zënë rreth 62 % dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 10 % të totalit dhe janë realizuar në masën 99 % pagat dhe 98 % sigurimet shoqërore ndaj planit vjetor 2018. Shpenzimet korrente zënë rreth 77 % të totalit dhe janë realizuar në masën 98.2 % ndaj planit vjetor. Ndërsa shpenzimet kapitale zënë rreth 3 % të totalit dhe janë realizuar në masën 83 % ndaj planit vjetor.

Plani dhe Realizimi i buxhetit për vitin 2020

Në zbatim të ligjit nr. 88/2019 ñPër buxhetin e vitit 2020ò, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, të ndryshuar, Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave nr. 2, datë 20.01.2020 ñPër zbatimin e Buxhetit për vitin 2020ò, i ndryshuar, Aktit Normativ nr. 15, datë 15.04.2020 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin 88/2019 ñPër buxhetin e vitit 2020ò fondet buxhetore të miratuara, të alokuara dhe të realizuara për Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2020 paraqiten si më poshtë:

Art.	**Emërtimi**	**Buxheti fillestar 2020**	**Ndryshimet në buxhet**	**Buxheti 2020 (i ndryshuar)**	**Realizimi FAKT**	**Realizimi ne (%) ndaj Planit përfundimtar te vitit 2020**	**Struktura ne %**
Shpenzime Korrente							
600	Paga	36.100.000	-1.230.000	34.870.000	34.869.100	100%	64%
601	Sigurime Shoqërore	6.250.000	-601.000	5.649.000	5.638.700	100%	10%
602	Mallra dhe Shërbime të tjera	12.676.000	924.300	13.600.300	13.583.700	100%	25%
605	Transferta Korrente të Huaja	200.000	-93.300	106.700	106.700	100%	0%
606	Trans. për Buxh. Fam. dhe Ind.	240.000	100.000	340.000	300.000	88%	1%
Shpenzime Kapitale							
231	Kapitale të Trupëzuara	1.000.000	-1.000.000	0	0		0%
Totali (Korrente+ Kapitale)	56.466.000	-1.900.000	54.566.000	54.498.200	99.8%	100%	

Fondet buxhetore të miratuara në fillim të vitit 2020 për Komisionerin e Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, në vlerën 56,466,000 lekë. Buxheti i ndryshuar shkoi në vlerën 54,566,000 lekë. Realizimi në vlerën 54,498,200 lekë. Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 99.8 % ndaj planit për 12-mujorin e 2020. Shpenzimet për paga zënë rreth 64 % dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 10 % të totalit dhe janë realizuar në masën 100 % pagat dhe 100 % sigurimet shoqërore ndaj planit vjetor 2020. Shpenzimet korrente zënë rreth 100 % të totalit dhe janë realizuar në masën 98 % ndaj planit vjetor.

Ndërsa shpenzimet kapitale zënë rreth 0 % të totalit duke qenë se nuk ka patur shpenzime kapitale për vitin 2020.
(Për sa më sipër është mbajtur akt-konstatimi nr. 7, datë 30.04.2021, dorëzuar me protokoll në Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil)

b. Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe dispozitave ligjore për pagat e punonjësve.

Në zbatim të pikës 3b të programit të auditimit: mbi ñRespektimin e strukturave organike të miratuara dhe dispozitave ligjore për pagat e punonjësveò u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
- Struktura organizative e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe krahasimi me faktin,
- Plani i nevojave për rekrutimin e personelit,
- Pagesa e përfituara nga fondi i veçantë,
-Vendimet e gjykatës për punonjësit e larguar nga shërbimi civil si dhe masat e marra nga institucioni në rastin ku punonjësi i larguar ka marrë një vendim të formës së prerë për pagesën e pagës deri në rikthimin e tij në punë.

- **Struktura organizative e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe krahasimi me faktin**

Sekretariati i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është struktura mbështetëse e Komisionerit në përmbushjen e detyrave të ngarkuara nga ligji dhe kjo strukturë funksionon me të gjithë kapacitetin e burimeve njerëzore të miratuara me Vendimin e Kuvendit Nr. 98, datë 4.12.2014, ñPër miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të vendeve të punës së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civilò. Organika e këtij Institucioni parashikon 31 pozicione pune, nga të cilat 25 pozicione janë pjesë e shërbimit civil.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në bazë të Nenit 11, të Ligjit Nr. 152/2013, ñPër nëpunësin civilò, i ndryshuar, me Vendim nr. 18, datë 11.03.2015 ka miratuar Rregulloren e Brendshme ñPër organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civilò. Mbi auditimin e kryer mbi respektimin e strukturave organike të miratuara dhe dispozitave ligjore për pagat e punonjësve u konstatua se organika e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është në përputhje me Rregulloren e Brendshme dhe Vendimet nga Këshilli i Ministrave.

Punonjësit me kontratë të përkohshme:
Bazuar në Vendimin nr. 47, datë 22.01.2020, për ñPërcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2020, në njësitë e qeverisjes qendroreò, në të cilën Këshilli i Ministrave vendosi që numri i punonjësve për Komisionerin e Mbikëqyrjes për Shërbimit Civil të jetë 4 punonjës me kontratë të përkohshme.
Bazuar në Vendimin nr. 1151, datë 24.12.2020, për ñPërcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2021, në njësitë e qeverisjes qendroreò, në të cilën Këshilli i Ministrave vendosi që numri i punonjësve për Komisionerin e Mbikëqyrjes për Shërbimit Civil të jetë 4 punonjës me kontratë të përkohshme.

Funksioni	**Nr. i punonjësve**	**Koha mesatare ditore**
Arkivë/ Protokoll	1	6 orë/ ditë
Sanitar	1	6 orë/ ditë
Operator	2	6 orë/ ditë
Punonjës gjithsej	**4**	

Grupi i auditimit ka analizuar dosjet e personelit si dhe Shpalljet për Nënpunës Civil , lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil për periudhën 2017- shkurt 2021. Emërimet janë kryer në zbatim të Ligjit 152/2013 ñPër nënpunësin civilò, i ndryshuar, nenet 22 dhe 25, si dhe Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, ñPër pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutiveò , kreu II, III dhe VII.

Grupi i auditimit verifikoi dosjet e punonjësve të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil bazuar në Vendimin Nr. 833, datë 28.10.2020, Lidhja I, Lidhja II, ku dokumentacioni i kërkuar me të dhënat e personelit ishte i plotë.

Stafi ka kryer trajnime sipas programeve nga Aspa, ky konstatim vjen edhe nga prezenca e dokumenteve të marra nga Aspa pas përfundimeve të trajnimeve në dosjet e audituara të personelit të KMSHC.

Grupi i auditimit konsiston se Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil nuk ka një plan të detajuar në lidhje me trajnimet e punonjëseve të institucionit.

Po ashtu në vijim të auditimit u vunë në dispozicion të grupit të auditimit shpalljet në vitet 2017-2021. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në zbatim të nenit 22 dhe 25, të Ligjit Nr. 152/ 2013, ñPër nënpunësin civilò, i ndryshuar, si dhe Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18.03.2015, i ndryshuar ka shpallur procedurat e lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil për disa pozicione. Në total për periudhën e auditimit janë bërë 8 shpallje nga të cilat:

- ✓ Në vitin 2017- 1 shpallje
- ✓ Në vitin 2018- 3 shpallje
- ✓ Në vitin 2019- 1 shpallje
- ✓ Në vitin 2020- 3 shpallje

Në shpalljen e vitit 2020, në pozicionin Inspektor në Drejtorinë e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, kandidatët duhet të plotësonin kritere të veçanta si Bachelor dhe Master Shkencor në degën e drejtësisë. Kandidati i përzgjedhur si fitues ndërkohë disponon Bachelor në drejtësi, por masterin shkencor e ka në degën e stomatologjisë.

Në lidhje sa më sipër në shkresën e datës 17.05.2021, nr. 602/11 Prot., protokolluar në KLSH, me nr. 157/18 në datën 19.05.2021, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka nisur observacionet mbi akt- konstatimet e mbajtura ku thuhet se: Shpalljet e vendeve të lira dhe publikimi i kritereve të përgjithshme dhe të veçanta bëhen në përputhje me përshkrimet e punës për pozicionet e shërbimit civil në institucionin e KMSHC. Këto akte janë hartuar dhe miratuar sipas procedurave të parashikuara në ligj dhe në aktet nënligjore që rregullojnë këtë aspekt të administrimit të shërbimit civil, e konkretisht me vendimin e titullarit të institucionit, nr. 20, datë 12.03.2015. Në rastin konkret, kërkesa e veçantë ka qenë që studimet ñ*Bachelor*ò dhe ñ*Master"* duhet të jenë kryer në të njëjtën fushë, ndërsa studimet në fushën e drejtësisë kanë qenë preferenciale dhe jo kritere specifike, ç`ka do të thotë se konkurrimi ka qenë i hapur edhe për fusha të tjera të studimit dhe jo domosdoshmërisht vetëm në fushën e drejtësisë.

*Përgjigje- Grupi i auditimit shqyrtoi observacionin dhe e mori n*ë konsideratë.

- **Plani i nevojave për rekrutimin e personelit**

Në organikën e tij, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka 12 inspektorë nga të cilët 6 inspektorë në Drejtorinë e Mbikëqyrjes dhe 6 inspektorë në Drejtorinë e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ. Në kërkesën e parashtruar me nr. prot. 838, datë 02.11.2018, drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, Komisionit për Çështje Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut si dhe Komisionit për Ekonominë dhe Financat, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka kërkuar disa ndryshime dhe shtesa në strukturën dhe organikën e KMSHC- së. Komisioneri ka vlerësuar si të domosdoshme të shtohen në 2

njësitë që zhvillojnë veprimtarinë direkte në fushën e mbikëqyrjes, në total 4 inspektorë nga të cilët 2 inspektorë në Drejtorinë e Mbikëqyrjes dhe 2 inspektorë në Drejtorinë e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ.

Në shkresën nr. 1046, datë 22.05.2019, për ñKërkesën për shtesë të fondeve financiare dhe mjeteve logjistike në mbështetje të procesit të monitorimit të sjelljes së nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhorò, drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Komisioneri mbi Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vlerësuar dhe përcaktuar nevojat e saj për të garantuar cilësi në zbatimin e detyrave të ngarkuara. Në rekomandimin 4.6 të ñUdhërrëfyesit për zbatimin e rekomandimeve të Raport Progresit për Reformën në Administratën Civileò, është përcaktuar se ñPalët kanë rënë dakord mbi nevojën për të rritur stafin dhe burimet e buxhetit të KMSHC- s me qëllim përmirësimin e rolit të tij mbikëqyrës për zbatimin e ligjit të shërbimit civil në nivel lokal, të përmbushjes së verifikimit më të mirë të shkarkimeve të paligjshme në administratën publike, për të pasur një rol më të madh në zgjedhjet e ardhshme lokale (përmes grupeve të monitorimit)ò. Në këtë shkresë KMSHC-ja ka specifikuar se kërkojnë mbështetje me financim nga buxheti i shtetit në Artikullin 600999 ñPaga dhe sigurimeò, prej 1,500,000 lekë, nuk përmendet në këtë shkresë nevojë për shtim në personel.

Grupi i auditimit konstatoi se ka mungesë të një plani të detajuar, specifik për sa i përket nevojave të institucionit për rekrutimin e personelit.

Në lidhje sa më sipër në shkresën e datës 17.05.2021, nr. 602/11 Prot., protokolluar në KLSH, me nr. 157/18 në datën 19.05.2021, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka nisur observacionet mbi akt- konstatimet e mbajtura ku thuhet se: Në zbatim të ligjit nr. 152/2013, dt. 30.05.2013 ñ*Për nëpunësin civil*ò, i ndryshuar, nenit 18 ñ*Plani vjetor i pranimit në shërbimit civil*ò, Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave ñ*Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil*ò, njësia përgjegjëse harton çdo fillim viti planin e pranimit/ rekrutimit në shërbimin civil sipas nevojave reale. Bashkëlidhur me këto observacione po ju vëmë në dispozicion shkresat e dala për periudhën objekt auditimi si: Shkresa nr 22/1, datë 20.07.2017, ñ*Plani i pranimit/rekrutimit në shërbimin civil për vitin 2017*ò; shkresa nr.1/3 prot, datë 27.02.2018, ñ*Plani i pranimit/rekrutimit në shërbimin civil për vitin 2018*ò; shkresa nr.1/2 prot, datë 20.02.2019, ñ*Plani i pranimit/rekrutimit në shërbimin civil për vitin 2019*ò, shkresa nr.1/2 prot, datë 16.02.2020, ñ*Plani i pranimit/rekrutimit në shërbimin civil për vitin 2020*ò,shkresa nr.1/2 prot, datë 22.02.2021, ñ*Plani i pranimit/rekrutimit në shërbimin civil për vitin 2021*ò *(bashkëlidhur planet e konkurrimit të miratuara nga njësia përgjegjëse).*

*Përgjigje- Grupi i auditimit shqyrtoi observacionin dhe e mori n*ë konsideratë observacionin duke qenë se u vunë në dispozicion planet e pranimit/ rekrutimit në shërbimin civil për periudhën e auditimit si dhe rithekson nevojën për shtimin në personel.

- **Pagesa e përfituara nga fondi i veçantë**

Nga auditimi, konstatohet se fondi i shpërblimeve është krijuar dhe përdorur sipas VKM nr. 929, datë 17.11.2010 ñPër krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantëò, i ndryshuar. Në total për periudhën objekt auditimi nga fondi i veçantë është dhënë shpërblim për tre raste vdekje dhe dy raste shpërblim për sëmundje të rënda. Shpërblimi për vitin 2017 është në vlerën 61,354 lekë, shpenzim për dhënie ndihme për rastin e fatkeqësisë së ndarjes nga jeta të nënpunësit të institucionit. Për vitin 2018 nuk ka patur shpërblim. Për vitin 2019 ka patur shpërblim në vlerën 100,000 lekë, nga 50,000 lekë për dy raste për dhënie ndihme për sëmundje të rëndë të dy punonjëseve. Për vitin 2020 nuk ka patur shpërblime. Për vitin 2021 ka patur shpërblim në vlerën 60,000 lekë nga 30,000 lekë për dy raste të vdekjes së një familjari të punonjëseve të KMSHC- së.

Vendimet e gjykatës për punonjësit e larguar nga shërbimi civil

Në nëntor të vitit 2014 institucioni Komisioni i Shërbimit Civil, krijuar sipas ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, ñStatusi i nënpunësit civilò, ka mbaruar veprimtarinë e tij. Bazuar në Vendimin nr. 30/2014 të Kuvendit të Shqipërisë ñPër vendimmarrjen e Kuvendit, lidhur me institucionin e Komisionit të Shërbimit Civil dhe zgjedhjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civilò, pika 2 ñQëndrimi në detyrë i Sekretariatit Teknik të Komisionit të Shërbimit Civil, deri në miratimin e strukturës së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civilò, më datë 04.12.2014, në Vendimin nr. 98, të Kuvendit të Shqipërisë, është miratuar struktura organike dhe kategorizimi i pozicioneve të punës të institucionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Në këto aktet ligjore dhe nënligjore nuk janë përcaktuar dispozita në lidhje me nënpunësit e Komisionit të Shërbimit Civil. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/ 2013 ñPër nënpunësin civilò, i ndryshuar u krijua institucioni i ri Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil , një person juridik publik. Në kohën kur u hapën konkurrimet nga ky institucion sipas Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vetëm një pjesë konkurruan nga institucioni i mëparshëm. Pesë nënpunësit civilë të KSHC- së të cilët nuk morën pjesë në këto procedura të konkurrimeve ju drejtuan Gjykatës Administrative duke kërkuar kështu nga KMSHC- ja të bënte emërimet e tyre në këtë institucion të krijuar rishtaz. Në zbatim të ligjit nr. 152/2013 kjo kërkesë e tyre nuk mund të kryhet, duke qenë sepse titullari konfirmon marrëdhëniet financiare vetëm pasi ndiqen etapat si: procedura e konkurrimit, shpallja e fituesit dhe nxjerrja e aktit të emërimit nga njësia e burimeve njerëzore.

Vendimet e gjykatës

Emër Mbiemër	Pozicioni i punës	Arsyeja e largimit nga shërbimi civil	Nr. / data e vendimit gjyqësor të formës së prerë	Nr. / data e urdhrit të parë të përmbaruesit	Nr. / data e aktit të riemërimit në detyrë	Nr. / data e urdhrit të përmbaruesit mbi të cilin është bërë ekzekutimi	Vlera e pagesës së kryer nga institucioni për ekzekutimin e vendimit
G. T.	Sekretar i Përgjithshëm	Mbyllje e institucionit	Nr. 3034, datë 14.11.2019	Nr. 422 prot., datë 20.01.2020 Ekzekutim vullnetar	Me marrëveshje, u dorëhoq	Nr. 52, dt. 25.09.2020 Nr. 57, dt. 14.10.2020	7.570.687
F. K.	Shef i Sektorit të Administratës	Mbyllje e institucionit	Nr. 4198, datë 11.10.2017	Ekzekutim vullnetar	Doli në pension	Nr. 96, dt. 13.11.2017	1.594.064
A. B.	Specialist arkiv-protokolli	Mbyllje e institucionit	Nr. 1580, datë 13.04.2017	Nr. 1131 prot., datë 02.06.2017	Refuzoi emërimin dhe e fituam me vendim gjykate	Nr. 83, dt. 09.11.2018 Nr. 49, dt. 08.07.2020	2.220.383
M. D.	Shef i Sektorit të Financës	Mbyllje e institucionit + Masë disiplinore	Nr. 521, datë 10.03.2016	Nr. 899- 575, datë 23.03.2016	Nr. 232 prot. datë 10.01.2019	Nr. 61, dt. 01.08.2019 Nr. 16, dt. 10.02.2020	4.718.138
E. G.	Inspekto-Këshilltar	Mbyllje e institucionit	Nr. 1540, datë 25.05.2015	Nr. 3703, datë 11.09.2015	Nr. 3690, datë 02.06.2017	Nr. 70, dt. 18.07.2017	2.935.713

Grupi i auditimit ka konstatuar se ekzekutimi i vendimeve gjyqësore nga data e vendimit tek datat e urdhër pagesave rezultojnë të kryera me vonesë. Në shkresën nr. 99/4, datë 11.03.2021, lidhur me ekzekutimet e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, specifikohen sipas rastit arsyet pse ka patur këto vonesa për pagesat e vendimeve gjyqësore. Për nënpunësit A. B., M. D. dhe E. G. nga KMSHC janë analizuar dhe verifikuar nëse nënpunësi gjyqfitues vazhdon tëi plotësojë kriteret si dhe nëse nënpunësi civil ka përfituar pagesa nga institucione shtetërore apo private gjatë ndërprerjes së shërbimit civil. Pasi kanë kryer verifikimet dhe llogaritjet e tyre, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka dorëzuar provat në Gjykatën Administrative ku për nëpunësen M. D. ka kursyer shumën prej 2,734,897 lekë, për faktin se nuk mund të paguhet me dy paga në të njëjtën periudhë kohe, nëse është i punësuar në ndonjë pozicion tjetër

brenda ose jashtë shërbimit civil dhe për nëpunësen A. B. shumën prej 1,162,780 lekë si pasojë e llogaritjes gabim të pagesave të përfituara nga punëdhënës të tjerë. Në rastin e E. G., sipas institucionit është kryer ekzekutimi me vonesë për shkak se është vlerësuar pagesa që i detyroheshin dhe stabilizimi i tij në një institucion tjetër, duke qenë se struktura e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ishte e plotësuar.
Janë 5 vendime gjyqësore për 5 ish- punonjës së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Nga këta 5 ish- punonjës vetëm vendimi gjyqësor nr. 4198, datë 11.10.2017, për Fatmir Kryekurti, është kryer me ekzekutim vullnetar. Vendimet për 4 punonjësit e tjerë janë ekzekutuar nëpërmjet shoqërive përmbarimore. Përgjatë viteve 2017, 2018, 2019, 2020 dhe 2021 rezulton të jenë paguar 19,038,985 lekë në total për vendimet gjyqësore të fituara nga ish- punonjësit pranë këtij institucioni.
Vlera e paguar kundrejt shoqërive përmbarimore është 1,311,349 lekë ,e cila ka rënduar buxhetin e institucionit.

Në lidhje sa më sipër në shkresën e datës 17.05.2021, nr. 602/11 Prot., protokolluar në KLSH, me nr. 157/18 në datën 19.05.2021, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka nisur observacionet mbi akt- konstatime, të cilat janë trajtuar plotësisht në projekt raportin e dërrguar me shkresën nr. 157/19, datë 14.09.2021.

9.Titulli i Gjetjes	**Mbi efektin financiar si pasojë e likuidimit të proceseve gjyqësore të humbura**
Situata:	Nga auditimi rezultoi se, për periudhën objekt auditimi, nga buxheti i KMSHC janë likuiduar fonde për shpenzime përmbarimore, për ekzekutimin e 4 vendimeve gjyqësore në shumën 1,311,349 lekë. Prej vitit 2017 e në vijim KMSHC ka likuiduar në total 19,038,985, fonde të cilat lidhen më 5 vendime gjyqësore (prej vitit 2015 e në vijim). Pagesat e kryera për likuidim të vendimeve gjyqësore dhe ato përmbarimore, përbëjnë menaxhim jo efektiv të fondeve buxhetore.
Kriteri:	Ligji Nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHò; Ligji nr152/2013 ñPër nëpunësin civilò. Ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò.
Ndikimi/Efekti:	Vendimet e formës së prerë të gjykatave, duke sjellë si pasojë kosto shtesë në buxhetit të shtetit
Shkaku:	Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mbylljes së institucionit Komisionit të Shërbimit Civil, në nëntor të vitit 2014, të krijuar sipas ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, ñStatusi i nënpunësit civilò.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtoria Juridike të marrë masa të monitorojë me përgjegjësi ecurinë e vendimeve gjyqësore me qëllim shmangien e kostove shtesë me impakt në buxhet. Për raste të vendimeve të formës së prerë, të merren masa që të njoftohet në kohë sektori I financës me qëllim planifikimin e fondeve dhe shmangien e kostove të mëtejshme si pasojë e vonesave.

(*Gjerësisht çështjet mbi "Respektimin e strukturave organike të miratuara dhe dispozitave ligjore për pagat e punonjësve" në Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil janë trajtuar në akt-konstatimi nr. 3, datë 30.04.2021, dorëzuar me protokoll në Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil)*

c. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare;

Në zbatim të Programit të auditimit pranë KMSHC, me nr. Prot. 157/1, datë 26.01.2021, procesi 3 ñÇështjet e auditimit financiarò, pika c: ñZbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetareò, nga auditimi rezultoi se:

Institucioni i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil organizohet dhe funksionon në përputhje me Ligjin Nr.152/2013, ñPër nëpunësin civilò, Rregulloren e Brendshme ñPër organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civilò, si dhe urdhrat, udhëzimet dhe aktet e tjera nënligjore të miratuara nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Mbi realizimin e kësaj pike u morën në shqyrtim këto dokumente të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

- *Magazina nga viti 2019-2020,*
- *Inventarizimi i aktiveve nga viti 2019-2020, asgjësimi (2018),*
- *Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave material e monetare,*
- *Urdhër-shpenzimet,*
- *Dietat,*
- *Borderotë e pagës,*
- *Libri i magazinës.*

c.1 Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës në lekë dhe në valutë.

Sipas Programit të Auditimit nr. Prot. 157/1 datë 15.10.2019, është audituar ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës, arkës dhe inventarizimi i pronës, për periudhën 2017-2020.

Për auditimin e kësaj pike, grupi i auditimit është mbështetur në:

- VKM nr. 870, datë 14.12.2011 ñPër trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë venditò, i ndryshuar;
- VKM nr, 997, datë 10.12.2010 ñPër trajtimin e punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punësò i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 2, datë 06.02.2012 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò i ndryshuar;
- Ligji 10296, datë 08.07.2010 ñMbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, i ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò i ndryshuar.

Nga auditimi i realizuar në Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për periudhën e auditimit 2017-2020, u konstatua se veprimet e kryera nëpërmjet bankës, në përgjithësi veprime kontabël, janë kryer në përputhje me aktet ligjore e nënligjore. Regjistrimi dhe kontabilizimi në ditar është kryer në mënyrë të rregullt dhe në fund të çdo muaji. Shuma e pagesave të bankës është e njëjtë me nxjerrjen e llogarisë në fund të viteve ushtrimore. Të gjitha veprimet janë kryer në mënyrë kronologjike në ditarët përkatës. Pagesat e kryera me urdhër-shpenzimi, në përgjithësi janë të shoqëruara me dokumente të rregullta justifikuese.

Të gjitha urdhër-shpenzimet janë realizuar në përputhje me kërkesat e formatit të përcaktuar nga Ministria e Financave.
Për sa ju përket shpenzimeve për udhëtime e dieta jashtë qendrës së punës dhe brenda vendit, pagesat janë përllogaritur dhe kryer në zbatim të VKM nr.329, datë 20.04.2016 ñPër disa ndryshime në Vendimin nr.997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave, ñPër trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda venditò, të ndryshuar.
Urdhër shpenzimet janë vulosur nga Dega e Thesarit Tiranë. Nga auditimi i veprimeve të kryera nëpërmjet arkës, për periudhën e auditimit rezultoi se regjistrimet kontabël në ditarin e arkës janë bërë në mënyrë të rregullt, bazuar në dokumentet justifikuese dhe çdo muaj është bërë kuadrimi i ditarit të arkës me gjendjen e librit të arkës.
Mandat-arkëtimet dhe mandate-pagesat janë firmosur nga të dyja palët, janë plotësuar në përputhje me kërkesat e formatit të përcaktuar në Urdhrin e Ministrisë së Financave dhe mbështeten në dokumentet justifikues ligjorë. Pagesat janë kryer duke u mbështetur në dokumentacionin justifikues, bashkëngjitur urdhër pagesës. Të gjitha urdhër-pagesat janë regjistruar në Ditarët e Kontabilitetit për secilin vit në programin Alpha Web. Veprimet kontabël janë kryer në përputhje me dispozitat ligjore. Gjendja e arkës në fund të çdo viti, paraqitet zero.
Gjatë auditimit të listë prezencës për periudhën 01.07.2019 deri në 31.07.2019 konstatuam se punonjësi A. N. (Inspektor) në Drejtorinë e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, rezulton se ka qenë me raport në ditët 01.07.2019 dhe 09.07.2019. Duke bërë verifikimet me dokumentet justifikues, na rezulton se A. N. ka marrë raport mjekësor nga Qendra Shëndetësore me nr. Regjistri 1894 për datën 01.07.2019. Ndërsa raporti mjekësor me nr. Regjistri 5586 është marrë për datat 09.07.2019 dhe 10.07.2019. Duke bërë verifikimet në Borderonë e Pagës për muajin korrik 2019, konstatohet se ditët e punës për muajin korrik 2019 janë 23 ditë. Në Borderonë e Pagës për muajin korrik 2019 konstatohet se punonjësi A. N. është paguar për 21 ditë pune dhe një ditë për raport mjekësor. Realisht ai ka qenë pushim me raport mjekësor datë 01.07.2019 dhe 09.07.2019. Kështu që duhet të ishte paguar për 21 ditë pune dhe dy ditë me raport mjekësor. Pavarësisht se raporti mjekësor i datës 09.07.2019 është marrë për dy ditë nga Qendra Shëndetësore, A. N. na rezulton të ketë qenë prezent në datë 10.07.2019 për shkak të shënimit që është bërë në fletën e raportit mjekësor.

Observacioni KMSHC nr. 157/18, datë 19.05.2021: Në lidhje me këtë konstatim, nga ana jonë do të bëhen verifikimet në sistemin HRMIS, dhe në rast se është problem i një algoritmi të përllogaritjes së pagave, që zakonisht ka ndodhur për muajt që kanë 31 ditë dhe pesë të diela, problematikë që është raportuar pranë HRMIS dhe tashmë është ezauruar, do tõ kërkohet punonjësit të sipërpërmendur kthimi i shumës së marrë padrejtësisht. (efekti ekonomik i përllogaritur rezulton 641 lekë).
Grupi i auditimit pasi mori në shqyrtim observacionin, e konsideron të pranuar.

C.2 Saktësia dhe rregullariteti i veprimeve të kryera në magazinë.
Mbështetur në dokumentacionin e magazinës, fletë hyrjet dhe fletë daljet, kartelat limit, librin e magazinës dhe ditarin analitik të lëvizjes së vlerave materiale, u konstatua se lëvizja e mallrave, materialeve e inventarëve nëpërmes magazinës, nuk është shoqëruar me urdhra dorëzimi dhe dokumentacionin mbështetës. Nga auditimi i dokumentimit u konstatua se nuk janë zbatuar drejt kriteret e përcaktuara në ligjin nr, 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe Kontrollinò dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò.
Kontabilizimi i veprimeve të magazinës është i azhornuar për çdo veprim ekonomik, hyrje, dalje, si për aktivet e qëndrueshme dhe për aktivet qarkulluese. Lidhur me ndarjen e punëve

dhe papajtueshmërinë midis funksioneve, nga grupi i auditimit konstatohet se funksionet e financës si mbajtja e ditarëve, mbajtjen e arkës në valutë, plotësimi dhe kontabilizimi i urdhër shpenzimeve janë mbajtur të gjitha për periudhën 2017-2020.
Përsa ju përket shpenzimeve për udhëtim e dieta jashtë vendit, pagesat janë përllogaritur dhe kryer në zbatim të VKM nr. 870, datë 14.12.2011 ñPër trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë venditò, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 22, datë 10.07.2013, në zbatim të tij, Bashkëngjitur mandate arkëtimit/ pagesës është ftesa nga organizatorët, autorizimi i NA, urdhër shërbimi, preventivi i shpenzimeve, fatura e biletave dhe akomodimit në hotel. Çdo urdhër shpenzimi është vulosur nga D. TH. Tiranë.

c.3 Inventarizimi i aktiveve.
Bazuar në Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011, pika 81 ñInventarizimi kryhet nga një komision i posaçëm që krijohet me Urdhër të Titullarit të njësisë publike ose Nënpunësit Autorizues të çdo niveli të njësisë publikeò. Komisioni nuk duhet të jetë më pak se tre punonjës, gjë e cila është zbatuar edhe në KMSHC. Në vitin 2017, anëtarët e Komisionit ishin: J. M., A. K. dhe G. B., bazuar në Urdhrin e Brendshëm nr. 98, nr. prot, 1807, datë 14.11.2017. Në vitin 2018, anëtarët e komisionit ishin: H. P., S. N. dhe B. H., bazuar në Urdhrin e Brendshëm nr. 86, nr prot. 864, datë 22.11.2018. Ndërsa në vitin 2019, anëtarët e Komisionit ishin: I. S., A. K., G. B., bazuar në Urdhrin e Brendshëm nr. 77, nr. prot, 1627, datë 03.12.2019.
Bazuar në Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011, pika 43 ñKomisioni përbëhet nga specialistë te fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevoje, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materialeò. Hyrja e aktiveve në magazinë është dokumentuar me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet dhe fletëdaljet janë lëshuar nga magazinieri dhe në përputhje me pikën 39, të Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011.
Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, sipas udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër ngritjen e Komisionit për vlerësimin e Aktiveve për vitin 2017ò, dhe i përbërë nga: O. H., H. L., I. S., A. H. dhe Dh. P., të cilët pasi kontrolluan një për një aktivet sipas natyrës dhe shërbimeve, vendosën të vlerësojnë për të nxjerrë nga përdorimi aktive, të cilat pas vlerësimit tekniko-ekonomik u konstatuan se ishin jashtë pune. Kjo gjë pasqyrohet në ñRelacionin mbi vlerësimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve për vitin 2017ò me nr. Prot, 1857/1, datë 26.12.2017, shoqëruar nga Procesverbali dhe Aneks 1 (Tabelat me Aktivet dhe Materialet të vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimi/asgjesim fizik.
Për sa i përket materialeve për vlerësim për nxjerrje jashtë përdorimit, duke qenë se janë krijuar ambjentet e reja të punës për punonjësit e KMSHC, janë nxjerrë shumë materiale jashtë përdorimit, për shkak të problematikave të pasqyruara në Magazinën e vitit 2017. Komisioni i Vlerësimit të Aktiveve për vitin 2017 ishte i përbërë nga pesë punonjës: O. H. (Kryetare), H. L. (Anëtar), I. S. (Anëtar), A. H. (Anëtar), Dh. P. (Anëtar). Nga ky komision është konstatuar se 49 (dyzetë e nëntë) lloje produktesh janë konsideruar jashtë funksionit (të thyera ose të dëmtuara) ose me kosto shumë të lartë riparimi për institucionin. Totali i vlerës së mbetur për aktivet jashtë përdorimit na rezulton të jetë në vlerën 400,234 mijë lekë.
Bazuar në Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011, pika 43 ñKomisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevoje, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materialeò. Në rastin tonë, duke qenë se kemi mallra ti tilla si: kompjutera, printera etj, për të cilët është e nevojshme të klasifikohen nga specialistë të fushës. Ndër ta I. S. është specialiste e fushës. Dokumenti ku janë paraqitur materialet që kanë kaluar në një vlerësim tekniko-ekonomik janë firmosur nga Komisioni i Vlerësimit të aktiveve për vitin 2017.

Sipas udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër ngritjen e Komisionit për vlerësimin e Aktiveve për vitin 2017ò, pika 82: Komisioni nuk duhet të jetë me më pak se 3 punonjës. Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi. Në komision nuk merr pjesë punonjësi që ka në ngarkim/përdorim aktivin, por ai duhet të jetë i pranishëm kur bëhet inventarizimi dhe në mungesë të tij, zbatohen kriteret e përcaktuara në paragrafin 13 dhe 14 të këtij udhëzimi.

Anëtarët e Komisionit për inventarizimin fizik të aktiveve janë: J. M. (Kryetar), A. K. (Anëtare) dhe G. B. (Anëtare). Bazuar në auditimin e kryer në këtë institucion, konstatojmë se numri i anëtarëve të Komisionit është në përputhje me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011. Sipas fletës së inventarit, të paraqitur në dokumentat e magazinës 2017, konstatojmë se J. M. ka në ngarkim material zyre me vlerë 219,504.83 lekë, A. K. ka në ngarkim materiale me vlerë 1784998,88 lekë dhe G. B. (H.) ka në ngarkim materiale me vlerë 2,425,447.91 lekë.

Bazuar në Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011, pika 43 ñKomisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevoje, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materialeò. Në rastin tonë, duke qenë se kemi mallra ti tilla si: kompjutera, printera etj, për të cilët është e nevojshme të klasifikohen nga specialistë të fushës.

Sipas Urdhrit nr. 104, datë 26.12.2017, nr. Prot. 1861/2, ñPër ngritjen e komisionit për ngritjen nga përdorimi dhe asgjesimit të aktiveve për vitin 2017ò, u ngrit Komisioni me pesë anëtarë: B. H. (Kryetar), M. H. (Anëtar), H. P. (Anëtar), S. P. (Anëtar), Z. M. (Anëtar). Pra është zbatuar Udhëzimi nr. 30, pasi nuk janë të njëjtët persona me komisionin e ngritur për vlerësimin e akiveve, Komisioni i vlerësimit, i ngritur me Urdhrin nr. 103, datë 11.12.2017, vendosi në dispozicion të komisionit të asgjesimit të gjithë dokumentacionin e përpiluar dhe të nevojshëm për këtë proces. Gjithashtu pjesë e procedurës është edhe Procesverbali për asgjësimin e aktiveve të KMSHC të nxjerra jashtë përdorimi, i mbajtur në datë 19.01.2018 në ambientet e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ndërmjet Komisionit për nxjerrjen nga përdorimi dhe asgjesimin e aktiveve për vitin 2017 dhe përfaqësuesit të subjektit E. T.: A. D. (targë automjeti AA920PF). Kurse Procesverbali tjetër për pjesën e mbetur të materialeve për azgjësim u mbajt në datën 22.01.2018 në ambientet e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ndërmjet Komisionit për nxjerrjen nga përdorimi dhe azgjësimin e aktiveve për vitin 2017 dhe përfaqësuesit të subjektit I. A.: F. L. (targë automjeti AA480GU).

Në vitin 2018 dhe 2019 nuk janë nxjerrë produkte jashtë përdorimit, por thjesht është bërë inventarizimi i aktiveve të KMSHC. Në vitin 2018, sipas Urdhrit nr 86, datë 22.11.2018, nr. prot 864 është ngritur komisioni për inventarizimin fizik të aktiveve të KMSHC për vitin 2018. Për vitin 2019, sipas Urdhrit nr 77, date 03.12.2019, nr. prot 1627 është ngritur komisioni për inventarizimin fizik të aktiveve të KMSHC për vitin 2019.

Sipas Urdhrit të Brendshëm nr. 54 të KMSHC, datë 07.10.2020, nr. 771/1 prot, ñPër ngritjen e Komisionit për vlerësimin e aktiveve për vitin 2020ò u përcaktuan në komision: O. H. (Kryetar), P. U. (Anëtar), A. Xh. (Anëtar), H. P. (Anëtar), S. N. (Anëtar). Për këtë është mbajtur procesverbal me të gjitha firmat e anëtarëve të komisionit. Gjithashtu, është paraqitur edhe tabela e vlerësimit të llojeve të materialeve të vlerësuara nga komisioni. Sipas shkresës nr 771/6 prot, datë 21.12.2020 është realizuar një relacion mbi asgjësimin e aktiveve të vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimi për vitin 2020. Komisioni për asgjësimin e materialeve përbëhej nga: B. H. (Kryetar), L. Zh. (Anëtar), M. H. (Anëtar), I. C. (Anëtar), Z. M. (Anëtar). Sipas vlerësimeve të komisionit, 59 lloje materialesh u nxorrën jashtë përdorimit në bazë të gjendjes fizike të tyre. Sipas Urdhrit nr 77, date 03.12.2019, nr prot. 1627, Anëtarët e Komisionit janë përcaktuar: I. S., A. K., G. B.. Ndër ta vërejmë se I. S. ka qenë e pranishme gjatë vlerësimit tekniko-ekonomik të aktiveve të vitit 2019.

Grupi i auditimit, konstatoi se procesi i inventarizimit për vitin 2020 nuk ishte realizuar nga KMSHC. Në bazë të inventarizimit do të realizohej evidentimi i gjendjes fizike të aktiveve dhe krahasimi i tyre me gjendjen kontabël. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar Neni 7, Pika 1 dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme", Kreu 3.1, Pika 30, më hollësisht trajtuar në faqet 24-28 të Raportit përfundimtar të Auditimit. Sipas Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, pika 74 "Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës". Mungesa e procesit të inventarizimit nuk jep siguri të mjaftueshme mbi saktësinë dhe plotësinë e zërit të aktiveve në pasqyrat financiar.

10.Titulli i Gjetjes	**Mos kryerja e inventarizimit për vitin 2020**.
Situata:	Nga auditimi rezultoi se, procesi i inventarizimit për vitin 2020 nuk është realizuar nga KMSHC. Në kushtet kur ky proces synon ndër të tjera, të evidentojë gjendjen fizike të aktiveve dhe krahasimin e tyre me gjendjen kontabël, moskryerja e tij cënon dhënien e sigurisë së arsyeshme mbi plotësinë dhe saktësinë e vlerës së zërave të aktiveve të pasqyruar në kontabilitet si dhe mbi ekzistencën e tyre.
Kriteri:	Sipas Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, pika 74 ñÇdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetësò.
Ndikimi/Efekti:	*Mungesa e procesit të inventarizimit nuk jep siguri të mjaftueshme mbi saktësinë dhe plotësinë e zërit të aktiveve në pasqyrat financiar.*
Shkaku:	Nisur nga situata e krijuar për shkak të Covid-19 dhe akteve normative të dala për parandalimin e përhapjes së virusit, institucioni i KMSHC ka punuar me numër të reduktuar punonjësish, ku pjesa më e madhe kanë punuar nga shtëpia (sipas observacionit).
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Në kushtet kur moskryerja e inventarizimit ka pasur si shkak kryesor situatën e krijuar prej Covid 19, rekomandojmë që nga ana e Komisionerit të merren masa që ky proces të kryhet menjëherë në funksion të ruajtjes dhe mbrojtjes së aktiveve në pronësi të KMSHC.

Për sa më sipër, KMSHC ka observuar me Observacionin nr. 157/18, datë 19.05.2021: Në lidhje me këtë konstatim sqarojmë se nisur nga situate e krijuar për shkak të ñCovid-19ò dhe aktet normative të dala për parandalimin e përhapjes së virusit, institucioni ka punuar me numër të reduktuar punonjësish, ku pjesa më e madhe kanë punuar nga shtëpia. Për pasojë nuk ka pasur edhe lëvizje të aktiveve në këtë institucion, me përjashtim të materialeve të domosdoshme për vazhdimin e veprimtarisë, të asaj pjese të punonjësve që kanë punuar në këtë institucion si dhe të materialeve anti-Covid. Nisur nga sa më sipër, u vlerësua që inventari të kryhet vitin pasardhës. Sipas dokumenteve të paraqitura në observacion është paraqitur edhe Urdhri nr. 29, datë 30.04.2021, nr. 601 prot. ñPër ngritjen e Komisionit për inventarizimin fizik të aktiveve të KMSHC-së për vitin 2021ò, ku janë përcaktuar tre anëtarë Komisioni: Luiseda Zhupa, Migena Haznedari, Helga Peti.

Grupi i auditimit te KLSH pasi shqyrtoi observacionin konkludon se: Observacioni pranohet pjesërisht sa i takon inicimit të punës për inventarizimin dhe rekomandohet përfundimi i këtij procesi sa më shpejt me qëllim që të reflektohet gjithashtu në pasqyrat financiare vlera e rakorduar me gjendjen fizike të aktiveve.
Nga auditimi në institucionin e KMSHC u konstatua **se në vitin 2017** nuk është bërë fletë-dalje e firmosur nga magazinieri për produktet e nxjerra jashtë përdorimit nga Komisioni i Vlerësimit të Aktiveve. Në dokumentacion konstatohet të jetë vetëm një tabelë ku janë listuar materialet e nxjerra jashtë përdorimit me personat përgjegjës dhe firmat e tyre bashkëngjitur (dokument që mund të jetë realizuar në momentin e dorëzimit të materialeve që janë në ngarkim të punonjësve dhe jo si fletë dalje nga magazina). Ky dokument është firmosur vetëm nga Komisioni i inventarizimit: J. M., A. K. dhe G. B., ndërkohë që magazinieri nuk e ka firmosur këtë dokument.

Për sa më sipër, KMSHC ka observuar me *Observacionin* nr. 157/18, datë 19.05.2021: Në lidhje me këtë konstatim sqarojmë se në Programin financiar ñAlpha Web Buxhetorò, për aktivet që janë në ngarkim të punonjësve, çdo punonjës funksionon si një magazinë më vete. Nisur nga ky fakt, për artikujt e nxjerrë jashtë përdorimit në vitin 2018 është konsideruar e drejtë nxjerrja jashtë përdorimit direkt nga personi që e ka në ngarkim në bazë të një liste të nënshkruar nga punonjësi që e ka në ngarkim artikullin. Mbi bazën e kësaj procedure, më pas është bërë regjistrimi i veprimit kontabël në kartelat e magazinës artikull për artikull dhe punonjës pas punonjës. Rezultati në këtë rast është i njëjtë, vetëm se është ndryshuar rradha e veprimit, aktivi i nxjerrë jashtë përdorimit është çrregjistruar nga librat e magazinës. Grupi i auditimit te KLSH pasi shqyrtoi observimet konkludoi se observacioni pranohet pjesërisht dhe se në çdo rast duhet ndjekur rruga që dikton udhëzimi nr.30, date 27.12.201, ku artikuj e nxjerre jashtë përdorimi kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale te riciklueshme, hiqen nga regjistri i aktiveve ne përdorim, bëhen hyrje ne magazine dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë (me përjashtim të rasteve kur sipas rregullave të shëndetësisë duhet të asgjësohen), kurse të tjerat asgjësohen nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi duke ndryshuar formën e tyre fillestare, groposur ose djegur.

Në lidhje me auditimin e dokumentacionit shoqërues për shpenzime dhe dieta, u krye auditim me zgjedhje në bazë risku, duke u mbështetur në metodën e gjurmueshmërisë së dokumentacionit, si më poshtë vijon:
-Në 1 rast pagesa për udhëtim e dieta për z. A. Sh., Drejtor i Mbikëqyrjes, është mbështetur sipas autorizimit Nr. 1460/5, datë 20.09.2019, të Komisionerit, nga Tirana për në Has, Kukës, Dibër, Bulqizë, Mat dhe Klos në datat 23.09.2019 ï 27.09.2019. Ndërsa sipas autorizimit Nr.1460/1, datë 20.09.2019, te Komisionerit, punonjësit e KMSHC, nisen nga Tirana për në Vorë, Shijak, Divjakë, Lushnjë në datat 23.09.2019 ï 27.09.2019, ku ndër ta figuron dhe nëpunësi z. A. Sh. i cili është i autorizuar për të shkuar me shërbim nga Tirana për në Vorë, Shijak, Divjakë, Lushnjë në datat 23.09.2019 ï 27.09.2019. Pra, në këtë praktikë rezulton se ai është paguar në praktikën Vorë, Shijak, Divjakë, Lushnjë, ndërkohë fletat e hotelit të administruara në këtë praktikë, janë në Kukës, Dibër, Bulqizë.
Për Bashkinë Kukës dhe Has ka vetëm një kërkese për shtyrje afati, në datat 01.10.2019 ï 03.10.2019, pa shoqëruar me autorizim përkatës që vërteton udhëtimet për dieta dhe shpenzime duke përcaktuar kohën e zgjatjes së shërbimit dhe qëllimin e tij për nëpunësit udhëtues A. Sh., I. S., A. N., B. T. dhe mungesa e këtij autorizimi pra sjell pavlefshmërinë e pagesave për dieta dhe shpenzime, veprime këto jo në përputhje me përcaktimet e Kreut V, pika 2, të VKM nr.997, datë 10.12.2010 ñPër trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda venditò, i ndryshuar, ku shprehimisht citohet:

"Dërgimi me shërbim i punonjësit autorizohet nga: Titullari i institucionit qendror për shërbime në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës. Në autorizim përcaktohen koha e zgjatjes së shërbimit dhe qëllimi i tij".

11.Titulli i Gjetjes	**Për një çështje që lidhet me dietat për shërbimet brenda vendit në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës.**
Situata	Referuar autorizimit Nr. 1460/5, datë 20.09.2019, të KMSHC, rezultoi se punonjësi A.Sh ka përfituar dieta për udhëtime nga Tirana për në Has, Kukës, Dibër, Bulqizë, Mat dhe Klos në datat 23.09.2019 ï 27.09.2019, ku ndërkohë për të njëjtën periudhë, sipas autorizimit Nr.1460/1, datë 20.09.2019, i njëjti punonjës rezulton të ketë qenë pjesë edhe e grupit të punës të autorizuar për të shkuar me shërbim nga Tirana në Vorë, Shijak, Divjakë, Lushnjë, praktikë për të cilën edhe është paguar. Në vijim, referuar edhe observacioneve të vetë subjektit konstatojmë se, Drejtori i *Mbikëqyrjes gjendet në disa Autorizime të nxjerra nga Komisioneri njëkohësisht dhe se prioriteti se në cilin destinacion do shkojë Drejtori në këto raste, vendoset sipas orientimeve të dhëna nga Komisioneri, si dhe problematikave të ndryshme që mund të hasen nga grupet e punës në subjektet përkatëse. Vendosja e drejtorit të mbikëqyrjes në disa autorizime njëkohësisht, për të njëjtat periudha kohore, jo vetëm nuk gjen mbështetje ligjore, po gjithashtu krijon konfuzion dhe hapësira për abuzime. Për më tepër që vetë drejtori firmos listëprezencën për punonjësit në shërbim.* *Në këto kushte, grupi I auditimit me qëllim marrjen e evidencës së besueshme dhe relevante për këtë çështje kërkon vënien në dispozicion nga ana e KMSHC, të urdhër-shërbimeve për rastet e konstatuara për grupin e inspektimit përfshirë edhe Drejtorin e Drejtorisë së Mbikëqyrjes.*
Kriteri	VKM Nr.997, datë 10.12.2010 Kreut V, pika 2, ñPër trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda venditò, i ndryshuar, ku shprehimisht citohet: *"Dërgimi me shërbim i punonjësit autorizohet nga: Titullari i institucionit qendror për shërbime në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës. Në autorizim përcaktohen koha e zgjatjes së shërbimit dhe qëllimi i tij".*

Për sa trajtuar më sipër është mbajtur akt konstatimi nr.4, datë 30.04.2021. Lidhur me këtë praktikë është dërguar observacion me Nr. 602/11, date 17.05.2021, ka bërë komente e shpjegime për aktet e konstatimit, të cilat janë trajtuar plotësisht në projekt-raportin e dërguar me shkresën nr. 157/19, datë 14.09.2021.

d. Prokurimet e fondeve publike:

Gjatë auditimit mbi procedurat e realizuara të Prokurimeve të fondeve publike aga ana e Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil (KMSHC) për vitet buxhetore 2017, 2018 deri 28.02.2021, grupi i audituesve të KLSH-së, u fokusua në zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore të ligjit Nr.9646 datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, VKM nr.918 datë 29.12.2014 ñPër kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronikeò, Udhëzimin e APP-së nr.2 datë 27.01.2015 ñPër hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të prokurimit publikò, Udhëzimin e APP-së nr.3 datë 27.01.2015 ñPër procedurën e prokurimit me vlerë të vogëlò dhe çdo akti juridik që

është në fuqi në lidhje mbi prokurimet publike të financuara nga Buxheti i Shtetit, ndryshimet e tjera të APP-së.

Në lidhje me zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike rezultoi se:

- ✓ Për vitin **2019**, sipas zërave të regjistrit të prokurimeve u parashikuan të kryen procedura në vlerën prej **2,892,466** leke pa TVSH dhe realizuar në vlerën prej **2,329,600** lekë pa TVSH. Janë kryer 7 procedura prokurimesh dhe 1 prej tyre është anuluar.
- ✓ Për vitin **2020**, sipas zërave të regjistrit të prokurimeve u parashikuan të kryen procedura në vlerën prej **1,027,547** leke pa TVSH dhe realizuar në vlerën prej **148,900** leke pa TVSH. Janë kryer 2 procedura me vlerë të vogël.
- ✓ Për vitin **2021**, për periudhën objekt auditimi nuk është kryer Prokurim Publik.

Për vitin 2017 u konstatua se, KMSHC ka hartuar regjistër të realizimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2017 dhe ka realizuar gjithsej 20 prokurime, të cilat ndahen si më poshtë:
11 procedura me vlerë të vogël/në formë shkresore (me fond limit deri në 100,000 lekë pa TVSH). Vlera në total për këto procedura është:
560,544 lekë me TVSH, 467,120 lekë pa TVSH
5 procedura me vlerë të vogël/në formë elektronike (me fond limit nga 100,000- 800,000 lekë pa TVSH). Vlera totale për këto procedura është:
850,350 lekë me TVSH, 708,625 lekë pa TVSH
2 procedura ñKërkesë për propozimò/në formë elektronike (me fond limit mbi 800,000 lekë pa TVSH). Vlera totale për këto procedura është:
3,565,320 lekë me TVSH, 2,971,100 lekë me TVSH
2 minikontrata, të lidhura në bazë të marrëveshjes kuadër, me vlerë totale:
1,035,240 lekë më TVSH, 862,700 lekë pa TVSH

- ✓ **Për vitin 2017**:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u shqyrtua procedura e prokurimit publik me objekt: **"Blerje mobiljesh dhe orendi zyre"**, mbështetur në metodën e gjurmueshmërisë së dokumentacionit dhe vlerës më të lartë të Prokurimeve Publike**:**

A. Të dhëna mbi objektin:

Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: " Blerje mobiljesh dhe orendi zyre ".		
1. **Urdhër Prokurimi** Nr. 37, datë 19.04.2017	3.1 **Njësia e Prokurimit** KMSHC	4. **Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Nr. 40 datë 24.04.2017
2. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** Kërkesë për Propozim		
5. **Fondi Limit** (pa TVSh) **2,322,222** lekë	6. **Oferta fituese** (pa tvsh) **2,240,000**lekë	7. **Diferenca me fondin limit** (pa tvsh) 82222 lekë - diferenca
1. **Data e hapjes së tenderit** 08/05/2017 ; ora 10:00	2. **Burimi Financimit** xheti i Shtetit	10. **Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender 3 b) Sëkualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. **Ankimime AK**- Nr. 527Prot, datë 16.05.2017	12. **Përgjigje Ankesës nga AK** Vendimi Nr. 123 prot, datë 18.05.2018	
b. **Zbatimi i Kontratës Punëve**		
14. Lidhja e kontratës 18.06.2018	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 2,688,000 lekë	

B. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit

1.Me urdhrin Nr. 22 datë 23.03.2017, ngrihet komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e vlerës së fondit limit për procedurën e prokurimit ôBlerje pajisje zyreö, me përbërje H. L.- Kryetar, J. M., A. E. -anëtar.
2.Me urdhrin Nr. 37 datë 19.04.2018, urdhërohet procedura e prokurimit me objekt ôblerje mobilje dhe orendi zyreö, me fond limit **2,322,222** (dy milion e treqind e njëzetë e dy mijë e dyqind e njëzetë e dy) lekë pa TVSH vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, me këtë përbërje: M. I., kryetare, I. S. dhe A. E. - anëtar.
3. Me urdhrin Nr. 40, datë 24.04.2017, ngrihet grupi i vlerësimit të ofertave me objekt ôblerje mobilje dhe orendi zyreö, për nevojat e Institucionit të KMSHC, me përbërje A. Sh. - Kryetar, I. V., A. H. (H.) anëtare, (specialist i fushës së jashtme). Në zbatim të urdhrit 43, datë 25.04.2017 z. A. Sh. është zëvendësuar me E. H.
4. Me shkresë Nr. 290/2, datë 25.04.2017 është protokolluar Ftesa për Ofertë për 5 operatorët ekonomik OE të cilët ushtrojnë veprimtari në fushën objekt prokurimi. REF-08452-04-24-2017.
Në dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, përllogaritja e fondit limit nuk është përllogaritur duke studiuar tregun apo burime të dhënash të tjera, të cilat do të ndihmonin në përllogaritjen më të saktë të fondeve, por është bërë vetëm duke u bazuar në përvojën e mëparshme, si dhe duke marre oferta nga 3 OE. *Konstatohet se komisioni i përllogaritjes së fondit limit, për marrjen e ofertave i është drejtuar OE-ve të cilët, më pas kanë marrë pjesë në tender. Sa më sipër, kjo procedurë, mbart risqe që këta OE të kenë një informacion paraprak mbi çmimin që do tenderohet*.
Këto veprime cenojnë objektin e Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar ñPër Prokurimin Publikò në të cilën, në pikën 2, gërmat a), b), c), d), dh) të nenit 1 parashikohet: qëllimi i tij është: ñ*të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik".*
Pika 4, e nenit 39 të VKM 914, datë 29.12.2014 ôPër miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikôö citohet shprehimisht: *Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do të ftojë.*
5.Nga AK janë vendosur specifikimet e përgjithshme teknike dhe kriteret e veçanta të kualifikimit, në përputhje me bazën ligjore. Në mbështetje të nenit **23** të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, për Prokurimin Publik, pika **1**,**2** e këtij neni, janë përcaktuar që *<u>Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik</u>.*

Për sa më sipër, grupi i auditimit konstaton, mungesë në studimit të tregut, në kryerjen e procedurës së prokurimit publik, kërkesë për propozim, për fondin limit, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit. Rezulton se për këtë procedurë prokurimi me REF-08452-04-24-2017, pas hapjes së ofertave, kanë marrë pjesë 3 OE, nga të cilat ofertat e paraqitura nga 2 operatorët ekonomik kanë qenë në vlerën 1,254,000 lekë dhe 1,203,000 lekë pa tvsh dhe oferta fituese ka qenë në vlerën 2,224,000 lekë pa tvsh, çka tregon se nuk është kryer studimi i duhur i tregut, duke shkaktuar efekte negative financiare si pasojë e menaxhimit pa efektivitet, efiçencë dhe ekonomicitet të fondeve publike. Këta operatorë nuk janë sôkualifikuar si oferta anomalisht të ulëta, por që nuk kanë përmbushur kriteret e veçanta.
Në vendosjen e kritereve të veçanta të kualifikimit, pika **3.3** kapaciteti teknik dhe profesional: është kërkuar një punonjës arkitekt dhe licenca profesionale e ushtrimit të aktivitetit. Vendosja e një kriteri të tillë, siç është licenca e ushtrimit të aktivitetit të arkitektit, është një kriter i diskriminues dhe jo i barabartë sepse objektet e kërkuara për prodhim nga AK, janë të

dizenjuara e të specifikuara nga një arkitekt i jashtëm i AK dhe kriteri i lejes së ushtrimit të profesionit në këtë pikë vlerësohet se është i panevojshëm, duke e konsideruar si një nga kriteret diskriminues të operatorëve ekonomik.

12.Titulli i Gjetjes	**Mungesë në studimin e tregut në përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimet teknike të hartuara nga njësia e Prokurimit.**
Situata	Nga auditimi rezultoi se për procedurën e prokurimit ñkërkesë për propozimò me REF-08452-04-24-2017, me objekt ñ**Blerje mobiljesh dhe orendi zyre"**, dhe fond limit prej **2,322,222** leke, nuk është kryer studim tregu. Për këtë procedurë, rezultoi se, pas hapjes së ofertave, kanë marrë pjesë 3 OE, nga të cilat ofertat e paraqitura nga 2 operatorët ekonomik kanë qenë në vlerën 1,254,000 lekë dhe 1,203,000 lekë pa tvsh dhe oferta fituese ka qenë në vlerën 2,224,000 lekë pa tvsh, çka tregon se nuk është kryer studimi i duhur i tregut, duke shkaktuar efekte negative financiare si pasojë e menaxhimit pa efektivitet, efiçencë dhe ekonomicitet të fondeve publike. Këta operatorë nuk janë sõkualifikuar si oferta anomalisht të ulëta, por si OE që nuk kanë përmbushur kriteret e veçanta. Në vendosjen e kritereve të veçanta të kualifikimit, pika **3.3** kapaciteti teknik dhe profesional: është kërkuar një punonjës arkitekt dhe licenca profesionale e ushtrimit të aktivitetit. Vendosja e një kriteri të tillë, siç është licenca e ushtrimit të aktivitetit të arkitektit, është një kriter i diskriminues dhe jo i barabartë sepse objektet e kërkuara për prodhim nga AK, janë të dizenjuara e të specifikuara nga një arkitekt i jashtëm i AK dhe kriteri i lejes së ushtrimit të profesionit në këtë pikë vlerësohet se është i panevojshëm, duke e konsideruar si një nga kriteret diskriminues të operatorëve ekonomik. *Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*
Kriteri	Ligji Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar ñPër Prokurimin Publikò pika 2, gërmat a), b), c), d), dh) të nenit 1. Pika 4, e nenit 39 të VKM 914, datë 29.12.2014 õPër miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikô. Pika **1**,**2** e nenit **23** të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, për Prokurimin Publik.
Ndikimi/Efekti	Mungesë në studimit të tregut dhe vendosja e kritereve diskriminuese të operatorëve ekonomik.
Rëndësia	I Lartë
Rekomandime	KMSHC duhet të respektojë rregullat e hartimit të DST të tenderit, me qëllim që të mundësojë një trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit.

Për sa trajtuar më sipër është mbajtur akt konstatimi nr.5, datë 30.04.2021. Lidhur me këtë praktikë është dërguar observacion me Nr. 602/11, date 17.05.2021, ka bërë komente e shpjegime për aktet e konstatimit, të cilat janë trajtuar plotësisht në projekt raportin e auditimit dërguar në subjekt me shkresën nr. 157/19, datë 14.09.2021.

C. Mbi vlerësimin e ofertave.

1.Me hapjen e ofertave në datën 24.04.2017 në Procedurën e Prokurimit kanë marrë pjesë 3 operatorët ekonomik (OE) si më poshtë:

Nr.	Operatorët Ekonomikë	Oferta pa TVSH	S'kualifikuar/Kualifikuar
1.	ôB.ô sh.p.k	1,254,000 lekë	Sõkualifikuar
2.	ñSh.ò sh.p.k	1,203,000 lekë	Sõkualifikuar
3.	ñT. L.ò sh.p.k	2,224,000 lekë	Kualifikuar/Fituesi

2. Me shkresën Nr. 290/5, datë 05.06.2017 është protokolluar Formulari i Njoftimit të Fituesit për shoqërinë ôT. L.ôò sh.p.k me NUIS K.....C, ku në kriteret e përzgjedhjes është vendosur çmimi më i ulët.

****

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u shqyrtua procedura e prokurimit publik, me objekt: **"Blerje pajisje elektronike"**REF-14959-05-25-2017**:**

A. Të dhëna mbi objektin:

Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Blerje pajisje elektronike"		
3. **Urdhër Prokurimi** Nr. 52, datë 22.05.2017	3.1 **Njësia e Prokurimit** KMSHC REF-14959-05-25-2017	4. **Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Nr. 52 datë 22.05.2017
4. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** ñKërkesë për Propozimò		
5. **Fondi Limit** (pa tvsh) **931.667** lekë	6. **Oferta fituese** (pa tvsh) **731.100 lekë**	7. **Diferenca me fondin limit** (pa tvsh) 200.567 lekë - diferenca
3. **Data e hapjes së tenderit** 25/05/2017	4. **Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit	10. **Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender 5 b) Sõkualifikuar 4 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. **Ankimime AK**- Nr. 1127 prot, datë 14.06.2017	12. **Përgjigje Ankesës nga AK** Vendimi Nr. 1127/2 prot, datë 16.06.2017	
b. **Zbatimi i Kontratës Punëve**		
14. **Lidhja e kontratës** 17.07.2017	15. **Vlera e kontratës** (me tvsh) **877.320 Lekë**	

B. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

1.Me urdhrin Nr. 50 datë 18.05.2017, ngrihet komisioni për llogaritjen e vlerës së fondit limit për procedurën e prokurimit ôBlerje pajisje elektronikeôò, me përbërje H. L.- Kryetar, A. D., Z. M. -anëtar.

2.Me urdhrin Nr. 55 datë 24.05.2017, urdhërohet procedura e prokurimit me objekt ôblerje pajisje elektronikeôò, me fond limit **931.667** lekë (nëntëqind e tridhjetë e një lekë pikë gjashtë qind e gjashtë dhjetë e shtatë) lekë pa TVSH vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, nga Njësia e Prokurimit, me këtë përbërje: M. I., kryetare, B. H. dhe I. S. anëtar.

3. Me urdhrin Nr. 52, datë 22.05.2017, ngrihet KVO-ja me objekt ôblerje pajisje elektronikeôò, për nevojat e Institucionit të KMSHC, me përbërje E. H., kryetare, I. V. dhe A. R. anëtar.

B.1 Në dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, përllogaritja e fondit limit nuk është përllogaritur duke studiuar tregun apo burime të dhënash të tjera të cilat do të ndihmonin në përllogaritjen më të saktë të fondeve, por vetëm është bërë duke u bazuar në përvojën e mëparshme dhe duke marre oferta nga 3 OE. *Konstatohet se komisioni i përllogaritjes së fondit limit, për marrjen e ofertave i është drejtuar OE-ve* ***të cilët, më pas kanë marrë pjesë në tender****. Sa më sipër, kjo procedurë, mbart risqe që këta OE të kenë një informacion paraprak mbi çmimin që do tenderohet.*

B.2.1 Njësia e Prokurimit ka njoftuar për të marrë pjesë për 5 operatorët ekonomik OE të cilët ushtrojnë veprimtari në fushën objekt prokurimi, por nuk ka argumentuar përzgjedhjen e tyre, jo në përputhje me kërkesat e nenit 39, pika 4 e VKM 914, datë 29.12.2014 ôPër miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikôò.

Referuar nenit 39, pika 4 e VKM 914, datë 29.12.2014 ôPër miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikôò parashikohet:

-Pavarësisht nga publikimi i njoftimit të kontratës, sipas pikës 2, të këtij neni, autoriteti kontraktor fton për të marrë pjesë dhe të paktën 5 (pesë) operatorë ekonomikë.
-Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do të ftojë. Këto veprime cënojnë parimin e Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar ñPër Prokurimin Publikò në të cilën, në pikën 2, gërmat a), b), c), d), dh) të nenit 1 parashikohet: qëllimi i tij është: ñ*të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik".*

5**B.2.2** AK ka kërkuar kriteret e vendosura sipas, pikës **2.3** Kapaciteti teknik: *duhet që OE duhet të paraqesë certifikatën EN ISO 9001:2008 për sistemet e menaxhimit të cilësisë. OE duhet të kenë minimumi **3** punonjës të punësuar, nga të cilët **2** punonjës, me profesion inxhinier elektronik ose informatik ose telekomunikacioni* sipas DST (fq.80-82).
Lidhur për certifikatën EN ISO 9001:2008, me qëllim për të mundësuar një trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit që mos të shërbenin si pengesa në konkurrencën e Prokurimit Publik, nga AK, çdo referencë duhej të shoqërohej nga fjalët ñ***ose ekuivalent i tij/saj''***, referuar Legjislacionit të Prokurimit Publik, sipas nenit **23**, pika **3**, shkronja óôcôô të ligjit **9643**, datë 20.11.2006, i ndryshuar për PP.
Duke qenë se këto certifikata janë sipas standardeve ndërkombëtare, ato janë gjithmonë subjekt i përmirësimeve në bazë të direktivave të reja që dalin për përmirësimin e cilësisë dhe shërbimeve, por janë pa ndryshuar objektin e tyre. Pra, në vitin 2017 për procedurën e kryer, është kërkuar certifikata e EN ISO e vitit 2008 për menaxhimin e cilësisë, kur ndërkohë ka dalë edhe certifikata EN ISO 9001:2015 të cilat kanë të njëjtin standard.
Sa më sipër, këto të dhëna janë të paargumentuar nga AK, janë kërkesa diskriminuese duke kufizuar konkurrencën dhe janë jashtë natyrës dhe llojit të kontratës.
B.2.3 Vendosja e kritereve të tilla, si: *të kenë minimumi **3** punonjës të punësuar, nga të cilët **2** punonjës, me profesion inxhinier elektronik ose informatik ose telekomunikacioni, për të cilët kërkohet diplomë në degët inxhinieri*, janë të paargumentuara, si nga numri i punonjësve/inxhinierëve, po kështu edhe nga ana e profesionit. Në gjykimin e grupit të auditimit, kriteri i lejes së ushtrimit të profesionit në këtë pikë vlerësohet se është i panevojshëm, duke e konsideruar si një nga kriteret diskriminues të operatorëve ekonomik.
Në opinionin e grupit të auditimit, montimi i pajisjeve dhe vendosja sipas një konfigurimi të përshtatshëm për nevojat e KMSHC, për zbatimin e kontratës nga OE, mund të kryhen edhe nga punonjës që kanë njohuri dhe janë të pajisur me licencat profesionale apo dëshmi përkatëse, sipas përcaktimeve të *nenit 28, pika 5, të vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, ''për miratimin e rregullave të prokurimit publik'', i ndryshuar.*
Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në përputhje me nenin 46, pika 1, shkronja a), b) të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014.
Në kuptim të këtij ligji, kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.

13.Titulli i Gjetjes	**Mangësi në procesin e studimit të tregut dhe në hartimin e specifikimeve teknike të hartuara nga njësia e Prokurimit.**

Situata	Nga auditimi i procedurës së prokurimit ñkërkesë për propozimò, me objekt "Blerje pajisje elektronike", dhe fond limit 931.667 lekë, konstatuam mungesë në studimit të tregut, për nevoja të përllogaritjes së fondit limit. Rezulton se fondi limit nuk është përllogaritur duke studiuar tregun apo mbi burime të dhënash të cilat do të ndihmonin në përllogaritjen më të saktë të fondeve, por është bërë duke u bazuar vetëm në përvojën e mëparshme dhe duke marre oferta nga 3 OE, për më tepër kur këto 3 OE rezultojnë të kenë marrë pjesë në këtë tender, duke mbartur risqe që k*ëta operatorë të kenë një informacion paraprak mbi çmimin që do tenderohet*. Gjithashtu rezultoi se, në kriteret e vendosura nga AK, pika **2.3** Kapaciteti teknik kërkon që *OE:* *- duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2008 për sistemet e menaxhimit të cilësisë.* *- të kenë minimumi **3** punonjës të punësuar, nga të cilët **2** punonjës, me profesion inxhinier elektronik ose informatik ose telekomunikacioni* sipas DST (fq.80-82), Sa më sipër, të pa shoqëruar me fjalët ñ***ose ekuivalent i tij/saj'', duke mos stimuluar pjesëmarrjen në kundërshtim me*** **nenin 46**, pika 3 të LPP. Këto certifikata janë gjithmonë subjekt i përmirësimeve në bazë të direktivave të reja që dalin për përmirësimin e cilësisë dhe shërbimeve, por gjithmonë pa ndryshuar objektin e tyre. Në këto kushte nuk argumentohet se pse për procedurën e kryer në vitin 2017, është kërkuar certifikata e EN ISO e vitit 2008 për menaxhimin e cilësisë. Sa më sipër, këto të dhëna janë të paargumentuar nga AK, janë kërkesa diskriminuese duke kufizuar konkurrencën dhe janë jashtë natyrës dhe llojit të kontratës. Gjithashtu kriteri i lejes së ushtrimit të profesionit, vlerësohet se është i panevojshëm, dhe diskriminues pasi në gjykimin e pavarur të audituesit, montimi i pajisjeve dhe vendosja sipas një konfigurimi të përshtatshëm për nevojat e KMSHC, për zbatimin e kontratës nga OE, mund të kryhen edhe nga punonjës që kanë njohuri dhe janë të pajisur me licencat profesionale apo dëshmi përkatëse, sipas përcaktimeve të *nenit 28, pika 5, të vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, ''për miratimin e rregullave të prokurimit publik'', i ndryshuar*.
Kriteri	Ligji Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar ñPër Prokurimin Publikò shkronjës ôcô, pikës **3**, të nenit **23**. Pika 4, e nenit 39 të VKM 914, datë 29.12.2014 ôPër miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikô. Pika **1**,**2** e nenit **23** të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, për Prokurimin Publik.
Ndikimi/Efekti	Mungesë në studimit të tregut dhe vendosja e kritereve diskriminuese të operatorëve ekonomik.
Rëndësia	I Lartë
Rekomandime	KMSHC (grupi I përllogaritjes së fondit limit) përgjatë përllogaritjes së fondit limit të vlerësojë dhe argumentojë me kujdes përzgjedhjen e alternativave që do tu referohet, me qëllim rritjen e transparencës në procedurat e prokurimit.

	KMSHC, në vendosjen e kritereve specifike për kualifikim të merren masa të zbatohen parimet që mundësojnë trajtim të njëjtë dhe jo diskriminues për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit, me qëllim rritjen e konkurrencës, ndër të tjera duke shoqëruar kriteret edhe me fjalët ñose ekuivalent i tij/e saj)

Për sa trajtuar më sipër është mbajtur akt konstatimi nr.5, datë 30.04.2021. Lidhur me këtë praktikë është dërguar observacion me Nr. 602/11, date 17.05.2021, ka bërë komente e shpjegime për aktet e konstatimit, të cilat janë trajtuar plotësisht në projekt raportin e auditimit dërguar në subjekt me shkresën nr. 157/19, datë 14.09.2021.

C. Mbi Vlerësimin e Ofertave.

1.Me hapjen e ofertave në datën 25.05.2017 në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë **5** operatorët ekonomik (OE) si më poshtë:

Nr.	Operatorët Ekonomikë	Oferta pa TVSH	S'kualifikuar/Kualifikuar
1.	ôS.C.ô sh.p.k	731,100 lekë	Kualifikuar/Fituesi
2.	ñB. E.ò shpk	743,000	Kualifikuar
4.	ôP. S.ô shpk	745,000	Kualifikuar
3.	ñI. S, S.òshpk	839,160	Kualifikuar
5.	ôI. GJ. K.ô shpk	Nuk ka paraqitur	Sôkualifikuar

2. Në datën 14.06.2017, pranë Autoritetit Kontraktor, Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është depozituar ankesa nga operatori ekonomik ôP. S.ô sh.p.k, protokolluar me nr.1127, datë 14.06.2017 dhe me vendim nr. 1127, datë 16.06.2017 i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së subjektit ankimues, shoqëria ôP. S.ô shpk si të pabazuara pretendimet e subjektit ankimues dhe nuk përbëjnë shkak për anulimin e vendimit të KVO-së.

3. Me shkresën Nr. 586/4, datë 28.06.2017 është protokolluar Formulari i Njoftimit të Fituesit për ôS. C.ô sh.p.k si oferta e suksesshme dhe me çmimin më të ulët.

-Praktika rezulton e përfunduar me lidhjen e kontratës në datën 17.07.2017, shoqëruar me faturat tatimore përkatëse dhe me magazinimin e mallrave/shërbimeve pranë autoritetit kontraktor.

✓ **Për vitin 2018**

KMSHC për vitin 2018 ka hartuar regjistër të realizimeve të Prokurimeve Publike dhe ka realizuar gjithsej **20 prokurime**, të cilat ndahen si më poshtë:

- **14** procedura me vlerë të vogël/në formë shkresore me vlerë 1186066 leke me tvsh
- **2** procedura me sistem dinamik me vlerë totale 1656960 leke me tvsh
- **2** procedura ñKërkesë për propozimò/në formë elektronike me vlerë 3666180 leke me tvsh
- **2** minikontrata, me vlerë 518140 lekë me tvsh

Nga auditimi, u konstatua se sipas regjistrit të parashikuar u konstatua në vlerë prej **7194746** lekë me tvsh, dhe është realizuar në vlerë prej **5995622** lekë pa tvsh.

Grupi i auditimit ka përzgjedhur **2** procedura prokuruese, kërkesë për propozim, në bazë të vlerës së lartë të kontratës, natyrës dhe objektit të prokurimit, duke u mbështetur në metodën e gjurmueshmërisë së dokumentacionit.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u shqyrtua procedura e prokurimit publik, me objekt: **"Blerje pajisje elektronike"** REFï 67811-05-08-2018.

A. Të dhëna mbi objektin:

Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Blerje pajisje elektronike"		
5. **Urdhër Prokurimi** Nr. 40, datë 08.05.2018	3.1 **Njësia e Prokurimit** KMSHC	4. **Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Nr. 39 datë 07.05.2018
6. **Lloji i Procedurës së Prokurimit**		

ñKërkesë për propozimò		
5. **Fondi Limit** (pa tvsh) **1,246,663** lekë	6. **Oferta fituese** (pa tvsh) **1,076.350 lekë**	7. **Diferenca me fondin limit** (pa tvsh) 2.15,270 lekë - diferenca
5. **Data e hapjes së tenderit** 09/05/2018	6. **Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit	10. **Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender 3 b) Sõkualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. **Ankimime AK**- Nr. 442 prot, datë 14.05.2018 Nr. 447 prot, datë 14.05.2018	12. **Përgjigje Ankesës nga AK** Vendimi Nr. 442/2 prot, datë 16.05.2018 Vendimi Nr. 447/2 prot, datë 17.05.2018	
b. **Zbatimi i Kontratës Punëve**		
14. **Lidhja e kontratës** 18.06.2018	15. **Vlera e kontratës** (me tvsh) 1.291.620 kë	

B. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

1. Me urdhrin Nr. 40 datë 08.05.2018, urdhërohet procedura e prokurimit me objekt õõblerje pajisje elektronikeõõ, me fond limit **1,246,663** (një milion e dyqind e dyzetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit. REFï 67811-05-08-2018.

2.Me urdhrin Nr. 39 datë 07.05.2018, ngrihet grupi i vlerësimit të ofertave me objekt õõblerje pajisje elektronikeõõ, për nevojat e Institucionit të KMSHC, me përbërje E. H. - Kryetar, I. V., A. R. anëtare, (specialist i fushës së jashtme).

B.1 Me shkresë Nr. 332/5, datë 08.05.2018 nga njësia e prokurimit, është protokolluar Ftesa për Ofertë për 5 operatorët ekonomik OE të cilët ushtrojnë veprimtari në fushën objekt prokurimi, por për këtë procedure sqarohet se do të pranohen edhe oferta të paraqitura nga OE të tjerë, të cilët janë të interesuar.

B.1.1 Me shkresën Nr. 332/3 Prot, datë 04.05.2018 është kryer hartimi mbi specifikimet teknike, që operatorët ekonomik të provojnë se zotërojnë edhe certifikatat ISO 2000-1:2011, mbi õõMenaxhimin e shërbimitõõ, ISO 22301:2012, mbi õõsistemet e menaxhimit të vazhdimësisë së biznesitõõ, ISO 9001:2008, mbi õõSistemet e menaxhimit të cilësisë, ISO 27001:2013, õõmbi sistemet e menaxhimit të sigurisë informatikeõõ, bazuar në nenin 46, pika, 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 õõPër prokurimin publikõõ, i ndryshuar dhe nenin 30, të VKM, Nr. 914, datë 29.12.2014 õõPër miratimin e rregullave të Prokurimit publikõõ. N*ë këtë praktikë nuk argumentohet përsa janë përshkruar këto kërkesa të veçanta të kualifikimit 2.1 specifikimet ligjore/profesionale, 2.2 kapacitetin ekonomik dhe financiar, 2.3 kapacitetin ekonomik 3.mbi çertifikatat ISO, sipas shtojcave 6,7,8,9 sipas DST*[24] *dhe nuk janë arsyetuar përse këto kërkesa, duhet që të përmbushen nga operatori ekonomik fitues.*

Sqarohet se këto kritere janë vendosur me qëllim që OE të provojë se është shpërndarës i autorizuar i prodhuesit ose prodhuesve të mallrave objekt prokurimi.

Referuar nenit 1 të LPP parashikohet: "[…]të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik në procedurat e prokurimit publik, të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomik, të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik".

Referuar nenit 2 të LPP parashikohet: "Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me parime të përgjithshme, mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve dhe transparencë në procedurat e prokurimit". Neni 20 të LPP, "AK duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomik, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve

[24] *Sipas Dokumentave Standartë të Tenderit (DST), neni 10, VKM 614, datë 29.12.2004 dhe pikës 1,2,3,4, të nenit 23 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 për PP, i ndryshuar.*

ose ndaj kategorive të tyre".
Referuar nenit 23 LPP, pikat 1,2,5 mbi Specifikimet teknike, është parashikuar:
Pika 1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.
Pika 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.
Pika 5. Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.
Rezulton se, Autoriteti Kontraktor ka vendosur kritere të sforcuara mbi certifikatat ISO, për të cilën kërkohet që OE të jenë pajisur me certifikatat ISO 2000-1:2011; ISO 9001:2008; ISO 27001:2013; ISO 22301:2012, pa përdorur fjalët ñose ekuivalent i tij/sajò, në përputhje me kërkesat e nenit 23, pika, 3, shkronja c, e ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 ôPër prokurimin publikôõ, i ndryshuar. Në kërkesat e saj, autoriteti kontraktor çdo referencë duhet të shoqërohej nga fjalët ñ***ose ekuivalent i tij/saj''***, që të mos shërbente si pengesë në parimin e konkurrencës sepse këto certifikata që janë sipas standardeve ndërkombëtare, janë gjithmonë objekt i përmirësimeve në bazë të direktivave të reja që dalin për përmirësimin e cilësisë dhe shërbimeve, por pa ndryshuar objektin e tyre, me qëllim që të krijonin një pjesëmarrje më të gjerë.

B.1.2 Në vendosjen e kritereve të veçanta, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që Operatorët Ekonomik të kenë një inxhinier të certifikuar për serinë e serverit DELL Power Edge R710, por ky specifikim më pas është hequr nga Komisioni i përgatitjes së specifikimeve teknike, jo në përputhje me kërkesat e nenit 23, pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, për Prokurimin Publik, i ndryshuar, ku parashikohet: *[…]specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emër i veçantë […]* .

Në kuptim të nenit 23, trajtuar në referencën nr. 3,në përshkrimin e mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale.
Sa më sipër, këto të kriter vlerësojmë dhe gjykojmë se janë të paargumentuara dhe diskriminuese, duke kufizuar kështu konkurrencën.

14.Titulli i Gjetjes	**Mungesë në argumentimin dhe vendosjen e kritereve të veçanta të kualifikimit nga njësia e Prokurimit.**
Situata	Për vitin 2018, nga auditimi i procedurës së prokurimit ñkërkesë për propozimò, me objekt "Blerje pajisje elektronike", dhe fond limit 1,246,663 lekë, konstatuam se n*ë këtë praktikë nuk është bërë argumentimi mbi vendosjen e kritereve të veçanta të kualifikimit mbi certifikatat ISO, sipas shtojcave 6,7,8,9 të DST*[25]*, si dhe nuk është argumentuar nevoja për këto kërkesa, në kundërshtim me* nenin 23, ku në përshkrimin e mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së

[25] *Sipas Dokumentave Standartë të Tenderit (DST), neni 10, VKM 614, datë 29.12.2004 dhe pikës 1,2,3,4, të nenit 23 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 për PP, i ndryshuar.*

	kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Konstatuam se, Autoriteti Kontraktor ka vendosur specifikime teknike pa përdorur fjalët ñose ekuivalent i tij/e sajò, në kundërshtim me shkronjën óçcô, pika 3, të nenit 23, të ligjit 9643, datë 20.11.2006, duke kërkuar që operatorët ekonomik të provojnë se zotërojnë edhe certifikatat ISO 20000-1:2011, mbi óôMenaxhimin e shërbimitôô, ISO 22301:2012, mbi óôsistemet e menaxhimit të vazhdimësisë së biznesitôô, ISO 9001:2008, mbi óôSistemet e menaxhimit të cilësisë, ISO 27001:2013, óômbi sistemet e menaxhimit të sigurisë informatikeôô. Sipas AK, certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga RSH. Grupi i auditimit vëren se, këto certifikata janë gjithmonë subjekt i përmirësimeve në bazë të direktivave të reja që dalin për përmirësimin e cilësisë dhe shërbimeve, por gjithmonë pa ndryshuar objektin e tyre.
Kriteri	Ligji Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar ñPër Prokurimin Publikò shkronjës óçcô, pikës **3**, të nenit **23**. Pika 4, e nenit 39 të VKM 914, datë 29.12.2014 óôPër miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikôô. Pika **1**,**2** e nenit **23** të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, për Prokurimin Publik.
Ndikimi/Efekti	Mungesë në studimit të tregut dhe vendosja e kritereve të sforcuara të operatorëve ekonomik.
Rëndësia	I Lartë
Rekomandime	KMSHC (njësia përgjegjëse), në <u>vendosjen e kritereve specifike</u> për kualifikim të marr masa të zbatohen parimet që mundësojnë trajtim të njëjtë dhe jo diskriminues për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit, me qëllim rritjen e konkurrencës, ndër të tjera duke shoqëruar në çdo rast kriteret edhe me fjalët ñose ekuivalent i tij/e sajò.

Për sa trajtuar më sipër është mbajtur akt konstatimi nr.6, datë 30.04.2021.

C. Mbi zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave

1.Me hapjen e ofertave në datën 09.05.2018 në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3 operatorët ekonomik (OE) si më poshtë:

Nr.	Operatorët Ekonomikë	Oferta pa TVSH	S'kualifikuar/Kualifikuar
1.	óôS. C.ôô sh.p.k, me NUIS K 11324003F	1,076,350 lekë	Kualifikuar/Fituesi
2.	ñB.ò shpk	Nuk ka paraqitur	Sôkualifikuar
3.	ñE. I.ò	Nuk ka paraqitur	Sôkualifikuar

Konstatohet se kjo procedurë është pezulluar dy herë sepse 2 prej operatorëve ekonomikë kanë bërë ankim lidhur mbi specifikimet teknike (*konform rregullave dhe legjislacionit të Prokurimit Publik*).

-Në datën 14.05.2018, pranë Autoritetit Kontraktor, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është depozituar ankesa nga operatori ekonomik óôB. E.ôô sh.p.k, protokolluar me nr. 447, datë 14.05.2018 dhe me vendim nr. 49, datë 17.05.2018 i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, ka vendosur të modifikojë pikën 2, Kriteret e veçanta të kualifikimit, në pikën 2.1 kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë dhe njoftimin e Titullarit të Institucionit.

-Me shkresën Nr. 332/10, datë 07.06.2018 është protokolluar Formulari i Njoftimit të Fituesit

për ôôS. C.ôô sh.p.k me NUIS K.....F duke identifikuar si ofertën me të suksesshme.
B.2.1 Sipas procesverbalit Nr. 7, i mbajtur në datën 30.05.2018 të anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO), nënshkruar nga E. H.-Kryetare, I. V., A. R., M. H.-anëtarë, rezulton se për pajisjen kompjuter Desktop, tek modeli DELL Optiplex 3050 MT në katalog nuk janë markuar specifikimet për ***sound and speakers***, por ky model i verifikuar nga anëtari i Komisionit me cilësinë e ekspertit të fushës në faqen zyrtare të DELL, i përfshin të gjitha specifikimet e kërkuara. Nga ana tjetër, ky operator, përmes deklaratës së përmbushjes së specifikimeve teknike ka marrë përsipër përmbushjen e të gjitha specifikimeve të kërkuara, si dhe pas verifikimit në SPE, këto specifikime nga Operatori Ekonomik fitues nuk janë ngarkuar, ndërkohë KVO-ja ka vlerësuar këtë operator ekonomik, i cili nuk i përmbush këto specifikime, por është sqaruar se këto specifikime do të përshkruheshin me një proçesverbal me lidhjen e kontratës nga Komisioni i Marrjes në dorëzim

-Me shkresën Nr. 332/15, datë 19.06.2018, të Urdhrit Nr. 56, datë 19.06.2018 për ngritjen e Komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara nëpërmjet procedurës së prokurimit ôôKërkesë për propozimôô, me objekt ôôBlerje pajisje elektronikeôô. Për rrjedhojë, Komisioni ka mbajtur në datë 25.06.2018 procesverbalin për marrjen në dorëzim të pajisjeve elektronike, me përbërje si më poshtë: B. H. ï Kryetar, M. I., A. R.-Anëtar. Bashkëlidhur gjendet fatura tatimore e shitjes, datë 25.06.2018, duke nënshkruar për emërtimet e pajisjeve, por pa përmendur në proçesverbal nëse specifikimet për ***sound and speakers*** janë të përfshira ose jo.

Si përfundim, nga procedura e kryer ôôBlerje pajisje elektronikeôô, nga Autoriteti Kontraktor, (*komisioni i marrjes në dorëzim*), nuk është mbajtur proçesverbal mbi specifikimet teknike konkretisht për markimin e PC, ***speaker and sound*** megjithëse në proçesverbalin Nr. 7, i mbajtur në datën 30.05.2018 ky detaj do të përmendej në fund të lidhjes së kontratës, gjë e cila nuk është përmendur nga komisioni i marrjes në dorëzim.

Në kundërshtim me nenin 1, 2 dhe neni 20,të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, për Prokurimin Publik, i ndryshuar, në vendosjen e kritereve AK ka kërkuar që OE në përmbushjen e kritereve të përgjithshme dhe ato të veçanta të kualifikimit, të provojnë se zotërojnë edhe çertifikatat ISO 2000-1:2011; ISO 22301:2012; ISO 9001:2008; ISO 27001:2013, ku nga 5 OE të cilët kanë marrë pjesë në këtë tender, këto kritere i zotëronte vetëm OE ôôSinteza Coôô sh.p.k. Në kërkesat e saj, AK në çdo referencë duhet të shoqërohej nga fjalët ñ***ose ekuivalent i tij/saj''***, që mos shërbenin si pengesa në konkurrencën e Prokurimit Publik sepse këto çertifikata që janë sipas standardeve ndërkombëtare, janë gjithmonë objekt i përmirësimeve në bazë të direktivave të reja që dalin për përmirësimin e cilësisë dhe shërbimeve, por pa ndryshuar objektin e tyre.
Në kundërshtim me pikën 5 të nenit 23 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, për Prokurimin Publik, i ndryshuar, në vendosjen e kritereve të veçanta, AK ka kërkuar që OE të ketë një inxhinier të certifikuar për serinë e serverit DELL Power Edge R710, por ky specifikim është hequr nga Komisioni. Në kuptim të këtij neni, citohet se: specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emër i veçantë, por në gjykimin e grupit të auditimit, krijon dyshime të arsyeshme, për një procedurë tenderimi të paracaktuar, diskriminim të operatorëve ekonomik dhe në fund të procedurës së tenderimit rezulton të jetë bërë njoftimi i fituesit ôôS. C.ôô sh.p.k i cili ka lëvruar markën Dell. Rezulton se kjo kompani është përfaqësuesi nr. 1 dhe promovuesi i markës **Dell** në Shqipëri që prej vitit 1998[26]
Në kundërshtim me pikat 1, 2, 3, 4, të nenit 23, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, për

[26] sinteza-al.com

Prokurimin Publik, i ndryshuar, vendosja e kritereve të veçanta, mbi specifikimet teknike, në këtë praktikë prokurimi nuk është bërë argumentimi mbi përzgjedhjen dhe vendosjen e kritereve të veçanta të kualifikimit që janë përshkuar sipas DST, në pikat 2.1 specifikimet ligjore/profesionale, 2.2 kapacitetin ekonomik dhe financiar, 2.3 kapacitetin ekonomik 3.mbi çertifikatat ISO, sipas shtojcave 6,7,8,9 dhe nuk janë arsyetuar përse janë përshkruar këto kërkesa, që të përmbushen nga operatori ekonomik fitues, veprime të cilat bien ndesh me nenet e përshkruar më sipër dhe janë objekt diskriminimi, duke dëmtuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomik pjesëmarrës.

15.Titulli i Gjetjes	**Mungesë në mbajtjen e procesverbaleve të DST për dokumentimin e procedurës së PP dhe vendosja e referencave të markave apo emrave të veçantë.**
Situata	-Nga auditimi rezultoi se, për vitin 2018, nga auditimi i procedurës së prokurimit ñkërkesë për propozimò, me objekt "Blerje pajisje elektronike", dhe fond limit 1,246,663 lekë, për pajisjen kompjuter Desktop, tek modeli DELL Optiplex 3050 MT në katalog nuk ishin markuar specifikimet për *"sound and speaker"*, por ky model, i verifikuar nga anëtari i Komisionit me cilësinë e ekspertit të fushës në faqen zyrtare të DELL, i përfshin të gjitha specifikimet e kërkuara. Nga ana tjetër, Operatori Ekonomik, përmes deklaratës së përmbushjes së specifikimeve teknike ka marrë përsipër përmbushjen e të gjitha specifikimeve të kërkuara në DST, si dhe pas verifikimit në SPE rezultoi se këto specifikime nga Operatori Ekonomik fitues nuk janë ngarkuar (nëse përfshihen ose jo), por ndërkohë, KVO-ja ka vlerësuar këtë operator ekonomik, edhe pse nuk i përmbushte këto specifikime, gjë e cila më pas, është sqaruar se këto specifikime do të përshkruheshin me proçesverbal me lidhjen e kontratës nga Komisioni, me marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve. **-**Me shkresën Nr. 332/15, datë 19.06.2018, të Urdhrit Nr. 56, datë 19.06.2018 është ngritur Komisioni për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara nëpërmjet procedurës së prokurimit ôôKërkesë për propozimôô, me objekt ôôBlerje pajisje elektronikeôô, me përbërje si më poshtë: B. H.ï Kryetar, M. I., A. R., i cili më datë 25.06.2018 ka mbajtur proçesverbalin për marrjen në dorëzim të pajisjeve elektronike, bashkëlidhur të cilit gjendet fatura tatimore e shitjes, datë 25.06.2018, ku cilësohen emërtimet e pajisjeve, por vijojnë të **mos** përmendet nëse specifikimet për ñ***sound and speakers"*** janë të përfshira ose jo. - Nga auditimi rezultoi se, AK ka kërkuar që OE të ketë një inxhinier të certifikuar për serinë e serverit DELL Power Edge R710, kriter i vendosur, jo në përputhje me kërkesat e nenit 23, pika 5, të ligjit 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, ku përcakton se specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë **apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë […]. Vendosja e një kriteri të tillë, jo ligjor mbart riskun e një procedure të paracaktuar**, ku cënohen parimet e trajtimit të barabartë, si dhe të mosdiskriminim të operatorëve ekonomik. Në përfundim të procedurës së tenderimit rezulton të jetë shpallur fituesi ôôS. C.ôô sh.p.k, njëkohësisht promovuesi i markës **Dell** në Shqipëri që prej vitit 1998[27].

[27] sinteza-al.com

Kriteri	Neni 1, 2 dhe neni 20,të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, për Prokurimin Publik, i ndryshuar. Pika 5 e nenit 23 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, për Prokurimin Publik, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Vendosje e kritereve diskriminuese të operatorëve ekonomik.
Rëndësia	I Lartë
Rekomandime	KMSHC, në vendosjen e kritereve specifike për kualifikim të marr masa të zbatohen parimet që mundësojnë trajtim të njëjtë dhe jo diskriminues për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit, me qëllim rritjen e konkurrencës, ndër të tjera duke shoqëruar kriteret edhe me fjalët ñose ekuivalent i tij/e saj). Çdo etapë e procesit të prokurimit të dokumentohet në përputhje me rregullat e parashikuara sipas kuadrit ligjor dhe rregullator në fushën e legjislacionit, në përputhje me kriterin e prokurimit publik.

Për sa trajtuar më sipër është mbajtur akt konstatimi nr.6, datë 30.04.2021. Lidhur me këtë praktikë është dërguar observacion me Nr. 602/11, date 17.05.2021, ka bërë komente e shpjegime për aktet e konstatimit, të cilat janë trajtuar plotësisht në projekt-raportin e dërguar në subjekt me shkresën nr. 157/19, datë 14.09.2021.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u shqyrtua procedura e prokurimit publik, me objekt: **"Blerje pajisje mobilje zyre"** REF ï 63067-04-17-2018**:**

A. Të dhëna mbi objektin:

Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: " Blerje pajisje mobilje zyre "		
7. **Urdhër Prokurimi** Nr. 35 datë 17.04.2018	3.1 **Njësia e Prokurimit** KMSHC REF ï 63067-04-17-2018	4. **Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Nr. 39 datë 07.05.2018
8. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** Kërkesë për propozim		
5. **Fondi Limit** (pa tvsh) **2073267** lekë	6. **Oferta fituese** (pa tvsh) 2073267 **lekë**	7. **Diferenca me fondin limit** (pa tvsh)
7. **Data e hapjes së tenderit** 17/04/2018	8. **Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit	10. **Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender 2 b) Sëkualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. **Ankimime AK**- Nr. 442 prot, datë 14.05.2018 Nr. 447 prot, datë 14.05.2018	12. **Përgjigje Ankesës nga AK** Vendimi Nr. 442/2 prot, datë 16.05.2018 Vendimi Nr. 447/2 prot, datë 17.05.2018	
b. **Zbatimi i Kontratës Punëve**		
14. **Lidhja e kontratës** 18.06.2018	15. **Vlera e kontratës** (me tvsh) 2.374.560 lekë	

B. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

1. Me urdhrin Nr. 28 datë 13.03.2018, ngrihet komisioni për përllogaritjen e fondit limit, me objekt ő blerje pajisje mobilje zyre, për nevojat e Institucionit të KMSHC, me përbërje P. U. - Kryetar, G. H. - anëtarë, S. M.- anëtar. Komisioni për përllogaritjen e fondit, është protokolluar një ditë më pas nga Njësia e Prokurimit.

2. Me urdhrin Nr. 26 datë 12.03.2018, ngrihet njësia e prokurimit, me përbërje M. H. - Kryetar, A. E. - anëtare, S. N. - anëtar.

Me urdhrin Nr. 35 datë 17.04.2018, urdhërohet procedura e prokurimit me objekt ő blerje

pajisje mobilje zyreò, me fond limit **2073267** (dy milion e shtatëdhjetë e tre mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit
Me shkresë Nr. 331/3, datë 13.04.2018 janë hartuar specifikimet teknike, si dhe argumentimi dhe llogaritja e vlerës limit.
Me shkresë Nr. 331/4, datë 17.04.2018 urdhërohet prokurimi për blerje pajisje mobilje zyre dhe është proceduar me ftesë për 5 OE.
3. Me urdhrin Nr. 39, datë 07.05.2018 ngrihet KVO-ja, me përbërje E. H. ï Kryetar, H. P., A. H. - anëtar.

B.1 Autoriteti Kontraktor, ka zgjedhur alternativën e testimit të tregut, ku u bë i mundur të siguroheshin tre oferta nga shoqëritë tregtare në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës. Ai ka zgjedhur si procedurë, çmimet e tregut, duke siguruar tre oferta nga shoqëritë tregtare, të cilat detyrimisht duhet të ushtrojnë veprimtari në tregtimin e mobilieve, pajisjeve dhe orendive për zyra. Bazuar në ekstraktin historik të gjendur në QKB, për subjektet tregtar R., me NUIS J.....M, T. L, shpk, me NUIS K.....C dhe subjektin tregtar C. me NUIS J.....I, rezulton se nga kërkimi i kryer në QKB për **1** nga **3** OE: subjekti ekonomik **C.** me NUIS **J.....I**, nuk ushtron veprimtari në tregtimin e mobilieve, pajisjeve dhe orendive për zyra, nuk janë të licencuar nga shteti për objektin e prokurimit, bazuar në ekstraktin historik të gjendur në QKB, por veprimtaria e tij është: *Import eksport të lëndëve të para dhe ndihmëse për industrinë, pajisje elektromekanike, elektronike, goma të të gjitha llojeve etj. Projektim dhe instalimi i pajisjeve të transmetimit(figurë dhe zë) si dhe të pajisjeve të vëzhgimit (kamera). Importimi, tregtimi, riparimi i të gjitha llojeve e pajisjeve të telekomunikacionit si qendrore dhe fundore. Të projektojë e zbatoj të gjitha llojet e rrjetat lokale dhe kombëtare me pajisje telekomunikacioni si qendrore ashtu dhe fundore etj.*
Faktet e mësipërme, e bëjnë procedurën të pavlefshme pasi nuk është aspak e argumentuar dhe e dokumentuar, e për rrjedhojë, AK ka nxjerrë një përllogaritje jo reale të vlerës për kryerjen e këtij shërbimi, jo në përputhje me kërkesat e nenit 59 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar.
"Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohetò.
Grupi i Auditimit shprehet me rezerva për procedurën e prokurimit, ôblerje pajisje mobilje zyreôsepse mungesa e studimit të duhur të tregut, në përllogaritjen e fondit limit, si dhe me çmimet e ofertuara nga operatorët ekonomik, në gjykimin e grupit të auditimit rezultojnë të jenë më të larta në raport me çmimet e tjera të tregut e për rrjedhojë, ato rrezikojnë të sjellin efekte negative financiare si pasojë e menaxhimit pa efektivitet, efiçencë dhe ekonomicitet të fondeve publike. Autoriteti Kontraktor, në përllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, duhet tôi referohej alternativave të tjera të renditura si: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj).

Mbi zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave.
B.2 Në vijim, me hapjen e ofertave në datën 18.04.2018 në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 operatorët ekonomik (OE) si më poshtë:

Nr.	Operatorët Ekonomikë	Oferta pa TVSH	S'kualifikuar/Kualifikuar
1.	óB.ôôshpk	1,873,000 lekë	Sôkualifikuar
2.	ñT. L.ôôshpk	1,978,800	Kualifikuar/Fituesi

B.3 Me shkresën Nr. 441/2, datë 14.05.2018 është protokolluar Formulari i Njoftimit të Fituesit për ôôT. L.ôô sh.p.k me NUIS K.....C dhe më datë 19.05.2018 është nënshkruar formulari i njoftimit të kontratës, në vlerën 2073267 lekë pa tvsh dhe 2.374.560 lekë me tvsh.

Rezulton se për nevojat e KMSHC është bërë kërkesa për propozim për **14** poltrona rrotullues, me çmim për njësi **26 000** lekë, kompozim librari 1 në vlerën **814 400** lekë dhe kompozim librari 2, në vlerën **800 400** lekë të reja pa TVSH.
Në datën 23.05.2018, është lidhur kontrata, shoqëruar me mallrat dhe pagesën sipas faturës tatimore shitjes.
Në përfundim konkludojmë se, në lidhje me këtë procedurë tenderimi, Autoriteti Kontraktor, nuk ka arritur qëllimin e këtij ligji, për të mundësuar rritjen e efiçencës dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore, pasi nuk ka nxitur pjesëmarrjen dhe konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë e për rrjedhojë nuk ka siguruar mirëpërdorim të fondeve publike. Konstatohet se ofertuesit janë vetëm dy garues, pa pjesëmarrje të tjerë të operatorëve ekonomik.

16.Titulli i Gjetjes	**Mangësi në procesin e studimit të tregut, e përllogaritjes së fondit limit, si dhe çmime të objekteve më të larta në raport me çmimet e tregut.**
Situata	Për vitin 2018, nga auditimi i procedurës së prokurimit ñBlerje mobilje zyre", me fond limit **2,073,267** lekë, rezultoi se me qëllim përllogaritjen e fondit limit, AK i është drejtuar 3 OE-ve, pa marrë në konsideratë alternativave të tjera si: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj). Për më tepër kur, bazuar në ekstraktin historik në QKB, një nga 3 subjektet në fjalë , **C. shpk** me NUIS **J.....I**, në fakt **nuk** ka objekt veprimtarie tregtimin e mobilieve, pajisjeve dhe orendive për zyra, por veprimtaria e tij është: *Import eksport të lëndëve të para dhe ndihmëse për industrinë, pajisje elektromekanike, elektronike, goma të të gjitha llojeve etj. Projektim dhe instalimi i pajisjeve të transmetimit (figurë dhe zë) si dhe të pajisjeve të vëzhgimit (kamera). Importimi, tregtimi, riparimi i të gjitha llojeve e pajisjeve të telekomunikacionit si qendrore dhe fundore. Të projektojë e zbatoj të gjitha llojet e rrjetat lokale dhe kombëtare me pajisje telekomunikacioni si qendrore ashtu dhe fundore etj.* Në këto kushte vlera e fondit limit e përllogaritur mbi një bazë të tillë është e pasaktë dhe e pambështetur, duke rrezikuar të ketë pasoja negative në buxhetin e institucionit, për arsye të përllogaritjes së vlerës së fondit më të lartë nga vlera e tregut
Kriteri	Neni 1, 2 dhe neni 20,të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, për Prokurimin Publik, i ndryshuar. Pika 5 e nenit 23 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, për Prokurimin Publik, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Menaxhim pa efektivitet, efiçencë dhe ekonomicitet të fondeve publike.
Rëndësia	I Lartë
Rekomandime	Autoriteti Kontraktor duhet të respektojë procedurën e saktë në përllogaritjen e vlerës së fondit limit, duke ju referuar alternativave të tjera si: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj), dhe jo të mjaftohet me përzgjedhjen e disa ofertave për

	më tepër nga OE, të cilët nuk kanë për objekt ushtrimin e aktivitetit - objekt prokurimi.

Për sa trajtuar më sipër është mbajtur akt konstatimi nr.6, datë 30.04.2021. Lidhur me këtë praktikë është dërguar observacion me Nr. 602/11, date 17.05.2021, ka bërë komente e shpjegime për aktet e konstatimit, të cilat janë trajtuar plotësisht në projekt raportin e dërguar në subjekt me shkresën nr. 157/19, datë 14.09.2021.

e. Auditimi i llogarive vjetore të institucionit, etj.

Në zbatim të Programit të auditimit pranë KMSHC, me nr. Prot. 157/1, datë 26.01.2021, drejtimi 3 ñÇështjet e auditimit financiarò, pika e: ñAuditim i llogarive vjetore të institucionitò, nga auditimi rezultoi se:

- Pasqyrat financiare nga viti 2017-2020.
- Akt-rakordimet për çdo vit, Vendime, Urdhra të Brendshëm.
- Ditarët vjetorë nga viti 2017-2020.
- Borderotë e pagës nga viti 2017-2021.

1. Mbi auditimin e bilancit kontabël dhe plotësimit të pasqyrave financiare përkatëse

Në KMSHC mbajtja e kontabilitetit për periudhën 2017-shkurt 2021, është bërë në bazë të ligjit Nr. 25/2018 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò. Ndërsa struktura, funksionimi dhe mbyllja e llogarive vjetore është bërë në bazë të VKM dhe udhëzimeve të MFE për mbylljen e llogarive për periudhën 2017-shkurt 2021.

Konstatohet se Pasqyrat Financiare të KMSHC janë dërguar për çdo vit në Degën e Thesarit Tiranë, në përputhje me pikën 117 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8. datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisje së përgjithshmeò.

Pasqyrat financiare të KMSHC përmbajnë të gjitha pasqyrat që përcaktohen në pikën 25 dhe 26 të Udhëzimit të MFE nr.8. datë 09.03.2018, konkretisht nga:

- Pasqyra e pozicionit financiar;
- Pasqyra e performancës financiare;
- Pasqyra e flukseve monetare;
- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
- Shënimet shpjeguese, si dhe pasqyrat statistikore;
- Pasqyrat e investimeve dhe burimit të financimit të tyre;
- Pasqyrat mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto;
- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Pasqyrat financiare vjetore të KMSHC për vitet 2018-2020 kanë ndryshuar format në bazë të Udhëzimit të MFE dhe përbëhen nga:

1. Formati 1- Pasqyra e pozicionit financiar;
2. Formati 2- Pasqyra e performancy s financiare ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve;
3. Formati 3- Pasqyra e flukseve monetare;
4. Formati 4- Pasqyra e ndryshimeve ny aktivet neto/ fondet neto;
5. Formati 5- Shy nimet shpjeguese py r hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.
6. Formati 6- Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre;
7. Formati 7- Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto.
8. Formati 8- Pasqyra e numrit të punonjy sve dhe fondi i pagave.

KMSHC ka përfshirë në pasqyrat financiare të dorëzuara *shënimet shpjeguese* sipas formatit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ty emyrtuara *"Pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore"*, i cili përbëhet nga 19 pyetje, që mbulojnë elementë të ndryshëm të raportimit financiar të njësive.

Sipas Udhëzimit nr. 8. datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshmeò Kreu 3.7 ñ*Rregullat për dhënien e shënimeve shpjeguese për pasqyrat financiare individuale"* janë plotësuar për vitin 2018 dhe 2019. Ndërsa për vitin 2017 për shkak se kanë format tjetër nuk janë plotësuar fare *shënimet shpjeguese* në Pasqyrat Financiare viti 2017.

Akt-rakordimet për vitet 2017-2020 janë të dokumentuara dhe të firmosura nga palët përgjegjëse: Ollga Hodaj (Drejtor Finance në KMSHC) dhe Ariana Kruja (për Drejtorinë e Buxhetit).

Gjatë auditimit në KMSHC, krahasuam Akt-rakordimet e secilit vit me Pasqyrën e flukseve monetare (Cash-Flow). Sipas akt-rakordimit, të mbajtur me datë 26.01.2018 për rakordimin e planit të buxhetit me ndryshimet e buxhetit për vitin 2017 për Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për periudhën 01.01.2017- 31.12.2017 midis përfaqësuesit të këtij institucioni Znj. O. H. dhe specialistes së Drejtorisë së Menaxhimit të Buxhetit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë Znj. A. K., na rezulton se totali i akt rakordimit është 52,191,000 lekë. Ndërsa në Pasqyrën e Lëvizjes në Cash (Cash Flow) të vitit 2017, konstatuam se Fondet Buxhetore Korente janë 52,191,000 lekë. Pra përputhen si vlerë me totalin e akt-rakordimit.

Sipas akt-rakordimit, të mbajtur në datë 20.01.2019 për rakordimin e planit të buxhetit me ndryshimet e buxhetit për vitin 2018 për Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për periudhën 01.01.2018- 31.12.2018 midis përfaqësuesit të këtij institucioni Znj. O. H. dhe specialistes së Drejtorisë së Menaxhimit të Buxhetit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë Znj. A. K., na rezulton se totali i aktrakordimit është 53,720,000 lekë. Ndërsa në Pasqyrën e Flukseve Monetare (Cash-Flow) të vitit 2018, konstatuam se Fondet Buxhetore për shpenzime Korente janë 53,720,000 lekë. Pra përputhen si vlerë me totalin e akt-rakordimit.

Sipas akt-rakordimit, të mbajtur me datë 20.01.2020 për rakordimin e planit të buxhetit me ndryshimet e buxhetit për vitin 2019 për Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për periudhën 01.01.2019- 31.12.2019 midis përfaqësuesit të këtij institucioni Znj. O. H. dhe specialistes së Drejtorisë së Menaxhimit të Buxhetit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë Znj. A. K., na rezulton se totali i aktrakordimit është 55,386,000 lekë. Ndërsa në Pasqyrën e Flukseve Monetare (Cash-Flow) të vitit 2019, konstatuam se Fondet Buxhetore për shpenzime Korente janë 55,386,000 lekë. Pra përputhen si vlerë me totalin e akt-rakordimit.

Sipas akt-rakordimit, të mbajtur me datë 25.01.2021 për rakordimin e planit të buxhetit me ndryshimet e buxhetit për vitin 2020 për Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për periudhën 01.01.2020- 31.12.2020 midis përfaqësuesit të këtij institucioni Znj. O. H. dhe specialistes së Drejtorisë së Menaxhimit të Buxhetit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë Znj. A. K., na rezulton se totali i aktrakordimit është 54,566,000 lekë. Ndërsa në Pasqyrën e Flukseve Monetare (Cash-Flow) të vitit 2020, konstatuam se Fondet Buxhetore për shpenzime Korente janë 54,566,000 lekë. Pra përputhen si vlerë me totalin e akt-rakordimit.

Në mijë lekë

	2017	**2018**	**2019**	**2020**
Akt-rakordimet	52,191	53,720	55,386	54,566
Cash Flow (Fondet Buxhetore për shpenzime Korente)	52,191	53,720	55,386	54,566

Burimi: KMSHC, Përpunuar nga grupi i auditimit.

2. Auditimi i llogarive të ardhurave dhe shpenzimeve.

Prej vitit 2018, formati i raportimit të pasqyrave financiare ka pësuar një ndryshim në renditje, konform udhëzimeve të nxjerra nga MFE. Kështu nëse në vitin 2017 pasqyra e shpenzimeve mban nr. 3/1, prej vitit 2018, 2019 dhe 2020 kjo pasqyrë mban nr. 2 dhe përfshin si të ardhurat edhe të shpenzimet e vitit ushtrimor, të renditura njëra pas tjetrës. Formatet e miratuara që shoqërojnë llogarinë vjetore të aparatit të vitit 2018, janë plotësuar si më poshtë: Për vitin 2018 Formati 2 ñPasqyra e performancës financiareò është plotësuar si më poshtë: Llogaritë e seksionit A ñTë ardhuratò për vitin 2018 paraqiten në shumën 50.084.164 lekë dhe përbëhet nga këto poste:

Nga auditimi rezultoi se, të ardhurat paraqiten thuajse në të njëjtat nivele, për të gjitha vitet objekt auditimi konkretisht: për vitin 2017 rezultojnë në shumën 51,075,664 lekë, për vitin 2018, të ardhurat janë 50,084,164 lekë, për vitin 2019 - 54,936,415 lekë dhe për vitin 2020 - 54,782,308 lekë. Trendi i shpenzimeve po njëlloj me një rritje të lehtë si vijon: shpenzimet për vitin 2017 rezultuan 51,075,664 lekë, për vitin 2018- 49,946,276 lekë, për vitin 2019- 55,078,682 lekë dhe vitin 2020- 55,117,422 lekë.

Seksioni B ñShpenzimetò paraqiten në shumën 51,680,459 lekë në vitin 2017, në vlerën 49,946,276 lekë në vitin 2018, në vlerën 55,078,682 lekë në vitin 2019 dhe në vlerën 55,117,422 lekë në vitin 2020, të cilat janë analizuar si më poshtë:

Llogaria 600 ñPagat dhe përfitimet e punonjësveò të mara nga dokumentat justifikuese sipas detyrimeve të konstatuara dhe listë-pagesat e ekzekutuara, ndihma ekonomike dhe shpërblimet e dhëna gjatë vitit ushtrimor 2017 rezulton të jenë në vlerën 32,982,731 lekë. Kjo vlerë paraqet shpenzimet për pagat e punonjësve për vitin 2017. Për vitin 2018 këto shpenzime janë në vlerën 34,135,190 lekë, ndërsa në vitin 2019 janë 35,312,489 lekë. Pra konstatojmë se këto shpenzime kanë pësuar një rritje në vitet në vazhdim. Ndërsa në vitin 2020, llogaria 600 rezulton me një ulje të lehtë, duke arritur në vlerën 35,078,632 lekë.

Llogaria 601 ñKontribute të Sigurimeve Shoqëroreò është në vlerën 5,269,989 lekë, që paraqet shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pra pjesa e paguar nga punëdhënësi. Për vitin 2018, ky zë i shpenzimeve ka arritur në vlerën 5,420,195 lekë, për vitin 2019 në vlerën 5,714,016 lekë, ndërsa në vitin 2020 në vlerën 5,713,216 lekë.

Llogaria 602 ñBlerje mallra e shërbime për 12,608,893 lekë paraqet shpenzimet e KMSHC-s për nevojat funksionale të veprimtarisë së saj. Për vitin 2018, ky zë i shpenzimeve ka arritur në vlerën 10,081,717 lekë, për vitin 2019 në vlerën 13,475,761 lekë, ndërsa në vitin 2020 në vlerën 13,583,720 lekë.

Llogaria 6020 ñMateriale dhe shërbime zyre të përgjithshmeò për 11,167,255 lekë e cila nga vetë emërtimi paraqet shpenzimet që institucioni ka kryer për blerje dhe kancelari etj gjatë vitit 2017. Për vitin 2018, ky zë i shpenzimeve ka arritur në vlerën 427,174 lekë, për vitin 2019 në vlerën 351,320 lekë, ndërsa në vitin 2020 në vlerën 577,684 lekë.

Llogaria 6021 ñMateriale dhe shërbime specialeò për 177,000 lekë e cila paraqet shpenzimet që institucionet kanë kryer për blerje dhe kancelari etj gjatë vitit 2018, ndërsa për vitin 2017 janë zero lekë. Për vitin 2019 konstatojmë se shpenzimet që institucionet kanë kryer për blerje dhe kancelari gjatë vitit janë në vlerën 30,000 lekë, ndërsa në vitin 2020 janë në vlerën 90,000 lekë.

Llogaria 6022 ñShërbime nga të tretëtò për shumën 0 lekë për vitin 2017 përfaqëson shpenzimet që institucionet tona kryejnë realizuar me shërbime nga të tretët energji elektrike, ujë, postë, komunikim si dhe ruajtje objektesh me roje civile. Për vitin 2018, ky zë i shpenzimeve ka arritur në vlerën 1,677,944 lekë, për vitin 2019 në vlerën 1,797,800 lekë, ndërsa në vitin 2020 në vlerën 1,140,283 lekë.

Llogaria 6023 ñShërbime transportiò për shumën zero lekë për vitin 2017 përfaqësojnë shpenzime për automjetet e institucioneve si naftë, vaj, pjesë këmbimi etj, që sipas konstatimit tonë rezulton që nuk ka pasur asnjë shpenzim për këtë zë shpenzimesh. Për vitin

2018, llogaria 6023 ka arritur në vlerën 632,626 lekë, në vitin 2019 në vlerën 31,184 lekë, ndërsa në vitin 2020 në vlerën 204,246 lekë.

Llogaria 6024 ñShpenzime udhëtimiò për shumën 0 lekë për vitin 2017 përfaqësojnë shpenzimet që të gjithë institucionet e varësisë kryejnë për pagesën e dietave të punonjësve të tyre që largohen me punë jashtë vendbanimit të tyre, Pra konstaton që për këtë zë nuk është bërë asnjë shpenzim. Për vitin 2018, ky zë i shpenzimeve ka arritur në vlerën 4,874,635 lekë, në vitin 2019 në vlerën 5,698,525 lekë, ndërsa në vitin 2020 në vlerën 71,160 lekë.

Llogaria 6025 ñMirëmbajtje të zakonshmeò për shumën 0 lekë për vitin 2017 janë shpenzimet që janë bërë për mirëmbajtje dhe riparime të zakonshme të AQT-ve të tyre. Për vitin 2018, ky zë i shpenzimeve ka arritur në vlerën 450,206 lekë, për vitin 2019 në vlerën 143,314 lekë, ndërsa në vitin 2020 në vlerën 211,740 lekë.

Llogaria 6027 ñDetyrime për kompesime legaleò për shumën 1,441,638 lekë për vitin 2017 paraqet shpenzimet që institucioni ka kryer për vendimet gjyqësore të ekzekutuara gjatë vitit për punonjësit e larguar nga puna. Për vitin 2018, ky zë i shpenzimeve ka arritur në vlerën 567,451 lekë, për vitin 2019 në vlerën 3,434,798 lekë, ndërsa në vitin 2020 në vlerën 8,175,496 lekë.

Llogaria 6029 ñShpenzime të tjera Operativeò për shumën 0 lekë për vitin 2017, e cila përfaqëson shpenzime të tjera që nuk janë përfshirë në zërat e sipërpërmendur sipas kritereve të klasifikimit buxhetor. Për vitin 2018, ky zë i shpenzimeve ka arritur në vlerën 1,274,681 lekë, për vitin 2019 në vlerën 1,988,820 lekë, ndërsa në vitin 2020 në vlerën 3,113,111 lekë.

Në Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve të vitit 2017 në nxjerrjen e rezultatit financiar është përfshirë efekti i ndryshimit të gjendjeve inventariale pasqyruar në llog. 63 në vlerën 404,795 lekë duke ndikuar në rritjen e të shpenzimeve të vitit 2018. Për vitin 2018 KMSHC sipas pasqyrave financiare rezulton me rezultat debitor në vlerën -137,888 lekë. Sipas kësaj pasqyre, për vitin e mëparshëm 2017 rezultati i periudhës është 24,845,137 lekë, ndërsa sipas pasqyrave financiare të vitit 2018 kjo rezulton 25,460,747 lekë. Nga grupi i auditimit u përmblodhën të dhënat e mëposhtme në lidhje me rezultatin e veprimtarisë gjatë vitit ushtrimor 2017 dhe 2018.

Në Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve të vitit 2019 në nxjerrjen e rezultatit financiar është përfshirë efekti i ndryshimit të gjendjeve inventariale pasqyruar në llog. 63 në vlerën 130,009 lekë duke ndikuar në rritjen e të shpenzimeve të vitit 2018. Për vitin 2020 KMSHC sipas pasqyrave financiare, llogaria 63 rezulton në vlerën 335,114 lekë. Sipas kësaj pasqyre, për vitin e mëparshëm 2019 rezultati i periudhës është 87,074,593 lekë, ndërsa sipas pasqyrave financiare të vitit 2020 kjo rezulton 80,337,287 lekë. Nga grupi i auditimit u përmblodhën të dhënat e mëposhtme në lidhje me rezultatin e veprimtarisë gjatë vitit ushtrimor 2019 dhe 2020.

Tabelë: *"Rezultati i veprimtarisë për vitin 2017-2020".* ***në lekë***

	Viti 2017 (PF_{2017})	**Viti 2018 (PF_{2018})**	**Viti 2019 (PF_{2019})**	**Viti 2020 (PF_{2020})**
Shpenzimet	51,680,459	49,946,276	55,078,682	55,117,422
Të ardhurat	51,075,664	50,084,164	54,936,415	54,782,308
Rezultati i veprimtarisë	-604,798	137,888	-142,267	-335,114

Burimi: KMSHC, Përpunuar nga grupi i auditimit.

3. Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur dhe kontabilizuar saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Nga auditimi u konstatua se: Bilanci i vitit 2017 i KMSHC është dorëzuar në Degën e Thesarit Tiranë me shkresën nr. 292 prot, datë 28.02.2018, të vulosur dhe nënshkruar nga

Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, pra brenda afateve ligjore. Bilanci i vitit 2018 i KMSHC është dorëzuar në Degën e Thesarit Tiranë me shkresën nr. 378 prot, datë 26.03.2019, të vulosur dhe nënshkruar nga Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, pra brenda afateve ligjore. Bilanci i vitit 2019 i KMSHC është dorëzuar në Degën e Thesarit Tiranë me shkresën nr. 322 prot, datë 18.05.2020, të vulosur dhe nënshkruar nga Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, pra brenda afateve ligjore, pasi afati i dorëzimit të pasqyrave financiare të vitit 2019 ishte shtyrë deri në datën 30.07.2020**.** Bilanci i vitit 2020 i KMSHC është dorëzuar në Degën e Thesarit Tiranë me shkresën nr. 417 prot, datë 18.03.2021, të vulosur dhe nënshkruar nga Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, pra brenda afateve ligjore. Veprimet kontabël janë kryer konform dispozitave ligjore në fuqi, ku çdo regjistrim është bërë në bazë të dokumenteve justifikuese, si dhe janë zbatuar parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Të gjitha veprimet regjistrohen në librat kontabël në mënyrë sistematike dhe kronologjike të marra nga dokumentet bazë. Nga auditimi me zgjedhje rezultoi se dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi. Sistemi i kontabilitetit në këtë institucion është mbajtur në programin financiar Alpha Web, gjë e cila konsiston në sigurinë e regjistrimeve të rregullta të veprimeve kontabël. Nga verifikimi i llogarive të bilancit rezulton se llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me pasqyrat financiare dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike.
Bilanci Kontabël për grupet e llogarive të Aktivit gjendje më 31.12.2017, 31.12.2018, 31.12.19 dhe 31.12.2020, paraqiten si më poshtë:

Grupet	Emërtimi	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
A.	Aktive Afatshkurtra	8,521,971	6,963,394	6,821,128	6,770,119
B.	Aktive Afatgjata	16,938,776	17,881,743	80,253,465	73,567,168
Totali		25,460,747	24,845,137	87,074,593	80,337,287

Burimi: KMSHC, Përpunuar nga grupi i auditimit.

Aktivet afatgjata materiale të vitit 2018 (Llogaria 21) janë në vlerën 17,881,743 lekë nga 16,938,776 lekë që ishin një vit më parë (ose 943 mijë lekë me shumë nga viti i mëparshëm), që ka ardhur si rezultat i pasqyrimit të blerjeve të aktiveve të reja në këtë vit. Ndërsa në vitin 2020, llogaria 21 rezultoi në vlerën 73,567,168 lekë, nga 80,253,465 lekë që ishte në vitin 2019 (ose 6,686 mijë lekë më pak nga viti i mëparshëm).
Përgjatë periudhës se auditimit, aplikimit të normave të Amortizimit bazuar në Udhëzimin Nr 8 datë 09.03.2018 ñPër Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò ñ- Për aktivet afatgjata, materiale si: ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur; - Kompjuterët, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softe e sisteme informacioni të amortizohen mbi bazë grupimi me normën 25%; - Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi; dhe - Për aktivet afatgjata jo materiale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%.ò. Zëri i amortizimit të Aktiveve të Qëndrueshme krahasuar në vite ka pësuar rritje, konstatohet se amortizimi është llogaritur sipas normave të miratuara.
- Nga auditimi rezultoi se, vlera e Aktiveve qarkulluese më 31.12.2018 rezultoi 3,671,975 lekë, nga 3,534,087 lekë që paraqitej një vit më parë (ose me rritje prej 137 mijë lekë); ndërsa më 31.12.2018, vlera e këtij zëri paraqitet 3,541,967 lekë dhe më 31.12.2020 3,206,853 lekë (ose 335 mijë lekë më pak se në vitin 2019), diferencë kjo vjen për arsye se janë nxjerrë

jashtë përdorimi aktive sipas Urdhrit të brendshëm të KMSHC nr 54 datë 07.10.2020 ñPër ngritjen e Komisionit për vlerësimin e aktiveve për vitin 2020.ò

Nga verifikimi me zgjedhje i llogarive debitore rezultoi se: evidentimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konform rregullave. Lidhur me rakordimin dhe kuadrimin e 0tyre si për llogarinë sintetike dhe ato analitike na u vu në dispozicion dokumentacioni kontabël për të shqyrtuar vërtetësinë e tyre për periudhën e auditimit. Bilanci Kontabël për grupet e llogarive të Pasivit përgjatë viteve 2017-2020, paraqitet si më poshtë:

Tabela: ñPasivi i bilancit të KMSHCò. ***Në lekë***

Grupet	Emërtimi	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
A.	Pasive Afatshkurtra	4,987,884	3,291,419	3,279,161	3,563,266
B.	Pasive Afatgjata	0	0	0	0
Totali		4,987,884	3,291,419	3,279,161	3,563,266

Burimi: KMSHC, Përpunuar nga grupi i auditimit

Llogaria 4342 ñOperacione me shtetin (të drejta)ò është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Në vitin 2017, Llogaria 4342 ñOperacione me shtetin (të drejta)ò janë në vlerën 4,944,261 lekë. Në vitin 2018, llogaria 4342 është në vlerën 3,247,796 lekë. Në vitin 2019, llogaria 4342 është në vlerën 3,235,538 lekë. Ndërsa në vitin 2020, llogaria 4342 në vlerën 3,519,643 lekë. Raste specifike te tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm. Posti òDetyrimeò përbëhet vetëm nga detyrimet afatshkurtra të cilat arrijnë në vlerën 4,987,884 lekë për vitin 2017, në vlerën 3,291,419 lekë në vitin 2018, në vlerën 3,279,161 lekë në vitin 2019, në vlerën 3,563,266 lekë në vitin 2020. Për vitin 2017, detyrimet afatshkurtra përbëhen nga llogaria 42 ñPersoneli e llogari të lidhura me toò në vlerën 2,168,978 lekë, nga llogaria 431 ñDetyrim ndaj shtetit për tatim-taksaò në vlerën 243,750 lekë, nga llogaria 4341 ñTë tjera operacione me shtetinò në vlerën 43,623 lekë, nga llogaria 435 ñSigurime shoqëroreò në vlerën 739,699 lekë, nga llogaria 436 ñSigurime shëndetësoreò në vlerën 95,235 lekë dhe nga llogaria 467 ñKreditorë të ndryshëmò në vlerën 1,696,599 lekë. Në vitin 2018, pasivet afatshkurtra përbëhen nga llogaria 42 ñDetyrime ndaj personelitò me vlerë 2,178,042 lekë, nga llogaria 431 ñDetyrime ndaj shtetit për tatim taksaò në vlerën 240,801 lekë, nga llogaria 435 ñSigurime shoqëroreò në vlerën 733,623 lekë, nga llogaria 436 ñSigurime shëndetësoreò në vlerën 95,330 lekë, nga llogaria 4341 ñOperacione me shtetinò në vlerën 43,623 lekë. Edhe në vitin 2019 dhe 2020 të njëjtat llogari janë prekur.

Llogaria 467 ñKreditor të ndryshëmò në vitin 2017 janë në shumën 1,696,599 lekë. Në vitin 2018, 2019, 2020, llogaria 467 është zero. Këto përfaqësojnë detyrimet ndaj furnitorëve, të cilat momentalisht janë të gjitha të likuiduara.

17.Titulli i Gjetjes	**Mospërputhje e vlesës së llogarisë 60274 "Shpenzime për ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësore" në Realizimin e Buxhetit për vitin 2017 me vlerën në Pasqyrën Financiare të Ardhura Shpenzime (PASH-i).**
Situata:	Nga auditimi rezultoi se, referuar treguesve të realizimit të buxhetit për vitin 2017 vlera e llogarisë 60274 ñShpenzime për ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësoreò, rezultoi të jetë 3,094,000 lekë; Ndërkohë në Pasqyrën Financiare të Ardhura-Shpenzime kjo llogari është paraqitet në vlerën 1,441,638 lekë (ose rreth 1,652 mijë lekë më pak nga sa deklaruar në buxhet). Gjithashtu referuar treguesve të realizimit të buxhetit për vitin 2018 vlera e llogarisë 60274

	shpenzime për ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësore, është 2,264,050 lekë; Ndërkohë në Pasqyrën Financiare të Ardhura-Shpenzime kjo llogari paraqitet në vlerën 567,451 lekë (ose 1,697 mijë lekë më pak nga sa deklaruar në buxhet).
Kriteri:	Në zbatim të Udhëzimit të MFE nr. 8 datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshmeò.
Ndikimi/Efekti:	Gabim në paraqitjen e llogarisë 60274 ñShpenzime për ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësoreò.
Shkaku:	Gabim në hedhjen e të dhënave në PASH
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	KMSHC të marr masa për ngritjen e një grupi pune me qëllim analizimin e shkaqeve të mosrakordmit të këtyre shifrave dhe vlerësimin e impaktit që ka sjellë kjo mospërputhje në zërat kontabël të mbartur në pasqyrat financiare (më konkretisht në çeljet e viteve pasardhës). Sektori i Financës të marr masa të bëjë sistemimet e nevojshme ne kontabilitet në lidhje me reflektimin e kësaj vlerë.

DREJTIMI 4: TË TJERA NGA AUDITIMI

Me shkresën nr. 602/11, datë 17.05.2021, protokolluar me tonën me nr. 157/18, DATË 19.05.2021 në KLSH kanë ardhur observacionet e subjektit KMSHC, në faqet e para të të cilit, trajtohen disa çështje të përgjithshme mbi auditimin (dhe jo referuar drejtimeve specifike të programit të auditimit nr. 157/1, datë 26.01.2021. Për sa më sipër, u gjykua që kjo pjesë e observimeve të subjektit të trajtohet si çështje më vete në këtë raport.

Pretendimi i subjektit: *Në vijim të komunikimit zyrtar, institucional, që ka nisur për shkak të auditimit që Kontrolli i Lartë i Shtetit është duke ushtruar pranë institucionit të Komisionerit, si edhe të nevojës që ka lindur për të diskutuar disa aspekte specifike që kanë të bëjnë me sqarimin e fushës së veprimit të dy institucioneve tona, fillimisht dëshiroj të shpreh keqardhjen për faktin se nuk i është dhënë asnjë përgjigje shqetësimeve të ngritura nga Komisioneri, të cilat kanë të bëjnë me unifikimin e praktikave të kontrollit nga ana e institucioneve që ne drejtojmë, të materializuara në përmbajtjen e disa shkresave që i janë dërguar institucionit të KLSH-së. Nisur nga përmbajtja e disa prej akteve të konstatimit që janë vënë në dispozicion të Komisionerit, nga ana e grupit të auditimit, sidomos të akt-konstatimit nr. 1, datë 30.04.2021, duket qartë se nuk është kuptuar drejt fusha e veprimit dhe mënyra e funksionimit të institucionit të audituar dhe për pasojë nuk është bërë e mundur nga ana e audituesve, ndarja e kompetencave lëndore të kontrollit të ligjshmërisë që ushtrohet nga Komisioneri dhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Problemi qëndron që në fillim të procesit të kontrollit, kur në programin e auditimit ka një përcaktim* kontradiktor *midis objektivave dhe qëllimit të auditimit. Në hyrje të programit të auditimit, nën titullin objektivat e auditimit, përcaktohet: "Dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit me kuadrin rregullator në fuqi, në lidhje me mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil". Në vijim të programit të auditimit, parashikohet qëllimi i auditimit: "Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. "Në këtë moment kemi të bëjmë me dy aspekte që duhet të diskutohen. Së pari, objektivat dhe qëllimi i auditimit, janë aspekte që duhet të kenë lidhje midis tyre; duhet të flasin për të njëjtën fushë veprimi; për të njëjtin subjekt kontrolli dhe duhet të vijnë si rrjedhë logjike e njëri-tjetrit. Në rastin konkret nuk ka ndodhur kështu. Si objektiv auditimi është*

parashikuar dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit në lidhje me procesin e mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, që ka të bëjë me kontrollin e veprimeve administrative që kryejnë subjektet që përfshihen në sistemin e shërbimit civil, që janë institucionet e pavarura, institucionet e administratës vendore dhe institucionet e administratës shtetërore, sipas kërkesave dhe procedurave ligjore që parashikohen në institute të veçanta të ligjit të posaçëm nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, ndërsa qëllimi i auditimit, duket qartë që ka lidhje me vlerësimin e aspektit të zbatimit të ligjeve specifike, që kanë lidhje me një fushë tjetër veprimi, që në këtë rast është aktiviteti, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara nga ana e një subjekti konkret, që është Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Kjo do të thotë që është objektivisht e pamundur që të arrihet në konkluzione të qarta dhe të sakta nga grupi i auditimit, kur subjektet e kontrollit nuk janë të njëjtë dhe kur nuk lidhet fusha e kontrollit (objekti i auditimit) me subjektin e auditimit. Së dyti, ashtu siç e kemi sqaruar edhe më parë, në shkresat që ju kemi dërguar, Komisioneri vlerëson se grupi i auditimit është duke kontrolluar ushtrimin e kompetencave të institucionit të Komisionerit, në drejtim të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil, ndërkohë që kjo fushë nuk përfshihet në kompetencat lëndore të institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Po kështu, grupi i auditimit, për shkak të fushës së specializuar të kontrollit dhe përshkrimit të tij të punës, nuk i ka njohuritë e nevojshme për të vlerësuar objektivisht nëse janë respektuar kërkesat procedurale; janë evidentuar problematikat; janë propozuar zgjidhjet e drejta dhe të duhura ligjore; është dhënë asistenca e duhur teknike; janë respektuar standardet më të mira në administrimin e shërbimit civil nga njësitë përgjegjëse apo në drejtim të mbikëqyrjes; apo kontributin e veprimtarisë së Komisionerit në drejtim të rregullimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, ç`ka janë përpjekur të bëjnë anëtarët e grupit të auditimit deri në këtë fazë të kontrollit, duke sjellë për pasojë një perceptim dhe interpretim jo të drejtë të problematikave dhe ligjit dhe të veprimeve juridike administrative të Komisionerit në fushën e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit për administrimin e shërbimit civil, që janë analizuar nga ana e tyre në akt-kontrolle, ashtu si do të evidentohet në vijim të paraqitjes së observacioneve. Ligjvënësi ka ngritur një institucion të posaçëm, për të vlerësuar nivelin e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil dhe për të raportuar për situatën e evidentuar në këtë fushë, që është Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nëpërmjet ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, duke rregulluar edhe veprimtarinë e tij në këtë mënyrë: Ligji nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, ka përcaktuar qartësisht objektin dhe qëllimin e tij në dy dispozitat e para (neni 1 dhe 2, i ligjit), ku parashikohet shprehimisht: "Qëllimi dhe objekti 1. Ky ligj ka për qëllim krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike. 2. Ligji rregullon marrëdhënien juridike ndërmjet shtetit dhe nëpunësit civil (në vazhdim "marrëdhënia e shërbimit civil") dhe përcakton rregullat për administrimin e shërbimit civil. Marrëdhënia e shërbimit civil është marrëdhënie juridike e natyrës administrative". "Fusha e veprimit (Shtuar shkronjat "h", "i", "j", "k" dhe "l" me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014) Ky ligj zbatohet për çdo nëpunës (në vazhdim "nëpunës civil"), që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore, ...Nëpërmjet këtij ligji janë ngritur: ***1)*** *mekanizmat e ngarkuara me detyra specifike për administrimin e shërbimit civil, që janë njësitë përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore dhe Departamenti i Administratës Publike për administratën shtetërore, si edhe 2) organi i specializuar, i cili do të kontrollojë zbatimin e këtyre rregullave në të gjithë sistemin e shërbimit civil, që është Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Konkretisht, kompetencat lëndore dhe mjetet me të cilat ushtron autoritetin e tij Komisioneri, janë të parashikuara në dispozitat që nisin me nenin 11 deri në nenin 16 të*

ligjit në fjalë. Në pikën 1, të nenit 11 të këtij ligji, Komisioneri parashikohet me tiparet e një institucioni të pavarur të kontrollit të jashtëm, të specializuar në fushën e administrimit të shërbimit civil, kur përkufizohet si person juridik publik, i pavarur, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil. Më tej, në nenin 14, parashikohen edhe kompetencat lëndore të Komisionerit, mbi bazën e të cilave funksionon ky institucion:"1. Komisioneri mbikëqyr, kryesisht ose me kërkesë të institucioneve, zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë. 2. Në ushtrimin e kompetencave, Komisioneri: a) kryen hetim të plotë administrativ, sipas Kodit të Procedurave Administrative; b) kërkon dhe merr nga institucionet çdo informacion të nevojshëm për kryerjen e detyrave të tij; c) inspekton dosjet dhe çdo dokument, lidhur me administrimin e shërbimit civil; ç) kërkon, kryesisht apo me kërkesë, dëshmi të çdo nëpunësi apo funksionari të institucionit; d) këqyr dhe inspekton çdo praktikë administrimi në çdo institucion që punëson nëpunës civilë. 3. Institucionet që punësojnë nëpunës civilë, si dhe çdo funksionar publik ose nëpunës civil, që kanë kompetenca në administrimin e shërbimit civil, apo kanë informacion në këtë fushë, kanë detyrimin të bashkëpunojnë me Komisionerin. "Në nenin 15, materializohen edhe a) aktet administrative me të cilat e ushtron në praktikë veprimtarinë e tij Komisioneri (vendim paralajmërues dhe vendim gjobe); b) mjetet për të rivendosur ligjshmërinë, nëpërmjet gjobitjes së personave përgjegjës që nuk zbatojnë detyrat e lëna; si edhe c) organin kompetent që vlerëson vendimet e Komisionerit për personat përgjegjës që nuk kanë zbatuar detyrat e lëna, që në këtë rast i shqyrton vetëm gjykata: "1. Nëse gjatë mbikëqyrjes, Komisioneri çmon se ka shkelje të ligjit në administrimin e shërbimit civil, me vendim me shkrim, paralajmëron institucionin përkatës, duke i lënë detyrat për përmirësimin e situatës dhe duke përcaktuar një afat të arsyeshëm për zbatimin e tyre. 2. Në rast të moszbatimit të vendimit të dhënë, sipas pikës 1 të këtij neni, Komisioneri mund të gjobisë nëpunësin përgjegjës për moszbatimin e masave. Masa e gjobës është nga 20 për qind deri në 30 për qind të pagës mujore të nëpunësit përgjegjës. Në rast të moszbatimit të mëtejshëm të vendimit, Komisioneri mund të vendosë një gjobë tjetër deri në 50 për qind të pagës mujore të personit përgjegjës. 3. Vendimi për dhënien e gjobës mund të ankimohet në gjykatën kompetente për mosmarrëveshjet administrative. "Pra, në këtë rast, nisur nga specifikat e administrimit të shërbimit civil, ligjvënësi i ka dhënë të drejtë Komisionerit që të paralajmërojë institucionin dhe të vendosë një afat të arsyeshëm (të pa përcaktuar shprehimisht në ligj) dhe vetëm pas përfundimit të këtij afati, mund të jepet vendimi për dhënien e gjobës. Në nenin 16, parashikohet edhe procedura e mbledhjes së gjobave: "Vendimi i gjobës ekzekutohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative". Në drejtim të saktësimit të fushës së veprimit institucional, Komisioneri ka analizuar edhe bazën ligjore mbi të cilën funksionon institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit, që është Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ligji organik dhe rregulloret e manualet që disiplinojnë veprimtarinë e tij. Në pjesën 14, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 162 parashikohen kompetencat e këtij institucioni:"1. Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar. Ai u nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. 2. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit zgjidhet dhe shkarkohet nga Kuvendi me propozim të Presidentit të Republikës. Ai qëndron në detyrë për 7 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje "Më tej, në nenin 163, parashikohet fusha e veprimit për kontrollin e ushtruar nga ky institucion: "Kontrolli i Lartë i Shtetit kontrollon: a) veprimtarinë ekonomike të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridikë shtetërorë; b) përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve shtetërore nga organet e pushtetit qendror dhe atij vendor; c) veprimtarinë ekonomike të personave juridikë, në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e pjesëve ose të aksioneve, ose kur huatë, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti. "Në ligjin organik të institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, ligji nr. 154/2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 2,

"Qëllimi", specifikohen kompetencat ligjore dhe mënyra e funksionimit të tij, duke parashikuar se: "Kontrolli i Lartë i Shtetit, nëpërmjet auditimeve, synon përdorimin me efektivitet, efiçencë dhe ekonomicitet të fondeve publike, pronës publike dhe asaj shtetërore, zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të menaxhimit financiar, kryerjen si duhet të aktiviteteve administrative, si dhe informimin e autoriteteve publike dhe publikut, nëpërmjet publikimit të raporteve të tij."Në nenin 3, "Përkufizime" të ligjit në fjalë, kornizohet procesi i auditimit në disa tipologji të tij, ndër të cilat edhe auditimi i përputhshmërisë (që në rastin konkret është ushtruar pranë DAP dhe DPT):"Në këtë ligj, termat dhe shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime:1. "Auditim" nënkupton veprimtarinë e auditimit, të kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, i cili përfshin auditimin e përputhshmërisë, auditimin financiar, auditimin e performancës, auditimin e IT-së, si dhe auditimin e kombinuar të tyre. Në këtë ligj termi "auditim" ka të njëjtin kuptim me termin "kontroll" të përdorur në nenet 162, pika 1, 163 dhe 164, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës.

... 5. "Auditim i përputhshmërisë" nënkupton dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord. "Ky koncept i auditimit, zhvillohet në vijim të ligjit dhe konkretisht në nenin 12 të tij, ku parashikohet shprehimisht:" Auditimi i përputhshmërisë Në auditimet e përputhshmërisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të përcaktojë: a) nëse të ardhurat dhe shpenzimet kanë qenë në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin; b) nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik. "Auditimi i përputhshmërisë është i trajtuar hollësisht edhe në Rregulloren e Procedurave të Auditimit, miratuar me vendimin nr. 107/2017 të Kryetarit të KLSH, të ndryshuar me vendimin nr. 63/2020.Në nenin 4 të rregullores, janë parashikuar llojet e Projekteve të Auditimit, nga të cilat në vijim po shkëpusim përkufizimin e auditimit të përputhshmërisë: "Auditime të Përputhshmërisë (pajtueshmërisë), të cilat përfshijnë: a. dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kritereve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj. b. njëherësh aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kritereve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik). c. promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre."Të njëjtat parashikime ligjore (neni 12 i ligjit) janë materializuar edhe në manualin e auditimit të përputhshmërisë, pikërisht në Kapitullin I - Auditimi i Përputhshmërisë në Sektorin Publik, në pikën 1.2 "Procesi dhe elementët e auditimit të përputhshmërisë", në nëntitullin: "Objekti dhe natyra e auditimit të përputhshmërisë". Duke vijuar me analizën e përmbajtjes së këtij manuali, në pikën 5 të tij, "Konsiderata rreth mjaftueshmërisë, përkatësisë dhe besueshmërisë së evidencës së auditimit", nën pikën 5.6 "Hartimi i procedurave të auditimit", rezulton se në auditimet e përputhshmërisë, zonat kryesore për të cilat mund të ndërmerren procedura thelbësore auditimi, gjatë testimit të nivelit të përputhshmërisë me ligjet dhe rregullat ndër të tjera evidentohen:"1. Baza Ligjore. Për çdo akt, veprim, transaksion të rëndësishëm dhe procedurë, kërkohet ekzistenca e bazës përkatëse ligjore (Dispozitat ligjore për menaxhimin financiar, Vendime të Këshillit të Ministrave; Urdhra, Udhëzime, Qarkore, Rregullore të

Brendshme; marrëveshje, kontrata specifike veçanërisht në rastet e dhënies së shërbimeve në të tretë përmes marrëveshjeve koncensionare, etj.).2. Procedura përzgjedhjeje. Tek shpenzimet direkte) Përputhshmëria me rregullat sa i takon ftesave për oferta.b) Respektimi i parimeve të proporcionalitetit, paanshmërisë, objektivitetit, transparencës, barazisë së palëve, mos diskriminimit dhe informimit siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi.c) Përmbajtja e kontratave, shtojcat, ndryshimet, amendimet, raportet e vlerësimit, rekomandimet, etj.Tek grantet a) kërkesa për propozime,b) vlerësimi i zbatimit të marrëveshjeve, etj.3. Autorizimet e pagesave.a) Pagesat janë kryer në përputhje me specifikimet e angazhimeve buxhetore respektive (dokumentet justifikuese) dhe paguar brenda afateve të parashikuara me ligj.b) Shuma e pagesës është përllogaritur saktë dhe në përputhje me parashikimet ligjore dhe kontraktuale (p.sh. verifikimi i kostove të deklaruara, kurset e këmbimit të përdorura, etj).c) urdhër pagesat i referohen përfituesit të duhur (emri dhe llogaria bankare).d) Kryerja e pagesave (konferma bankare).4. Përllogaritjet e fondit limit.5. Shpenzimet për pritje përcjellje konform dispozitave.6. Realizimi i numrit të punonjësve sipas planit dhe strukturës organike.7. Krahasimi i gjendjes kontabël me gjendjen fizike të pasurisë.8. Nxjerrjet jashtë përdorimit të aseteve.9. Zbatimi i dispozitave ligjore në dhënien me qira të objekteve. "Nga gjithë sa analizuam me sipër, ku përfshihet Kushtetuta, ligji organik i KLSH-së, Rregullorja dhe Manuali përkatës i auditimit, rezulton se procesi i auditimit të përputhshmërisë ka lidhje me përdorimin e përshtatshëm; në përputhje me ligjin dhe rregullat; efektiv; efiçent dhe me ekonomicitet, të fondeve buxhetore dhe publike dhe çdo aspekt tjetër që ka lidhje me administrimin dhe menaxhimin financiar nga ana e subjektit të audituar. Konstatohet se, parashikimi ligjor i kompetencave të Kontrollit të Lartë të Shtetit nuk është mbajtur parasysh, në kushtet kur, si pikë e veçantë në programin e auditimit është parashikuar: "Zbatimi i detyrave ligjore nga ana e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përputhje me përcaktimet e nenit 11 e vijim të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar", duke tejkaluar në këtë mënyrë kompetencat ligjore në fushën e auditimit. Nga ana tjetër, çdo organ administrativ jep llogari dhe e arsyeton punën e vet dhe ligjshmërinë e veprimeve të tij para një organi tjetër kompetent administrativ, ekzekutiv, ligjvënës ose gjyqësor. Ndjekja e veprimtarisë së Komisionerit, e më tej zbatimi i vendimeve të këtij institucioni është objekt i monitorimit sistematik të Kuvendit, si pjesë e kontrollit parlamentar, që realizohet nëpërmjet Mekanizmit të ngritur me vendimin nr. 49/2017 të Kuvendit "Për monitorimin e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj të veçantë", veprimtaria e të cilit është rregulluar më tej nëpërmjet vendimit nr. 134/2018, datë 20.12.2008 të Kuvendit, "Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik", në të cilin parashikohen mënyrat, afatet dhe përgjegjësitë për subjektet e monitoruara. Veprimtaria e Komisionerit në drejtim të ushtrimit të kompetencave të tij lëndore është e monitoruar, vlerësuar dhe e miratuar për çdo vit nga Komisioni i Ligjeve dhe, më tej, është e miratuar me shumicë votash në Kuvendin e Shqipërisë, nëpërmjet rezolutës së përvitshme, ku konkretisht evidentohet puna e kryer gjatë vitit dhe lihen detyrat përkatëse, për realizimin e të cilave raportohet në vitin pasardhës, 4 herë në vit dhe në mënyrë përfundimtare në fund të vitit, me raportin vjetor të veprimtarisë së institucionit, pasi ky është një detyrim ligjor. Po kështu, janë kryer seanca mbikëqyrjeje në selinë e Komisionerit, nga ana e Komisionit të Ligjeve të Kuvendit, me grup deputetësh të këtij komisioni, ku është diskutuar për proceset e punës dhe për ecurinë e ekzekutimit të vendimeve të Komisionerit. Në përfundim të gjithë kësaj analize, Komisioneri vlerëson se Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil janë dy institucione të pavarura, me kompetenca të veçanta kontrolli në fusha të ndryshme të veprimtarisë shtetërore, të cilat nuk duhet të konkurrojnë me njëra-tjetrën dhe në rast se kjo ndodh, situata duhet të zgjidhet me marrëveshje, apo në rrugë të përcaktuara ligjore. Gjej rastin të theksoj se, Komisioneri është një institucion mbikëqyrës, i cili e ushtron aktivitetin e tij mbi bazën e

ligjit për nëpunësin civil, rregulloreve të miratuara nga Komisioneri, ashtu si e ka parashikuar ligji dhe në bazë të Kodit të Procedurave Administrative, e për këtë arsye, veprimtaria dhe vendimmarrja e tij është objekt si i kontrollit gjyqësor, ashtu edhe i monitorimit/vlerësimit nga Kuvendi.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Në lidhje me pretendimet e mësipërme të subjektit të audituar, ju sjellim në vëmendje se këto çështje janë trajtuar nga grupi i auditimit edhe në takimet që kemi pasur me znj. A. B., e cila na u caktua si person kontakti nga Komisioneri, përgjatë auditimit. Përgjatë diskutimeve tona kemi argumentuar me kujdes pikat e programit si dhe i kemi dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura mbi çështje që lidhen me drejtimet e programit të auditimit, me qëllim përmbushjen me sukses të këtij programi. Në kushtet kur, edhe pas sqarimeve të grupit të auditimit, përgjatë fazës së auditimit në terren (si edhe komunikimeve shkresore të këmbyera me qëllim përmbushjen e drejtimeve të programit të auditimit), KMSHC në observacione e akt-konstatimeve vijon të ngrejë të njëjtën problematikë, grupi i auditimit kërkoi një qëndrim nga Departamenti Juridik i Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili argumenton si vijon:*

KLSH është institucion i pavarur kushtetues, më i larti i kontrollit ekonomik dhe financiar,i ndërtuar që të jetë ñagjentò i Kuvendit dhe palëve të interesit duke i informuar në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë, mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në përdorimin e kontributit të taksapaguesve shqiptarë e duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet luftës kundër korrupsionit. Konceptet e transparencës, llogaridhënies, administrimit dhe mirëqeverisjes në sektorin publik janë parimet bazë të mirëqeverisjes. Përputhshmëria me ligjet, aktet dhe normat është një element thelbësor i qeverisjes. Të gjitha njësitë e sektorit publik si administrues e përdorues të fondeve publike, kanë detyrimin që veprimtaritë e tyre vendimmarrëse dhe zbatuese tí zhvillojnë brenda një kuadri të caktuar ligjor e rregullator. Si institucioni më i lartë audites publik në Shqipëri, KLSH siguron përmbushjen e misionit të tij kushtetues dhe ligjor lidhur me përputhshmërinë e akteve ligjore në fuqi dhe menaxhimin e fondeve publike nëpërmjet kryerjes së auditimeve.
Auditimi i Sektorit Publik është pjesë jetike e një sistemi rregullator, i cili ka për qëllim të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar si edhe shfrytëzimin me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Përdorimi i fondeve publike bazohet në parime, rregulla dhe standarde që të gjitha bashkë përbëjnë kuadrin rregullator. Për shkak të rëndësisë specifike që KLSH posedon si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, kufijtë e aktivitetit institucional të KLSH-së përcaktohen vetëm nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligji organik KLSH-së. Ky parim jo vetëm që është i shprehur në mënyrë eksplicite në nenin 162 të Kushtetutës, por të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata Kushtetuese në Vendimin nr. 19, datë 03.05.2007.Në dispozitivin e këtij vendimi Gjykata Kushtetuese shprehet se: *"Gjykata Kushtetuese konsideron të rëndësishme të ritheksojë se ligjet organike zbërthejnë më tej dhe konkretizojnë më qartë dhe më mirë pavarësinë e organeve dhe institucioneve kushtetuese që garantojnë sipas rastit dispozita të veçanta të Kushtetutës. Kjo pavarësi nuk është thjesht një privilegj i tyre, por një prerogativë e vërtetë dhe e domosdoshme, e cila u jep më shumë siguri, qëndrueshmëri dhe efikasitet organeve dhe institucioneve kushtetuese në ushtrimin e detyrave të tyre. Pavarësia funksionale e organeve dhe institucioneve kushtetuese është e lidhur ngushtësisht me përmbajtjen e veprimtarisë që këto realizojnë, e cila rregullohet drejtpërsëdrejti dhe e ka themelin e vet në dispozitat përkatëse kushtetuese. Në përputhje me detyrat që i ka ngarkuar Kushtetuta, secili prej tyre është i pajisur me pushtet të mjaftueshëm që i jep atij mundësinë të marrë vendime në mënyrë të lirë e të pavarur. Asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve qendrore, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që, sipas rastit, do të përbënin objektin*

qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese." Për rrjedhojë, KLSH auditon në zbatim të programeve vjetore të auditimit, të hartuara e të propozuara në mënyrë të pavarur dhe të miratuara nga Kryetari i KLSH-së. Përcaktimi i planit të auditimeve është në diskrecionin e KLSH-së. Metodologjia e përdorur për përgatitjen e planit të auditimeve është mbi bazë risku, duke i dhënë rëndësi dhe përparësi njësive/subjekteve, fushave dhe veprimtarive të cilat vlerësohen të kenë risk më të lartë. Njëkohësisht, lidhur me kërkesën për dokumentacion shtesë gjatë procesit auditues, ligji i organik i KLSH-së, ka dispozita të qarta përsa i përket eksesit të pakufizuar në informacion dhe dokumentacion tek subjektet e audituara. Koordinimi Juaj i brendshëm me qëllim vënien në dispozicion të këtij informacioni nuk ka rëndësi specifike për procesin, për aq kohë sa dokumentet e nevojshme i vihen në dispozicion grupit të auditimit. Lidhur me pretendimin e parashtruar në shkresën drejtuar KLSH për dublim dhe konkurrim kompetencash, saktësojmë që KLSH në asnjë moment nuk pretendon të ushtrojë tagrat e KMSHC-së për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil. Megjithatë, për shkak se këto procese mund të përkthehen në kosto dhe risk potenciale për buxhetin e shtetit dhe fondeve publike, bazuar në pavarësinë organizative të saj, KLSH nëpërmjet auditimeve të zhvilluara synon të promovoj qeverisjen e mirë duke identifikuar dobësitë dhe devijimet nga ligjet dhe rregulloret, si dhe duke vlerësuar rregullshmërinë aty ku kuadri ligjor rregullator rezulton i pamjaftueshëm dhe/ose i papërshtatshëm, me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese. Ky proces jo vetëm që nuk dublon punën e KMSHC, por në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërinstitucional KLSH-KMSHC, bën të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, rritjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara si dhe parandalimin e shkeljeve, me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve. Njëkohësisht, Raporti Përfundimtar i Auditimit nuk është akt administrativ i mirëfilltë dhe për rrjedhojë nuk krijon, ndryshon ose shuan pasoja juridike. Raporti i Auditimit është një akt me karakter rekomandues, i cili orienton subjektin nën auditim të ndërmarrë masat e nevojshme me qëllim mirëmenaxhimin e financave publike, si dhe ndihmon Kuvendin për të kontrolluar llogaridhënien e qeverisë. Aktet e gjeneruara nga KMSHC me qëllim materializimin e mbikëqyrjes së shërbimit civil dhe vendimmarrja e këtij institucioni nuk kanë karakter të njëjtë me aktet që prodhohen nga KLSH dhe fakti që këto akte janë objekt i kontrollit gjyqësor, nuk e pengon KLSH në ushtrimin e veprimtarisë audituese. Kryerja e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në KMSHC, jo vetëm i shërben institucionit që Ju drejtoni në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm dhe mirëqeverisjes por njëkohësisht vjen në linjë edhe me frymën e marrëveshjes së bashkëpunimit dhe ndërveprimit ndërinstitucional KLSH-KMSHC. Në përfundim, KLSH ka bashkëpunuar dhe synon të bashkëpunoj edhe në vijimësi në mënyrë sistematike dhe frytdhënëse me KMSHC dhe çdo subjekt nën auditim, duke mbajtur një komunikim efektiv përvijues për të gjitha problematikat e konstatuara, në të gjitha fazat e procesit të auditimit, në respektim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan disa problematika lidhur me planifikimin e mbikqyrjeve/inspektimeve të kryera nga KMSHC për periudhën objekt auditimi.

-Më hollësisht, përzgjedhja e institucioneve, bazohet në indikatorë të tillë si regjistri i ankesave/informacioneve të qytetarëve, dhe raporteve të mbikëqyrjeve orientuese, por pa dokumentuar një metodologji të caktuar në bazë risku shoqëruar me informacione të tjera si numri i pozicioneve të punës në shërbimin civil që ka çdo institucion i mbikëqyrur.

-Nga auditimi konstatohet se në planin e vitit **2019** dhe **2020**, tek monitorimet/inspektimet e përgjithshme, nuk rezultojnë të jenë përcaktuar qartësisht subjektet e përfshira në monitorim, pasi në plan është përcaktuar se mbikëqyrja do të realizohet për institucionet në varësinë e

disa ministrive, por jo saktësisht se kush do jenë këto institucione. Në inspektimet tematike për vitin 2019 është përcaktuar mbikëqyrja e të gjithë institucioneve që disponojnë statusin e nëpunësit civil. Në inspektimet tematike për vitin 2020 është përcaktuar mbikëqyrja e të gjithë institucioneve të administratës shtetërore, të pavarura, vendore për vendimet gjyqësore/ dhe bashkia Tropojë për shkak të ankesave të mëdha.

- KMSHC për periudhën objekt auditimi nuk ka hartuar plane periodike 3 mujore për monitorimet/inspektimet, sikundër përcakton, neni 12 pika 2 e rregullores.

-Nga auditimi konstatohet se në planet e hartuara dhe të rishikuara të KMSHC nuk është marë parasysh neni 1, pika 10 e rregullores, pasi në planet e vitit korrent nuk janë përfshirë mbikëqyrjet e pa realizuara në vitin paraardhës. Si rezultat konstatojmë se një sërë mbikëqyrjesh të planifikuara fillimisht, duke mos u mbartur në planet e viteve pasaardhës, kanë mbetur pa realizuar, si vijon:

a. në planin e vitit **2017,** nuk janë realizuar **mbikëqyrjet e përgjithshme** ne disa Drejtori Arsimore, për shkak të ristrukturimit të tyre, më hollësisht Drejtoria Arsimore Rajonale Dibër dhe Zyrat Arsimore: Bulqizë, Mat, Drejtoria Arsimore Rajonale Fier dhe Zyrat Arsimore: Lushnje, Mallakastër, Drejtoria Arsimore Rajonale Gjirokastër dhe Zyrat Arsimore: Përmet, Tepelenë, Drejtoria Arsimore Rajonale Vlorë dhe Zyrat Arsimore: Delvinë, Sarandë.

b. Referuar planit të vitit **2018**, rezultojnë të mos jenë realizuar **mbikëqyrjet e përgjithshme** sipas planit vjetor apo planeve të mëtejshme në vitet pasardhëse deri në përfundim të periudhës së auditimit në **3 ministri:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

c. Referuar planit të vitit **2019**, rezultojnë të mos jenë realizuar **mbikëqyrjet e përgjithshme** sipas planit vjetor apo planeve të mëtejshme në vitet pasardhëse deri në përfundim të periudhës së auditimit në 4 Bashki: Bashkia Elbasan dhe Njësitë Administrative përbërëse të saj, Bashkia Shkodër dhe Njësitë Administrative përbërëse të saj, Bashkia Kavajë dhe Njësitë Administrative përbërëse të saj, Bashkia Berat dhe Njësitë Administrative përbërëse të saj; dhe planifikimi për kryerjen e mbikëqyrjeve në Institucionet e varësisë së Ministrisë së Turizmit.

d. Referuar planit të vitit **2020**, rezultojnë të mos jenë realizuar **mbikëqyrjet e përgjithshme** sipas planit vjetor apo planeve të mëtejshme në vitet pasardhëse deri në përfundim të periudhës së auditimit në 2 bashki: Bashkia Kavajë dhe Njësitë Administrative përbërëse të saj, Bashkia Pogradec dhe Njësitë Administrative përbërëse të saj; dhe në INSTAT.

- KMSHC-së përgjatë vitit i është dashur të iniciojë mbikëqyrje/inspektime, të cilat nuk rezultojnë të jenë reflektuar më pas në planin vjetor, pasi ky plan nuk është rishikuar asnjëherë, në kundërshtim me Nenin 11, pika 6 e rregullores.

1.1 Rekomandimi: KMSHC të hartojë dhe dokumentojë procedurat e ndjekura/metodologjinë për përzgjedhjen e institucioneve objekt inspektimi/mbikëqyrjeje, në mënyrë që të evidentohet qartë ky proces, duke përfshire në të analiza të kryera mbi bazë risku për institucionet e përzgjedhura, mbështetur në kritere/indikatorë të tjerë si: numri i pozicioneve të punës në shërbimin civil që ka çdo institucion i mbikëqyrur, apo të dhëna të tjera, në mënyrë që të garantohet gjithë përfshirja dhe monitorimi sa më i plotë i institucioneve publike.

-KMSHC, në planin vjetor të mbikëqyrjeve/inspektimeve të reflektojë qartë dhe individualisht të gjitha subjektet e përfshira në plan (të ndara këto sipas mbikëqyrjeve të mbartura nga vitit paraardhës dhe ato të planifikuara rishtaz për vitin korrent), si dhe të reflektojë në këtë dokument ndryshime sa herë të diktohen nga nevoja e institucionit.

-Komisioneri të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me qëllim analizën dhe verifikimin e zbatueshmërisë së çështjeve që lidhen me planet periodike (3 mujore) apo të tjera lidhur me planifikimin, duke identifikuar nivelin e zbatueshmërisë së tyre dhe shkaqet që kanë çuar në mos aplikimin e disa prej kërkesave të rregullores, në lidhje me këtë proces.

Menjëherë dhe në vazhdim

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, në rregulloren "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr.17, datë 11.03.2015 të Komisionerit të KMSHC, janë përshkruar hollësisht procedurat dhe dokumentacionet që do të hartohen për mbikqyrjet/inspektimet "e përgjithshme", ndërsa për mbikqyrjet/inspektimet "orientuese", dhe ato "tematike", numri i të cilave është rritur ndjeshëm vitet e fundit, ka munguar rrjedha e dokumentuar e proceseve nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to, përfshirë këtu dokumentacionin, raportimin dhe sistemimin e mbajtjes së dosjeve. Konkretisht në vitin 2017 ishin planifikuar 50 mbikëqyrje të përgjithshme; në vitin 2018 u planifikuan 30 të tilla (ose 40% më pak se një vit më parë); në vitin 2019 u planifikuan 19 (ose 60% më pak se në vitin 2017); në vitin 2020 u planifikuan të kryhen 15 mbikëqyrje të përgjithshme (ose 70% më pak krahasuar me vitin 2017).

- Nga auditimi rezultoi se struktura në fuqi është miratuar me Vendimin nr. 18, datë 11.03.2015. Edhe pse referuar rregullores dhe strukturës organizative të KMSHC, ekziston një ndarje për kryerjen e "inspektimeve" nga Drejtoria e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ dhe "mbikëqyrjeve" nga Drejtoria e Mbikëqyrjes, në praktikë rezultoi se këto drejtori kanë funksionuar si një e vetme duke mbivendosur detyrat e njëra tjetrës. Kjo edhe për shkak të stafit të reduktuar që institucioni disponon (ku Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes ka në total një staf prej 15 punonjësish, nga të cilët 1 drejtor i përgjithshëm, 2 drejtorë drejtorie dhe 12 inspektorë), i cili duhet të kryejë një mbulim relativisht të gjerë për garantimin e mbikëqyrjes të zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë; shtuar këtu edhe sa diktuar nga rekomandimet e lëna nga rezoluta e Kuvendit.
- Për pasojë afatet e ndjekura, dhe aktet e hartuara gjatë secilës hallkë të procesit, etj; vazhdimisht rast pas rasti.

Mungesa e gjurmëve të auditimit për këto procese të rëndësishme të KMSHC-së, nuk ka siguruar dokumentimin e operacioneve në formë të tillë që të "u mundësojë audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit, në kundërshtim kjo me nenin 16, të ligjit nr, 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.

2.1 Rekomandimi: KMSHC të marrë masa për të miratuar gjurmët e auditimit, të detajuara për aktivitetet kryesore të institucionit duke siguruar që të gjitha operacionet e njësisë publike të dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm si dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit të KMSHC. Veçanërisht të merren masat për të reflektuar sa më sipër në rregullore, duke parashikuar proceset e punës që do të ndiqen për kategoritë e tjera të mbikqyrjes/inspektimeve që institucioni kryhen, të ndryshme nga ato të përgjithshme, me qëllim përgatitjen e hartës së proceseve të punës duke i unifikuar këto procedurave sipas dokumenteve standarde, të zbatueshëm nga inspektorët si gjurmë të punës së kryer.

Menjëherë

2.2 Rekomandimi: Në kushtet kur aktiviteti i KMSHC-së ka pësuar ndryshime nga viti në vit, diktuar këto edhe nga nevojat e institucioneve subjekt mbikëqyrjeje apo rekomandimet e lëna nga rezoluta e Kuvendit, dhe KMSHCS-së i është dashur që, me të njëjtin staf inspektorësh, të mbulojë një gamë më të gjerë aktivitetesh, **rekomandojmë** rishikimin e strukturës në drejtim të shtimit të stafit "inspektorë", dhe ri-organizimin e punës brenda secilës drejtori të mbikëqyrjes dhe inspektimit, me qëllim ndarjen dhe realizimin e detyrave sikundër parashikohen ne rregullore.

Brenda vitit 2021

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, numri i mbikëqyrjeve ñtë përgjithshmeò, ka patur një rënie nga viti 2017 në 2020 si në planifikim dhe në realizim, krahasuar me vitet e mëparshme, si vijon:
- për vitin 2017 janë realizuar 7 nga 50 të planifikuara në total (ose 14% e planit),
- për vitin 2018 janë realizuar 42 nga 73 të planifikuara[28] në total përfshirë dhe 43 mbikëqyrjet e mbartura nga viti 2017 (ose 50% e planit),
- për vitin 2019 janë realizuar 21 nga 36 të planifikuara në total përfshirë 17 mbikëqyrjet e mbartura nga vitet e mëparshme (ose 58% e planit),
- për vitin 2020 janë realizuar 7 nga 26 të planifikuara në total përfshirë 11 mbikëqyrjet e mbartura nga vitet e mëparshme (ose 27% e planit),

Gjithashtu vihet re se, ndërsa numri i mbikëqyrjeve të përgjithshme është ulur, numri i mbikëqyrjeve dhe inspektimeve ñtematikeò dhe ñtë orientuaraò ka ardhur në rritje dhe ka përfshirë jo vetëm çështje të iniciuara nga denoncime por edhe të tjera shtesë si: (i) *Monitorime lidhur me procesin e ristrukturimit të institucioneve të administratës shtetërore; (ii) Monitorime të administrimit të shërbimit civil gjatë zgjedhjeve; (iii) Administrimi dhe analiza e të dhënave për të evidentuar situatën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë; (iv) Respektimi i institutit të lirimit nga shërbimi civil në rastin e plotësimit të moshës për pension të plotë pleqërie.*

Nga auditimi konstatohet se për periudhën objekt auditimi KMSHC ka operuar në mungesë të një sistemi informacioni (qoftë edhe në formën e një regjistri/databaze të kategorizuar sipas llojit të inspektimeve/mbikëqyrjeve të kryera për çdo vit), në mënyrë që të ndiqet realizimi i tyre në kohë, dhe që tâu sigurojë drejtuesve informacion rregullisht mbi arritjen e objektivave të njësisë[29]. Si pasojë progresi drejt arritjes së objektivave është i vështirë për tâu monitoruar rregullisht si dhe për tâu analizuar shkaqet që mund të çojnë në mosrealizimin e tyre[30].

Gjithashtu një regjistër i tillë do tâi shërbente përpunimit dhe analizimit të të dhënave për tâu lejuar audituesve të jashtëm si dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit të KMSHC, në përputhje kjo edhe me nenin 16, të ligjit nr, 10296, datë 8.7.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar.

3.1 Rekomandimi: KMSHC, të marë masat për hartimin e një regjistri ku të evidentohen të gjitha inspektimet dhe mbikëqyrjet e kryera të ndara sipas kategorive dhe sipas planit të çdo viti, në mënyrë që të bëhet e mundur ndjekja e vijueshmërisë së vendimeve të lëna nga Komisoneri për mbikqyrjet dhe inspektimet respektive.

Menjëherë dhe në vazhdim

3.2 Rekomandimi: Në rregulloren e brendshme të KMSHC, në lidhje me këtë proces, të parashikohen procedurat që do të ndiqen dhe personat përgjegjës për ruajtjen dhe administrimin e të dhënave zyrtare të aktivitetit të institucionit.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan mangësi në drejtim të dokumentimit të punës së bërë nga KMSHC në vijim të zbatimit të **rekomandimit të lënë në rezolutat e Kuvendit**[31] për përmbylljen e veprimeve për administrimin e të dhënave që kanë të bëjnë me rikthimin e nëpunësve civilë gjyqfitues në detyrë, në të gjithë sistemin e shërbimit civil, me

[28] Në këtë zë, grupi I audtimit ka përfshirë edhe auditimet e planifikuara dhe të parealizuara në vitet e mëparshme
[29] Komponenti I "Informimit dhe komunikimit" te MFK-së
[30] Komponenti "Monitorimi" / pyetesori I MFK-se
[31] Publikuar gjithashtu ne faqe zyrtare të KMSHC: http://www.kmshc.al/raportimi-vjetor-per-kuvendin/ (fq 12, 126, 158 e Raportit te vitit 2019; 101, 128 e Raportit te vitit 2020)

qëllim evidentimin e arsyeve që pengojnë ecurinë e këtij procesi dhe vijimit të procesit të hetimit administrativ në lidhje me rastet individuale, të konstatuara në shkelje të ligjit.

Nga auditimi rezultoi se, puna e institucionit për sa i përket këtij procesi ka nisur në vitin 2018 me urdhrin nr. 589, datë 01.08.2018, të Komisionerit ò*Për fillimin e procesit të monitorimit të zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë*ò. Në vijim, me urdhrin nr. 10, datë 21.01.2019, të Komisionerit "*Mbi fillimin e inspektimit për rastet e mos zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë, në institucionet që janë subjekt i ligjit për nëpunësin civil*", parashikohet të fillojë **hetimi administrativ** për çdo rast të konstatuar në shkelje të ligjit, akt i cili i ka shtrirë efektet e tij edhe gjatë vitit 2020.

Nga auditimi rezultoi se, për këtë proces të rëndësishëm por edhe sensitiv, në KMSHC nuk është hartuar dhe miratuar rrjedha e dokumentuar e aktiviteteve nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to (gjurma e auditimit). Grupit të auditimit, iu vu në dispozicion vetëm një dosje (MASR) mbi punën e kryer nga KMSHC në zbatim të këtij procesi, me pretendimin se po njëlloj është monitoruar ky aktivitet në të gjitha ministritë; ndërsa sa i takon hetimeve administrative për rastet individuale të konstatuar në shkelje të ligjit, nuk iu vendosën në dispozicion ,grupit të auditimit.

Në kushtet kur, në lidhje me procesin e monitorimit dhe hetimit administrativ për çështjet e mësipërme që lidhen me vendimet gjyqësore:

- Ka munguar gjurma e auditimit, dhe
- Ka munguar evidenca e mjaftueshme dhe përkatëse

grupi i auditimit nuk jep siguri të arsyeshme mbi efektivitetin e këtij procesi dhe impaktin e tij në përmirësimin e situatës.

Pavarësisht se kjo detyrë e lënë nga rezoluta e Kuvendit, në raportet vjetore të KMSHC është raportuar si ñe realizuar plotësishtò, numri i vendimeve të pa ekzekutuara dhe i gjyqfituesve në listën e pritjes për sistemim në pozicionet e punës, vijon të mbetet i lartë dhe një dosje e vetme e vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, mbi realizimin e kësaj detyre, nuk është përfaqësuese për procesin në tërësi.

Ndërsa rezultoi se, databaza e përgjithshme e rekordeve historike që përfshin aktet e largimit nga shërbimi civil të gjyqfituese, e rekomanduar për tôu zbatuar nga Kuvendi, është ende në proces plotësimi të dhënash, dhe si rezultat platforma administrata.al vijon të mos jetë funksionale.

4.1 Rekomandimi: KMSHC, në vijim edhe të detyrave të lënë nga Rezoluta e Kuvendit të marrë masat për intensifikimin e punës nëpërmjet një roli më aktiv në drejtim të problematikës lidhur me nëpunësit gjyqfitues civil në listë pritjeje në të gjithë sistemin e shërbimit civil, nëpërmjet hartimit dhe miratimit të rrjedhës së dokumentuar të aktiviteteve që lidhen me mbikëqyrjet orientuese dhe hetimit administrativ (ne veçanti në lidhje me proceset gjyqësore), nga fillimi deri në përfundim të tyre, i cili duhet të synojë të përshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.

Pas miratimit të gjurmës së auditimit, KMSHC, të marrë masa për kryerjen dhe dokumentimin sa i takon punës mbikëqyrëse *për rastet individuale të konstatuara në shkelje të ligjit për proceset e rikthimit të nëpunësve civilë gjyqfitues në detyrë, si dhe finalizimin me sukses të databazës së përgjithshme të rekordeve historike, ku të përfshihen aktet e largimit nga shërbimi civil të gjyqfituesve, sikundër kërkuar në Rezolutën e Kuvendit.*

Sa më sipër me kontribut në minimizimin e efekteve negative në buxhet si pasojë e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për largimet e padrejta të punonjësve nga puna.

Menjëherë dhe në vazhdim

5. Gjetje nga auditimi: Në zbatim të nenit 11, pika 5 e Rregullores së Brendshme të KMSHC, Procedurat e rekrutimit dhe largimit nga puna në shërbimin civil janë pjesë e përhershme e çdo plani vjetor/periodik të mbikëqyrjes/inspektimit, nëpërmjet kryerjes së mbikëqyrjes së orientuar. Ky proces është konceptuar nga Komisioneri për tâu kryer online nëpërmjet mbledhjes së informacionit në drejtim të funksionimit të procedurave të konkurrimit planifikuar nga Departamenti i Administratës Publike, duke përfshirë pranimin në nivelin ekzekutiv në shërbimin civilë, lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në trupën e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues (TND). Në një vit të caktuar ka patur një tentativë për pjesëmarrjen e grupeve nga ana e KMSHC në këto procedura, për të cilin ka munguar gjurma e auditimit, në vijim (për vitet 2019,2020) nuk është proceduar më në këtë formë.
Plotësimi i vendeve të punës në mënyra alternative nga ana e DAP (i cili përfshin edhe sistemimin e gjyqfituesve në pozicione vakante), nuk është objekt mbikëqyrjeje nga ana e KMSHC, dhe këto evidenca raportohen vetëm statistikisht sipas të dhënave të DAP. Edhe pse pjesë e veprimtarisë institucionale është verifikimi i një numri të konsiderueshëm të ankesave/informacioneve të përcjella lidhur me procedurat e konkurrimit kryer pranë DAP, ky proces rezulton të kryhet në mënyrë të pavarur nga KMSHC si inspektime tematike. Si rezultat në raportin vjetor të përcjellë pranë DAP në përfundim të mbikqyrjes së orientuar të kryer për afro një vit, nuk përfshihen konstatimet që kanë rezultuar nga verifikimi i inspektimeve tematike mbi procedurat e konkurrimit, për tâu bërë pjesë e konkluzionit përfundimtar dhe rekomandimeve të lëna për mbikëqyrjen e procedurave të rekrutimit dhe largimit nga puna të punonjësve në shërbimin civil.
5.1 Rekomandimi: KMSHC të shqyrtojë mundësinë për të zgjeruar fushën e veprimit të saj në kuadër të mbikqyrjes së procesit të rekrutimit dhe largimit nga puna pranë DAP, duke mos u bazuar vetëm në verifikimet online të procedurave, por duke përfshirë edhe monitorimin e plotësimit të vakancave në mënyra alternative; pjesëmarrjen e grupeve të punës nga KMSHC në disa procedura të përzgjedhura me bazë risku; përfshirjen në raportin vjetor të kësaj mbikqyrjeje të problematikave kryesore të konstatuara në vijim të ankesave të përcjella nga pjesëmarrësit gjatë procesit dhe rekomandimeve të lëna për rastet respektive; për garantimin e një roli sa më aktiv të mbiqkyrjes së institucionit në procedurat e rekrutimit dhe largimit nga puna në shërbimin civil.

Në vazhdim

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, sipas nenit 2, pika 2.j e Rregullores së Procedurave të Mbikëqyrjes/Inspektimit, pjesë e fushës së veprimit të KMSHC është mbikëqyrja e zbatimit të detyrave të lëna nga mbikëqyrjet e mëparshme, duke kryer **mbikëqyrje/inspektim në vazhdim**. Në vijim, në nenin 35, të kësaj rregulloreje përcaktohen më hollësisht procedurat që ndiqen nga institucioni për zbatimin e vendimeve dhe afatet përkatëse, konkretisht:
Pika *2: Subjekti i mbikëqyrjes/inspektimit/verifikimit apo hetimit administrativ është i detyruar të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për korrigjimin e shkeljeve brenda afatit të përcaktuar dhe, nëse është e nevojshme, të paraqesë edhe provat që vërtetojnë këtë fakt.*
Pika 3. Nëse Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil e konsideron të arsyeshme, urdhëron kryerjen e një mbikëqyrjeje/inspektimi për të kontrolluar zbatimin e vendimit nga subjekti i mbikëqyrur/inspektuar.ò.
Për vitin 2020, sa i përket ecurisë së zbatimit të vendimeve të Komisionerit, konstatohet se nga mbikëqyrjet në 61 Bashkitë e vendit:

-në **15**[32] **raste janë zbatuar vendimet e** Komisionerit.
-Në **12**[33] **raste**, Komisioneri ka dalë me vendim përfundimtar se nuk janë konstatuar parregullsi.
- Për **34 bashkitë e mbetura**, vendimet e Komisionerit nuk janë zbatuar dhe për këto rastet të konstatuara, pas kërkesës së KLSH-së pas mbajtjes së aktit të konstatimit, KMSHC përpunoi të dhënat, dhe me observacione raporton se janë 961 individë në total për të cilat Komisioneri ka kërkuar anulimin e aktit të emërimit dhe plotësimin e pozicioneve të punës me anë të procedurave të konkurrimit; nga të cilët:

- në 667 raste ose 70% e totalit raportohet se situata është rregulluar; dhe
- në 294 raste ose 30% ndaj totalit, KMSHC është duke vijuar procesin e verifikimit

Mbetet e paqartë se si KMSHC ndjek procesin e verifikimit të vendimeve, në kushtet kur nuk ka iniciuar kryerjen e ndonjë mbikëqyrjeje/inspektimi për të kontrolluar zbatimin e vendimit nga subjekti i mbikëqyrur/inspektuar, por thjesht duke mbetur në pritje të njoftimit nga ana e s*ubjektit të mbikëqyrjes/inspektimit/verifikimit apo hetimit* administrativ për korrigjimin e shkeljeve brenda afatit të përcaktuar dhe, paraqitjes së provave që vërtetojnë këtë fakt.
Gjithashtu rezultoi se, KMSHC ka dalë me vendime përmbyllëse, vetëm kur për të gjithë rastet individuale të përmendura në vendim,
situata është përmirësuar. Për ato raste kur brenda të njëjtit vendim disa raste individuale janë zbatuar, dhe të tjerat jo, në përfundim të afateve, KMSHC **nuk ka** dal me vendim përmbyllës, ku të cilësojë sa prej tyre janë zbatuar, sa nuk janë zbatuar dhe sa janë në proces; si dhe **nuk** ka ngritur mekanzima për të ndjekur ecurinë më tej të zbatueshmërisë së tyre të plotë.
Në gjykimin e pavarur të audituesit, monitorimi në këtë formë (pra duke raportuar në nivel vendimi vetëm) nuk mundëson identifikimin e rasteve individuale të pazbatuara me qëllim ndjekjen deri në zbatimin e plotë të tyre, nëpërmjet aplikimit të gjobave respektive në rast të moszbatimit të masave, në përputhje me nenin 15, të ligjit nr. 152/2013 ñPër nëpunësin civilò, i ndryshuar.

---

[32] 1. Bashkia Pustec
2.Bashkia Shijak
3.Bashkia Dropull
4.Bashkia Konispol
5.Bashkia Himarë
6.Bashkia Vlorë
7.Bashkia Devoll
8.Bashkia Cërrik
9.Bashkia Mirditë
10.Bashkia Bulqizë
11.Bashkia Dibër
12.Bashkia Klos
13.Bashkia Tepelenë
14.Bashkia Libohovë
15.Bashkia Roskovec

13. [33] Bashkia Durres
14. Bashkia Vorë
15. Bashkia Shkodër
16. Bashkia Kurbin
17. Bashkia Maliq
18. Bashkia Kamëz
19. Bashkia Polican
20. Bashkia Berat
21. Bashkia Pogradec
22. Bashkia Korcë
23. Bashkia Ura Vajgurore
24. Bashkia Tirane

6.1 Rekomandimi: KMSHC, të marë masa për hartimin dhe miratimin e procedurave të detajuara që do të duhet të ndiqen për verifikimin e zbatimit të vendimeve të KMSHC edhe në nivel rastesh individuale, për të garantuar përmirësimin e situatës brenda afateve të parashikuara; rikërkimin e zbatimit të tyre dhe analizën e shkaqeve në rastet e moszbatimit, kjo në funksion të misionit të institucionit në zbatim të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil.

Brenda vitit 2021

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi vlerësimin e funksionimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm rezultoi se:
- në KMSHC nuk është hartuar plani i trajnimeve për periudhën objekt auditimi. Gjithashtu nuk janë kryer trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik në fushën e Menaxhimit të Riskut dhe atë të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, në kundërshtim ke kërkesat që burojnë nga Ligji Nr. 10296, datë 8.7.2010, ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar.
- Regjistri i Riskut është kryer çdo 2 vite, konkretisht në 2016 me nr. prot. 869/1, datë 30.12.2016; në vitin 2018 me nr. prot. 358/6, datë 12.10.2018; dhe në vitin 2020 me nr. prot. 652/1, datë 01.09.2020. Rezultoi se risqet e parashtruara në këto dokumente kanë të njëjtin koeficent vlerësimi (i njëjtë për të tre vitet), konfirmuar si procedohet si dhe cilët janë zotëruesit e risqeve por vihet re se, nuk janë parashikuar masa konkrete për tâı ndërmarrë nga personat përgjegjës sipas drejtorive, në mënyrë që të bëhet adresimi i risqeve dhe ndjekja e tyre (gjurmimi).
- në KMSHC nuk është kryer asnjë shërbim i auditit të brendshëm, i cili ka për qëllim të ofrojë siguri objektive dhe këshillim për drejtimin e institucionit, si dhe të ndihmojë njësinë publike për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike. Kjo pasi KMSHC nuk ka në strukturën organizative, një strukturë të dedikuar për kryerjen e këtij shërbimi.

7.1 Rekomandimi: Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil të marrë masa që për periudhën në vijim, të kryhet hartimit dhe zbatimi i planit të trajnimeve për stafin si dhe të kryhen trajnime veçanërisht për GMS-në në fushën e Menaxhimit financiar dhe Kontrollit si dhe Menaxhimit të Riskut.

Në vijimësi

7.2 Rekomandimi: Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil të marrë masa për ngritjen e grupit të punës me qëllim identifikimin dhe vlerësimin e risqeve me qëllim marrjen e masave për ndjekjen dhe adresimin e tyre, në funksion të realizmit të objektivave të njësisë

Në vijimësi

7.3 Rekomandimi: Si institucion që kryen funksione publike, KMSHC duhet të marrë masa të sigurojë kryerjen e shërbimit të auditimit të brendshëm, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. Nr. 114/2015 ñPër Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publikò, ose nëpërmjet krijimit të një njësie të dedikuar brenda strukturës organizative të institucionit, ose nga njësia e auditimit të brendshëm e një njësie tjetër publike, në bazë të një marrëveshjeje ndërmjet titullarëve të njësive publike përkatëse, e cila duhet të miratohet paraprakisht nga Ministri i Financave, sa më sipër me qëllim dhënien e sigurisë së arsyeshme për titullarin e njësisë së sektorit publik, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshillimit për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë e sektorit publik

Brenda vitit ushtrimor

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, për periudhën objekt auditimi, nga buxheti i KMSHC janë likuiduar fonde për shpenzime përmbarimore, për ekzekutimin e 4 vendimeve gjyqësore në shumën 1,311,349 lekë. Prej vitit 2017 e në vijim KMSHC ka likuiduar në total 19,038,985, fonde të cilat lidhen më 5 vendime gjyqësore (prej vitit 2015 e në vijim). Pagesat e kryera për likuidim të vendimeve gjyqësore dhe ato përmbarimore, përbëjnë menaxhim jo efektiv të fondeve buxhetore. Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mbylljes së institucionit

Komisionit të Shërbimit Civil, në nëntor të vitit 2014, të krijuar sipas ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, ñStatusi i nënpunësit civilò.

8.1 Rekomandimi: Drejtoria Juridike, në vijim të marrë masa të monitorojë me përgjegjësi ecurinë e vendimeve gjyqësore me qëllim shmangien e kostove shtesë me impakt në buxhet. Për raste të vendimeve të formës së prerë, të merren masa që të njoftohet në kohë sektori i financës me qëllim planifikimin e fondeve dhe shmangien e kostove të mëtejshme si pasojë e vonesave.

Në vazhdim

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, procesi i inventarizimit për vitin 2020 nuk është realizuar nga KMSHC. Në kushtet kur ky proces synon ndër të tjera, të evidentojë gjendjen fizike të aktiveve dhe krahasimin e tyre me gjendjen kontabël, moskryerja e tij cënon dhënien e sigurisë së arsyeshme mbi plotësinë dhe saktësinë e vlerës së zërave të aktiveve të pasqyruar në kontabilitet si dhe mbi ekzistencën e tyre

9.1 Rekomandimi: Në kushtet kur moskryerja e inventarizimit ka pasur si shkak kryesor situatën e krijuar prej Covid 19, rekomandojmë që nga ana e Komisionerit të merren masa që ky proces të kryhet menjëherë në funksion të ruajtjes dhe mbrojtjes së aktiveve në pronësi të KMSHC.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se për procedurën e prokurimit ñkërkesë për propozimò me REF-08452-04-24-2017, me objekt ñ**Blerje mobiljesh dhe orendi zyre"**, dhe fond limit prej **2,322,222** leke, nuk është kryer studim tregu. Për këtë procedurë, rezultoi se, pas hapjes së ofertave, kanë marrë pjesë 3 OE, nga të cilat ofertat e paraqitura nga 2 operatorët ekonomik kanë qenë në vlerën 1,254,000 lekë dhe 1,203,000 lekë pa TVSh dhe oferta fituese ka qenë në vlerën 2,224,000 lekë pa tvsh, çka tregon se nuk është kryer studimi i duhur i tregut, duke shkaktuar efekte negative financiare si pasojë e menaxhimit pa efektivitet, efiçencë dhe ekonomicitet të fondeve publike. Këta operatorë nuk janë sôkualifikuar si oferta anomalisht të ulëta, por si OE që nuk kanë përmbushur kriteret e veçanta.

Në vendosjen e kritereve të veçanta të kualifikimit, pika **3.3** kapaciteti teknik dhe profesional: është kërkuar një punonjës arkitekt dhe licenca profesionale e ushtrimit të aktivitetit. Vendosja e një kriteri të tillë, siç është licenca e ushtrimit të aktivitetit të arkitektit, është një kriter i diskriminues dhe jo i barabartë sepse objektet e kërkuara për prodhim nga AK, janë të dizenjuara e të specifikuara nga një arkitekt i jashtëm i AK dhe kriteri i lejes së ushtrimit të profesionit në këtë pikë vlerësohet se është i panevojshëm, duke e konsideruar si një nga kriteret diskriminues të operatorëve ekonomik.

Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

10.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit të marrë masa që me grupe të veçanta të analizojë situatën, shkaqet të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa e nevojshme, për sa konstatuar më sipër.

Menjëherë

10.2 Rekomandimi: Në çdo rast, grupet e përllogaritjes së specifikimeve teknike në KMSHC, të respektojnë rregullat e hartimit të DST të tenderit, me qëllim që këto të fundit të mundësojnë një trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit ñkërkesë për propozimò, me objekt "Blerje pajisje elektronike", dhe fond limit 931.667 lekë, konstatuam mungesë në studimit të tregut, për nevoja të përllogaritjes së fondit limit. Rezulton se fondi limit nuk

është përllogaritur duke studiuar tregun apo mbi burime të dhënash të cilat do të ndihmonin në përllogaritjen më të saktë të fondeve, por është bërë duke u bazuar vetëm në përvojën e mëparshme dhe duke marre oferta nga 3 OE, për më tepër kur këto 3 OE rezultojnë të kenë marrë pjesë në këtë tender, duke mbartur risqe që k*ëta operatorë të kenë një informacion paraprak mbi çmimin që do tenderohet*.

Gjithashtu rezultoi se, në kriteret e vendosura nga AK, pika **2.3** Kapaciteti teknik kërkon që *OE:*

- *duhet të paraqesë çertifikatën ISO 9001:2008 për sistemet e menaxhimit të cilësisë.*
- *të kenë minimumi **3** punonjës të punësuar, nga të cilët **2** punonjës, me profesion inxhinier elektronik ose informatik ose telekomunikacioni* sipas DST (fq.80-82),

Sa më sipër, të pa shoqëruar me fjalët ñ***ose ekuivalent i tij/saj'', duke mos stimuluar pjesëmarrjen në kundërshtim me*** **nenin 46**, pika 3 të LPP. Këto çertifikata janë gjithmonë subjekt i përmirësimeve në bazë të direktivave të reja që dalin për përmirësimin e cilësisë dhe shërbimeve, por gjithmonë pa ndryshuar objektin e tyre. Në këto kushte nuk argumentohet se pse për procedurën e kryer në vitin 2017, është kërkuar certifikata e EN ISO e vitit 2008 për menaxhimin e cilësisë.

Sa më sipër, këto të dhëna janë të paargumentuar nga AK, janë kërkesa diskriminuese duke kufizuar konkurrencën dhe janë jashtë natyrës dhe llojit të kontratës.

Gjithashtu kriteri i lejes së ushtrimit të profesionit, vlerësohet se është i panevojshëm, dhe diskriminues pasi në gjykimin e pavarur të audituesit, montimi i pajisjeve dhe vendosja sipas një konfigurimi të përshtatshëm për nevojat e KMSHC, për zbatimin e kontratës nga OE, mund të kryhen edhe nga punonjës që kanë njohuri dhe janë të pajisur me licencat profesionale apo dëshmi përkatëse, sipas përcaktimeve të *nenit 28, pika 5, të vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, ''për miratimin e rregullave të prokurimit publik'', i ndryshuar*.

11.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit të marrë masa që me grupe të veçanta të analizojë situatën, shkaqet të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa e nevojshme, për sa konstatuar më sipër.

Menjëherë

11.2 Rekomandimi: Në të gjitha rastet në vijim, grupet respektive në KMSHC, përgjatë përllogaritjes së fondit limit të vlerësojnë dhe argumentojnë me kujdes përzgjedhjen e alternativave që do tô referohen, me qëllim rritjen e transparencës në procedurat e prokurimit.

Anëtarët e njësive të prokurimit, në vendosjen e kritereve specifike për kualifikim të zbatojnë parimet që mundësojnë trajtim të njëjtë dhe jo diskriminues për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit, me qëllim rritjen e konkurrencës, ndër të tjera duke shoqëruar kriteret edhe me fjalët ñose ekuivalent i tij/e sajò.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2018, nga auditimi i procedurës së prokurimit ñkërkesë për propozimò, me objekt "Blerje pajisje elektronike", dhe fond limit 1,246,663 lekë, konstatuam se n*ë këtë praktikë nuk është bërë argumentimi mbi vendosjen e kritereve të veçanta të kualifikimit mbi certifikatat ISO, sipas shtojcave 6,7,8,9 të DST*[34]*, si dhe nuk është argumentuar nevoja për këto kërkesa, në kundërshtim me* nenin 23, ku në përshkrimin e mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale.

[34] *Sipas Dokumentave Standartë të Tenderit (DST), neni 10, VKM 614, datë 29.12.2004 dhe pikës 1,2,3,4, të nenit 23 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 për PP, i ndryshuar.*

Konstatuam se, Autoriteti Kontraktor ka vendosur specifikime teknike pa përdorur fjalët ñose ekuivalent i tij/e sajò, në kundërshtim me shkronjën ôcôô, pika 3, të nenit 23, të ligjit 9643, datë 20.11.2006, duke kërkuar që operatorët ekonomik të provojnë se zotërojnë edhe certifikatat ISO 20000-1:2011, mbi ôôMenaxhimin e shërbimitôô, ISO 22301:2012, mbi ôôsistemet e menaxhimit të vazhdimësisë së biznesitôô, ISO 9001:2008, mbi ôôSistemet e menaxhimit të cilësisë, ISO 27001:2013, ôômbi sistemet e menaxhimit të sigurisë informatikeôô. Sipas AK, certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga RSH. Grupi i auditimit vëren se, këto certifikata janë gjithmonë subjekt i përmirësimeve në bazë të direktivave të reja që dalin për përmirësimin e cilësisë dhe shërbimeve, por gjithmonë pa ndryshuar objektin e tyre.

12.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit të marrë masa që me grupe të veçanta të analizojë situatën, shkaqet të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa e nevojshme, për sa konstatuar më sipër.

Menjëherë

12.2 Rekomandimi: Në të gjitha rastet në vijim, grupet respektive në KMSHC, në vendosjen e kritereve specifike për kualifikim të marr masa të zbatohen parimet që mundësojnë trajtim të njëjtë dhe jo diskriminues për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit, me qëllim rritjen e konkurrencës, ndër të tjera duke shoqëruar në çdo rast kriteret edhe me fjalët ñose ekuivalent i tij/e sajò.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, për vitin 2018, nga auditimi i procedurës së prokurimit ñkërkesë për propozimò, me objekt "Blerje pajisje elektronike", dhe fond limit 1,246,663 lekë, për pajisjen kompjuter Desktop, tek modeli DELL Optiplex 3050 MT në katalog nuk ishin markuar specifikimet për *"sound and speaker"*, por ky model, i verifikuar nga anëtari i Komisionit me cilësinë e ekspertit të fushës në faqen zyrtare të DELL, i përfshin të gjitha specifikimet e kërkuara. Nga ana tjetër, Operatori Ekonomik, përmes deklaratës së përmbushjes së specifikimeve teknike ka marrë përsipër përmbushjen e të gjitha specifikimeve të kërkuara në DST, si dhe pas verifikimit në SPE rezultoi se këto specifikime nga Operatori Ekonomik fitues nuk janë ngarkuar (nëse përfshihen ose jo), por ndërkohë, KVO-ja ka vlerësuar këtë operator ekonomik, edhe pse nuk i përmbushte këto specifikime, gjë e cila më pas, është sqaruar se këto specifikime do të përshkruheshin me procesverbal me lidhjen e kontratës nga Komisioni, me marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve.

-Me shkresën Nr. 332/15, datë 19.06.2018, të Urdhrit Nr. 56, datë 19.06.2018 është ngritur Komisioni për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara nëpërmjet procedurës së prokurimit ôôKërkesë për propozimôô, me objekt ôôBlerje pajisje elektronikeôô, me përbërje si më poshtë: B. H. ï Kryetar, M. I., A. R., i cili më datë 25.06.2018 ka mbajtur proçesverbalin për marrjen në dorëzim të pajisjeve elektronike, bashkëlidhur të cilit gjendet fatura tatimore e shitjes, datë 25.06.2018, ku cilësohen emërtimet e pajisjeve, por vijojnë të **mos** përmendet nëse specifikimet për ñ***sound and speakers"*** janë të përfshira ose jo.

- Nga auditimi rezultoi se, AK ka kërkuar që OE të ketë një inxhinier të certifikuar për serinë e serverit DELL Power Edge R710, kriter i vendosur, jo në përputhje me kërkesat e nenit 23, pika 5, të ligjit 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, ku përcakton se specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë **apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë […].**

Vendosja e një kriteri të tillë, jo ligjor mbart riskun e një procedure të paracaktuar, ku cënohen parimet e trajtimit të barabartë, si dhe të mosdiskriminim të operatorëve ekonomik.

Në përfundim të procedurës së tenderimit rezulton të jetë shpallur fituesi ôS. C.ô sh.p.k, njëkohësisht promovuesi i markës **Dell** në Shqipëri që prej vitit 1998[35].

13.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit të marrë masa që me grupe të veçanta të analizojë situatën, shkaqet të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa e nevojshme, për sa konstatuar më sipër.

Menjëherë

13.2 Rekomandimi: Në të gjitha rastet në vijim, grupet respektive në KMSHC, në vendosjen e kritereve specifike për kualifikim të marrin masa që të zbatojnë parimet që mundësojnë trajtim të njëjtë dhe jo diskriminues për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit, me qëllim rritjen e konkurrencës, ndër të tjera duke shoqëruar kriteret edhe me fjalët ñose ekuivalent i tij/e saj).

Çdo etapë e procesit të prokurimit të dokumentohet në përputhje me rregullat e parashikuara sipas kuadrit ligjor dhe rregullator në fushën e legjislacionit, në përputhje me kriterin e prokurimit publik.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2018, nga auditimi i procedurës së prokurimit ñBlerje mobilje zyre", me fond limit **2,073,267** lekë, rezultoi se me qëllim përllogaritjen e fondit limit, AK i është drejtuar 3 OE-ve, pa marrë në konsideratë alternativave të tjera si: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj).

Për më tepër kur, bazuar në ekstraktin historik në QKB, një nga 3 subjektet në fjalë , **C. shpk** me NUIS **J.....I**, në fakt **nuk** ka objekt veprimtarie tregtimin e mobilieve, pajisjeve dhe orendive për zyra, por veprimtaria e tij është: *Import eksport të lëndëve të para dhe ndihmëse për industrinë, pajisje elektromekanike, elektronike, goma të gjitha llojeve etj. Projektim dhe instalimi i pajisjeve të transmetimit (figurë dhe zë) si dhe të pajisjeve të vëzhgimit (kamera). Importimi, tregtimi, riparimi i të gjitha llojeve e pajisjeve të telekomunikacionit si qëndrore dhe fundore. Të projektojë e zbatoj të gjitha llojet e rrjetat lokale dhe kombëtare me pajisje telekomunikacioni si qëndrore ashtu dhe fundore etj.*

Në këto kushte vlera e fondit limit e përllogaritur mbi një bazë të tillë është e pasaktë dhe e pambështetur, duke rrezikuar të ketë pasoja negative në buxhetin e institucionit, për arsye të përllogaritjes së vlerës së fondit më të lartë nga vlera e tregut

15.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit të marrë masa që me grupe të veçanta të analizojë situatën, shkaqet të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa e nevojshme, për sa konstatuar më sipër.

Menjëherë

14.2 Rekomandimi: Në të gjitha rastet në vijim, grupet respektive në KMSHC, duhet të respektojnë procedurën e saktë në përllogaritjen e vlerës së fondit limit, duke ju referuar alternativave të tjera si: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj), dhe jo të mjaftohet me përzgjedhjen e disa ofertave për më tepër nga OE, të cilët nuk kanë për objekt ushtrimin e aktivitetit - objekt prokurimi.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, referuar treguesve të realizimit të buxhetit për vitin 2017 vlera e llogarisë 60274 ñShpenzime për ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësoreò,

[35] sinteza-al.com

rezultoi të jetë 3,094,000 lekë; Ndërkohë në Pasqyrën Financiare të Ardhura-Shpenzime kjo llogari është paraqitet në vlerën 1,441,638 lekë (ose rreth 1,652 mijë lekë më pak nga sa deklaruar në buxhet). Gjithashtu referuar treguesve të realizimit të buxhetit për vitin 2018 vlera e llogarisë 60274 shpenzime për ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësore, është 2,264,050 lekë; Ndërkohë në Pasqyrën Financiare të Ardhura-Shpenzime kjo llogari paraqitet në vlerën 567,451 lekë (ose 1,697 mijë lekë më pak nga sa deklaruar në buxhet).

15.1 Rekomandimi: Titullari i KMSHC të marr masa për ngritjen e një grupi pune me qëllim analizimin e shkaqeve të mosrakordimit të këtyre shifrave dhe vlerësimin e impaktit që ka sjellë kjo mospërputhje në zërat kontabël të mbartur në pasqyrat financiare (më konkretisht në çeljet e viteve pasardhës).

Sektori i Financës të marr masa të bëjë sistemimet e nevojshme ne kontabilitet në lidhje me reflektimin e kësaj vlerë.

Brenda datës 30.10.2021

B. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 57, 58 dhe 59 të ligjit nr. 153/2013 ñPër nëpunësin civilò, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", për punonjësit e identifikuar me përgjegjës në lidhje me shkeljet e konstatuara e të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, *i rekomandojmë* **Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil**, ngritjen e një grupi pune, me qëllim që, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si dhe të kërkojë fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore nga *"Vërejtje"* deri te *"Largim nga puna*ò, për personat që gjenden me përgjegjësi në këtë Raport Përfundimtar Auditimi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi

GRUPI I AUDITIMIT
A. J., Përgjegjëse e Grupit të Auditimit,
J. T.,
E. G.,
E. M.,
K. Sh.

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

A. J.

VI. ANEKSE

Aneksi 1-Realizimi i mbikëqyrjeve/inspektimeve të përgjithshme dhe tematike 2017-2020

Nr	Plani vjetor 2017	Objekti	Realizuar
I	**Mbikëqyrje/Inspektim i orientuar në mbledhjen e informacionit në lidhje me pranimin dhe zhvillimin e karrierës në shërbimin civil**	Procedurat e rekrutimit, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë në institucionet që punësojnë nëpunës civil, në administratën shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore.	- Të gjitha institucionet e përfshira në mbikëqyrje të përgjithshme *(Vendore dhe të pavarura)* në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes e kanë të trajtuar në një rubrikë më vete - Në lidhje me DAP është hartuar një raport i veçantë.

II	Mbikëqyrje/inspektim i përgjithshëm			
	Njësitë e qeverisjes vendore	**Plani fillestar**	**Realizuar**	**Plan i rishikuar**
1.	Bashkia Fier / 10 njësitë administrative	Po	Jo	Kaluar për vitin 2018 dhe përfunduar ne 2019
2.	Bashkia Vau Dejës / 5 njësite administrative	Po	Jo	Kaluar për vitin 2018 dhe përfunduar ne 2019
3.	Bashkia Kuçovë /3 njësitë administrative	Po	Jo	Përfunduar në 2018
4.	Bashkia Skrapar / 8 njësitë administrative	Po	✓	Përfunduar në 2017
5	Bashkia Poliçan / 2 njësitë administrative	Po	✓	Përfunduar në 2017
6.	Bashkia Urë Vajgurore / 3	Po	Jo	Përfunduar në 2018

	njësitë administrative			
7.	Bashkia Gjirokastër / 7 njësitë administrative	Po	Jo	Përfunduar në 2018
8.	Bashkia Memaliaj / 5 njësitë administrative	Po	Jo	Përfunduar në 2018
9.	Bashkia Këlcyrë / 3 njësitë administrative	Po	Jo	Përfunduar në 2018
10	Bashkia Dropull / 3 njësitë administrative	Po	Jo	Përfunduar në 2018
11.	Bashkia Korçë / 9 njësitë administrative	Po	✓	Përfunduar në 2017
12.	Bashkia Pogradec / 7 njësitë administrative	Po	Jo	Përfunduar në 2018
13.	Bashkia Pustec	Po	Jo	Përfunduar në 2018
14	Bashkia Maliq /6 njësitë administrative	Po	✓	Përfunduar në 2017
15	Bashkia Devoll / 4 njësitë administrative	Po	✓	Përfunduar në 2017
16	Bashkia Kolonjë / 7 njësitë administrative	Po	Jo	Ka nisur në 2018 dhe përfunduar në 2019
17.	Bashkia Kukës / 14 njësitë administrative	Po	✓	Përfunduar në 2017
18.	Bashkia Tropojë / 8 njësitë administrative	Po	Jo	Ka nisur në 2018 dhe përfunduar në 2019
19.	Bashkia Has / 4 njësitë administrative	Po	Jo	Ka nisur në 2018 dhe përfunduar në 2018
20.	Bashkia Lezhë / 9 njësitë administrative	Po	✓	Përfunduar në 2017
21.	Bashkia Mirditë / 7 njësitë administrative	Po	Jo	Ka nisur në 2018 dhe përfunduar në 2018
22.	Bashkia Selenicë /6 njësitë administrative	Po	Jo	Ka nisur në 2018 dhe përfunduar në 2018
23.	Bashkia Himarë / 3 njësitë administrative	Po	Jo	Ka nisur në 2018 dhe përfunduar në 2018
24.	Bashkia Delvinë / 1 njësitë administrative	Po	Jo	Ka nisur në 2017 dhe përfunduar në 2018
25	Bashkia Sarandë / 1 njësitë administrative	Po	Jo	Ka nisur në 2017 dhe përfunduar në 2018
26.	Bashkia Finiq / 4 njësitë administrative	Po	Jo	Ka nisur në 2017 dhe përfunduar në 2018
27.	Bashkia Konispol / 2 njësitë administrative	Po	Jo	Ka nisur në 2017 dhe përfunduar në 2018
28.	Bashkia Cërrik / 4 njësitë administrative	Po	Jo	Ka nisur në 2018 dhe përfunduar në 2018
29.	Bashkia Peqin / 9 njësitë administrative	Po	Jo	Ka nisur në 2017 dhe përfunduar në 2018
30.	Bashkia Malësi e Madhe /5 njësitë administrative	Po	Jo	Kaluar për vitin 2018 dhe përfunduar ne 2019

31.	Bashkia Gramsh / 9 njësitë administrative	Po	Jo	Ka nisur në 2017 dhe përfunduar në 2018
32.	Bashkia Librazhd / 6 njësitë administrative	Po	Jo	Ka nisur në 2017 dhe përfunduar në 2018
33.	Bashkia Përrenjas / 3 njësitë administrative	Po	Jo	Ka nisur në 2017 dhe përfunduar në 2018
34.	Bashkia Patos / 2 njësitë administrative	Po	Jo	Ka nisur në 2017 dhe përfunduar në 2018
35.	Bashkia Roskovec / 3 njësitë administrative	Po	Jo	Ka nisur në 2017 dhe përfunduar në 2018
36.	Bashkia Lushnjë / 10 njësitë administrative	Po	Jo	Ka nisur në 2017 dhe përfunduar në 2018
37.	Bashkia Divjakë / 4 njësitë administrative	Po	Jo	Ka nisur në 2017 dhe përfunduar në 2018
	Institucione të Administratës Shtetërore			
	Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore, si institucione në varësi të Ministrisë së Arsimit			
1.	Drejtoria Arsimore Rajonale Berat dhe Zyrat Arsimore: Kuçovë, Skrapar	Po	✓	Përfunduar në 2017
2.	Drejtoria Arsimore Rajonale Dibër dhe Zyrat Arsimore: Bulqizë, Mat	Po	Jo	JO, për shkak të ristrukturimit
3.	Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës dhe Zyra Arsimore Krujë	Po	✓	Përfunduar në 2017
4.	Drejtoria Arsimore Rajonale Elbasan dhe Zyrat Arsimore: Gramsh, Librazhd, Peqin	Po	✓	Përfunduar në 2017
5.	Drejtoria Arsimore Rajonale Fier dhe Zyrat Arsimore: Lushnje, Mallakastër	Po	Jo	JO, për shkak të ristrukturimit
6.	Drejtoria Arsimore Rajonale Gjirokastër dhe Zyrat Arsimore: Përmet, Tepelenë	Po	Jo	JO, për shkak të ristrukturimit
7.	Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë dhe Zyrat Arsimore: Devoll, Kolonjë, Pogradec	Po	✓	Përfunduar në 2017
8.	Drejtoria Arsimore Rajonale Kukës dhe Zyrat Arsimore: Has, Tropojë	Po	✓	Përfunduar në 2017
9.	Drejtoria Arsimore Rajonale Lezhë dhe Zyrat Arsimore: Kurbin, Mirditë	Po	✓	Përfunduar në 2017
10.	Drejtoria Arsimore Rajonale	Po	✓	Përfunduar në 2017

	Shkodër dhe Zyrat Arsimore: Malësi e Madhe, Pukë			
11.	Drejtoria Arsimore Rajonale, Qyteti Tiranë	Po	✓	Përfunduar në 2017
12.	Drejtoria Arsimore Rajonale, Qarku Tiranë dhe Zyrat Arsimore: Kamëz, Kavajë	Po	✓	Përfunduar në 2017
13.	Drejtoria Arsimore Rajonale Vlorë dhe Zyrat Arsimore: Delvinë, Sarandë	Po	Jo	JO, për shkak të ristrukturimit
	Institucione te pavarura		nuk ka të planifikuara	
III	**Mbikëqyrje/inspektim tematik**			
	Njësitë e Qeverisjes Vendore			
1.	Bashkia Dibër	Po	✓	Mbikëqyrje/inspektim tematik bashkë me zbatimin e vendimit
2.	Bashkia Belsh	Po	✓	Mbikëqyrje/inspektim tematik bashkë me zbatimin e vendimit
3.	Bashkia Kavajë	Po	✓	Mbikëqyrje/inspektim tematik bashkë me zbatimin e vendimit
4.	Bashkia Vlorë	Po	✓	Inspektim për zbatimin e vendimit
5.	Bashkia Fushë Arrëz	Po	✓	Inspektim për zbatimin e vendimit
6.	Bashkia Shkodër	Po	✓	Inspektim për zbatimin e vendimit
7.	Bashkia Mat	Po	✓	Mbikëqyrje/inspektim tematik bashkë me zbatimin e vendimit
8.	Bashkia Klos	Po	✓	Inspektim për zbatimin e vendimit
9.	Bashkia Laç/Kurbin	Po	✓	Mbikëqyrje/inspektim tematik bashkë me zbatimin e vendimit
	Jashtë planit (shtuar)	Shtuar		
1.	Bashkia Bulqizë	Shtuar	✓	Mbikëqyrje/inspektim tematik bashkë me zbatimin e vendimit
2.	Bashkia Tiranë	Vijuar nga 2015	✓	Iniciuar ne 2015 dhe përfunduar ne 2017
3.	Bashkia Përmet	Shtuar	✓	Mbikëqyrje/inspektim tematik bashkë me zbatimin e vendimit

4.	Bashkia Tepelenë	Shtuar	✓	Mbikëqyrje/inspektim tematik bashkë me zbatimin e vendimit
5.	Bashkia Libohovë	Shtuar	✓	Mbikëqyrje/inspektim tematik bashkë me zbatimin e vendimit
6.	Bashkia Mallakastër	Shtuar	✓	Mbikëqyrje/inspektim tematik bashkë me zbatimin e vendimit
	Institucione të Administratës Shtetërore			
1.	Prefektura Shkodër	Po	✓	Mbikëqyrje/inspektim tematik bashkë me zbatimin e vendimit
2.	Prefektura Kukës	Po	✓	Mbikëqyrje/inspektim tematik bashkë me zbatimin e vendimit
3.	Prefektura Lezhë	Po	✓	Mbikëqyrje/inspektim tematik bashkë me zbatimin e vendimit
4.	Prefektura Korçë	Po	✓	Mbikëqyrje/inspektim tematik bashkë me zbatimin e vendimit
5.	Prefektura Vlorë	Po	✓	Inspektim për zbatimin e vendimit
6.	Drejtoria e Bujqësisë Dibër	Po	✓	Mbikëqyrje/inspektim tematik bashkë me zbatimin e vendimit
7.	Drejtoria e Bujqësisë Shkodër	Po	✓	Mbikëqyrje/inspektim tematik bashkë me zbatimin e vendimit
8.	Drejtoria e Bujqësisë Korçë	Po	✓	Mbikëqyrje/inspektim tematik bashkë me zbatimin e vendimit
9.	Drejtoria e Bujqësisë Kukës	Po	✓	Mbikëqyrje/inspektim tematik bashkë me zbatimin e vendimit
10	Drejtoria e Bujqësisë Vlorë	Po	Jo	Inspektim për zbatimin e vendimit
11.	Drejtoria e Bujqësisë Gjirokastër	Po	jo	Inspektim për zbatimin e vendimit
	Jashtë planit (shtuar)			
1.	Prefektura Durrës	Shtuar	✓	Mbikëqyrje/inspektim tematik bashkë me zbatimin e vendimit
2.	Prefektura Tiranë	Shtuar	✓	Mbikëqyrje/inspektim

				tematik bashkë me zbatimin e vendimit
3.	Drejtoria e Bujqësisë Tiranë	Shtuar	✓	Mbikëqyrje/inspektim tematik bashkë me zbatimin e vendimit
4.	AKU	Shtuar	✓	Mbikëqyrje/inspektim tematik bashkë me zbatimin e vendimit)
5.	Agjencia Kombëtare e Duhan Cigareve	Shtuar	✓	Mbikëqyrje/inspektim tematik bashkë me zbatimin e vendimit
6.	Agjencia Kombëtarë e Bregdetit	Shtuar	✓	Mbikëqyrje/inspektim tematik bashkë me zbatimin e vendimit
7.	Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës	Shtuar	✓	Mbikëqyrje/inspektim tematik bashkë me zbatimin e vendimit
8.	Këshilli i Qarkut Tiranë	Shtuar	✓	Mbikëqyrje/inspektim tematik bashkë me zbatimin e vendimit
9.	Autoriteti i Aviacionit Civil	Shtuar	JO	Tematik, I papërfunduar në 2017
IV	**Mbikëqyrje e orientuar**			
1.	**Monitorim lidhur me procesin e ristrukturimit të institucioneve të administratës shtetërore**			Këto institucione nuk kane dale me vendim pasi është përpiluar raporti përkatës për situatën, konkluduar në vitin 2018
1.	Kryeministria	Po	✓	
2.	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	Po	✓	
3.	Ministria e Mbrojtjes	Po	✓	
4.	Ministria e Brendshme	Po	✓	
5.	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Po	✓	
6.	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Po	✓	
7.	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Po	✓	
8.	Ministria e Drejtësisë	Po	✓	
9.	Ministria e Kulturës	Po	✓	
10.	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Po	✓	
11.	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Po	✓	
12.	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Po	✓	

	Jashtë planit (shtuar)			
2.	**Monitorimi i administrimit të shërbimit civil gjatë zgjedhjeve të vitit 2017 për Kuvendin e Shqipërisë, me fokus sjelljen e nëpunësit civil.** *Në përfundim të procesit është hartuar një raport monitorimi dërguar Kuvendit të Shqipërisë.* **Shënim:** Gjatë procesit të monitorimit të zgjedhjeve, nga ana e Komisionerit, është administruar informacion gjatë gjithë fushatës zgjedhore nga të gjitha institucionet e përfshira ne proces *(**208** institucione)*, për 30 ditë, të cilat kanë raportuar për çdo ditë pranë Komisionerit, prezencën ditore të nëpunësve civilë, si dhe probleme të tjera të evidentuara gjatë këtij procesi. *Bashkëlidhur me këtë tabelë është edhe lista e institucioneve të monitoruara dhe ndarja e punës midis anëtarëve të grupit të monitorimit, pranë Komisionerit.*	Shtuar	✓	Këto institucione nuk kane dale me vendim pasi është përpiluar raporti përkatës për situatën, konkluduar në 2018
V.	**Inspektimet tematike**			
	Inspektimet tematike të kryera mbi bazën e denoncimeve dhe informacioneve të ardhura nga nëpunësit civil të përfshirë në procese të administrimit të shërbimit civil. **Shënim:** Ndjekja e informacioneve është një proces i planifikuar, ndërkohë që numri i këtyre inspektimeve është në varësi të denoncimeve dhe informacioneve që vijnë nga nëpunës civilë, të cilët denoncojnë probleme me	Po	✓	**33** vendime në vijim të kërkesave/ankesave të punonjësve.

	zbatimin e ligjit pranë Komisionerit. Për këtë arsye, në lidhje me këtë veprimtari, gjatë vitit 2017 janë trajtuar rastet qe do te paraqiten në listën që do t`ju dërgohet me e mail.			
VI	**Raporti Vjetor i veprimtarisë së Komisionerit për vitin 2016**	Po	✓	po

Nr	**Plani vjetor 2018**	**Objekti**	**Realizuar**
I	**Mbikëqyrje/Inspektim i orientuar në mbledhjen e informacionit në lidhje me pranimin dhe zhvillimin e karrierës në shërbimin civil**	Procedurat e rekrutimit, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë në institucionet që punësojnë nëpunës civil, në administratën shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore.	- Të gjitha institucionet e përfshira në mbikëqyrje të përgjithshme *(Vendore dhe të pavarura)* në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes e kanë të trajtuar në një rubrikë më vete - Në lidhje me DAP është hartuar një raport i veçantë.

II	**Mbikëqyrje/inspektim të përgjithshëm**			
	Njësitë e qeverisjes vendore	Plan fillestar	Përfunduar me vendim deri në fund të 2018	Plan i rishikuar
1.	Bashkia Fier / 10 njësitë administrative	Po	Jo	Përfunduar ne 2019
2.	Bashkia Vau Dejës / 5 njësitë administrative	Po	Jo	Përfunduar ne 2019
1.	Bashkia Kolonjë / 7 njësitë administrative	Po	Jo	Përfunduar ne 2019
2.	Bashkia Tropojë / 8 njësitë administrative	Po	Jo	Përfunduar ne 2019
3.	Bashkia Has / 4 njësitë administrative	Po	✓	Përfunduar ne 2018
6.	Bashkia Mirditë / 7 njësitë administrative	Po	✓	Përfunduar ne 2018
7.	Bashkia Selenicë /6 njësitë administrative	Po	✓	Përfunduar ne 2018
8.	Bashkia Himarë / 3 njësitë administrative	Po	✓	Përfunduar ne 2018
9.	Bashkia Malësi e Madhe /5 njësitë	Po	Jo	Përfunduar ne 2019

	administrative			
10.	Bashkia Cërrik / 4 njësitë administrative	Po	✓	Përfunduar ne 2018
	Institucione të Administratës Shtetërore			
1.	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Po	Jo	Shtyrë për një kohë të mëvonshme
2.	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Po	Jo	Shtyrë për një kohë të mëvonshme
3.	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Po	Jo	Shtyrë për një kohë të mëvonshme
4.	AZHBR	Po	✓	Përfunduar ne 2018
5.	Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë	Po	Jo	Ndryshuar ligji dhe nuk janë subjekte të ligjit për nëpunësin civil.
6.	Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Durrës	Po	Jo	Ndryshuar ligji dhe nuk janë subjekte të ligjit për nëpunësin civil.
7.	Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier	Po	Jo	Ndryshuar ligji dhe nuk janë subjekte të ligjit për nëpunësin civil.
8.	Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Korçë	Po	Jo	Ndryshuar ligji dhe nuk janë subjekte të ligjit për nëpunësin civil.
	Institucione të pavarura			
1.	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	Po	✓	Përfunduar ne 2018
2.	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	Po	✓	Përfunduar ne 2018
	Jashtë planit (shtuar)			
	Institucion i Administratës Qendrore			
1.	Instituti i Transportit	Shtuar	✓	Pas riformatimit të institucioneve të varësisë
2.	Sekretariati për Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI)	Shtuar	✓	Pas riformatimit të institucioneve të varësisë
3.	Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve Ujërave dhe Turizmit	Shtuar	✓	Pas riformatimit të institucioneve të varësisë

4.	Drejtoria e Shërbimit të provës	Shtuar	✓	Pas riformatimit të institucioneve të varësisë
5.	QTTB Lushnjë	Shtuar	✓	Pas riformatimit të institucioneve të varësisë
6.	QTTB Vlorë	Shtuar	✓	Pas riformatimit të institucioneve të varësisë
7.	QTTB Fushë Krujë	Shtuar	✓	Pas riformatimit të institucioneve të varësisë
8.	QTTB Shkodër	Shtuar	✓	Pas riformatimit të institucioneve të varësisë
9.	QTTB Korçë	Shtuar	✓	Pas riformatimit të institucioneve të varësisë
	Institucion i pavarur			
	Autoriteti i Konkurrencës	Shtuar	✓	Përfunduar ne 2018
III	**Inspektim tematik**			
	Inspektimet tematike të kryera mbi bazën e denoncimeve dhe informacioneve të ardhura nga nëpunësit civil të përfshirë në procese të administrimit të shërbimit civil. **Shënim:** Ndjekja e informacioneve është një proces i planifikuar, ndërkohë që numri i këtyre inspektimeve është në varësi të denoncimeve dhe informacioneve që vijnë nga nëpunës civilë, të cilët denoncojnë probleme me zbatimin e ligjit pranë Komisionerit. Për këtë arsye, në lidhje me këtë veprimtari, gjatë vitit 2018 janë trajtuar rastet qe do te paraqiten në listën që do t`ju dërgohet me *e mail.*	Po	✓	16 vendime në vijim të kërkesave/ankesave të punonjësve.
IV	**Mbikëqyrje të orientuara**			
1.	**Monitorim lidhur me procesin e ristrukturimit të institucioneve të administratës shtetërore**			.
1.	Kryeministria	Po	✓	Raporti i mbikëqyrjes

2.	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	Po	✓	iniciuar në 2017 dhe ka përfunduar në 2018 (vetëm raport, jo vendim)
3.	Ministria e Mbrojtjes	Po	✓	
4.	Ministria e Brendshme	Po	✓	
5.	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Po	✓	
6.	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Po	✓	
7.	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Po	✓	
8.	Ministria e Drejtësisë	Po	✓	
9.	Ministria e Kulturës	Po	✓	
10.	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Po	✓	
11.	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Po	✓	
12.	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Po	✓	
	Shënim: Sqarojmë se mbikëqyrja për këto institucione ka filluar në fund të vitit 2017, pas zgjedhjeve të përgjithshme dhe janë mbartur për vitin 2018.			Raporti ka konkluduar në 2018, dhe ka iniciuar që në 2017.
2.	**Administrimi dhe analiza e të dhënave për të evidentuar situatën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për rikthimin e nëpunësve civilë në pozicionin e punës që është pjesë e shërbimit civil.** **Shënim**: Ky proces ka nisur me kërkesën e Kuvendit në rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit dhe është shtrirë me faza, për të gjithë periudhën që nga momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil (viti 2013) në të gjitha institucionet që janë pasqyruar në listën në vijim që do të bashkëlidhet me këtë tabelë. Gjatë këtij viti u administruan të dhënat bazë për të ngritur një *data base* për këto akte e cila nuk ekzistonte më parë në asnjë institucion.	**Shtuar**	✓	
V	**Raporti Vjetor i veprimtarisë së Komisionerit për vitin 2017.**	Po	✓	

Nr	Plani vjetor 2019	Objekti	Realizuar
I	**Mbikëqyrje/Inspektim i orientuar në mbledhjen e informacionit në lidhje me pranimin dhe zhvillimin e karrierës në shërbimin civil**	Procedurat e rekrutimit, lëvizjes paralel edhe ngritjes në detyrë në institucionet që punësojnë nëpunës civil, në administratën shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore.	- Të gjitha institucionet e përfshira në mbikëqyrje të përgjithshme *(Vendore dhe të pavarura)* në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes e kanë të trajtuar në një rubrikë më vete - Në lidhje me DAP është hartuar një raport i veçantë.

II	**Mbikëqyrje/inspektim i përgjithshëm**	**Plan fillestar**	**Përfunduar vendimi deri në fund të vitit 2019**	**Plan i rishikuar**
	Njësitë e qeverisjes vendore			
1.	Bashkia Elbasan dhe Njësitë Administrative përbërëse të saj	Po	Jo	Shtyrë për një kohë të mëvonshme
2.	Bashkia Shkodër dhe Njësitë Administrative përbërëse të saj	Po	Jo	Shtyrë për një kohë të mëvonshme
3.	Bashkia Kavajë dhe Njësitë Administrative përbërëse të saj	Po	Jo	Shtyrë për një kohë të mëvonshme
4.	Bashkia Berat dhe Njësitë Administrative përbërëse të saj	Po	Jo	Shtyrë për një kohë të mëvonshme
	Institucione të Administratës Shtetërore			
	Institucionet e varësisë Ministria e Financave dhe Ekonomisë			
1.	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara	Po	Po	2019
2.	Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO)	Po	Po	2019
3.	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimit	Po	Po	2019
4.	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit	Po	Po	2019
5.	Drejtoria e Përgjithshme e	Po	Po	2019

	Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE, Bankës Botërore dhe Donacioneve të tjera			
6.	Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave	Po	Po	2019
7.	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale	Po	Po	2019
8.	Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit	Po	Po	2019
9.	Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë	Po	Po	2019
10	Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit	Po	Jo	Përfunduar ne 2020
11.	Qendra e Trajnimit të Administratës Doganore dhe Tatimore	Po	Po	2019
12.	Qendra Kombëtare e Biznesit	Po	Po	2019
	Institucionet e varësisë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Po	Jo	Shtyrë për një kohë të mëvonshme, pasi ka qene në proces reformimi të institucioneve të varësisë
	Institucionet e varësisë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Po	Jo	Shtyrë për një kohë të mëvonshme, pasi ka qene në proces reformimi të institucioneve të varësisë
	Jashtë planit (shtuar)			
1.	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit *(AKU)*	Shtuar	JO	Ka filluar në 2019 dhe ka përfunduar në 2020
III	**Inspektime tematike**			
	Inspektimet tematike të kryera mbi bazën e denoncimeve dhe informacioneve të ardhura nga nëpunësit civil të përfshirë në procese të administrimit të shërbimit civil. **Shënim:** Ndjekja e informacioneve	Po	✓	15 vendime të KMSHC në vijim të kërkesave të punonjësve

	është një proces i planifikuar, ndërkohë që numri i këtyre inspektimeve është në varësi të denoncimeve dhe informacioneve që vijnë nga nëpunës civilë, të cilët denoncojnë probleme me zbatimin e ligjit pranë Komisionerit. Për këtë arsye, në lidhje me këtë veprimtari, gjatë vitit 2019 janë trajtuar rastet qe do te paraqiten në listën që do t`ju dërgohet me e - mail.			
IV	**Mbikëqyrje e orientuar**			
1.	**Monitorimi i administrimit të shërbimit civil gjatë zgjedhjeve të vitit 2019 për qeverisjen e administratës vendore, me fokus sjelljen e nëpunësit civil.** *Në përfundim të procesit është hartuar një raport monitorimi dërguar Kuvendit të Shqipërisë.* **Shënim:** Gjatë procesit të monitorimit të zgjedhjeve, nga ana e Komisionerit, është administruar informacion gjatë gjithë fushatës zgjedhore nga të gjitha institucionet e përfshira ne proces *(**208** institucione)*, për 30 ditë, të cilat kanë raportuar për çdo ditë pranë Komisionerit, prezencën ditore të nëpunësve civilë, si dhe probleme të tjera të evidentuara gjatë këtij procesi. *Bashkëlidhur me këtë tabelë është edhe lista e institucioneve të monitoruara nga anëtarët e grupit të monitorimit, pranë Komisionerit.*	Po	✓	Po, sipas raportit përkatës.
2.	**Administrimi dhe analiza e të dhënave për të kuptuar situatën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për rikthimin e nëpunësve civilë në**	Po	✓	Proces në vijim dhe në monitorim të vazhdueshëm i nisur në vitin 2018

	pozicionin e punës që është pjesë e shërbimit civil. **Shënim**: Ky proces është kërkuar nga Kuvendi dhe është në vijim nga viti 2018, i cili është zhvilluar në dinamikë edhe përgjatë vitit 2019 duke u fokusuar sidomos tek institucionet e administratës shtetërore të cilat kanë paraqitur problematikë më të theksuar; duke trajtuar rastet konkrete nëpërmjet seancave dëgjimore dhe duke administruar dokumentacionin ligjor për secilin rast. Institucionet e përfshira paraqiten në listën në vijim që do të bashkëlidhet me këtë tabelë. Gjatë këtij viti ka vijuar të përditësohet dhe të saktësohet *data base* e vendimeve gjyqësore për të gjitha institucionet e sistemit të shërbimit civil.			
3.	**Respektimi i institutit të lirimit nga shërbimi civil në rastin e plotësimit të moshës për pension të plotë pleqërie.** **Shënim:** Nëpërmjet e mailit do të dërgojmë listën e institucioneve të përfshira në këtë proces, i cili është finalizuar me vendime paralajmëruese për institucionet që kanë raportuar raste të tilla. Ky proces ka nisur me kërkesë të Kuvendit në detyrat e lëna me Rezolutën e vlerësimit të veprimtarisë..	Po	Po	65 vendime në përfundim të procesit
V	**Raporti i veprimtarisë vjetore të Komisionerit për vitin 2018**		✓	
			✓	

Nr	**Plani vjetor 2020**	**Objekti**	**Realizuar**
		Procedurat e rekrutimit,	- Të gjitha institucionet e përfshira në

I	**Mbikëqyrje/Inspektim i orientuar në mbledhjen e informacionit në lidhje me pranimin dhe zhvillimin e karrierës në shërbimin civil**	lëvizjes paralel edhe ngritjes në detyrë në institucionet që punësojnë nëpunës civil, në administratën shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore.	mbikëqyrje të përgjithshme *(Vendore dhe të pavarura)* në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes e kanë të trajtuar në një rubrikë më vete - Në lidhje me DAP është hartuar një raport i veçantë.

II	**Mbikëqyrje/inspektim të përgjithshëm**			
	Njësitë e qeverisjes vendore	**Plani fillestar**	**Përfunduar vendimi deri në fund të vitit 2020**	**Plani i rishikuar**
1.	Bashkia Kavajë dhe Njësitë Administrative përbërëse të saj	Po	Jo	Shtyrë për një periudhë të mëvonshme për shkak të pandemisë covid 19.
2.	Bashkia Pogradec dhe Njësitë Administrative përbërëse të saj	Po	Jo	Shtyrë për një periudhë të mëvonshme për shkak të pandemisë covid 19.
	Institucione të Pavarura			
1.	INSTAT	Po	Jo	Shtyrë për një periudhë të mëvonshme për shkak të pandemisë covid 19.
	Institucionet e varësisë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë			
1.	Qendra e Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme	Po	Jo	I papërfunduar deri në fund të 2020
2.	Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit	Po	Po	Përfunduar në 2020
3.	Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera	Po	Po	Përfunduar në 2020
	Institucionet e varësisë Ministria e Turizmit dhe	Po	Jo	Shtyrë për një periudhë të mëvonshme pasi

	Mjedisit			kanë qenë në një proces të thellë riformatimi.
	Institucionet e varësisë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale			
1.	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror	Po	✓	Përfunduar në 2020
2.	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës	Po	✓	Përfunduar në 2020
3.	Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim	Po	✓	Përfunduar në 2020
4.	Instituti Integrimit të të Përndjekurve Politikë	Po	✓	Përfunduar në 2020
5.	Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore	Po	✓	Përfunduar në 2020
			✓	
III	**Mbikëqyrje/inspektim tematik**			
1.	**Inspektimet tematike të kryera mbi bazën e denoncimeve dhe informacioneve të ardhura nga nëpunësit civil të përfshirë në procese të administrimit të shërbimit civil.** **Shënim:** Ndjekja e informacioneve është një proces i planifikuar, ndërkohë që numri i këtyre inspektimeve është në varësi të denoncimeve dhe informacioneve që vijnë nga nëpunës civilë, të cilët denoncojnë probleme me zbatimin e ligjit pranë Komisionerit. Për këtë arsye, në lidhje me këtë veprimtari, **gjatë vitit 2020** janë trajtuar rastet që do të paraqiten në listën që do t`ju dërgohet me e - mail.	Po	✓	73 vendime në përfundim të trajtimit të kërkesave të punonjësve.
2.	Bashkia Tropojë	Po	Jo	Shtyrë për një periudhë të mëvonshme për shkak të pandemisë covid 19.

3.	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	Shtuar	✓	Përfshirë në mbikqyrje duke vlerësuar risk për parregullsi ligjore gjatë ristrukturimit dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore
IV	**Mbikëqyrje e orientuar**			
1.	**Administrimi dhe analiza e të dhënave për të evidentuar situatën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për rikthimin e nëpunësve civilë gjyqfitues në pozicionin e punës që është pjesë e shërbimit civil.** **Shënim**: Kjo detyrë i është ngarkuar Komisionerit nga Kuvendi fillimisht në vitin 2018 e ka vazhduar edhe në Rezolutat pasardhëse. Ndjekja e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në fushën e shërbimit civil është zhvilluar në dinamikë edhe përgjatë vitit 2020 duke u fokusuar tek institucionet e administratës vendore *(bashkitë dhe këshillat e qarkut)*, pasi institucionet e administratës vendore janë trajtuar një vit më parë. Gjatë këtij procesi janë trajtuar rastet konkrete sidomos nëpërmjet komunikimit ñ*on line*ò për shkak të pandemisë covid 19, si dhe duke administruar dokumentacionin ligjor për secilin rast. Institucionet paraqiten në listën në vijim që do të bashkëlidhet me këtë tabelë. Gjatë këtij viti ka vijuar të përditësohet dhe të saktësohet *data base* e vendimeve gjyqësore për të gjithë sistemin e shërbimit civil.	Po	✓	

2.	**Respektimi i rregullave të vendosura nga instituti ligjor i lirimit nga shërbimi civil, në rastin e plotësimit të moshës për pension të plotë pleqërie.** **Shënim:** Nëpërmjet *e – mail- it*, do të dërgojmë listën e institucioneve të përfshira në këtë proces, i cili është finalizuar me vendime paralajmëruese për institucionet. Ky proces ka nisur me kërkesën e Kuvendit në Rezolutën e vlerësimit të veprimtarisë së Komisionerit.	po	✓	65 vendime për institucionet në të cilat janë identifikuar parregullsi për punonjësit që kanë mbushur moshën për pensionin e pleqërisë.
3.	**Për shkak të pamundësisë për të shkuar në subjekt si pasojë e pandemisë covid 19, Komisioneri ka përfshirë në mbikëqyrje orientuese, të gjitha institucionet e administratës vendore, *(61 bashkitë e vendit dhe 12 këshilla qarku).*** Ky proces është realizuar nëpërmjet kërkesave të dërguara nga Komisioneri dhe përgjigjeve të ardhura nga institucionet nëpërmjet postës zyrtare dhe asaj elektronike; nëpërmjet komunikimit *"on line"*, si dhe duke përdorur të gjitha mjetet e tjera të komunikimit. Në lidhje me këtë proces janë administruar të dhëna nga të gjitha institucionet me qëllim njohjen e situatës së administrimit të shërbimit civil, sidomos në drejtim të emërimeve në kundërshtim me ligjin, disiplinës në shërbimin civil; lirimin nga shërbimi civil; strukturimin e institucioneve etj., me qëllim evidentimin e parregullsive dhe më tej, përcaktimin e subjekteve	Shtuar	✓	Ky proces është shtuar në planin e punës duke vlerësuar faktin se administrata vendore paraqet probleme më të theksuara në fushën e administrimit të shërbimit civil.

	që duhet të përfshihen në mbikëqyrjen e vitit 2021, për rregullimin e situatës ligjore.			
IV	**Raporti vjetor i Komisionerit për vitin 2019**	Po	✓	

Aneksi nr.2- Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve sipas vendimeve të KMSHC
Proceset e **verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Komisionerit të kryera në vitin 2018**

Nr	Institucioni	Vendimi për zbatimin		Vendimi i inspektuar		Objekti i vendimit fillestar	Problematika
1	Bashkia Vlorë	6	20.02.2018	26	21.03.2016	Mbikqyrje e përgjithshme	Situata është përmirësuar
2	Agjencia Kombëtare e Bregdetit	23	13.04.2018	101	13.09.2016	Mbikqyrje e përgjithshme	Situata është përmirësuar
3	Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave (punonjës)	100, datë	20.12.2018	239	26.12.2017	Punonjës	Situata është përmirësuar
4	Punonjës			187	05.09.2017		
5	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë	56	04.06.2018	6	31.01.2017	Mbikqyrje e përgjithshme	Situata është përmirësuar
6	Bashkia Tiranë	66	21.06.2018	78	10.04.2017	Verifikimit të procedurës së plotësimit të pozicioneve të punës	Situata është përmirësuar
7	Këshilli i Qarkut Tiranë	99	03.12.2018	131	13.06.2017	Verifikimit të procedurës së plotësimit të pozicioneve të punës	Situata është përmirësuar
8	Punonjës						
9	Punonjës			131	13.06.2017		
10	Bashkia Poliçan	141	20.11.2019	223	06.11.2017		Situata është përmirësuar
11	Bashkia Skrapar	154	05.12.2019	190	20.09.2017		Problematika vijon
12	Bashkia Korçe	144	20.11.2019	217	25.10.2017		Situata është përmirësuar
13	Bashkia Maliq	126	11.11.2019	238	13.12.2017		Situata është përmirësuar
14	Bashkia Devoll	127 dhe 72,	11.11.2019 dhe 17.07.2020	237	06.12.2017		Situata është përmirësuar
15	Punonjës			2	06.02.2018		
16	Ish Drejtoritë e Bujqësisë	35	17.04.2018			Verifikimit të procedurës së plotësimit të pozicioneve të punës	
17	AUTORITETI I KONKURRENCËS			40	02.05.2018		
18	Punonjës			42	10.05.2018		

19	Punonjës			72	20.07.2018		
20	ISHMPU-Qendër			85	23.10.2018		
21	Punonjës	100	20.12.2018	71	06.07.2018		Situata është përmirësuar

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH sipas të dhënave të KMSHC

Proceset e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Komisionerit të kryera në vitin **2019**

Nr	Institucioni/Personi	Vendimi për zbatimin		Vendimi i inspektuar		Objekti i vendimit fillestar	Problematika
1	Bashkia Devoll	16	22.02.2019	237	06.12.2017	Mbikqyrje e përgjithshme	Situata është përmirësuar
2	Bashkia Maliq	17	22.02.2019	238	13.12.2017	Mbikqyrje e përgjithshme	Situata është përmirësuar
3	Bashkia Memaliaj	24	10.04.2019	24	13.04.2018	Mbikqyrje e përgjithshme	Situata është përmirësuar
5	Bashkia Patos	11	19.02.2019	39	27.04.2018	Mbikqyrje e përgjithshme	Situata është përmirësuar
6	Bashkia Dropull	12	21.02.2019	12	13.03.2018	Mbikqyrje e përgjithshme	Situata është përmirësuar
7	Bashkia Gjirokastër	13	21.02.2019	11	09.03.2018	Mbikqyrje e përgjithshme	Situata është përmirësuar
8	Bashkia Pustec	14	22.02.2019	54	30.05.2018	Mbikqyrje e përgjithshme	Situata është përmirësuar
9	Bashkia Ura Vajgurore	15	22.02.2019	16	23.03.2018	Mbikqyrje e përgjithshme	Situata është përmirësuar
10	Bashkia Cërrik	41	24.04.2019	90	13.11.2018	Mbikqyrje e përgjithshme	Situata është përmirësuar
11	Bashkia Mirditë	49	29.05.2019	89	13.11.2018	Mbikqyrje e përgjithshme	Situata është përmirësuar
12	Autoriteti i Aviacionit Civil	51	29.05.2019	38	27.04.2018	Mbikqyrje e përgjithshme	Situata është përmirësuar
13	Autoriteti i Konkurrencës	40	24.04.2019	78	17.09.2018	Mbikqyrje e përgjithshme	Situata është përmirësuar
14	KQZ	50	29.05.2019	79	21.09.2018	Mbikqyrje e përgjithshme	Situata është përmirësuar
15	Punonjës			73	20.07.2018		
16	Punonjës			75	01.08.2018		
17	Punonjës			83	15.10.2018		
18	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës	96	23.12.2019	81	25.09.2018	Mbikqyrje e përgjithshme	Situata është përmirësuar
19	Punonjës			5	16.01.2019		
20	Punonjës			2	15.01.2019		
21	Punonjës			44	07.05.2019		
22	Qendrën e Transferimit të Teknologjive Korçë	89	31.07.2019	45	09.05.2019	Mbikqyrje e përgjithshme	Situata është përmirësuar
23	Punonjës			86	17.07.2019		
24	Punonjës			85	17.07.2019		
25	Qendrën e Transferimit të Teknologjive Vlorë	94	16.10.2019	75	10.06.2019	Mbikqyrje e përgjithshme	Situata është përmirësuar
26	Punonjës			74	05.06.2019		
27	Punonjës			21	01.04.2019		
28	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale	197	23.12.2019	52	30.05.2019	Mbikqyrje e përgjithshme	Situata është përmirësuar
29	Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë	198	23.12.2019	72	31.05.2019	Mbikqyrje e përgjithshme	Situata është përmirësuar
30	Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve	199	23.12.2019	73	19.04.2019	Mbikqyrje e përgjithshme	Situata është përmirësuar

31	QKB	200	23.12.2019	80	02.07.2019	Mbikqyrje e përgjithshme	Situata është përmirësuar

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH sipas të dhënave të KMSHC

Proceset e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Komisionerit të kryera në vitin **2020**

Nr	Institucioni/Personi	Vendimi për zbatimin		Vendimi i inspektuar		Objekti i vendimit fillestar	Problematika
1	Instituti i Transportit	150	18.11.2020	92	14.11.2018	Mbikqyrje e përgjithshme	Situata është përmirësuar
2	Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë ï Krujë	151	18.11.2020	26	19.04.2019	Mbikqyrje e përgjithshme	Situata është përmirësuar
3	Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Shkodër	98	29.09.2020	42	26. 04.2019	Mbikqyrje e përgjithshme	Situata është përmirësuar
4	Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Lushnje	131	22.10.2020	43	03.05.2019	Mbikqyrje e përgjithshme	Situata është përmirësuar
5	Bashkia Ura Vajgurore	59	10.07.2020	59	31.05.2019	Hetim administrativ të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit	Situata është përmirësuar
6	Bashkia Poliçan	54	10.07.2020	63	31.05.2019	Hetim administrativ të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit	Situata është përmirësuar
7	Drejtoria e Përgjithshme të Standartizimit	106	01.10.2020	68	31.05.2019	Mbikqyrje e përgjithshme	Situata është përmirësuar
8	Drejtoria e Përgjithshme të Akreditimit	121	15.10.2020	69	31.05.2019	Mbikqyrje e përgjithshme	Situata është përmirësuar
9	Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, Bankës Botërore dhe Donatorëve të Tjerë	126	21.10.2020	71	31.05.2019	Mbikqyrje e përgjithshme	Situata është përmirësuar
10	Bashkia Pustec	93	21.09.2020	100	28.10.2019	Raste të emërimeve në kundërshtim me ligjin	Situata është përmirësuar
11	Bashkia Shijak	45	29.06.2020	104	30.10.2019	Raste të emërimeve në kundërshtim	Situata është përmirësuar

						me ligjin	
12	Bashkia Dropull	46	29.06.2020	115	05.11.2019	Raste të emërimeve në kundërshtim me ligjin	Situata është përmirësuar
13	Bashkia Konispol	53	10.07.2020	116	05.11.2019	Raste të emërimeve në kundërshtim me ligjin	Situata është përmirësuar
14	Bashkia Himarë	48	02.07.2020	120	07.11.2019	Raste të emërimeve në kundërshtim me ligjin	Situata është përmirësuar
15	Bashkia Vlorë	22	17.02.2020	125	08.11.2019	Raste të emërimeve në kundërshtim me ligjin	Situata është përmirësuar
	Bashkia Devoll	72	17.07.2020	127	11.11.2019	Raste të emërimeve në kundërshtim me ligjin	Situata është përmirësuar
16	Bashkia Cërrik	76	21.07.2020	128	11.11.2019	Raste të emërimeve në kundërshtim me ligjin	Situata është përmirësuar
17	Bashkia Mirditë	55	10.07.2020	140	20.11.2019	Raste të emërimeve në kundërshtim me ligjin	Situata është përmirësuar
18	Bashkia Bulqizë	47	30.06.2020	147	21.11.2019	Raste të emërimeve në kundërshtim me ligjin	Situata është përmirësuar
19	Bashkia Dibër	44	26.06.2020	148	22.11.2019	Raste të emërimeve në kundërshtim me ligjin	Situata është përmirësuar
20	Bashkia Klos	75	21.07.2020	150	03.12.2019	Raste të emërimeve në kundërshtim me ligjin	Situata është përmirësuar
21	Bashkia Tepelenë	51	03.07.2020	152	05.12.2019	Raste të emërimeve në kundërshtim me ligjin	Situata është përmirësuar
22	Bashkia Libohovë	49	02.07.2020	156	06.12.2019	Raste të emërimeve në kundërshtim	Situata është përmirësuar

						me ligjin	
23	Bashkia Roskovec	50	03.07.2020	203	26.12.2019	Raste të emërimeve në kundërshtim me ligjin	Situata është përmirësuar
24	Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave	104	01.10.2020	209	27.12.2019	Mbikqyrje e përgjithshme	Situata është përmirësuar
25	Bashkia Durrës	89	10.09.2020	218	27.12.2019	Hetim administrativ të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit	Situata është përmirësuar
26	Punonjës xx			221	27.12.2019		
27	Punonjës xx			11	10.02.2020		
28	Punonjës xx			16	12.02.2020		
29	Punonjës xx			32	07.05.2020		
30	Bashkia Belsh	99	29.09.2020	61	14.07.2020	Hetim administrativ të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit	Situata është përmirësuar
31	Bashkia Tropojë	102	01.10.2020	64	15.07.2020	Hetim administrativ të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit	Situata është përmirësuar
32	Bashkia Mirditë	206	28.12.2020	67	17.07.2020	Hetim administrativ të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit	Situata është përmirësuar
33	Bashkia Patos	108	02.10.2020	68	17.07.2020	Hetim administrativ të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit	Situata është përmirësuar
34	Bashkia Lushnjë	118	14.10.2020	69	17.07.2020	Hetim administrativ të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit	Situata është përmirësuar
35	Bashkia Shkodër	95	24.09.2020	70	17.07.2020	Hetim administrativ të nëpunësve që kanë	Situata është përmirësuar

						plotësuar moshën e pensionit	
36	Bashkia Vau i Dejës	109	02.10.2020	71	17.07.2020	Hetim administrativ të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit	Situata është përmirësuar
37	Prefektura e Qarkut Gjirokastër	111	09.10.2020	78	21.07.2020	Hetim administrativ të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit	Situata është përmirësuar
38	Bashkia Vorë	100	29.09.2020	80	21.07.2020	Hetim administrativ të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit	Situata është përmirësuar
39	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	193	15.12.2020	81	21.07.2020	Hetim administrativ të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit	Situata është përmirësuar
40	Bashkia Krujë	115	14.10.2020	103	01.10.2020	Hetim administrativ të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit	Situata është përmirësuar
41	QKB	132	22.10.2020	107	01.10.2020	Hetim administrativ të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit	Situata është përmirësuar
42	Agjencia e Prokurimit Publik	158	23.11.2020	112	09.10.2020	Hetim administrativ të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit	Situata është përmirësuar
43	Bashkia Devoll	159	23.11.2020	117	14.10.2020	Hetim administrativ të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit	Situata është përmirësuar
44	Punonjësi			119	14.10.2020		

45	Punonjësi			123	14.10.2020		
46	AZHBR	155	23.11.2020	127	22.10.2020	Hetim administrativ të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit	Situata është përmirësuar
47	Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës	157	23.11.2020	133	22.10.2020	Hetim administrativ të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit	Situata është përmirësuar
48	Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Tiranë	165	03.12.2020	134	02.11.2020	Hetim administrativ të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit	Situata është përmirësuar
49	Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Korçë	166	03.12.2020	135	02.11.2020	Hetim administrativ të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit	Situata është përmirësuar
50	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare	164	03.12.2020	136	02.11.2020	Hetim administrativ të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit	Situata është përmirësuar
51	Punonjës xx			148	16.11.2020		
52	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	200	24.12.2020	161	25.11.2020	Hetim administrativ të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit	Situata është përmirësuar
53	Bashkia Shijak	198	23.12.2020	171	09.12.2020	Hetim administrativ të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit	Situata është përmirësuar
54	Bashkia Maliq	205	28.12.2020	174	09.12.2020	Hetim administrativ të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit	Situata është përmirësuar
55	Bashkia Lushnjë	207	28.12.2020	182	15.12.2020	Hetim administrativ	Situata është përmirësuar

						të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit	
56	Bashkia Gjirokastër	211	28.12.2020	185	15.12.2020	Hetim administrativ të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit	Situata është përmirësuar
57	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	232	30.12.2020	190	15.12.2020	Hetim administrativ të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit	Situata është përmirësuar
58	Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Korçë	204	28.12.2020	191	15.12.2020	Hetim administrativ të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit	Situata është përmirësuar
59	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	231	30.12.2020	195	18.12.2020	Hetim administrativ të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit	Situata është përmirësuar
60	Bashkia Vau Dejës	234	30.12.2020	199	23.12.2020	Hetim administrativ të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit	Situata është përmirësuar

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH sipas të dhënave të KMSHC

Aneksi nr. 3 – pasqyrat financiare në KMSHC

Formati nr. 1

AKTIVI i BILANCIT KONTABEL 2017 *(ne leke)*

Nr.	Nr.llog.	EMERTIMI i LLOGARIVE TE AKTIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi i Paraardhës
1	**12**	**Rezultate te mbartura(saldo debitore)**		
2	**A**	**AKTIVE TE QENDRUESHME**	**16,938,776**	**19,390,824**
3	**20, 230**	**I.Te pa trupëzuara**	**0**	**0**
4	**21,23,24,28**	**II.Akt.Qendr.te Trupëzuara**	**16,938,776**	**19,390,824**
5	214	Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune	8,487,681	8,893,726
6	215	Mjete transporti	2,580,000	2,580,000
7	218	Inventar ekonomik	19,571,486	17,669,366

8	219	Amortizimi aktiv,Qendr,te trupëzuara(-)	-13,700,391	-17,683,197
9	**25,26**	**III.Aktive Financiare**	**0**	**0**
10	**B**	**AKTIVE QARKULLUESE**	**8,521,971**	**7,221,630**
11	**Klasa 3**	**I.Gjendja e Inventarit**	**3,534,087**	**3,938,882**
12	31	Materiale	2,625,521	3,089,867
13	32	Objekte inventari	908,566	849,015
14	**Klasa 4**	**II.Kerkesa arkëtimi mbi Debitorët**	**4,987,884**	**3,081,826**
15	4342	Te tjera operacione me shtetin(debitor)	4,944,261	3,038,203
16	468	Debitore te ndryshëm	43,623	43,623
17	**51**	**III.Llogarite financiare**	**0**	**200,922**
18	520	Disponibilitete ne thesar	0	200,922
19	**C**	**LLOGARI TE TJERA AKTIVE**	**0**	**0**
20	**85**	**REZULTATI i USHTRIMIT(saldo debitore)**		
21	**X**	**TOTALI i AKTIVIT**	**25,460,747**	**26,612,454**
22	80,81	**LLOGARITE JASHTE BILANCIT**	0	0
23	80,81	Evidenca aktive		

Formati nr, 2

PASIVI i BILANCIT KONTABEL 2017 *(ne leke)*

Nr,	Nr,llog,	EMERTIMI i LLOGARIVE TE PASIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi i Paraardhës
1	**A**	**FONDE TE VETA**	**20,472,863**	**23,329,706**
2	**10**	**I.Fonde te veta**	**20,472,863**	**23,329,706**
3	101	Fonde baze	**20,472,863**	**23,329,706**
4	**11**	**II.Fonde te tjera te veta**	**0**	**0**
5	**12**	**III.Rezultati i mbartur**		
6	**13**	**IV.Subvecione te jashtëzakonshme(-)**		
7	**14**	**V. Pjesëmarrje te instit,ne invest,per te trete**		
8	**15**	**VI.Shuma parashikuara për rreziqe e shpenz,**		
9	**B**	**D E T Y R i M E**	**4,987,884**	**3,282,748**
10	**16,17,18**	**I.Borxhe afatgjate**	**0**	**0**
11	**Klasa 4**	**II.Detyrime afatshkurter**	**4,987,884**	**3,282,748**
12	42	Personeli e llogari te lidhura me to	2,168,978	1,972,354
13	431	Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa	243,750	211,183
14	4341	Te tjera operacione me shtetin(kreditor)	43,623	43,623
15	435	Sigurime shoqërore	739,699	662,609
16	436	Sigurime shëndetësorë	95,235	86,128
17	**C**	**LLOGARI TE TJERA**	**0**	**0**
18	**85**	**REZULTATI i USHTRIMIT(Saldo kreditore)**		
19	**X**	**T O T A L i i P A S i V i T**	**0**	**0**

20	80,81	**LLOGARITE JASHTE BILANCIT**	0	0
21	80,81	Evidenca pasive		

	Kontroll	**Pasiv = Aktiv**	**0**	**0**

NJËSIA PUBLIKE **Komisioneri i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil**

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR VITI 2018

NË / LEKË

Nr, Rreshti	Referenca e Llogarive	E M Ë R T i M i	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
1	**A**	**A K T i V E T**	**24,845,137**	**25,460,743**
2		**I.Aktivet Afat shkurtra**	**6,963,394**	**8,521,971**
3		**1,Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre**	**0**	**0**
4		**2.Gjendje Inventari qarkullues**	**3,671,975**	**3,534,087**
5	31	Materiale	2,763,809	2,625,521
6	32	Inventar i imët	908,166	908,566
7		**3,Llogari te Arketueshme**	**3,291,419**	**4,987,884**
8	468	Debitore te ndryshem	43,623	43,623
9	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	3,247,796	4,944,261
10		**4,Te tjera aktive afatshkurtra**	**0**	**0**
11		**II,Aktivet Afat gjata**	**17,881,743**	**16,938,772**
12		**1,Aktive Afatgjata jo materiale**	**0**	**0**
13		**2,Aktive Afatgjata materiale**	**17,881,743**	**16,938,772**
14	214	Iinstalime teknike, makineri e pajisje	868,578	1,234,018
15	215	Mjete Transporti	1,020,065	1,073,753
16	218	Inventar ekonomik	15,993,100	14,631,001
17		**3,Aktive Afatgjata Financiare**	**0**	**0**
18		**4,Investime**	**0**	**0**
19	**B**	**PASIVET**	**3,291,419**	**4,987,884**
20		**I,Pasivet Afat shkurtra**	**3,291,419**	**4,987,884**
21		**1, Llogari te Pagueshme**	**3,291,419**	**4,987,884**
22	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to		
23	42	Detyrime ndaj personelit	2,178,042	4,168,978
24	431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	240,801	243,750
25	435	Sigurime Shoqërore	733,623	739,699
26	436	Sigurime Shëndetësorë	95,330	95,235
27	467	Kreditore te ndryshem	0	1,696,599
28	4341	Operacione me shtetin(detyrime	43,623	43,623
29		**2,Te tjera pasive afatshkurtra**	0	0
30		**II,Pasivet Afatgjata**	0	0
31	**C**	**AKTIVET NETO/ FONDET NETO (A-B)**	**21,553,718**	**20,472,859**
32		**FONDET NETO PERBEHEN NGA :**	**21,553,718**	**20,472,859**
33	101	Teprica(Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	21,415,830	20,877,654
34	85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	137,888	-404,795
35		**TOTALI i PASIVEVE (B+C)**	**24,845,137**	**25,460,743**

KONTROLLE	Shifra 0 (zero)- tregon Kuadraturën	Kuadratura	Kuadratura
Kontrolli 1	Aktivet Neto a janë të barabarta me Fondin e Konsoliduar	0	0
Kontrolli 2	Totali i Aktiveve a është i barabartë me = Totalin e Pasiveve	0	0

NJËSIA PUBLIKE **Komisioneri i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil**

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR VITI 2019

NË / LEKË

Nr. Rreshti	Referenca e Llogarive	E M Ë R T i M i	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
1	**A**	**A K T i V E T**	**87,074,593**	**24,845,138**
2		**I,Aktivet Afat shkurtra**	**6,821,128**	**6,963,395**
3		**1,Mjete monetare dhe ekujvalent te tyre**	**0**	**0**
4		**2,Gjendje Inventari qarkullues**	**3,541,967**	**3,671,976**
5	31	Materiale	2,633,801	2,763,809
6	32	Inventar i imet	908,166	908,167
7		**3.Llogari te Arketueshme**	**3,279,161**	**3,291,419**
8	468	Debitore te ndryshem	43,623	43,623
9	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	3,235,538	3,247,796
10		**4.Te tjera aktive afatshkurtra**	**0**	**0**
11		**II.Aktivet Afat gjata**	**80,253,465**	**17,881,743**
12		**1.Aktive Afatgjata jo materiale**	**0**	**0**
13		**2.Aktive Afatgjata materiale**	**80,253,465**	**17,881,743**
14	212	Ndertesa e Konstruksione	65,185,919	
15	214	Iinstalime teknike, makineri e paisje	1,594,862	868,578
16	215	Mjete Transporti	816,052	1,020,065
17	218	Inventar ekonomik	12,656,632	15,993,100
18		**3.Aktive Afatgjata Financiare**	**0**	**0**
19		**4.Investime**	**0**	**0**
20	**B**	**PASIVET**	**3,279,161**	**3,291,419**
21		**I.Pasivet Afat shkurtra**	**3,279,161**	**3,291,419**
22		**1. Llogari te Pagueshme**	**3,279,161**	**3,291,419**
23	42	Detyrime ndaj personelit	2,161,748	2,178,042
24	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	236,761	240,801
25	435	Sigurime Shoqerore	742,307	733,623
26	436	Sigurime Shendetsore	94,722	95,330
27	4341	Operacione me shtetin(detyrime	43,623	43,623
28		**2.Te tjera pasive afatshkurtra**	0	0
29		**II.Pasivet Afatgjata**	0	0
30	**C**	**AKTIVET NETO/ FONDET NETO (A-B)**	**83,795,432**	**21,553,718**
31		**FONDET NETO PERBEHEN NGA :**	**83,795,432**	**21,553,718**
32	101	Teprica(Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	83,925,441	21,415,830
33	12	Rezultatet e mbartura		
34	85	Rezultati i Veprimtarise Ushtrimore	-130,009	137,888
35		**TOTALI i PASIVEVE (B+C)**	**87,074,593**	**24,845,137**

KONTROLLE	Shifra 0 (zero)- tregon Kuadraturën	Kuadratura	Kuadratura
Kontrolli 1	Aktivet Neto a janë të barabarta me Fondin e Konsoliduar	0	0
Kontrolli 2	Totali i Aktiveve a është i barabartë me = Totalin e Pasiveve	0	0

NJESIA PUBLIKE	Komisioneri I Mbikqyrjes se Sherbimit Civil	Formati nr.1

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR **VITI 2020**

NE / LEKE

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	E M E R T I M I	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
1	**A**	**A K T I V E T**	**80.337.287**	**87.074.593**
2		**I.Aktivet Afat shkurtra**	**6.770.119**	**6.821.128**
3		**1.Mjete monetare dhe ekujvalent te tyre**	**0**	**0**
4		**2.Gjendje Inventari qarkullues**	**3.206.853**	**3.541.967**
5	31	Materiale	2.453.307	2.633.801
6	32	Inventar I imet	753.546	908.166
7		**3.Llogari te Arketushme**	**3.563.266**	**3.279.161**
8	468	Debitore te ndryshem	43.623	43.623
9	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	3.519.643	3.235.538
10		**4.Te tjera aktive afatshkurtra**	**0**	**0**
11		**II.Aktivet Afat gjata**	**73.567.168**	**80.253.465**
12	**20**	**1.Aktive Afatgjata jo materiale**	**0**	**0**
13	**21**	**2.Aktive Afatgjata materiale**	**73.567.168**	**80.253.465**
14	212	Ndertesa e Konstruksione	61.926.623	65.185.919
15	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	0	0
16	214	Iinstalime teknike, makineri e paisje	1.253.265	1.594.862
17	215	Mjete Transporti	652.842	816.052
18	216	Rezerva Shteterore	0	0
19	217	Kafshe pune e prodhimi	0	0
20	218	Inventar ekonomik	9.734.437	12.656.632
21	25-26	**3.Aktive Afatgjata Financiare**	**0**	
22		**4.Investime**	**0**	**0**
23	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		
24	231	Per Aktive Afatgjata materiale		0
25	**B**	**PASIVET(DETYRIMET)**	**3.563.266**	**3.279.161**
26		**I.Pasivet Afat shkurtra**	**3.563.266**	**3.279.161**
27		**1. Llogari te Pagushme**	**3.563.266**	**3.279.161**
28	42	Detyrime ndaj personelit	2.350.024	2.161.748
29	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	258.092	236.761
30	435	Sigurime Shoqerore	808.524	742.307
31	436	Sigurime Shendetsore	103.003	94.722
32	4341	Operacione me shtetin(detyrime	43.623	43.623
33		**2.Te tjera pasive afatshkurtra**	**0**	**0**
34		**II.Pasivet Afat Gjata**	**0**	**0**
35	**C**	**AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)**	**76.774.021**	**83.795.432**
36	**D**	**FONDI I KONSOLIDUAR :**	**76.774.021**	**83.795.432**
37	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	77.109.135	83.925.441
38	12	Rezultatet e mbartura		
39	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	-335.114	-130.009
40		Te Tjera	0	0
41	**E**	**TOTALI I PASIVEVE(B+C)**	**80.337.287**	**87.074.593**

K O N T R O L E	Shifra 0(Zero)- Tregon Kuadraturen	Kuadratura	Kuadratura
Kontroll 1.	Aktivet Neto a jane te barabarta me Fondin e Konsoliduar	**0**	**0**
Kontroll 2.	Totali I Aktiveve a eshte i barabarte me = Totalin e Pasiveve	**0**	**0**

Aneksi nr. 4 Lista e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia	Viti	Cmimi	Vlera	Amortizimi i akumuluar	Vlera e mbetur	Vlerësimi tekniko ekonomik
1,	Mbajtëse Disketa	Cope	1	-	2500	2500	-	-	E thyer, e dëmtuar, nuk riparohet dhe nuk nevojitet,
2,	Neona 18Ë	Cope	1	-	150	150	-	-	I thyer, i panevojshëm në ambjentet e reja
3,	Mbajtëse dokumentash horizontale me sirtar	Cope	3	-	3500	10500	-	-	Të thyer, të dëmtuar, nuk riparohen
4,	Tavull duhani Inox	Cope	1	-	660	660	-	-	Nuk nevojitet, ndalohet duhani,
5,	Mbajtëse dokumentash me sirtar	Cope	1	-	5000	5000	-	-	E thyer, e dëmtuar, nuk riparohet,
6,	Tabelë emërtuese KSHC-së 70x50	Cope	2	-	9000	18000	-	-	Krisur xhami, të panevojshme për institucionin e ri- me logo të ish Institucionit,
7,	Flamur me logo ish institucioni	Cope	1	-	2500	2500	-	-	Të panevojshme për institucionin e ri, me logo të ish Institucionit,
8,	Tabelë institucioni	Cope	1	-	7000	7000	-	-	Edëmtuar, dalë boja dhe shkruajtur me gabime,

9,	Flamur 100x140 cm LOGO (ish)	Cope	1	-	6000	6000	-	-	E panevojshme për institucionin e ri,
10	Disketa	Copë	17	-	50	850	-	-	Nuk happen, të papërdorshme me sistemet e reja IT,
11	Stricë makine	Cope	8	-	40	320	-	-	Nuk kanë më përdorim, të panevojshme, thithur lagështirë,
12	Bojë Fax-i Brother	Cope	5	-	2400	12000	-	-	Nuk kanë përdorim, të skaduara dhe të panevojshme,
13	Bojë printeri Brother	Cope	5	-	8000	40000	-	-	Nuk kanë përdorim, të skaduara dhe të panevojshme,
14	Bojë printeri Cerox lazer	Cope	2	-	15000	30000	-	-	Të skaduara, thithur lagështirë dhe të panevojshme,
15	Toner Xerox 3117/3121/3124	Cope	2	-	8400	16800	-	-	Të skaduara dhe të panevojshme, nuk kemi pajisje në punë të tillë,
16	Toner Fax Brother 1360/1460	Cope	8	-	1200	9600	-	-	Nuk kanë përdorim, të skaduara dhe të panevojshme,
17	Toner printeri Cerox 3124	Cope	3	-	6318	18954	-	-	Nuk kanë përdorim, të skaduara dhe të dëmtuara nga lagështira, Të panevojshme,

18	Perde grilë vertikale	Cope	10	-	2160	21600	-	-	Të dëmtuara, pa funksion në ambjentet e reja,
19	Grila vertikale	Cope	25	-	1896	47400	-	-	Të dëmtuara, të papërdorshme pasi nuk ka vetrata në hapësirat e tanishme,
20	Ndricues 1x32 Ë	Cope	3	-	2800	8400	-	-	Të prishura dhe pa funksion,
21	Abazhur Peshore	Cope	6	16,09,2002	15000	90000	37697	52303	Ndricim i papërshtatshëm në ambjentet e sotme,
22	Neona Tavani	Cope	2	13,12,2002	6500	13000	5868	7132	Të dëmtuara nga vitet e përdorimit, të papërdorshme,
23	Platfonier Dru i Vogël	Cope	6	16,09,2002	3500	21000	8796	12204	Të dëmtuara, nuk mund të riparohen, të spanuara tek pjesa e montimit, të panevojshme,
24	Platfoniere neoni 60x60 (SALLA)	Cope	1	30,09,2004	4800	4800	1908	2892	Të dëmtuara nga vitet e përdorimit, të papërdorshme,
25	Platfonier Dru i madh	Cope	2	16,09,2002	5000	10000	3593	6407	Të dëmtuara, nuk mund të riparohen, të spanuara tek pjesa e montimit, të panevojshme,
26	Ndricues Neoni (SALLA)	Cope	2	30,09,2004	1200	2400	954	1446	Të thyer dhe të djegur,

27	Grila Vertikale	m^2	30,4	11,09,2002	2160	64886,4	21907	42980	Të grisura, të prishura, nuk riparohen,
28	Poltron Titullari	Cope	6	21,11,2008	30000	180000	49200	130800	Të rrjepura, të grisura, të dëmtuara tëk ndenjësja dhe boshti mbajtës, nuk riparohen
29	Poltrone rrotullues me lëkurë	Cope	4	15,05,2001	27600	110400	54511	55889	Të rrjepura, të grisura, të dëmtuara tëk ndenjësja dhe boshti mbajtës, nuk riparohen
30	Poltron rrotullues i thjeshtë	Cope	1	12,07,2005	18600	18600	6956	11644	E thyer, e dëmtuar në krahët, e grisur, e shtrembëruar ndenjësja dhe boshti mbajtës nuk riparohet,
31	Kondicioner Fuego 12 HP	Cope	1	22,12,2008	36000	36000	20926,4	15073,6	Djegur motori, nuk ndizet, kosto e riparimit më e lartë se cmimi fillestar,
32	Kondicioner	Copë	1	08,07,2005	75000	75000	57741,7	17258,3	Djegur motori, nuk ndizet, kosto e riparimit më e lartë se cmimi fillestar,
33	Printer me ngjyra	Cope	4	03,12,2008	27500	110000	101895,55	8104,45	Të dëmtuar fizikisht dhe me probleme të rënda në board,
34	Printera HL 1230	Cope	4	20,09,2002	58700	234800	228581,32	6218,68	Të djegur, të prishur dhe nuk përshtaten me sistemin IT sot,

35	Printer Xerox Lazer 3124	Kopje	6	24,07,2007	19531	117186	111297,17	5888,83	Të degur, të prishur, të vjetër dhe nuk përshtaten më me sistemin IT sot,
36	Lazer Printer Xerox Docuprint P8ex	Kopje	1	21,12,2000	68250	68250	66628,58	1621,42	Të djegur, të dëmtuar fizikisht, të vjetër dhe nuk përshtaten me sistemin IT sot,
37	Power Tree UPS650VA, seria PTG2011E038630	Kopje	1	28,09,2011	4150,8	4150,8	3459,2	691,60	I djegur, i pariparueshëm,
38	Power Tree UPS650VA, seria PTG2011E038629	Kopje	1	22,09,2011	4150,8	4150,8	3462,36	688,44	I djegur, i pariparueshëm,
39	Power Tree UPS650VA, seria PTG2011E038478	Kopje	1	22,09,2011	4150,8	4150,8	3462,36	688,44	I djegur, i pariparueshëm,
40	Power Tree UPS650VA, seria PTG2011E038480	Kopje	1	23,09,2011	4150,8	4150,8	3461,73	689,07	I djegur, i pariparueshëm,
41	Power Tree UPS650VA, seria PTG2011A007912	Kopje	1	22,09,2011	4150,8	4150,8	3462,36	688,44	I djegur, i pariparueshëm,
42	Power Tree UPS650VA, seria PTG2011E038614	Kopje	1	04,09,2012	4150,8	4150,8	3412,06	738,74	I dëmtuar fizikisht dhe i pariparueshëm,
43	Power Tree UPS650VA, seria PTG2011E038479	Kopje	1	23,09,2011	4150,8	4150,8	3461,73	689,07	I djegur, i pariparueshëm,
44	UPS BK650MI	Kopë	2	21,11,2002	16900	33800	33561,43	238,57	Elemente të djegura në qark, të pariparueshëm,
45	UPS 650VA S650BX	Kopje	4	24,07,2007	3803	15212	13878,98	1333,02	Elemente të djegur në qark, të pariparueshëm, Të

									dëmtuar fizikisht,
46	UPS Power tree S650 BX	Cope	2	24,07,2007	3216	6432	6108,95	323,05	Elemente të djegur në qark, të paripareuesh ëm,
47	UPS BK650EI	Cope	3	13,06,2005	14000	42000	40468,6	1531,4	Të djegur, të prishur, të vjetër dhe të papërshtatshëm me sistemet e reja,
48	Kompjuter Dell Optiplex 320N	Cope	1	24,07,2007	73602	73602	69906,30	3695,7	Nuk ndizen boardi i djegur, Procesor i dëmtuar dhe model i vjetër,
49	Kompjuter Gx170PC	Cope	3	13,06,2005	126500	379500	369123,46	10376,5	Model i vjetër, fizikisht i dëmtuar dhe me board të djegur,
	TOTALI							**400234**	

V. SQARIM RRETH LLOJEVE TË NDRYSHME TË OPINIONEVE TË APLIKUARA NGA KLSH

<u>Në Auditimin e Përputhshmërisë:</u>[36]

a. Opinion i pamodifikuar:

- Audituesi duhet të shprehë një opinion të pamodifikuar në ato raste kur ka marrë siguri të arsyeshme, si dhe nuk ka konstatuar (për çështjet e audituara) aspekte materiale të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara.
- Audituesi duhet të shprehë një opinion të pamodifikuar në ato raste kur ka marrë siguri të kufizuar, si dhe në bazë të punës së kryer, *asgjë nuk ka tërhequr vëmendjen që çështja e audituar nuk është në përputhje në aspektin material me kriteret e aplikuara*.

b. Opinion i modifikuar.

Jepet në ato raste kur audituesi ka marrë siguri të arsyeshme, si dhe ka konstatuar gabime materiale, ose kur audituesi ka marrë siguri të kufizuar, pasi në bazë të punës së kryer nuk ka siguruar evidencë e mjaftueshme për të mbështetur dhënien e opinionit, por që në gjykimin profesional të audituesit mund të kenë mospërputhshmëri të aspektit material.

Opinion i kualifikuar/i cilësuar, jepet në ato raste kur është marrë siguri e arsyeshme, është siguruar një evidencë e majftueshme dhe e plotë, por janë evidentuar raste të

[36] - Rregullorja e Procedurave te Auditimit të KLSh, miratuar me Vendimin e Kryetarit nr.63, datë 22.6.2020, neni 4, piaka 2, faqe 16

mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara, të cilat janë *materiale, por jo të përhapura*, ose kur audituesi nuk është në gjendje të mbledhë prova të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, dhe efektet e mundshme janë materiale, por jo të përhapura.

c. Opinion i kundërt.

Jepet në ato raste kur është marrë siguri e arsyeshme, është siguruar një evidencë e mjaftueshme dhe e përshtatshme/ e plotë, por *devijimet e pajtueshmërisë janë materiale dhe të përhapura*.

d. Refuzim i opinionit.

Refuzimi i opinionit do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur që të mbërrijë në një opinion për sa i përket pasqyrave financiare të marra në tërësi, si pasojë e pasigurisë apo e kufizimit të fushëveprimit aq shumë thelbësor, në mënyrë që një opinion me rezerve në disa aspekte të caktuara të mos jetë i përshtatshëm. Formulimi i refuzimit të opinionit qartëson faktin se është e pamundur të jepet një opinion duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha rastet e paqartësisë. Refuzimi i opinioni, është një mohim i përgjegjësisë, pasi *audituesi nuk është në gjendje të marrë prova të mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimi* për të siguruar një bazë për dhënien e opinionit, *për t'u shprehur në lidhje me pajtueshmërinë me kriteret e aplikuara, si dhe për të gjykuar nëse efektet e mundshme mund të janë materiale dhe të përhapura.*

VI. QASJA DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 1,5% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për tê audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka ulur gamën e gabimeve për tu konsideruar, duke marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 1,5%, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është konkluduar që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti dhe verifikimin e tyre me evidencat periodike me Degën e Thesarit, si dhe dokumentacionin shoqërues (praktikën e urdhër shpenzimit). Konkretisht, mbi transaksionet u aplikuan:

-teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (trajtuar gjerësisht ne pikën e programit mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin); dhe

-teste të detajeve.

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

-Risku i lidhur me shpenzimin specifik, nga ku nën gjykimin profesional të audituesit niveli i riskut për shpenzime që lidhen me llogarinë 602 dhe me llogarinë 231 u vlerësuan me 2; dhe

-Pesha specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Mbi këta zëra shpenzimesh, si më poshtë, për shkak të volumit të ulët të aktivitetit të këtij institucioni u audituan 100% shpenzimet e kryera në llogaritë e pagave, sigurimeve, mallrave e shërbimeve dhe investimeve:

Pasqyrat Financiare (2017)	Shuma	Risk Factor
Paga (600)	32,982,731	0,70
Sigurime Shoqërore dhe shëndetësorë(601)	5,269,989	0,70
Mallra e Shërbime (602)	12,608,893	2,00
Shpenzime kapitale të trupëz. (231)	-	2,00
Total	**50,861,613**	
Materialiteti në përqindje	1,5%	
Materialiteti në vlerë (leke)	**762,924.2**	

Pasqyrat Financiare (2018)	Shuma	Risk Factor

Paga (600)	34,135,190	0,70
Sigurime Shoqërore dhe shëndetësorë(601)	5,420,195	0,70
Mallra e Shërbime (602)	10,081,717	2,00
Shpenzime kapitale të trupëz. (231)	-	2,00
Total	**49,637,102**	
Materialiteti në përqindje	1,5%	
Materialiteti në vlerë (leke)	**744,556.5**	

Pasqyrat Financiare (2019)	**Shuma**	**Risk Factor**
Paga (600)	34,135,190	0,70
Sigurime Shoqërore dhe shëndetësore(601)	5,420,195	0,70
Mallra e Shërbime (602)	10,081,717	2,00
Shpenzime kapitale të trupëz. (231)	-	2,00
Total	**49,637,102**	
Materialiteti në përqindje	1,5%	
Materialiteti në vlerë (leke)	**744,556.53**	

Pasqyrat Financiare (2020)	**Shuma**	**Risk Factor**
Paga (600)	35,078,632	0,70
Sigurime Shoqërore dhe shëndetësore(601)	5,713,216	0,70
Mallra e Shërbime (602)	13,583,720	2,00
Shpenzime kapitale të trupëz. (231)	-	2,00
Total	**54,375,568**	
Materialiteti në përqindje	1,5%	
Materialiteti në vlerë (leke)	**815,633.52**	

Sa i takon auditimit të prokurimeve nën gjykimin profesional të audituesit, përzgjedhja e prokurimeve u krye ***së pari*** nisur nga rëndësia që kanë procedurat e përzgjedhura ndaj realizimit të objektivave kryesorë të KMSHC-së siç është: kërkesa për propozim; procesi i blerjes së mobiljeve për zyra; dhe **së dyti** për nga pesha specifike e secilës prej tyre ndaj vlerës totale vjetore të prokurimeve të realizuara: Grupi i auditimit ka përzgjedhur për të verifikuar procedurat e zhvilluara për vitet 2017-2018, pasi për periudhën 2019-2020 ishin kryer gjithsej 7 procedura me vlerë të vogël dhe 2 me sistem dinamik; ndërsa për periudhën e audituar të vitit 2021 nuk kishte procedura objekt auditimi. Konkretisht:

	Nr. i procedurave te realizuara	**Vlera pa TVSH**	**Nr. i procedurave të audituara**	**Vlera pa TVSH**	**Mbulimi ne %**
Viti 2017	2	3,253,889	2	3,253,889	100%
Viti 2018	2	3,319,930	2	3,319,930	100%
Viti 2019	0	-	-	-	-
Viti 2020	0	-	-	-	-

Viti 2017

Objekti i prokurimit	**Vlera e Prokuruar (pa tvsh)**	**Vlera e kontratës (me tvsh)**	**Koha e zhvillimit të tenderit**	**Procedura e prokurimit**	**Firma Fituese**
1.Blerje mobiljesh dhe orendi zyre	2,322,222	2,688,000	08/05/2017	Kërkesë për Propozim	ôôTop Lineôô sh.p.k
2. Blerje pajisje elektronike	931,667	877,320	25/05/2017	Kërkesë për Propozim	ôôPC Storeôô sh.p.k

Viti 2018

Objekti i prokurimit	Vlera e Prokuruar (pa tvsh)	Vlera e kontratës (me tvsh)	Koha e zhvillimit të tenderit	Procedura e prokurimit	Firma Fituese
1. Blerje pajisje elektronike	1,246,663	1.291.620	09/05/2018	Kërkesë për Propozim	"Sinteza Co" sh.p.
2.Blerje mobiljesh dhe orendi zyre	2,073,267	2.374.560	17/04/2018	Kërkesë për Propozim	"Top Line" sh.p.k

Në zbatim të Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë i cili përcakton se pavarësisht se materialiteti është konsideruar shpesh në aspektin e vlerës, ai ka gjithashtu edhe aspekte të tjera sasiore dhe cilësore, karakteristikat e të cilave mund të jenë një çështje materiale për vetë natyrën e tyre. Një çështje mund të jetë materiale për shkak të kontekstit në të cilin ndodhet dhe për të vlerësuar materialitetin e dobësive të konstatuara të sistemeve në raste të tjera (p.sh. pa teste të mjaftueshme të kontrolleve dhe/ose testeve të detajeve), duhet të merren parasysh si në aspektin e tij sasior ashtu edhe në aspektin cilësor. Në rastet kur nuk mund të vendoset një prag materialiteti sepse mospërputhja nuk mund gjithmonë të kuantifikohet me shuma ose vlera monetare, mund të jetë më e përshtatshme për auditimin vendosja si prag të një norme të tolerueshme të mospërputhjes në tërësi apo edhe në fusha specifike. Për këtë, gjatë fazës së planifikimit të auditimit u vlerësuan për tu marrë nën shqyrtim aspekte të veprimtarisë së këtij institucioni, mos përputhja e të cilave edhe pse nuk lidhet me aspekte sasiore si vlerën, sasinë ose madhësinë, nxjerrin në pah problematika të rëndësishme të aktivitetit të institucionit dhe vlerësohen si me risk. Më hollësisht, aspekte të anomalive me karakter cilësor do të merren në konsideratë për vlerësimin e materialitetit në lidhje me nivelin e dobësitë e sistemeve të mbikëqyrjes dhe kontrollit të brendshëm apo faktorëve shtesë. Faktorët që duhet të merren parasysh, edhe sipas ISSAI - 4000 ï Standartet e Auditimit të Përputhshmërisë në hartimin e këtij gjykimi janë kërkesa të mandatit të Institucionit Suprem, çështje me interes të lartë publik, fusha të veçanta të fokusit, kërkesa të legjislativit, çështje të tilla si mashtrimi etj.

Konkretisht, në zbatim të akteve ligjore dhe rregullatorë sipas së cilave funksionon institucioni, nën gjykimin profesional të audituesve u përzgjodhën për ekzaminim disa prej produkteve që realizon institucioni ku përmendim:

- Mbikëqyrje/inspektim tematik;
- Mbikëqyrje/inspektim i përgjithshëm;
- Mbikëqyrje/inspektim i orientuar/përgatitor;
- Mbikëqyrje/inspektim në vazhdim;
- Raporti Vjetor i veprimtarisë së Komisionerit;
- Etj.

Për sa më sipër, gjykohet se do të tolerohen devijime që lidhen me mos përputhje për disa përcaktime jo thelbësore të Rregullores së Brendshme ñPër organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civilò, apo Rregullores óMbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimitô, por do të konsiderohen si mospërputhje apo devijime materiale mangësi të konsiderueshme me rregulloret e sipërcituara; mungesë të gjurmëve apo procesit të ndjekur; apo çështje të ndjeshme dhe me interes të lartë nga Parlamenti, publiku, mediat.